

Sovraniteti në Bashkimin Evropian: nga absolutizmi drejt relativizimit të tij.

Merisë Rukaj

Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Juridike), me profil (E Drejta Publike), për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Skender Kaçupi

Numri i fjalëve: 57,191

Tiranë, Shkurt, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë komisioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo në pjesë të veçanta. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

© Merisë Rukaj

ABSTRAKTI

Qasja e Jean Bodin ndaj konceptit të sovranitetit e teorizoi këtë të fundit si një pushtet absolut që i përket shtetit dhe pushtetit mbretëror. Sot, kuptimi i sovranitetit ka ndryshuar duke qënë se shteti është i detyruar të jetë pjesë e një bote të copëtuar, e globalizimit, e vështirësive ekonomike, etj.

Bashkimi Evropian është një eksperimentim i vërtetë i sovranitetit të ndarë. BE-ja provokon një ndarje të kompetencave mes Shteteve anëtare dhe kësaj organizate, që me kalimin e kohës është bërë e rëndësishme, duke shkuar deri aty sa të prekë kompetencat sovrane të shteteve.

Procesi komunitar modifikon konceptin e sovranitetit duke i dhënë atij një kuptim relativ, krejtësisht të ndryshëm nga përkufizimi tradicional. Në këtë pikë, duket se sovraniteti dhe absolutizmi nuk mund të qëndrojnë më bashkë meqënëse relativiteti i sovranitetit shfaqet në të gjitha dimensionet e tij, fakt ky i cili të shtyn të kërkojë një tjetër përkufizim mbi konceptin e sovranitetit. Duke u nisur nga kjo hipotezë shtrohen edhe pyetjet: A vazhdon të ruhet ideja e doktrinës fillestare që sovraniteti nuk mund të jetë asgjë tjetër veçse absolut? A është bashkëkohor koncepti i sovranitetit shtetëror? Çfarë kuptimi ka sot sovraniteti dhe a çenohet ai kur ballafaqohet me realitetin ndërkombëtar? A hedh Bashkimi Evropian dyshime mbi dobinë e konceptit të sovranitetit? Sa sovrane janë Shtetet anëtare të BE-së dhe çfarë pjesë të sovranitetit të tyre kanë humbur me aderimin e tyre në BE? Kush është sovrani kryesor në BE: Bashkimi Evropian apo Shtetet anëtare? A po shkon Bashkimi Evropian drejt zëvendësimit të Shteteve anëtare? A duhet të ripërkufizohet sovraniteti për të vazhduar t'i japim një rol kyç në përcaktimin e kuptimit të shtetit duke përjashtuar disa elementë të kuptimit tradicional të tij që tashmë janë të papërshtatshëm? Këto dhe shumë

pyetje të tjera do të jenë objekt analize të këtij kërkimi shkencor. Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, në fokus të këtij punimi do të jetë analiza e aspekteve historike të sovranitetit, qasjet bashkëkohore ndaj konceptit të sovranitetit. Ndërsa, vëmendja më e madhe dhe puna më voluminoze e këtij punimi do të përqëndrohet tek dy kapitujt e fundit analitikë, të cilët në funksion të vërtetimit të hipotezës dhe të pyetjeve kërkimore do të përqëndrohen tek ballafaqimi i konceptit të sovranitetit me Bashkimin Evropian dhe se si ky koncept është “zhveshur” nga karakteri i tij absolut pikërisht si rezultat i procesit të integritetit komunitar.

Fjalët kyçe: sovraniteti absolut, sovraniteti relativ, sovranitet i ndarë, Bashkimi Evropian.

THE ABSTRACT

Jean Bodin's approach to the concept of sovereignty theorized the latter as an absolute power that belongs to the state and royalty. Today, the meaning of sovereignty has changed since the state is forced to be part of a fractured world, globalization, economic difficulties, etc.

European Union is a true experimentation of divided sovereignty. The EU provokes a division of competences between Member States and the organization, which over time has become important, going so far as to affect the sovereign powers of states. In this way, the European Union casts doubt on the usefulness of the concept of sovereignty.

Community process modifies the concept of sovereignty by giving to it a relative meaning, totally different from the traditional definition. At this point, it seems that the sovereignty and absolutism should not stay together since the relativity of sovereignty appears in all its dimensions, a fact this that makes you seek another definition of the concept of sovereignty. Given this hypothesis some questions arise: Is it still retained the idea of the very first doctrine that sovereignty can not be anything but absolute? Is the concept of state sovereignty a modern concept? What does sovereignty means nowadays and is it affected when faced with international realities? Does European Union casts doubts on the usefulness of the concept of sovereignty? How sovereign are the Member States of the EU and what part of their sovereignty have they lost with their accession to the EU? Who is the main sovereign in the EU: the European Union or Member States? Is EU moving toward the replacement of the Member States? Should sovereignty be redefined in order to continue to provide a key sense in determining the meaning of the state excluding some elements of its traditional meaning that are already inadequate? These and many other

questions will be subject of analysis of this research. To answer these questions, the focus of this paper will be the analysis of the historical aspects of sovereignty, contemporary approaches to the concept of sovereignty. Whereas most attention and most voluminous work of this paper will focus on the last two analytical chapters, which in order to prove the hypothesis and research questions will focus on the juxtaposition of sovereignty to the European Union and how this concept is "stripped" of its absolute character precisely as a result of the process of European integration.

Key words: absolute sovereignty, relative sovereignty, divided sovereignty, European Union.

DEDIKIMI

Njeriut më të shtrenjtë të jetës time...

BABAIT TIM!

FALENDERIME

Falenderime dhe mirënjohje e sinqertë për të gjithë ato që u bënë pjesë e realizimit të këtij punimi.

Fillimisht dua të falenderoj udhëheqësin tim në këtë punim, Prof. Dr. Skender Kaçupi. Këshillat, mbështjetja, inkurajimi dhe sugjerimet e tij ishin mjaft të vlefshme për realizimin e këtij punimi.

Një falenderim i veçantë shkon për familjen time. Dashuria dhe përkrahja e tyre kanë qënë shumë të rëndësishme për mua në kryerjen e këtij kërkimi shkencor.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE	13
1.1. Hyrje	13
1.2. Qëllimi dhe rëndësia e punimit	16
1.3. Hipoteza e punimit	18
1.4. Pyetjet kërkimore	20
1.5. Struktura	20
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK.....	25
2.1. Debati doktrinar	25
2.2. Metodologjia dhe metodat e kërkimit	27
KAPITULLI III - EVOLUCIONI HISTORIK I SOVRANITETIT	30
Hyrje.....	30
3.1. Shfaqja e idesë së sovranitetit absolut në Mesjetë	31
3.1.1. <i>Sovraniteti absolut sipas Jean Bodin</i>	33
3.1.2. <i>Shfaqja e një sovrani të ri sipas teorisë së shekullit XVII: Populli</i>	38
3.2. Anti-absolutizmi	41
3.2.1. <i>Teoritë e para të sovranitetit të kufizuar</i>	41
3.2.2. <i>Teoria e ndarjes së pushteteve</i>	46
3.2.3. <i>Sovraniteti popullor</i>	48
3.2.4. <i>Lindja e sovranitetit kombëtar absolut</i>	50
3.2.5. <i>Shkolla gjermane: një përkufizim i ri i sovranitetit shtetëror</i>	52
3.2.6. <i>Sovraniteti juridik</i>	54
KAPITULLI IV: QASJET BASHKËKOHORE NDAJ KONCEPTIT TË SOVRANITETIT	61
Hyrje.....	61
4.1. Adaptimi i konceptit të sovranitetit me një realitet të ri ndërkombëtar.....	62
3.1.1. <i>Sovraniteti pozitiv dhe sovraniteti negativ sipas Robert Jackson</i>	63
3.1.2. <i>Sovraniteti si “hipokrizi e organizuar” sipas Stephen Krasner</i>	64
3.1.3. <i>Sovraniteti si fakt social</i>	66
4.2. Evolucion bashkëkohor i konceptit të sovranitetit.....	68
4.2.1. <i>Sovraniteti si përgjegjësi dhe sovraniteti si aftësi</i>	69

4.2.2.	<i>Sovraniteti dhe qeverisja e mirë.....</i>	70
4.3.	<i>Qasjet post-pozitiviste mbi konceptin e sovranitetit</i>	72
4.3.1.	<i>Sovraniteti: një koncept domosdoshmërisht normativ</i>	72
4.3.2.	<i>Një sovranitet përformues?.....</i>	74
4.4.	<i>Karakteristikat e sovranitetit</i>	77
4.4.1.	<i>Epërsia e shtetit mbi çdo pushtet tjetër si karakteristikë kryesore e shtetit sovran ..</i>	77
4.4.2.	<i>Pavarësia e Shtetit</i>	83

KAPITULLI V – SOVRANITETI NË BASHKIMIN EVROPIAN: NJË

SOVRANITET RELATIV85

Hyrje.....	85
5.1. Karakteristikat institucionale dhe sistemi juridik i Bashkimit Evropian.....	86
5.2. Procesi i transferimit të kompetencave dhe ndarja e sovranitetit	92
5.2.1. Traktatet themeluese të Komuniteteve Evropiane (KEQÇ, KEEA, KEE): pranimi i parimit të transferimit të kompetencave shtetërore	92
5.2.2. Nga Akti i Vetëm Evropian tek Traktati i Lisbonës: një ndarje kompetencash e miratuar por veçanërisht komplekse	94
5.2.3. Parashikimet kushtetuese të Shteteve anëtare “të vjetra” mbi transferimin e kompetencave në Bashkimin Evropian	102
5.2.4. Kushtetutat e vendeve të Evropës Qëndore dhe Lindore dhe parashikimet kushtetuese mbi transferimin e kompetencave sovrane.....	111
5.3. Zhvillimi i politikave evropiane integruese dhe praktika e shtyllave: nga Maastricht-i tek Lisbona	116
5.3.1. Praktika e vjetër e shtyllave.....	116
5.3.2. Forcimi dhe zgjerimi i politikave komunitare.....	120
5.3.3. Humbja e ndikimit të rregullit të unanimitetit	123
5.4. Integrimi i së drejtës komunitare në të drejtën e brendshme: një raport hierarkik në disfavor të sovranitetit shtetëror.....	126
5.4.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i së drejtës komunitare	126
5.4.2. Supremacia e së drejtës komunitare.....	131
5.4.3. Kundra-limitet ndaj përparësisë së të drejtës komunitare.....	139
5.5. Sovraniteti përballë pushtetit të gjyqtarëve	144
5.5.1. Shteti i nënshtruar ndaj juridiksionit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë	144
5.5.2. Bashkëpunimi i ngushtë mes GJED-së dhe gjykatave kombëtare	147
5.6. Pjesëmarrja e organeve politike kombëtare në fragmentimin e sovranitetit shtetëror	151

5.6.1.	<i>Projekt-Traktati i Kushtetutës Evropiane: një heqje dorë e Shteteve anëtare dhe një rezistencë e kombeve</i>	151
5.6.2.	<i>Traktati i Lisbonës: kontradikta Shtet/Komb mbi ndarjen e sovranitetit</i>	156
5.6.3.	<i>Zgjerimi i BE-së dhe ndikimi i tij tek sovraniteti i shteteve: një hendek mes vullnetit të Qeverive dhe vullnetit të Kombeve</i>	160
5.7.	Sovraniteti i shteteve kandidate në fazën e paraanëtarësimit: parashikimet kushtetuese në lidhje me pozicionimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemet e tyre juridike	163
5.7.1.	<i>Sovraniteti në kuadrin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian</i>	166
KAPITULLI VI - BASHKIMI EVROPIAN: NJË PUSHTET SOVRAN		
EMBRIONAR?		174
Hyrje.....		174
6.1.	Ruajtja e sovranitetit politik të shtetit	174
6.1.1.	<i>Ruajtja e sovranitetit të shtetit falë vetëkufizimit të BE-së</i>	175
6.1.2.	<i>Defiçiti demokratik: një faktor kryesor në kufizimin e pushteteve të BE-së</i>	179
6.2.	Struktura ndërshtetërore e BE-së: Shtetet gjithmonë në sfond	181
6.3.	Pamundësia e BE-së në zëvendësimin e shteteve	184
6.4.	Dobësia e sovranitetit embrionar të Bashkimit Evropian: attribute shtetërore jo të plota	189
6.4.1.	<i>Bashkimi Evropian: larg nga Shteti sovran i bazuar tek Kombësia</i>	190
6.4.2.	<i>Delegimi i pjesshëm i attributeve shtetërore Bashkimit Evropian</i>	192
6.5.	Kthimi i sovranitetit absolut nëpërmjet “klauzolës së tërheqjes”	193
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME		202
BIBLIOGRAFIA		210

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Hyrje

Përballë një bote në evolucion të vazhdueshëm, tematika e shtetit, e pushtetit shtetëror, aftësia e tij për të ruajtur një rol në skenën ndërkombëtare dhe e së ardhmes së tyre ruan një pozitë dominuese në diskutimet e qarqeve juridike. Që nga Antikiteti deri në ditët tona, ekzistenca e shtetit dhe e pushtetit në mënyrë të veçantë ka qënë, është dhe do jetë objekt diskutimesh dhe analizash.

Në fakt, shteti, para së gjithash, është një person juridik i së drejtës publike, një entitet i veçantë që ka një ekzistencë historike. Shteti nuk shpallet dhe nuk krijohet brenda një dite, por është fryt i një rrugëtimi, i veçantë për çdo popull, fryt i një ndërtimi të ngadaltë në kërkim të një legjitimiteti specifik, të aftë për të mbajtur entitetin e krijuar (Mortier, 2011:1).

Shteti është kështu një territor në të cilin jeton një bashkësi individësh të bashkuar nga ideja e kombësisë dhe që i nënshtrohen rregullave juridike dhe politike të përbashkëta, të pranuar nga të gjithë. Shteti pra ka një dimension abstrakt para se të materializohet ose të identifikohet nga përfaqësuesit e tij. Me pak fjalë, shteti mbështetet në këto elementë themelues: territori, popullsia, pushteti dhe institucionet qeverisëse me traditë të gjatë politike dhe juridike. Por shteti nuk mund të analizohet thjesht në aspektin e tij të brendshëm, ai duhet gjithashtu të zhvendoset edhe në nivel ndërkombëtar, në ballafaqim me shtetet e tjera (Mortier, 2011:2). Kur e marrim shtetin si një fenomen juridik, kemi parasysh jo vetëm një aparat të caktuar, por edhe disa elementë të tjerë që e bëjnë shtetin të aftë të dalë si palë në marrëdhëniet ndërkombëtare (Puto, 2004:96-97). Në një kontekst të tillë, analiza e pushtetit të shtetit paraqet vërtet një rëndësi të veçantë dhe në mënyrë të

pashmangshme, pjesë e kësaj analize, bëhet edhe koncepti i sovranitetit. Në fakt, në fokus të këtij punimi është pikërisht analiza e evolucionit të sovranitetit dhe e transformimit të tij si rezultat i shfaqjes së disa fenomeneve të cilat nuk ekzistonin në kohën kur vetë koncepti i sovranitetit u prezantua.

Sovraniteti akoma dhe sot vazhdon të jetë një koncept “misterioz” dhe jo i mirëpërcaktuar ndonëse origjina e këtij nocioni juridik dhe politik shfaqet me teoritë e Jean Bodin gati pesëqind vjet më parë (Truyol Serra, 1990:313) dhe pavarësisht tentativave të shumta për të saktësuar përmbajtjen e tij.

Sovraniteti, në kuptimin e tij origjinal, është përkufizuar si një pushtet i pandashëm, suprem, absolut dhe i patjetërsueshëm. J. Bodin ishte i pari që formuloi pandashmërinë e pushtetit. Kjo pandashmëri pushteti, sipas Bodin, ishte e nevojshme, pasi realiteti i asaj kohe do të çonte në mënyrë të pashmangshme në konflikte pushteti në qoftë se ky pushtet do ndahej mes disa autoriteteve. Sipas Bodin, pushteti për të bërë ligje nuk mund të ndahet, gjithmonë në qoftë se synimi i vetëm është që e drejta të jetë efektive dhe e aftë për të drejtuar një komunitet të caktuar (Goyard Fabre, 1989:87). Bodin i dha konceptit të sovranitetit edhe një sens absolut. Kjo karakteristikë e sovranitetit, sipas Bodin, buron nga pamundësia për ta ndarë atë, nga pamundësia për ta tjetërsuar dhe nga pamundësia për të krahasuar këtë pushtet me një pushtet tjetër eksistues. Një risi tjetër që solli J.Bodin konsiston në teorizimin e sovranitetit modern si një pushtet suprem. Me këtë koncept, Bodin synoi që të krijonte një pushtet të vetëm, të pandashëm dhe të aftë për të krijuar të drejta dhe për të imponuar detyrime.

Megjithatë, që nga kuptimi tradicional i sovranitetit dhe deri në kohët bashkëkohore, mund të themi se sovraniteti është shfaqur në shumë forma, qoftë në aspektin e përmbajtjes, qoftë në aspektin e titullarëve të tij. Thënë ndryshe, sovraniteti është një nocion juridik dhe

politik konturet e të cilit janë zhvendosur ndjeshëm meqënëse kuptimi i tij nuk është i fiksuar as në histori dhe as në fjalorin juridik. Sovraniteti, relativisht i qartë në refleksionet e J.Bodin, është shfaqur me kalimin e kohës një koncept gjerësisht i lakueshëm dhe i paqartë për atë kohë sa janë shfaqur divergjenca qoftë doktrinale, qoftë politike mbi natyrën dhe shtrirjen e këtij pushteti.

Është bërë gjithnjë e më shumë e vështirë të ruhet ideja e doktrinës fillestare që sovraniteti nuk mund të jetë asgjë tjetër veçse absolut. Si rrjedhojë, sovraniteti është luhatur në vazhdimësi mes një përkufizimi absolut dhe një përkufizimi më të nuancuar, që pranon relativitetin.

Në fakt pranimi i relativitetit përbën një sulm kundër mitit të sovranitetit absolut, i cili i drejtohet së pari përmbajtjes së tij. Një qëndrim i tillë është mbajtur nga doktrina gjermane dhe është konsideruar si një ndër lëvizjet më konkrete të fragmentarizimit të sovranitetit, lëvizje kjo që është e kundërta e asaj që zgjodhi J.Bodin.

Së dyti, relativiteti i sovranitetit prek edhe titullarët e tij. Kërcënimi në këtë aspekt do të vijë nga prishja e raportit Shtet-Komb dhe nga dallimi konfliktuoz mes sovranitetit të shtetit dhe sovranitetit kombëtar.

Së treti, çështja e vënies në diskutim të absolutizmit do të shfaqet po ashtu edhe në lidhje me pandashmërinë e sovranitetit, që ishte një ndër kriteret kryesore të konceptit unitar të sovranitetit.

Projekti evropian, i krijuar me Traktatin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, në vitin 1951, e mbi të gjitha me Traktatet e Romës, në vitin 1957, ka krijuar një rend juridik dhe politik të pashoq që ka kontribuar në modifikimin e konceptit të sovranitetit, si në përmbajtjen ashtu edhe në rëndësinë e tij. Ky nocion i rendit juridik dhe politik është

reflektuar kryesisht nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në dy vendime themelore të saj¹: Vendimi Van Gend en Loos , nr.26/62, 7 shkurt 1963: “Komuniteti krijon një rend të ri juridik dhe subjektë të këtij rendi nuk janë vetëm Shtetet anëtare por edhe shtetasit e këtyre shteteve” dhe Vendimi Costa k/ENEL, nr.6/64, 15 korrik 1964: “Ndryshe nga traktatet e zakonshme ndërkombëtare, Traktati i KEE-së ka krijuar një rend juridik të vetin i cili integrohet në sistemet juridike të Shteteve anëtare në momentin kur ky traktat hyn në fuqi”. Krijimi i Komuniteteve Evropiane, i institucioneve të tij, më vonë lindja e Bashkimit Evropian me Traktatin e Maastricht-it, sollën, në fakt, jo pak ndikime në sovranitetin e shteteve që aderuan.

Procesi komunitar, në të vërtetë, vë në diskutim pushtetin e shtetit pasi ai ushtron ndikim mbi kompetencat e shtetit dhe në ekskluzivitetin e pushtetit të shtetit. Në çdo rast, ai kundërshton supremacinë e pushtetit të shtetit, në një kohë kur ky i fundit është edhe mbajtës i sovranitetit. Pa asnjë hezitim mund të themi që evoluimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe veçanërisht procesi i integritetit evropian ka gërryer kompetencat e shtetit. Përparimet e fundit të Traktatit të Lisbonës nuk bëjnë asgjë tjetër veçse përforcojnë ndikimin mbi sovranitetin.

1.2. Qëllimi dhe rëndësia e punimit

Ky studim synon analizimin e konceptit të sovranitetit në kontekstin historik për të nxjerrë në pah evolucionin e kuptimit të tij, që nga titullarët deri tek përmbajtja, në periudha të ndryshme historike.

¹ Për më tepër shih: Vendimin Van Gend en Loos , nr.26/62, 7 shkurt 1963 dhe Vendimin Costa k/ENEL, nr.6/64, 15 korrik 1964.

Në vijim synohet evidentimi i problematikave të konceptit tradicional të sovranitetit përballë realiteteve ndërkombëtare dhe mundësitë për një ripërcaktim të kuptimit të sovranitetit.

Një qëllim tjetër i punimit është identifikimi dhe analizimi i fenomeneve në gjirin e BE-së që kanë ndikuar në relativizmin e sovranitetit, të tilla si procesi i transferimit të kompetencave sovrane të shteteve drejt BE-së, zhvillimi i politikave komunitare dhe influenca e së drejtës komunitare në sistemet e brendshme juridike të Shteteve anëtare.

Gjithashtu synohet një analizë juridike e praktikave të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me pozicionimin e rendit komunitar në rendet juridike kombëtare dhe me afirmimin e supremacisë së të drejtës komunitare në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare.

Synim i këtij punimi do të jetë analiza ligjore e neneve të traktateve themeluese dhe atyre reformuese të BE-së me qëllim evidentimin e pushteteve të BE-së dhe deri ku ato prekin apo influencojnë pushtetet sovrane të Shteteve anëtare. Po ashtu objekt i këtij punimi do të jenë edhe parashikimet kushtetuese të Shteteve anëtare dhe të Shteteve kandidate mbi delegimin e kompetencave të tyre drejt bashkësisë evropiane dhe në lidhje me pozicionimin e së drejtës komunitare në hierarkinë e normave të tyre juridike.

Gjithashtu synohet të bëhet një vlerësim i disa zhvillimeve në Bashkimin Evropian, si deficieti demokratik apo parashikimi ligjor, për herë të parë, i klauzolës së tërheqjes së Shteteve anëtare nga Bashkimi Evropian, të cilat vënë theksin tek aftësia e shtetit për të ruajtur sovranitetin e tij politik pavarësisht disa lëshimeve të cili, me vullnetin e tij, i ka bërë ndaj Bashkimit Evropian.

Pa dyshim që ky studim synon të arrijë në konkluzione dhe në rekomandime cilësore.

Rëndësia: Në lidhje me rëndësinë e këtij punimi mund të themi që ai përbën një kontribut të vogël në studimet akademike shqiptare, kjo për shkak të numrit të kufizuar të punimeve në literaturë në gjuhën shqipe referuar kësaj tematike. Ky studim mund t'i shërbejë studimeve të reja apo mund të konsiderohet edhe si një pikënisje për studime të tjera më të thelluara në këtë fushë. Një studim i tillë i drejtohet të gjithë atyre që operojnë në fushën e drejtësisë, kolegëve akademikë dhe të gjithë atyre që dëshirojnë të kenë njohuri në fushën juridike.

1.3. Hipoteza e punimit

Ky punim, përmes një studimi të pastër historik, doktrinar dhe jurisprudencial, synon të trajtojë evolucionin historik të sovranitetit dhe të evidentojë fenomenet që kanë ndikuar në transformimin e këtij koncepti nga procesi i integritit evropian. Kështu, për realizimin e këtij qëllimi, argumenti apo **hipoteza kryesore** është: Procesi komunitar modifikon konceptin e sovranitetit duke i dhënë atij një kuptim relativ, krejtësisht të ndryshëm nga përkufizimi tradicional i tij. Në këtë pikë, duket se sovraniteti dhe absolutizmi nuk mund të qëndrojnë më bashkë meqënëse relativiteti i sovranitetit shfaqet në të gjitha dimensionet e tij, fakt ky i cili të shtyn të kërkojë një tjetër përkufizim mbi konceptin e sovranitetit. Për arritjen e objektivave të punimit kemi paraqitur disa nënhipoteza të tjera:

-Në ballafaqim me Bashkimin Evropian koncepti i sovranitetit absolut dhe të pandashëm është transformuar në aspektin e përkufizimit dhe të përmbajtjes së tij. Kështu sovraniteti është në vështirësi pasi ai nuk kontribuon më plotësisht në kualifikimin e pushtetit shtetëror dhe nuk lejon më të përcaktojë dhe të përfshijë në përcaktimin e tij pushtetet që i janë besuar BE-së.

- Në mënyrë paradoksale, shteti vetë kontribuon në dobësimin e sovranitetit, pasi vetë shtetet, të nxitur nga nevojat ekonomike, politike, ushtarake, i kanë dhënë Bashkimit Evropian kompetenca të tilla sa që sot BE-ja mund të konsiderohet si një konkurrent serioz i shtetit. Madje vetë projekti për krijimin e një Kushtetute të Bashkimit Evropian ka treguar vullnetin e shteteve për të krijuar një Evropë me vokacion mbikombëtar dhe të integruar.

- Ndikimi i Bashkimit Evropian në sovranitetin e shteteve anëtare është lehtësisht i dukshëm. Megjithatë, edhe pse koncepti absolut dhe i pandashëm i sovranitetit nuk mund të vazhdojnë të mbijetojnë për shkak të ndikimit të Bashkimit Evropian, mund të themi që veçantia e pushtetit shtetëror, si rrjedhojë edhe e pushtetit sovran të shtetit, nuk suprimohet nga BE-ja. Në fakt, Bashkimi Evropian pavarësisht ndikimeve që ushtron mbi pushtetin sovran të Shteteve anëtare, ai gjithsesi nuk është në gjendje që të zëvendësojë përfundimisht ato.

- Bashkimi Evropian është një organizatë e veçantë, sui generis, e veshur me kompetenca të natyrës shtetërore, e cila gëzon një përqindje të sovranitetit shtetëror, sidomos juridik, e megjithatë BE-ja nuk është një Shtet dhe nuk ka sovranitet të plotë. Bashkimi Evropian është tashmë një pushtet-fuqi në mes të Shteteve, i cili, nganjëherë, u imponohet atyre por që është ngushtësisht i lidhur me ta.

- Shteti është pa diskutim arkitekti i Bashkimit Evropian, duke qënë kështu në të njëjtën kohë konceptuesi, organizatori dhe nganjëherë edhe ai që e pëson nga ky bashkim.

- Pavarësisht përkufizimit jo të formuluar saktë, sovraniteti është një koncept që vazhdon të tregojë dobinë e tij. Në të vërtetë, e drejta dhe praktika refuzojnë të braktisin sovranitetin si një tregues apo përcaktues të pushteteve të shtetit edhe pse dimensionin e tij absolut dhe i pandashëm e ka humbur tashmë rëndësinë e tij.

1.4. Pyetjet kërkimore

Për arritjen e objektivave të studimit dhe vërtetimin e hipotezës shumë pyetjeve mbetet për t'iu kthyer përgjigje.

- A vazhdon të ruhet ideja e doktrinës fillestare që sovraniteti nuk mund të jetë asgjë tjetër veçse absolut?
- A është bashkëkohor koncepti i sovranitetit shtetëror?
- Çfarë kuptimi ka sot sovraniteti dhe a cenohet ai kur ballafaqohet me realitetin ndërkombëtar?
- A hedh Bashkimi Evropian dyshime mbi dobinë e konceptit të sovranitetit?
- Sa sovrane janë Shtetet anëtare të BE-së dhe çfarë pjesë të sovranitetit të tyre kanë humbur me aderimin e tyre në BE?
- Kush është sovrani kryesor në BE: Bashkimi Evropian apo Shtetet anëtare?
- A po shkon Bashkimi Evropian drejt zëvendësimit të Shteteve anëtare?
- A duhet të ripërkufizohet sovraniteti për të vazhduar t'i japim një rol kyç në përcaktimin e kuptimit të shtetit duke përjashtuar absolutizmin që tashmë është i papërshtatshëm?

1.5. Struktura

Me qëllim realizimin e objektivave të punimit struktura e punimit është konceptuar si më poshtë:

Kapitulli I “Hyrje” përfshin një prezantim të përgjithshëm të objektit të studimit (hyrje), qëllimin dhe rëndësinë e punimit, parashtrimin e hipotezës dhe nënhipotezave, pyetjet kërkimore dhe strukturën e punimit.

Kapitulli II “Skeleti teorik dhe modeli analitik” trajton në mënyrë të përmbledhur debatet akademike rreth konceptit të sovranitetit. Doktrina vlerëson si të nevojshme ofrimin e perspektivave të reja mbi konceptin e sovranitetit duke qenë se sovraniteti tradicional nuk reflekton realitetin aktual ndërkombëtar, duke kërkuar më shumë në mundësinë për ta riinterpretuar se sa për ta zhvlerësuar atë. Po ashtu në këtë kapitull trajtohet metodologjia dhe metodat e kërkimit. Metodologjia e përdorur në këtë punim është ajo cilësore, ndërsa metodat e kërkimit janë: metoda historike, metoda e kërkimit doktrinar, metoda e analizës jurisprudenciale dhe metoda analitike.

Kapitulli III “Evolucioni historik i sovranitetit” është një kapitull i cili, siç kuptohet dhe nga vetë titulli, synon që të japë një pasqyrim dhe një analizë të përgjithshme të konceptit të sovranitetit përgjatë historisë duke filluar që nga Mesjeta deri në ditët e sotme. Arsyeja se pse ky punim fillon me një kapitull historik është e thjeshtë: vetëm një analizë e aspekteve historike të sovranitetit do bëjë të mundur të kuptojmë se cili është sot kuptimi dhe roli i nocionit të sovranitetit. Në këtë kapitull do të shihet se si sovraniteti paraqitet si një nocion evolutiv i cili vishet me karakteristikat e shoqërisë në të cilën zbatohet (Kranz, 1992:441). Kështu duke u nisur nga trajtimi që i bëhet në këtë kapitull evolucionit të sovranitetit qoftë në aspektin e përmbajtjes, qoftë në aspektin e titullarëve të tij, mund të themi që ky koncept ka kaluar nga të qenurit plotësisht absolut në domosdoshmërinë e kufizimit të tij.

Kapitulli IV “Qasjet bashkëkohore ndaj konceptit të sovranitetit” ka në fokus të tij qëndrimet e disa autorëve ndaj konceptit të sovranitetit, të cilët e shohin atë si një koncept

evolutiv, larg të kuptuarit tradicional të tij. Por ajo çfarë konstatojmë gjatë procesit të transformimit të konceptit të sovranitetit është se ky koncept edhe pse ka evoluar dukshëm ai asnjëherë nuk e ka humbur koherencën e tij analitike. Ky interesim, në kohët aktuale, për konceptin e sovranitetit (Sorensen, 1999:590) vjen si nevojë për t'i dhënë një kuptim të ri këtij nocioni i cili për një kohë të gjatë është konsideruar si i pakapshëm dhe i errët. Vitet e fundit sovraniteti ka kaluar nga një koncept i paprekshëm drejt një katalizatori debatesh në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në qoftë se disa studiues mjaftohen në ndarjen e sovranitetit në komponentë të ndryshëm, disa të tjerë shkojnë edhe më larg, duke ripërcaktuar madje edhe vetë përmbajtjen e konceptit të sovranitetit.

Kapitulli V “Sovraniteti në Bashkimin Evropian: një sovraniteti relativ” përbën kapitullin më voluminoz të këtij kërkimi shkencor, kjo sepse në këtë kapitull bëhet tentativa më e madhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore, të tilla si: A e ka humbur sovraniteti i shteteve karakterin e vet absolut duke u shndërruar në sovranitet relativ përballë realitetit të integritetit evropian? Sovraniteti i shteteve a është më i pandashëm? Sa sovraane janë shtetet që aderojnë në BE? Në këtë kapitull do evidentohet pikërisht se si koncepti i sovranitetit është relativizuar, duke u ushtruar në forma krejtësisht të ndryshme nga ato tradicionale, nëpërmjet tre fenomeneve tipike në gjirin e BE-së: transferimi i kompetencave të Shteteve anëtare drejt BE-së, zhvillimi i politikave komunitare si dhe prioriteti i së drejtës komunitare ndaj së drejtës kombëtare të Shteteve anëtare.

Kapitulli VI “Bashkimi Evropian: një pushtet sovran embrionar?” është vazhdim logjik i kapitulli V. Është një kapitull i cili synon t'i japë një identitet të mirëpërcaktuar Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian është sot ndoshta në një udhëkryq të ekzistencës së tij, me elementë që shkojnë në favor të sovranitetit por vazhdon të jetë i paafte në ushtrimin e sovranitetit me natyrë shtetërore. Pushteti i BE-së mund të krahasohet me një sovraniteti

embrionar, i cili mbart disa prej karakteristikave të sovranitetit pa qënë ndërkohë në gjëndje të marrë përsipër të gjitha karakteristikat e një shteti. Kështu pushteti i Bashkimit Evropian mbetet për t'u kualifikuar. BE-ja ka një lloj origjinaliteti të veshur me karakteristika dhe ndikime të shumta të cilat na çojnë nganjëherë edhe në përfundime kontradiktore. Megjithatë ne duhet të përpiqemi për të sqaruar natyrën e këtij pushteti. Në udhëkryq për të sqaruar nëse BE-ja është një organizatë ndërkombëtare apo një shtet me të gjitha atributet e tij, kemi konkluduar në një rrugë të ndërmjetme mes organizatës dhe shtetit. BE-ja nuk është një mekanizëm i aftë për të zëvendësuar shtetet, pavarësisht ndikimeve të pashmangshme që ky organizëm ushtron ndaj pushtetit sovran të Shteteve anëtare.

Pjesa e fundit e punimit është pjesa e konkluzioneve dhe e rekomandimeve, e strukturuar në një kapitull të veçantë. Ky seksion do të përfshijë në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe përfundimet e kapitujve paraardhës, të gjitha këto në funksion të hipotezës dhe pyetjeve kërkimore të ngritura gjatë këtij punimi. Punimi do të konsiderohej thjesht përshkrues dhe jo analitik nëse do të mbeteshim vetëm në rrafshin evidentues të problematikave që hasen gjatë punimit. Si rrjedhojë ky kapitull synon të nxisë të menduarit kritik mbi atë se çfarë mund të ndryshohet dhe përmirësohet lidhur me konceptin e sovranitetit me qëllim aktualizimin e këtij koncepti si rezultat i transformimeve të shoqërisë bashkëkohore. Në këtë kapitull arritëm në konkluzionin që sovraniteti vazhdon të jetë një nocion që përdoret për të treguar pushtetin e një shteti. Sovraniteti vazhdon të jetë, në fakt, atributi me të cilin një shtet vishet për të treguar pushtetin e tij, pavarësisht imperfeksioneve të nocionit, të përmbajtjes dhe të vënies shpesh herë në dyshim të vetë ekzistencës së tij. Kështu pra, sovraniteti është një koncept që vazhdon të tregojë dobinë e tij. Në të vërtetë, e drejta dhe praktika refuzojnë të braktisin sovranitetin si një tregues apo përcaktues të pushteteve të shtetit edhe pse dimensionin e tij absolut dhe të pandashëm e ka humbur tashmë rëndësinë e

tij. Duke u nisur nga ky konstatim konkludojmë që përdorimi i sovranitetit vazhdon të ruhet në gjuhën juridike si rezultat i pranimet të një versioni më të zbutur të tij sipas të cilit karakteri absolut dhe i pandashëm nuk është më një element i përkufizimit të tij.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK

2.1. Debat i doktrinar

Debatet rreth konceptit të sovranitetit nuk janë shuar asnjëherë, që nga koha e shfaqjes së tij si koncept politiko-juridik deri në ditët e sotme. Në të vërtetë, duhet pranuar që nëse sovraniteti është një koncept problematik, siç e afirmonte Waltz (Waltz, 1979:95), kjo ndodh për shkak të pamundësisë që shfaqet në kohët bashkëkohore për të realizuar konceptin e sovranitetit sipas kuptimit të tij tradicional. Kjo pamundësi krijohet si rezultat i shfaqjes së disa fenomeneve të reja, të cilat nuk ekzistojnë në kohën kur vetë koncepti u prezantua. Bëhet fjalë për fenomene të tilla si: globalizimi dhe ndërvlerësia, rritja gjithnjë e më shumë në numër e traktateve dhe e organizatave ndërkombëtare, etj. dhe përballë evolucioneve të tilla, doktrina juridike bashkëkohore ofron qasje të ndryshme ndaj nocionit të sovranitetit duke kërkuar më shumë në mundësinë për ta ri-interpretuar se sa për ta zhvlerësuar atë.

Në të vërtetë me zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare është shtruar nevoja e adaptimit ose e aktualizimit të konceptit të sovranitetit me këtë realitet të ri. Ndajmë të njëjtin mendim me Werner dhe De Wilde (Werner & De Wilde, 2001:285) sipas të cilëve po shkohet gjithnjë e më shumë drejt spostimit të elementëve konkretë që afirmojnë ekzistencën e shteteve sovrane. Ose siç thoshte James (James, 1986:166) nëse sovraniteti tradicional nuk reflekton realitetin aktual ndërkombëtar atëherë është e nevojshme të ofrojmë perspektiva të reja mbi konceptin e sovranitetit, duke kërkuar, siç është cituar edhe më lart, më shumë në mundësinë për ta ri-interpretuar se sa për ta zhvlerësuar atë.

Ekziston një debat në lidhje me pandashmërinë e sovranitetit. Sovraniteti sipas konceptit unitar mund të ndahet në katër pjesë: 1. Sovraniteti i brendshëm, i cili nënkupton organizimin e pushtetit politik brenda territorit të një shteti dhe niveli i kontrollit efektiv i ushtruar nga autoriteti shtetëror; 2. Sovraniteti si ndërvaresi që ka të bëjë me aftësinë e autoriteteve publike për të kontrolluar flukset ndërkufitare; 3. Sovraniteti ligjor ndërkombëtar, që i referohet njohjeve të ndërsjellta mes shteteve; 4. Sovraniteti westphalian i cili nënkupton përjashtimin e ndërhyrjes së faktorëve të jashtëm në çështjet e brendshme të një shteti, pra ky lloj sovraniteti i referohet rregullit të mos-ndërhyrjes (Krasner, 1999:9). Thelbi i debatit qëndron në faktin që këto katër elementë a duhet të jenë domosdoshmërisht të lidhur me njëri-tjetrin si një tërësi organike që një shtet të konsiderohet sovran? Mendojmë që këto elementë të ndryshëm që përbëjnë sovranitetin janë të pavarur nga njëri-tjetri. Thënë me fjalë të tjera, një shtet mund të ketë sovranitet ligjor ndërkombëtar, por është i paafte të sigurojë pavarësinë në zgjidhjen e çështjeve të tij të brendshme duke lejuar kështu, në mënyrë indirekte, ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm. Pra mund të mos ketë sovranitet westphalian. Për më tepër ushtrimi i një forme të sovranitetit mund të ndikojë në humbjen e një forme tjetër të tij (Krasner, 1999:4). Mund të përmendim si shembull rastin e shteteve që aderojnë në Bashkimin Evropian. Aderimi i tyre në këtë organizatë *sui generis* riafirmon sovranitetin e tyre ligjor ndërkombëtar, por ka si pasojë cënimin e pjesshëm të sovranitetit westphalian të shteteve aderuese.

Një tjetër debat doktrinar zhvillohet nga autorët konstruktivistë të cilët e vënë theksin tek aspekti social i konceptit të sovranitetit, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në relativizimin e interpretimit klasik të sovranitetit si pushtet apo autoritet absolut (Mathieu, 2012:8). Në të vërtetë, kuptimi i sovranitetit mund të transformohet fare mirë nga një fenomen aktual: integrimi i shteteve në Bashkimin Evropian. Aderimi i shteteve në një organizatë të tillë ka

sjellë ndikime të konsiderueshme ndaj konceptit të sovranitetit, qoftë në aspektin e burimit të legjitimitetit, pra të titullarit të tij, qoftë në aspektin e shtrirjes së veprimtarive që i janë besuar shtetit sovran (Biersteker dhe Weber, 1996:14).

Duke iu referuar debateve të shumta doktrinare dhe gjithë të dhënave të tjera të punimit mendojmë që koncepti i sovranitetit ka një vizion të ri, i cili e largon atë nga kuptimi tradicional, larg të kuptuarit të sovranitetit si një pushtet suprem, i pandashëm dhe absolut. Një vizion i tillë kërkon pashmangshmërisht një qasje të re ndaj konceptit të sovranitetit: ripërcaktimin e kuptimit të sovranitetit. Por një ripërkufizim i sovranitetit, ndryshe nga ai fillestar, do të cënonte qëndrueshmërinë e një koncepti kaq të rëndësishëm juridik dhe politik. Për këtë ndajmë të njëjtin mendim me studiuesit Keohane dhe Jackson: të vihen kufizime lidhur me transformimin e konceptit të sovranitetit sepse po nuk u vendosen caqet rrezikohet të shkohet larg përkufizimit fillestar duke mos e ri-interpretuar atë por duke krijuar një koncept krejtësisht të ndryshëm (Keohane, 2002:743, Jackson 1999:433).

2.2. Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Ç'është metodologjia?

Metodologjia është shkenca e metodave. Ajo studion tërësinë e metodave që përdoren në shkenca të veçanta, apo në një fushë të caktuar të shkencës. Metodologjia është para së gjithash një disiplinë logjike. Ajo ka të bëjë me logjikën e kërkimit shkencor dhe vlerëson në mënyrë kritike veprimet që kryhen gjatë kërkimit shkencor. Në këtë kuptim metodologjia ka të bëjë me filozofinë e kërkimit shkencor, të lidhur me objektin e studimit. (Sokoli, 2009:43). Metodologjia e përdorur është gur themeli i një studimi cilësor.

Ç'është metoda?

Fjala metodë vjen nga greqishtja, *methodos* [meta-drejt; odos-rrugë], që do të thotë rrugë, mënyrë, kriter, normë directive, me anë të së cilës arrihet një qëllim i caktuar (Zingarelli, 1971:1053). Me metodë shkencore kuptohet tërësia e parimeve që përbëjnë qarkun analitik të një shkence, së bashku me tërësinë e mënyrave të hulumtimit, me të cilat shkenca synon të zgjidhë detyrat e shtruara prej saj (Dida,1997:47). Metodë është tërësia e mënyrave dhe mjeteve që përdoren për të studiuar e për të shpjeguar diçka. Ajo përfaqëson një sistem parimesh e rregullash praktike që shërbejnë si rrugë për të arritur një qëllim të caktuar.

Metodologjia bazë e këtij punimi është ajo cilësore. Ndërsa metodat që do të përdoren në këtë kërkim shkencor, për realizimin e qëllimit të tij, duke iu përgjigjur kështu pyetjeve kërkimore dhe duke testuar hipotezat, janë: metoda historike, metoda e kërkimit doktrinar metoda e analizës jurisprudenciale dhe metoda analitike.

Metoda historike është përdorur në këtë punim për të pasqyruar evoluimin e këtij koncepti nga periudha e Mesjetës deri në kohët bashkëkohore.

Ndërsa me anë të metodës së kërkimit doktrinar është bërë i mundur skanimi dhe analizimi i konceptit të sovranitetit. Janë pikërisht qëndrimet doktrinale të cilat kanë nxjerr në pah karakteristikat e sovranitetit dhe transformimin e tij duke e shndërruar këtë të fundit nga një koncept plotësisht absolut në një koncept i cili, në ballafaqim me realitetet bashkëkohore, veçanërisht me fenomenin e Bashkimit Evropian, po shkon gjithnjë e më tepër drejt relativizimit të kuptimit të tij. Kjo metodë e kërkimit doktrinar, ndihmon këtë punim shkencor për të ngritur bazën mbi të cilën do të qëndrojë punimi, duke evidentuar dhe analizuar çështjen e rëndësisë së nocionit të sovranitetit përballë realiteteve të ndryshme historike. Metoda e kërkimit doktrinar, për të mos ngelur thjesht në kuadrin teorik të analizës së këtij punimi, ndihmohet edhe nga metoda e kërkimit të analizës

jurisprudenciale, ku vëmendja do të fokusohet tek vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila me praktikën e vet ka kontribuar në qartësimin e rolit dhe të pozicionimit të së drejtës së BE-së në rendet juridike të brendshme si dhe të pasojave të këtij raporti ndaj konceptit të sovranitetit.

Po ashtu në këtë punim përdoret edhe metoda analitike nëpërmjet së cilës synohet një analizë ligjore e neneve të traktateve themeluese dhe atyre reformuese të BE-së si edhe të dispozitave kushtetuese të Shteteve anëtare si edhe të Shteteve kandidate mbi delegimin e kompetencave të tyre drejt bashkësisë evropiane dhe në lidhje me pozicionimin e së drejtës komunitare në hierarkinë e normave të tyre juridike.

KAPITULLI III - EVOLUCIONI HISTORIK I SOVRANITETIT

Hyrje

Sovraniteti shtetëror është një koncept themelor i së drejtës, sidomos i së drejtës kushtetuese dhe i asaj ndërkombëtare (Omari, 2007:50), por pavarësisht kësaj kuptimi i saktë i nocionit *sovrانيت* nuk është i mirëpërcaktuar (Perrez, 2000:13). Sovraniteti është një ndër nocionet më me kundërthënie dhe më ekuivoke në fjalorin juridik ndërkombëtar. Kjo vjen për shkak të konceptimeve të ndryshme ndaj këtij nocioni në periudha të ndryshme historike (Henkin L. 1995:24-25).

Idetë dhe pikëpamjet rreth sovranitetit kanë ndryshuar nga koha në kohë duke e shndërruar kështu *sovrانيتin* në një nocion jo konstant dhe logjikisht ndryshimet në kohë kanë kërkuar edhe qasje të ndryshme ndaj këtij nocioni. Sipas Fassbender (Fassbender, 2003:115), koncepti i sovranitetit ka provuar të jetë shumë i adoptueshëm. Sipas tij, sovraniteti është një term kolektiv apo ombrellë që tregon të drejtat dhe detyrimet që një shteti i akordohen nga e drejta ndërkombëtare në një kohë të caktuar. E drejta ndërkombëtare e përcakton sovranitetin si statusin ligjor të një shteti. Për këtë arsye, sovraniteti nuk është as “natyral”, as statik. Për shkak të një procesi që ka vendosur gjithnjë e më shumë kufizime në lirinë e veprimit të shteteve, thelbi i nocionit të sovranitetit ka ndryshuar dhe do vazhdojë të ndryshojë në të ardhmen (Fassbender, 2003:129). Pra, është e natyrshe dhe e paevitueshme që kuptimi i nocionit të sovranitetit të ndryshojë duke iu përshtatur periudhave historike dhe kushteve politike të caktuara.

Në fakt, për të kuptuar më mirë rolin e sovranitetit në kohët bashkëkohore, në këtë kapitull do të bëhet një pasqyrim dhe një analizë e gjërë e evolucionit historik të përmbajtjes dhe të

titullarëve të nocionit të sovranitetit shtetëror që nga absolutizmi në Mesjetë deri në kohët aktuale.

3.1. Shfaqja e idesë së sovranitetit absolut në Mesjetë

Zhvillimi i idesë së sovranitetit ka kaluar në disa etapa: nga absolutizmi në periudhën e Mesjetës tek relativizimi i plotë i përmbajtjes së tij në kohët bashkëkohore. Transformimi substancial i sovranitetit ka ardhur si pasojë e domosdoshmërisë së përshtatjes së këtij nocioni me zhvillimin historik dhe me kushtet politike në periudha të ndryshme kohore.

Gjatë gjithë historisë, sovraniteti është diskutuar shpesh në dy aspekte: aspekti i parë që ka të bëjë me karakterin e tij dhe aspekti i dytë që ka të bëjë me titullarin e tij. Aspekti i parë lidhet me përmbajtjen e sovranitetit, konkretisht me cilësitë e tij: a është apo jo absolut, a është apo jo i kufizuar nga e drejta, etj.? Ndërsa aspekti i dytë i referohet mbajtësit të sovranitetit: a është Mbreti, Shteti apo populli mbajtësi i sovranitetit”? (Zhekeyeva, 2009:12).

Për ne, paraqet vërtet interes të analizojmë zhvillimin e sovranitetit nëpërmjet këtyre dy aspekteve sepse parë nën këtë optikë jo vetëm që do bëhet i mundur një vështrim i përgjithshëm i evoluimit historik të përmbajtjes së sovranitetit, por do mund t’i jepet përgjigje edhe pyetjes se çfarë roli dhe çfarë përmbajtjeje ka sot koncepti i sovranitetit.

Në të gjitha epokat e ekzistencës së shtetit, deri në fitoren e revolucionit anglez të shekullit XVII dhe sidomos të revolucionit francez dhe të luftës së popullit amerikan për pavarësi në shekullin XVIII, mbajtësi i sovranitetit ka qënë një organ i vetëm, pavarësisht nëse ai ishte organ monokratik apo kolegjal. Në Romën Republikane, në kohën e lulëzimit të saj, ishte Senati, organi kryesor që ushtronte ligjërisht pushtetin më të lartë, pushtetin sovran, duke

përfaqësuar, të paktën formalisht, edhe vullnetin e popullit, çka shprehej edhe me formulën e njohur me të cilën niste çdo akt legjislativ i Romës Republikane: “Senatus populusque romanus” (Senati dhe populli romak). Në periudhën e mëvonshme, që vazhdoi deri në përmbysjen e Perandorisë Romake, sovraniteti i përkiste Perandorit dhe kjo praktikë la gjurmët e saj të thella edhe në Mesjetë, kur mbretërit e shteteve të ndryshme evropiane, duke pasur edhe bekimin e institucioneve më të larta të kishës katolike në Perëndim dhe të asaj ortodokse në Lindje, ishin titullarë të sovranitetit (Omari, 2011:4-5).

Kuptohet që përqëndrimi i sovranitetit në duart e një personi ose të një institucioni përjashtonte idenë e ndarjes së pushteteve, ide për të cilën në atë kohë as që mund të bëhej fjalë. Kjo sigurisht nuk do të thotë se atëherë nuk ekzistonin organe të ndryshme shtetërore që realizonin funksione të veçanta. Funksioni gjyqësor ishte i veçantë. Por edhe kur ky funksion ushtrohej nga magjistratë të posaçëm, kreut të shtetit i takonte fjala e fundit në zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore; ishte ai që, zyrtarisht apo faktikisht, ushtronte funksionin e kryegjyqtarit. Duhet vënë në dukje se, sipas koncepteve mesjetare, kur mbizotëronte botëkuptimi fetar, pushteti i pakufizuar i sovranit argumentohej edhe me origjinën hyjnore të këtij pushteti. Kjo ishte, në përgjithësi, gjendja në Evropën Mesjetare (Omari, 2011:5).

Por zhvillimi ekonomik dhe politik i vendeve të kontinentit tonë impononte edhe përshtatjen e qeverisjes me kërkesat e kohës. Mund të thuhet se vepra e një autori francez të shekullit XVI, Jean Bodin, vepër e titulluar “Les Six Livres de la République” (“Gjashtë Librat e Republikës”) shënoi kalimin nga mënyra e të menduarit specifik mesjetar në atë specifik modern (Omari, 2011:6).

3.1.1. *Sovraniteti absolut sipas Jean Bodin*

Termi *sovrانيتet* u prezantua për herë të parë në vitin 1576 nga Jean Bodin në veprën e tij “Les Six Livres de la République”. Edhe përpara tij faktikisht sovraniteti ekzistonte, madje që në shtetet e para, por nuk ekzistonte asnjë nocion teorik lidhur me të. Në këtë kuptim, Bodin hapi një faqe të re në teorinë e shtetit dhe në doktrinën politike në përgjithësi (Omari, 2011:8). Ai është padiskutim themeluesi i doktrinës moderne të sovranitetit shtetëror, pavarësisht se ai akoma nuk e kishte përceptuar siç duhej qëllimin e këtij koncepti, duke pasur parasysh regjimin politik në të cilin ai jetoi. Kjo teori e sovranitetit modern i ka rrënjët në vullnetin e Bodin për të qetësuar shoqërinë e asaj kohe, e cila ishte e zhytur në luftra fetare të pazgjidhshme. Ai e konceptonte sovranitetin si një pushtet të aftë për të ruajtur paqen e mbretërisë, për ta shpëtuar nga kthetrat e Kishës, por pa qënë i vetëdijshëm për qëllimin e ardhshëm të një koncepti të tillë.

Veç kësaj, duhet vënë në dukje se teoria e Bodin dhe të gjitha teoritë e tjera që janë zhvilluar që nga shekulli XV, kanë mbështetur tezën e origjinës popullore të sovranitetit për të justifikuar kufizimin e sovranitetit absolut të monarkut, duke shënuar kështu një shkëputje nga teoria teokratike, që ishte mbisunduese gjatë gjithë Mesjetës. Pushteti-argumentonin disa teoricienë të periudhës së Rilindjes- vjen nga populli që ka lidhur me princin një kontratë nënshtrimi. Pra kjo teori nuk e kundërshton absolutizmin por, sipas saj, populli e kishte tjetërsuar në dobi të monarkut sovranitetin e vet (Omari, 2011:8).

Në teorinë e tij, Bodin e përkufizonte sovranitetin si superioritetin politik të pushtetit të shtetit brenda kufijve të territorit të vendit të tij. Çështja kryesore që u shtrua për trajtim nga Bodin ishte: “Me çfarë atributesh duhet të vishet pushteti politik i një shteti në mënyrë të tillë që ky i fundit të mos lejojë brenda territorit të tij asnjë pushtet tjetër më të lartë apo të

barabartë me të?” (Leikoff, 1995:108). Duke e drejtuar sovranitetin kundër pluralitetit të pushteteve, Jean Bodin e quante sovranitetin si një pushtet suprem, absolut, të patjetërsueshëm, të pandashëm, të pakufizuar (Omari, 2007:55).

Bodin e projektoi karakterin suprem të pushtetit sovran në masën që ai nuk mund të tjetërsohet. Ky pushtet i përket sovranit dhe askujt tjetër. Sovraniteti është në të njëjtën kohë pushteti më i lartë dhe pushteti për të qeverisur (Fabre, 1989:91). Bodin ishte i pari që formuloi një pandashmëri të tillë të pushtetit, pa marrë fillimisht parasysh se sovrani ka domosdoshmërisht një pushtet absolut. Ai gjithashtu theksoi që: “Në çdo komunitet, duhet të ketë një pushtet suprem, i cili duhet të jetë gjithmonë në përputhje me normat që ka pranuar i tërë komuniteti” (Franklin, 1993:175).

Bodin e konsideronte sovranitetin të pandashëm, në kuptim që pushteti për të bërë ligje nuk mund të ndahet në qoftë se ai do që të jetë efikas dhe i aftë për të qeverisur. Nisur nga ky supozim, pushteti sovran nuk mund të ndahet. Pandashmëria e pushtetit ishte për Bodin një domosdoshmëri pasi ai, me të drejtë, duke u nisur dhe nga realiteti që e rrethonte, theksonte që ndarja e pushtetit sovran ndërmjet disa autoriteteve, padiskutim që do të çonte në konflikte të pafundme (Mortier, 2011:28).

Bodin projektoi idenë që koncepti i sovranitetit absolut mund të çojë në një formë të rregjimit totalitar, por ai nuk nxjerr asnjë pasojë lidhur me limitet e këtij pushteti. Në të vërtetë, për Bodin, dhe duke iu referuar kohës kur ai jetoi, teoria e shtetit të së drejtës ishte e pamundur të zhvillohej, pavarësisht respektimit të ligjeve themelore të Mbretërisë. Kështu Bodin konkludon natyrshëm drejt karakterit absolut të sovranitetit, të cilin ia atribuon autoritetit mbretëror. Sipas Bodin sovraniteti duhet të jetë absolut sepse duhet që ata që janë sovranë të mos jenë në asnjë mënyrë të nënshtruar ndaj urdhërimeve të një tjetri. Kjo

shprehet edhe në formulat e njohura që e cilësonin princin si *“legibus solutus”*(i palidhur nga ligjet) apo *“quod princit placuit legis habet vigorem”*(ajo që i pëlqen Princit ka fuqinë e ligjit) (Omari, 2011:7).

Pra, sipas parimit të sovranitetit të Bodin, duhet të ekzistojë një autoritet suprem, i pandashëm dhe që duhet të jetë absolut. Ky autoritet është politikisht sovran në aspektin e fuqisë së ushtruar dhe juridikisht sovran në aspektin e krijimit, aplikimit dhe shfuqizimit të së drejtës. Pra thënë shkurt, Bodin e përcakton sovranitetin si një pushtet absolut, të përhershëm dhe të pandashëm (Omari, 2007:55).

Nga hulumtimet e tij, Bodin nxjerr idenë që të gjithë prerogativat e sovranitetit përfshihen tek pushteti i ligjbërjes dhe autoriteti që e mban këtë pushtet është padiskutim autoriteti suprem². Duhet thënë se, ky vizion mbi sovranitetin bie ndesh përfundimisht me kuptimin që sovraniteti kishte në periudhën e Mesjetës, pasi sovraniteti shndërrohet në një koncept politik i cili i jep një entiteti të vetëm ekskluzivitetin e prodhimit të së drejtës pozitive. Bodin shkoj edhe më tej duke e konsideruar sovranitetin si *“themelin kryesor të çdo shteti”*. Sovrani nuk njeh asnjë pushtet tjetër më të lartë se ai vetë, përveç Zotit; ai nuk i nënshtrohet urdhrave të një subjekti tjetër; ai mund të shfuqizojë ligje për të nxjerrë të tjera. Pra sovrani, sipas teorisë së Bodin, qëndron edhe mbi vetë ligjin, kjo bazuar në një logjikë të thjeshtë që sovrani nuk mund të jetë peng i ligjit të tij personal (Zhekeyeva, 2009:15).

Karakter i pakufizuar i pushtetit sovran të shpie drejt parimit të mungesës së përgjegjësisë së sovranit dhe drejt parimit të mosnënshtrimit të tij ndaj një pushteti tjetër. Megjithatë ekzistenca e këtyre parimeve përkrah sovranitetit nuk përkthehet si mundësi e krijimit të një monarku arbitrar, përkundrazi pushteti sovran bazohet në shtrëngimin fizik të pranueshëm

² Bodin shkruante që : *“sovraniteti ka pushtetin për të bërë dhe për të thyer ligjin”*. Për më tepër shih *“ Les six livres de la République”*, Botimi i Fayard, 1986, libri I, f. 306.

dhe të drejtë në shtetin përkatës (Zhekeyeva, 2009:16). Jean Jacque Chevallier, ka vënë në dukje se Bodin ishte larg nga despotizmi ose nga tirania. Është e vërtetë që Bodin ishte për një monarki absolute por në asnjë mënyrë për një monarki arbitrare (Chevallier, 1964:49).

Bodin analizoi po ashtu edhe kriterin e pushtetit absolut nga pikëpamja e aftësisë drejtuese. Parë në këtë kuptim, Bodin e prezantoi sovranitetin si një pushtet i cili gjatë ushtrimit të tij nuk kufizohet veçse nga ligjet natyrore dhe hyjnore. Duke u nisur nga ky raport i sovranitetin me të drejtën natyrore dhe hyjnore Bodin shkruante: “Përsa i përket ligjeve natyrore dhe hyjnore, të gjithë Princat iu nënshtrohen këtyre ligjeve dhe se ato nuk e kanë aspak fuqinë t’i kundërvihen, përkundrazi përballë madhësisë së Zotit të gjithë Monarkët e botës duhet të përkulen me frikë dhe përkushtim. Pra, pushteti absolut i sovranit nuk ushtron fare ndikim tek ligjet natyrore dhe ato hyjnore (Korowicz, 1961:49), përkundrazi sovrani është ai që i nënshtrohet këtyre ligjeve.”

Bazuar nga sa u tha më lart, të krijohet ideja që Bodin është një ndër themeluesit e idesë së sovranitetit mbretëror. Megjithatë nuk është tamam kështu. Sovraniteti, sipas Bodin, mund t’i përkiste fare mirë edhe formave të tjerë të pushtetit shtetëror: përfaqësisë kombëtare nën qeverisjen e pushtetit demokratik, monarkut nën qeverisjen monarkike apo aristokracisë nën qeverisjen aristokratike. Por tek Bodin u shfaq një pikëpamje e ngushtë mbi sovranitetin meqënëse ai e konsideronte monarkinë si formën më të mirë të qeverisjes. Sipas tij, vetëm Monarkia pasqyronte në vetvete unitetin dhe fuqinë e pushtetit shtetëror. Në fakt Bodin e parapëlqente monarkinë për disa arsye: Monarkia është regjimi që i përshtatet më shumë natyrës sepse të gjitha ligjet natyrore, sipas Bodin, të çojnë drejt monarkisë. Familja, modeli i Republikës (shteti) ka vetëm një kryetar. Qielli ka vetëm një diell (Omari, 2011:7).

Në lidhje me mbajtësin apo titullarin e sovranitetit, në periudhën kur Bodin trajtoi konceptin e sovranitetit, ky i fundit korrespondonte me nocionin e titullarit të sovranitetit. Për këtë arsye Bodin e personifikoi sovranitetin me figurën e sovranit.

Sipas disa autorëve, teoria e sovranitetit të Bodin e ka origjinën në kalimin nga shoqëria feudale drejt shoqërisë etatike (Picq, 2005:230). Megjithatë, nuk është e sigurtë që Bodin ishte plotësisht i ndërgjegjshëm që t'i atribuonte pushtetin sovran një entiteti juridik të tillë, si shteti. Por në fakt, Bodin, me teorinë e tij, kontribuoi në shfaqjen e shtetit, ku Sovrani kishte një objektiv të vetëm, atë të krijimit të shtetit (Mairet, 1996:33-34).

Me kalimin e viteve teoria e Bodin mbi sovranitetin është rishikuar në bazë të zhvillimeve ekonomike e shoqërore. Por gjithsesi disa nga tezat themelore të Bodin mbeten të vlefshme dhe të pakontestueshme edhe në ditët e sotme. Kështu, nuk mund të kontestohet lidhja e konceptit të sovranitetit me atë të një pushteti të qëndrueshëm. Elementë të padiskutueshëm, konstitutivë të sovranitetit janë qëndrueshmëria, pavarësia dhe kompetencat e pakufizuara (Omari, 2011:9). Pra gjithë këto elementë duhet të karakterizojnë një pushtet shtetëror sovran në çfarëdo kohe dhe në çfarëdo forme qoftë ai.

Ndërkohë konfuzioni mes sovranitetit, pushtetit mbretëror dhe shtetit erdhi më vonë, dukshëm falë pasuesve të Bodin. Nën influencën e teorisë skolastike³ dhe filozofisë aristoteliane⁴, koncepti i sovranitetit të prodhuar nga Bodin shndërrohet në kriterin themelor të përkufizimit të shtetit që sapo kishte filluar të shfaqej, përtej konceptit të mbretërisë (Rigaudière, 1993:16).

³Sipas teorisë skolastike sovraniteti i atribuon shtetit aftësinë për të ekzistuar dhe për të qeverisur. Kështu pra sovrani është shteti.

⁴Filozofia aristoteliane, zhvillimi i së cilës u zbeh ndjeshëm në Mesjetë, duke lënë mënjanë konceptin e shtetit në dobi të feudalizmit dhe sundimit të perandorive, u rishfaq edhe njëherë në periudhën e Rilindjes. Kjo lëvizje filozofike është e vetëdijshme për ekzistencën e shtetit si person juridik sovran.

Kështu sovraniteti shndërrohet në një tregues të pushtetit dhe të prerogativave të shtetit. Loyseau shkruante që: “Sovraniteti është zotësia e duhur e shtetit dhe që sovraniteti i konceptuar si një pushtet absolut, i përsosur dhe i plotë, i bashkangjitet shtetit”. Po sipas Loyseau, sovraniteti i jep shtetit një superioritet dhe autoritet të pakrahasueshëm dhe që ai është i pandashëm nga shteti (Vonglis, 1997:67). Duke u nisur nga këto reflektime, shteti bëhet, kështu, një me nocionin e sovranitetit dhe me Mbretin sovran (Collot, 1965:176).

Pas këtyre shtigjeve teorike, sovraniteti konceptohej si një pushtet absolut që nuk mund të mbahej nga dy entitete të ndryshme. Sovrani, domethënë Mbreti, posedonte tërësinë e prerogativave dhe shteti, që sapoi filloi të dilte në skenë u asimilua gjërësisht nga sovrani. Ishte doktrina e Loyseau që kontribuoi në krijimin e idesë që Mbreti ia delegon sovranitetin e vet shtetit (Vongolis, 1997:77).

3.1.2. Shfaqja e një sovrani të ri sipas teorisë së shekullit XVII: Populli

Autorë të shekullit XVI-XVII, duke marrë shkas nga konfuzioni mes Shtetit, Mbretit dhe sovranitetit, kërkuan titullarë të ri të pushtetit sovran, përtej autoritetit mbretëror ose hyjnor. Kështu gjatë Revolucionit në Angli në shekullin XVII, filloi lufta ndërmjet përkrahësve të sovranitetit monarkik dhe atij kombëtar (Palienko, 1903:109). Një ndër përkrahësit aktivë të sovranitetit kombëtar ishte Milton. Në veprën e tij “La defense du peuple anglais” (“Mbrotjtja e popullit anglez”), Milton shpalli parimet e sovranitetit kombëtar të bazuar në marrëveshjen mes monarkut dhe popullit, me të drejtën e këtij të fundit për të ndryshuar në çdo moment rregjimin politik dhe për të rrëzuar monarkun në momentin kur ai shkel kushtet e marrëveshjes.

Përgjigja ndaj kësaj ideje ishte doktrina e Thomas Hobbes, i cili në veprën e tij “*Léviathan ou matière, forme et puissance de l'Etat chrétien et civil*” (1615) modifikoi konceptin e sovranitetit sipas Bodin dhe e çoi interpretimin e sovranitetit absolut në kulmin e tij. Ai e konsideroi sovranitetin si pushtet suprem dhe absolut të pakufizuar nga ligji apo nga çdo marrëveshje tjetër. Sipas Hobbes, shteti është i përjashtuar nga çdo kufizim subjektiv apo objektiv dhe askush nuk mund ta gjykojë atë. Shteti posedon pushtetin absolut suprem dhe të pavarur dhe çdo person fizik apo bashkësi e organizuar në territorin e këtij shteti është i/e detyruar t’i nënshtrohet këtij pushteti. Në thelb, absolutizmi prezantohet si treguesi kryesor i shtetit (Zhekeyeva, 2009:17-18).

Në fakt, përkufizimi i sovranitetit të propozuar nga Bodin dhe që i referohet “autoritetit suprem mbi të cilin qëndron dhe parimi i Republikës” (Goyard, 1997:124) përsëritet në njëfarë mënyre edhe nga Hobbes: “pushteti sovran i përket Leviatanit, këtij Zoti të pavdekshëm, në të cilin qëndron edhe “Esenca e Republikës”.

Sovraniteti i Shtetit-Leviatan është konceptuar si tërësia e të drejtave ose e pushteteve të cilat individët, duke nënshkruar një kontratë *inter pares*, ia kanë besuar ushtrimin e këtyre të drejtave ose pushteteve *homo artificialis*, i cili është i ngarkuar për të përfaqësuar të gjithë dhe për të vepruar në emër dhe për llogari të tyre (Zhekeyeva, 2009:17-18).

Në kapitullin XVI të Leviatanit, Hobbes përcakton marrëdhënien mes aktorit dhe autorit të pushtetit. Të drejtat individuale të “autorit” transferohen në favor të personit që do të veprojë në emër dhe për llogari të tij dhe ai është: “aktori”. Në çdo fushë të jetës, qoftë politike, fetare, ushtarake, juridike...një person është përfaqësues i atyre që i kanë transferuar të drejtat e tyre (Goyard, 1997:73-74).

Në Republikë, përfaqësimi është konkluzioni logjik i kontratës. Sipas kësaj kontrate: “Një tërësi individësh shndërrohet në një person të vetëm, vetëm atëherë kur çdo individ, si pjesë e kësaj tërësie, e ka dhënë pëlqimin e tij. Secili i jep atij që e përfaqëson të gjithë autoritetin e vet, duke i konsideruar si të vetat të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi i tij, gjithmonë kjo në rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit autoritet pa kufizime”. Kështu individët “i kanë besuar pushtetin e tyre një personi të vetëm ose një asambleje të vetme, e cila, sipas rregullit të shumicës, mund t’i shndërrojë këto vullnete në një të vetëm. Që do të thotë: do të zgjidhet një person ose një asamble e cila do të marrë përsipër personalitetin e secilit prej individëve”. Thënë me fjalë të tjera, Leviatani mund të përcaktohet si një person i arsyeshëm dhe i vetëm, që përfaqëson një tërësi individësh, me qëllim arritjen e paqes mes tyre (Zhekeyeva, 2009:19).

Ajo çfarë të bie në sy në këtë vepër është se autori nuk zgjatet shumë me konceptin e sovranitetit. Megjithatë rëndësia e këtij koncepti duket qartazi, pasi Hobbes nuk e konsideron sovranitetin thjesht si një atribut të shtetit, si një funksion që shteti e ushtron në emër të tij. Ai shkon më tej, duke e konsideruar sovranitetin si “shpirtin” e trupit politik të kësaj krijese të fuqishme që Hobbes e simbolizon me Leviatanin, ky përbindësh i paprekshëm dhe i pamposhtur për të cilin flet Bibla (Passerin d’Entreves, 1969:134-135).

Sipas Hobbes pushteti sovran është absolut dhe buron, në mënyrë origjinale, nga një kontratë. E veçanta e kësaj kontrate është se ajo nuk është nënshkruar mes individëve dhe sovranit. Ajo është rezultat i vullnetit të individëve dhe në këtë mënyrë sovrani ngelet palë e tretë në këtë marrëveshje. Kështu sipas kësaj kontrate, sovrani mund të mos ndihet i veshur me detyrimet dhe kufizimet klasike të imponuara nga një kontratë (Meinecke, 1924:194, Hinsley, 1986:142-143), pasi sovraniteti i tij nuk buron nga kjo marrëveshje. Si rrjedhojë, të drejtat e sovranit janë shumë të gjëra: “E drejta për të marrë përsipër

personalitetin e të gjithë atyre që e kanë zgjedhur si sovran, që buron nga një marrëveshje e bërë vetëm mes individëve, detyron të gjithë individët që t'i nënshtrohen sovranit të tyre”.

Hobbes nuk e lavdëron absolutizmin dhe e paraqet atë si një pengesë të pashmangshme. Por në të njëjtën kohë, nënshtrimi ndaj një pushteti absolut është, sipas Hobbes, një domosdoshmëri për mbijetesë. Për më tepër, nëse pushteti sovran është pra domosdoshmërisht absolut, ky absolutizëm nuk i nënshtrohet arbitraritetit, që do të thotë, sovraniteti duhet të ushtrohet vetëm brenda kuadrit të ligjeve hyjnore dhe atyre natyrore. Pra sovrani duhet të ushtrojë funksionin e tij në përputhje me të drejtën hyjnore dhe natyrore dhe ai duhet të japë llogari vetëm përpara Zotit, që është autor i ligjit (Zhekeyeva, 2009:20).

3.2. Anti-absolutizmi

Doktrina e sovranitetit absolut ka arritur kulmin e saj në shekujtë XVII-XVIII, për t'i lënë vendin më vonë zhvillimit të teorive anti-absolutiste, të cilat u fokusuan në një studim më të thellë të nocionit të mbajtësit të sovranitetit dhe të mundësisë së ndarjes së pushtetit sovran.

3.2.1. Teoritë e para të sovranitetit të kufizuar

Një ndër përkrahësit e parë të teorisë së kufizimit të sovranitetit ishte teoricieni Althusius. Ai me veprën e tij “Politico methodice digesta atque exemplis sacris et profanis illustrata” (1603), i kundërvihet plotësisht paraardhësit të tij Bodin. Ai përkrah anti-absolutizmin dhe thekson që: “ekziston vetëm një mbajtës i mundshëm i sovranitetit: Populli.” (Chevallier,

1993:296). Althusius është një ndër autorët i lidhur me rrymën monarkomake⁵ (Morel, 1996:2) dhe është i pari që aplikoi nocionin e sovranitetit të popullit (Hinsley, 1986:132-133).

Teoria anti-absolutiste e Althusius fillon nga postulati që: populli, për nga vetë natyra e tij, është mbajtës i sovranitetit dhe se populli në raport me Mbretin, të cilit i ka deleguar pushtetin për të qeverisur në emër dhe për llogari të tij, gëzon superioritet ndaj këtij të fundit (Lloyd, 1997:262).

Idetë anti-absolutiste u përpunuan dhe u zhvilluan edhe nga autorë të tjerë, ku pa diskutim qasja e Hugo Grotius ndaj konceptit të sovranitetit meriton një ndalesë për analizë. Grotius e sheh sovranitetin si “pushtetin moral për të qeverisur një shtet”. Në veprën e tij, “De jure belli ac pacis”, Grotius beson që aftësia morale për të qeverisur një shtet buron nga aftësia për të krijuar norma juridike. Ai dallon dy subjekte si mbajtëse të pushtetit sovran: subjekti i përbashkët dhe subjekti individual. Më konkretisht, si subjekt i përbashkët i sovranitetit është shteti ndërsa subjekti individual është një person i vetëm ose një kolektivitet i cili zbaton ligjet dhe zakonet e një kombi të caktuar. Thënë me fjalë të tjera, me sa duket sovraniteti sipas Grotius nuk është absolut dhe ai i përket popullit. Megjithatë Grotius nuk është i mendimit që populli është mbajtësi i vetëm i sovranitetit. Populli, sipas Grotius, është i lirë të zgjedhë për t’iu nënshtuar një individ apo disa individëve, nëpërmjet procesit të transferimit të së drejtës për të qeverisur (Pradier-Fodert, 1999: 97-99). Ky transferim nuk është asgjë tjetër veçse shprehje e lirisë së plotë të individit për të zgjedhur se kush do ta qeverisë. Duke u nisur nga ky konstatim, Grotius arrin në konkluzionin që

⁵Kjo rrymë anti-absolutiste ishte rezultat i luftimeve fetare, e cila u përforcua akoma më shumë në shekullin XVI me masakrën e Shën Bartolomeut në vitin 1572. Kjo rrymë ishte shprehje e revoltës së Calvinistëve francezë kundër mbretit të pabesë dhe tiran. Në fakt, që nga 1572 lëvizja monarkomane, u shndërrua në kundërshtarin jo të regjimit monarkik, por në kundërshtarin e monarkisë absolute, e cila ishte, sipas tyre, një transformim i rrezikshëm i Mbretërisë origjinale.

populli nuk mund të qëndrojë mbi sovranin, kjo pasi populli i ka transferuar të gjithë pushtetin e tij sovranit dhe si rrjedhojë efektet e pushtetit nuk varen më nga vullneti i popullit. Kështu Grotius i qëndron idesë së ndarjes së sovranitetit mes popullit dhe sovranit. Sipas kësaj hipoteze, pushteti sovran nuk pushon së qënuri i tillë edhe atëherë kur ai që qeveris është i detyruar t'i nënshtrohet disa premtimeve drejt subjekteve të tij ose drejt Zotit (Zhekeyeva, 2009:23,24).

Pasardhës i teorive të Grotius ishte nxënësi i tij, Pufendorf. Ai me veprën e tij, “*De jure naturae et gentium*” (1672), përpunoi një teori të re të pushtetit, sipas së cilës të gjitha llojet e autoriteteve janë të bazuara në marrëveshje dhe në pëlqimin e lirë. Kjo lloj teorie u quajt nga Pufendorf doktrina e konservatizmit (Dufour, 1997:154). Nuk bëhej më fjalë për ndërhyrje teologjike; ndërhyrja sipas teorisë së Pufendorf-it duhet të vijë nga arsyeja. Njeriu është në të njëjtën kohë, për nga vetë natyra e tij, i shoqërueshëm por jo i gatshëm për t’iu nënshtuar autoritetit; në fakt shoqëria politike solli një ndryshim radikal në gjendjen natyrore të njeriut. Konkretisht ky ndryshim u pasqyrua në detyrimin e njeriut për të braktisur lirinë e tij natyrore dhe për t’iu nënshtuar sovranitetit, që nënkupton, ndër të tjera, të drejtën e jetës dhe të vdekjes mbi të si dhe të drejtën për të disponuar mbi pasurinë e tij (Dufour, 1997:519-520). Populli, me sa duket, qëndron në origjinë të të gjithave. Sipas Pufendorf, vetëm vullneti i popullit ka përcaktuar mbajtësin e pushtetit, vullnet i cili është shprehur në tre etapa të rëndësishme. Kështu, në fazën e parë, tërësia e individëve ka nënshkruar një kontratë asocimi që e ka transformuar atë në popull; faza e dytë ka të bëjë me marrëveshjen që arrihet nga populli për të përcaktuar modalitetet e kontratës së ardhshme të nënshtimit duke zgjedhur kështu formën e qeverisjes; për të kaluar më pas në fazën e tretë, në përfundimin e kontratës së nënshtimit e cila përcakton në të njëjtën kohë edhe mbajtësin e pushtetit, edhe detyrimet reciproke që një person ose një organ ka ndaj

atyre që e kanë zgjedhur si mbajtësin e pushtetit (Dufour, 1997:520-521). Thënë në mënyrë të përmbledhur, teoria e Pufendorf-it bazohet në dy kontrata: në kontratën e parë, që krijon shoqërinë civile, tërësia e individëve bashkohen në një trup të vetëm për të zgjidhur me marrëveshje të përbashkët çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe me sigurinë e tyre natyrore. Më pas, populli, me anë të një dekreti, vendos për formën e qeverisjes. Dhe në fund kemi kontratën e dytë sipas së cilës nëse qeveritarët angazhohen për të siguruar të mirën publike, të qeverisurit do t'i nënshtrohen me bisnikëri: ky pakt “nënshttrimi”, sipas Pufendorf, është më i rëndësishmi (Chevallier, 1993:520-521). Vullneti i popullit krijon kështu një realitet të ri moral, konkretisht një person moral që është Shteti, atributi dallues i të cilit është sovraniteti. Pufendorf krijon kështu një koncept të ri të personalitetit të shtetit. Sipas tij, personaliteti i shtetit nuk është një fikcion apo një trillim juridik, por një realitet moral, specifik dhe autonom; një person i përbërë. Shteti ka vullnetin e vet dhe pushtetin e tij karakteristik, që është sovraniteti (Dufour, 1997:520-521). Kështu sovraniteti shndërrohet në një atribut të shtetit dhe jo në një atribut të mbajtësit të pushtetit. E megjithatë nuk bëhet fjalë për një sovranitet popullor pasi pushteti nuk është thjesht krijim njerëzor. Nuk bëhet fjalë as për sovranitet hyjnor pasi pushteti i mbajtësit të sovranitetit nuk buron direkt nga Zoti. Si rrjedhojë, Pufendorf arrin në konkluzionin që sovraniteti buron në të njëjtën kohë edhe nga Zoti edhe nga populli si krijues i shoqërisë politike (Dufour, 1997:521-522).

Sipas Pufendorf, sovraniteti është pushteti suprem i një shteti, por jo pushteti absolut. Nisur nga ky qëndrim, Pufendorf konkludon që sovraniteti mund të kufizohet konstitucionalisht. Gjithashtu Pufendorf e cilëson sovranitetin si shpirtin e një shteti. Por pikërisht në këtë pikë teoria e Pufendorf-it tregon dobësitë e saj në lidhje me shkëputjen e pritshme nga absolutizmi: Ai beson se sovraniteti është i pandashëm, absolut dhe i shenjtë. Natyra e

shtetit aplikon pandashmërinë: ku çdo shkëputje apo ndarje e pjesëve të sovranitetit, do të thotë shkatërrim i shtetit. Pandashmëria e sovranitetit mund të krahasohet me lirinë e individëve në gjendjen e tyre natyrore, që është absolute dhe e pakufizuar, ku individi gëzon lirinë absolute për të vepruar sipas dëshirave dhe gjykimit të tij (Dufour, 1997:522-523).

Teoria e Pufendorf-it nuk mundi të dalë krejtësisht nga kthetrat e absolutizmit; për më tepër ajo tregon shpesh herë edhe “tendenca absolutiste” (Derathé, 1992:36). Ajo i jep një vend të rëndësishëm popullit duke nënvizuar që: të jesh sovran do të thotë të jesh absolut në kuptimin që duhet të njihesh si pushteti i vetëm dhe suprem por asnjëherë si pushtet absolutist në marrëdhënie me komunitetin (Hinsley, 1986:151). Duke iu referuar popullit, i cili mund t’i mbijetojë sovranitetit, shfaqet dhe mundësia e kufizimit të pushtetit të deleguar ose e ndarjes së tij mes disa organeve politike. Kështu sovraniteti nuk përcaktohet më në raport me sigurinë që duhet të garantojë por përcaktohet si rezultat i ndarjes së pushtetit mes disa grupeve shoqërore konkurrenente (Larrière, 1996:525). Çështja që mbetet është ajo e gjetjes së një hapësire të përshtatshme për të lejuar ushtrimin e pushtetit pa cënuar sovranitetin. Për këtë vjen në ndihmë teoria e ndarjes së pushteteve. Qëllimi i kësaj doktrine nuk është shkatërrimi i konceptit të sovranitetit. Përkundrazi, ekzistenca e sovranitetit është konsideruar si diçka e mirë-themeluar dhe e qartë. Nuk bëhet fjalë për të përcaktuar se ku qëndron sovraniteti dhe kujt i përket, por për të përcaktuar se si ai mund të ushtrohet në mënyrën më të mirë të mundshme nga të mandatuarit (Passerin d’Entreves, 1969:151). Në fund të fundit bëhet fjalë për t’i dhënë fund absolutizmit, i cili bazohej në pandashmërinë dhe në unitetin e pushtetit sovran. Në mënyrë të veçantë, objektivi kryesor i autorëve që mbështesnin teorinë e ndarjes së pushteteve ishte ndarja e pushtetit në mënyrë të tillë që çdo pjesë e tij pastaj të kontrollojë dhe të kufizojë njëri-tjetrin.

3.2.2. Teoria e ndarjes së pushteteve

Në pragun e përmbysjeve të mëdha politike që ndodhën në Angli, në shekullin XVII, dhe në Francë e Amerikë në shekullin XVIII, ishin tre mendimtarë të mëdhenj ata që u paraprinë ideologjive të kohës sonë: Locke, Montesquieu dhe Roussaueu (Omari, 2011:10).

Në teorinë e Locke, populli ka një rol të rëndësishëm në ekzistencën e sovranitetit, meqënëse ai është burimi i sovranitetit, por analiza e tij shkon më tej se ajo e Hobbes. Locke konstatoi që populli, materialisht, nuk mund të qeverisë. Si rrjedhojë e kësaj dhe të ndodhur përballë pamundësisë për t'i besuar popullit sovranitetin, ai zgjedh që t'ia besojë atë një grupi përfaqësuesish të popullit dhe jo shtetit. Kështu Locke, me teorinë e tij, bëhet paraardhësi i sovranitetit parlamentar (Mairet, 1996:68).

Locke në veprën e tij “Les Deux traités sur le gouvernement” (1689) formuloi idenë sipas së cilës pushteti i shtetit i përket gjithmonë shumicës, por që ky pushtet nuk është absolut, pasi individët nuk i kanë transferuar shtetit të gjitha të drejtat e tyre, por vetëm pushtetin ndëshkues dhe drejtësinë me qëllimin e vetëm që t’iu garantohet liria dhe pronësia e secilit prej tyre. Si rrjedhojë e kësaj Locke konkludon se i gjithë pushteti buron nga populli. Ai identifikoi tre aspekte apo tre forma me anën e të cilave shprehet pushteti: legjislativin, ekzekutivin dhe federativin (për marrëdhëniet ndërkombëtare), ku dy të fundit lidhen sëbashku në mënyrë të përgjithshme. Mbreti si president i pushtetit ekzekutiv, paraqitet si personi suprem në shtet dhe jo si autoriteti suprem. Për këtë arsye sovraniteti është parë si përkatësi ekskluzive e popullit, si burim i të gjitha pushteteve të shtetit (Zhekeyeva, 2009:26-27).

Ai që kontribuo në vazhdimin dhe në zhvillimin e ideve të Locke ishte Montesquieu. Ai në veprën e tij “De l’esprit des lois” (1748) përpunoi doktrinën e ndarjes së pushteteve, duke

vënë theksin tek ndarja horizontale e sovranitetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Në fakt, Montesquieu ishte autori i parë që propozoi ndarjen e pushteteve brenda shtetit duke u nisur nga ideja që liria duhet të jetë udhëzuesi i nevojshëm për ushtrimin e sovranitetit. Montesquieu i jep një vend të rëndësishëm ligjit, si një instrument të lirisë dhe ai i jep konceptit të sovranitetit një dimension kushtetues duke projektuar kështu sovranitetin parlamentar (Mortier, 2011:37). Gjithsesi duhet thënë që sovraniteti parlamentar i projektuar nga Montesquieu ngelet embrional dhe i pandashëm nga shteti duke qënë se ai u konceptua nën një rregjim monarkik (Mortier, 2011:37). Kështu Montesquieu nuk shpresonte të ndryshonte rregjimin monarkik të pranishëm në atë kohë në Francë dhe si rrjedhojë ai e projektonte sovranitetin parlamentar si një të tërë me sovranitetin e monarkut dhe me atë të shtetit. Nisur nga kjo, mund të themi që karakteri absolut i sovranitetit vazhdoi të jetë prezent edhe tek Montesquieu dhe që kuptimi i sovranitetit vazhdoi të ishte i papërcaktuar.

Megjithatë duhet thënë që kjo doktrinë ka shërbyer si themel për mohimin e absolutizmit dhe ka pasur influencë të konsiderueshme në përpunimin e teorisë së ndarjes së sovranitetit. Montesquieu theksonte se nëse pushteti legjislativ do të bashkohej me pushtetin ekzekutiv nuk do të ketë aspak liri. Kjo sepse në një unifikim të tillë pushtetesh mund të rrezikohet që monarku apo edhe senati të nxjerrin ligje tiranike për t'i zbatuar më pas në mënyrë tiranike. Për më tepër, nuk mund të pretendohet për liri nëse pushteti gjyqësor nuk është i ndarë nga ai legjislativ. Nëse ndarja nuk realizohet pushteti mbi jetën dhe lirinë e qytetarëve do të jetë, pa asnjë dyshim, arbitrar sepse gjyqtari do të jetë në të njëjtën kohë edhe ligjvënës. Situata do paraqitej problematike edhe atëherë kur pushteti ekzekutiv do të njësohej me pushtetin gjyqësor. Në këtë rast do rrezikohet t'i jepet gjyqtarit pushteti i një shtypësi. Të gjitha do të humbisnin nëse i njëjti person ose i njëjti organ do të ushtronte të tre këto

pushtete: pushtetin për të bërë ligje, pushtetin për të ekzekutuar ligjet dhe pushtetin për të gjykuar krimet. Megjithatë, nga sa u trajtua më lart, mund të konkludojmë që nuk bëhet fjalë për të zbatuar një doktrinë e cila ka si qëllim të saj shkatërrimin e sovranitetit. Përkundrazi kjo doktrinë synon që qytetarit t'i garantohet siguria e tij duke e kontrolluar atë dhe kjo do të arrihet më së miri duke ndarë ushtrimin e pushtetit në mënyrën më të mirë të mundshme (Passerin d'Entreves, 1969:152).

John Acton në veprën e tij “Ese dhe studime historike”,(1887) ka shkruar: “Pushteti ka prirje për korruptim dhe pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute” (Spagnol, 2007:750). Për të evituar këtë të keqe është e nevojshme të bëhet një organizim politik sipas të cilit pushteti i shtetit të ushtrohet nga organe të ndryshme.

Shpërdorimi i pushtetit mund të pengohet vetëm nëse “pushteti ndal pushtetin”. Kjo nënkupton jo një pushtet të vetëm dhe të përqëndruar, por një fragmentim të pushtetit dhe njëfarë shpërndarje të pushteteve të veçanta. Kjo ishte ideja e Montesquieu-së, megjithëse ai nuk e përdori shprehjen “ndarje e pushteteve”, që u përhap më vonë (Omari, 2011:13).

Teoria e Montesquieu-së do të kritikohet dukshëm nga Rousseau si teori e cila ka uzurpuar konceptin e sovranitetit.

3.2.3. Sovraniteti popullor

Jean Jacques Rousseau rishikoi teorinë e kontratës sociale të Hobbes dhe të Locke. Sipas tij, Hobbes ka uzurpuar sovranitetin në favor të monarkut dhe që sovrani i vetëm i mundshëm është populli. Rousseau e konceptonte sovranitetin si absolut dhe që i përket popullit duke hedhur poshtë idenë e sovranitetit përfaqësues (Mortier, 2011:38).

Kështu Rousseau në veprën e tij “Kontrata sociale”, duke përdorur idetë e Althusius mbi patjetërsueshmërinë e sovranitetit popullor, konceptin e Hobbes mbi pafundësinë e sovranitetit dhe doktrinën e Shkollës së të Drejtës Natyrore mbi origjinën kontraktuale të shtetit dhe të drejtat natyrore të njeriut, përpunoi doktrinën e sovranitetit popullor. Duke e përcaktuar sovranitetin si pushtetin absolut, të pavarur, të patjetërsueshëm dhe të pandashëm nga populli dhe të përcaktuar nga vullneti i përgjithshëm, ai e sheh esencën e sovranitetit ekskluzivisht tek ky vullnet (Fataud & Bartholy, 1972:105-106). Subjekti dhe mbajtësi i vetëm i sovranitetit është populli, i cili konsiderohet nga Rousseau si tërësia e qytetarëve të një vendi. Pra Rousseau ofron një tjetër përkufizim për sovranitetin, i cili është krijuar mbi bazën e vullnetin të përgjithshëm, që nënkupton vullnetin e vetëm të popullit.

Kështu Rousseau hap mundësinë e një revolucioni i cili do të lërë mënjanë sovranitetin mbretëror në favor të sovranitetit të popullit dhe që do të ndryshojë më në fund titullarin e sovranitetit, pa ndryshuar ndërkohë përmbajtjen e këtij nocioni (Mortier, 2011:38). Në fakt teoria e Rousseau-it e konsideron sovranitetin absolut, të pandashëm, të patjetërsueshëm, suprem dhe në duart e popullit.

Sovraniteti popullor, sipas Rousseau, është absolut sepse ai është vullneti i pandarë për vënien në jetë të së mirës së përbashkët. Në lidhje me karakterin absolut të sovranitetit, vlen të theksohet se, sipas Rousseau nuk bëhet fjalë për të vendosur sovranitetin absolut në kuptimin e teorive absolutiste. Sigurisht që pakti social kërkon një tjetërsim total të çdo individi bashkë me të drejtat e tij, tjetërsim që i jep fuqi absolute shtetit mbi të gjithë anëtarët e tij. Ky qëndrim i Rousseau-it është kritikuar nga interpretuesit e doktrinës së tij pasi ai, në kundërshtim me atë që thotë, ka sakrifikuar lirinë individuale në favor të plotfuqishmërisë së shtetit dhe krijon kështu një despotizëm që ka shumë ngjashmëri me atë

që citohej tek Leviatani i Hobbes. Është e qartë që tjetërsimi total i çdo bashkësie me të gjitha të drejtat e tij nuk shpie në suprimimin e të drejtave natyrore të individit, por bëhet fjalë për një truk të sofistikuar që synon shndërrimin e këtyre të drejtave në të drejta civile (Derathé, 1992:227-228).

Sovraniteti është suprem sepse asnjë pushtet tjetër nuk mund t'i kundërvihet vullnetit të përgjithshëm të popullit. Sovraniteti është i patjetërsueshëm, që do të thotë se nuk mund të ketë sovran tjetër përveç popullit (Derathé, 1992:49). Pra sovraniteti i përket ekskluzivisht dhe totalisht popullit. Në fakt sovrani nuk është asgjë tjetër veçse përfaqësimi i vullnetit të përgjithshëm, i cili nuk është as një përbërje e vullneteve individuale, as një kompromis mes tyre, por është vullneti i çdo qytetari, i cili është pjesë e popullit-sovran (Derathé, 1992:232-233).

Sovraniteti është i ngjashëm me lirinë e individit, i cili e bën atë të patjetërsueshëm: populli duhet të ruajë për vete ushtrimin e sovranitetit sepse sovraniteti i popullit është garanti i vetëm i lirisë individuale në shoqërinë civile (Derathé, 1992:262). Për më tepër, sovraniteti është i pandarë sepse vullneti i popullit është i përgjithshëm⁶.

3.2.4. Lindja e sovranitetit kombëtar absolut

Rousseau dhe Montesquie do të jenë baballarët doktrinarë të konceptit të ardhshëm të sovranitetit kombëtar. I pari, me teoritë e tij ishte shkaktari i ndryshimit të sovranit ndërkohë që i dyti bëri të mundur daljen e konceptit të sovranitetit kombëtar.

Në fakt Rousseau ka qënë kundërshtar i sistemit përfaqësues. Ai duke marrë shkas nga zgjedhjet parlamentare angleze thoshte se zgjedhësit anglezë janë të lirë vetëm kur zgjedhin

⁶Shih: Fataud & Bartholy, 1972:libri II, kapitulli II.

periodikisht njerëzit që do t'i përfaqësojnë në parlament, por pasi i zgjedhin, ata bëhen skllëvër të tyre. Populli, si sovran, duhet ta ushtrojë vetë pushtetin ligjvënës nëpërmjet referendumit, si shprehje e demokracisë së drejtpërdrejtë (Omari, 2011:14).

Parimisht idetë e Rousseau-it përjashtojnë parimin e përfaqësimit. Por, Rousseau pranonte që populli e ka të pamundur për t'u mbledhur periodikisht për marrjen e vendimeve dhe për këtë arsye ai propozoi idenë e zgjedhjes së njerëzve si të mandatuar të popullit për të përfaqësuar vullnetin e tij edhe pse jo me cilësinë e përfaqësuesit të popullit, por me cilësinë e atij që ka mandat detyrues (Omari, 2011:15).

Por ai që e teorizoi konceptin e sovranitetit kombëtar duke e “zbutur” teorinë e Rousseau-it dhe duke pranuar përfaqësimin ashtu siç u propozua nga teoria e Montesquie-së ishte Sieyès (Mortier, 2011: 37-38).

Sieyès i rikthehet idesë së Rousseau-it sipas së cilës sovraniteti është sinonim i vullnetit, por për të, ky vullnet duhet të ushtrohet vetëm nga kombi dhe jo nga populli. Sieyès mbështetet në teorinë e Rousseau-it në lidhje me përjashtimin e sovranitetit mbretëror duke ia atribuar atë kombit dhe ai propozon një përkufizim abstrakt, larg nga koncepti i popullit të prezantuar nga Rousseau (Mortier, 2011:38).

Sipas Sieyès, kombi është i pandashëm dhe i ndryshëm nga individët që e përbëjnë. Kombi përbëhet nga një entitet abstrakt, nga një person moral që ka vullnetin e vet, të pavarur nga vullneti i individëve. Ky vullnet sovran ka si qëllim arritjen e një të mire të përbashkët dhe meqënëse ajo është kolektive, ajo ka nevojë, si rrjedhojë, të caktojë përfaqësuesit e saj që të mund të ushtrohet dhe t'i imponohet pushtetit politik. Kështu, mund të themi që, sovraniteti kombëtar identifikohet me sovranitetin e deputetëve, kjo bazuar në një logjikë të thjeshtë: deputeti nuk ka mandat detyrues por quhet përfaqësues i popullit. Në fund të fundit, për

Sieyès, kombi është Shteti i tretë (Mortier, 2011:39). Teoria e sovranitetit kombëtar sipas Sieyès, pranon pa vështirësi përfaqësimin si një mekanizëm të nevojshëm qeverisjeje dhe që sovraniteti kalon nga populli tek përfaqësuesit e tij. Por pikërisht tek ky “kalim” bazohet dhe argumentimi që: kombi duke qënë një entitet abstrakt, në realitet, ai e largon popullin e vërtetë nga qeverisja. Faktikisht kjo tezë bie poshtë sepse vetë evolucioni i regjimit përfaqësues ka mundësuar pajtimin e kësaj teorie me idetë demokratike (Omari, 2011:15). Sot populli identifikohet me kombin në sajë të zbatimit të rregjimeve demokratike përfaqësuese dhe në sajë të universalizimit të votimit. Po ashtu sot i është hapur rruga edhe demokracisë së drejtpërdrejtë qëkurse është pranuar referundimi popullor (Chagnollaud, 2005:13). Për shembull në nenin 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është arritur një kompromis mes sovranitetit popullor dhe atij kombëtar: “1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. 2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose me referendum.”

Arsyeja se pse sot, në të gjitha vendet demokratike, ka përparësi sovraniteti kombëtar, ose thënë ndryshe demokracia përfaqësuese, ka të bëjë pikërisht me aftësinë e përfaqësuesve për të diskutuar në lidhje me problemet e një vendi, aftësi të cilat nuk mund t’i ketë një popull.

3.2.5. Shkolla gjermane: një përkufizim i ri i sovranitetit shtetëror

Doktrina gjermane, ofron një vizion më të fragmentuar të sovranitetit duke injoruar konceptin e sovranitetit kombëtar me qëllim nxjerrjen në pah të sovranitetit të shtetit. Ky sovranitet fillimisht ka një kuptim abstrakt dhe ka si titullar të tij shtetin dhe jo kombin. Sipas autorëve gjermanë debati lidhur me titullarin e sovranitetit është përfundimisht i zgjidhur: vetëm shteti është posedues i sovranitetit, ndërsa kombi nuk mund të konsiderohet

në asnjë mënyrë mbajtës i këtij pushteti abstrakt. Kështu pra ky sovranitet ka një kuptim konkret-material që korresponдон me pushtetin shtetëror dhe një kuptim konkret-organik i cili përcaktohet nga sovraniteti shtetëror (Mortier, 2011:52).

Sipas H.Gerber, pushteti shtetëror karakterizohet nga fuqia për të komanduar dhe reflekton një shkallë të caktuar të pushtetit, ndërsa sovraniteti nga ana tjetër nuk është asgjë tjetër veçse sinonim i pavarësisë së pushtetit publik. Kështu, sipas shkollës gjermane sovraniteti në mënyrë progresive boshatiset nga përmbajtja e tij duke përfaqësuar vetëm pavarësinë e tij, një formë abstrakte e sovranitetit sipas së cilës asnjë autoritet tjetër nuk mund të qëndrojë mbi shtetin (Mortier, 2011:53).

Edhe pse doktrina gjermane duket sikur fragmentarizon sovranitetin e shtetit duke injoruar sovranitetin kombëtar mund të themi që është e vështirë për të përcaktuar nëse kjo qasje teorike përbën apo jo pranimin e parë të kundërshtimit të karakterit absolut të sovranitetit. Në të vërtetë, kjo qasje të çon në dy përfundime krejtësisht të kundërta me njëra-tjetrën: Nga njëra anë, absolutizmi vazhdon të jetë prezent aty ku teoritë gjermane të sovranitetit të shtetit nuk pranojnë asnjë pushtet tjetër mbi shtetin; nga ana tjetër, evidentimi i pushtetit shtetëror “zhvesh” sovranitetin nga kuptimi i tij dhe si rrjedhojë dhe nga karakteri absolut (Mortier, 2011:53).

Rishfaqja e shtetit në doktrinën gjermane reflektohet gjithashtu edhe nga teoria e organit, që synon të bëjë ndarjen mes sovranit abstrakt, që është shteti dhe sovranit konkret që janë qeveritarët. Teoria e organit supozon që brenda shtetit ekzistojnë disa entitete përfaqësuese dhe ekzekutuese që veprojnë në emër të tij. Pikërisht në këtë kontekst, kombi kalon në plan të dytë, në rangun e një organi shtetëror , duke u krahasuar me trupin elektoral, i cili, sipas qasjeve gjermane përbën një ndër organet e një shteti sovran (Maulin, 2003:202).

Kjo teori shkon paralel me dallimin mes sovranitetit dhe pushtetit shtetëror, dallim i cili vazhdon të jetë një faktor dobësimi i konceptit të sovranitetit.

Dallimi që kjo teori bën mes sovranitetit dhe pushtetit publik mund të konsiderohet si një ndër shkaktarët e parë të vënies në diskutim të sovranitetit absolut. Së bashku me teorinë e organit ajo kontribuon në daljen në plan të parë të sovranitetit të shtetit duke spostuar kështu sovranitetin kombëtar. Megjithatë, akoma edhe sot ekzistojnë shtete të cilat vazhdojnë të ruajnë lidhjen e ngushtë Shtet-Komb duke ndikuar kështu në ruajtjen e sovranitetit absolut, siç është, për shembull, rasti i Francës. Por nga ajo çfarë u trajtua më lart, mund të shtrohet pyetja: Teoritë gjermane a vënë në dyshim lidhjen Shtet-Komb? Dhe përgjigja e vetme që mund të japim është se tashmë asgjë nuk është e sigurtë (Mortier, 2011:54). Në të vërtetë, doktrina gjermane ç'ekuilibron lidhjen mes Kombit dhe Shtetit, por pa e dëmtuar drejtpërdrejtë këtë lidhje. Ajo ofron një analizë ndryshe ndaj konceptit të sovranitetit dhe ka efekte tek natyra e pushtetit të shtetit dhe tek vendi që ai zë. Teoritë gjermane sollën thyrjen e parë të konceptit absolut të sovranitetit, pasi ato e projektojnë shtetin si titullarin e vetëm të pushtetit sovran, ndërsa Kombi cilësohet si një organ i shtetit. Megjithatë, teoritë gjermane, në thelb, nuk vënë në diskutim karakterin absolut të sovranitetit, duke qënë se karakteri absolut i tij i transferohet plotësisht sovranitetit të shtetit (Mortier, 2011:54).

3.2.6. Sovraniteti juridik

Duke marrë shkas nga çfarë u trajtua më lart mund të themi që nga pikëpamja e titullarit të sovranitetit, pra në planin politik, teoritë doktrinale patën vërtet ndikim në fragmentimin e sovranitetit pa i hequr ndërkohë atij dimensionin e vet absolut. Ndërsa nga pikëpamja e përmbajtjes, pra në planin juridik, karakteri absolut i sovranitetit kërcënohet më shumë.

Me kthimin e shtetit në plan të parë, një pjesë e konsiderueshme e doktrinës ka përkrahur idenë që sovraniteti është tërësia e pushteteve të shtetit, duke përsëritur kështu prerogativat e sovranitetit sipas teorisë së Bodin (Mortier, 2012:65). Sipas Laferrière, termi sovranitet nuk është cilësia e pushtetit shtetëror, por është përmbajtja pozitive e këtij pushteti (Laferrière, 1947:347).

Dallimi që u bë nga autorët gjermanë mes sovranitetit dhe pushtetit shtetëror ka provokuar shfaqjen e konceptit juridik të sovranitetit. Kështu, duke ndarë sovranitetin abstrakt nga pushteti i shtetit, logjikisht shkohet drejt idesë që është e mundur të bëhet ndarja mes cilësisë së pushtetit sovran dhe përmbajtjes së tij (Mortier, 2011:65). Kështu, sovraniteti u transformua në një koncept juridik që nënkupton tërësinë e kompetencave të shtetit (Hauriou, 1970:137). Në të vërtetë, janë autorët gjermanë ato që kanë teorizuar nocionin e sovranitetit si kompetencë të shtetit (Vahlas, 2005:1574-1575).

Kompetenca është pushteti që i atribuohet shtetit dhe pikërisht kombinimi i këtyre pushteteve bën të mundur që ta përkufizojmë sovranitetin si një tërësi kompetencash. Duke e konsideruar sovranitetin e shtetit si kompetenca e kompetencave të tij ai krijon një lidhje të ngushtë me të drejtën kjo bazuar në një logjikë të thjeshtë: vetëm nëpërmjet të drejtës shteti përcakton kompetencat e tij dhe si rrjedhojë edhe sovranitetin e tij (Mortier, 2011:65).

Sipas Jellinek, sovraniteti është “aftësia ekskluzive për të përcaktuar shtrirjen e rendit të vet juridik” (Beaud, 1994:1259). Po ashtu edhe Carré de Malberg e përcakton sovranitetin si “aftësinë e shtetit për të shtrirë pafundësisht kompetencat e tij” (Mortier, 2011:65).

Teoria e sovranitetit juridik është shumë më fleksibël se sa sovraniteti politik për sa kohë që ajo e pranon si të mundur ndarjen e sovranitetit (Hauriou, 1970:137). Si realizohet kjo

ndarje e sovranitetit mbi bazën e kësaj teorie? Meqënëse sovraniteti përcaktohet si një tërësi kompetencash atëherë mund të themi se këto kompetenca mund të ndahen ndërmjet disa autoriteteve shtetërore, po ashtu edhe ndërmjet shteteve të ndryshme apo organizatave ndërkombëtare. Pra, si rrjedhojë e konceptit juridik të sovranitetit dogma e sovranitetit absolut e bazuar tek pandashmëria bie poshtë duke i krijuar hapësirë ndarjes apo copëtimit të tij.

Sipas këtij koncepti teorik, sovraniteti juridik supozon një ndarje të pushteteve në bazë të ligjit dhe Kushtetutës e cila përcakton dhe rolet e secilit. Kështu sovraniteti juridik shërben si pikënisje e zhvillimit të konstitucionalizmit (Mortier, 2011:66).

Duke e bazuar pushtetin tek kompetencat dhe jo tek fuqia e titullarit, pjestueshmëria e sovranitetit është teorikisht e mundur duke qënë se ai mund të ndahet ndërmjet titullarëve të ndryshëm (Mortier, 2011:66).

Në këtë kontekst, karakteri absolut i sovranitetit mund të mbahet vetëm në drejtim të aftësisë së organit për të ruajtur kompetencën e tij dhe për ta bërë atë të zbatueshme. Kështu sovraniteti absolut mund të ruhet në disa fusha për sa kohë që aty kompetencat e ushtruara nuk kanë konkurrencë nga autoritete të ndryshme (Le Fur, 2000:484). Në këtë nivel reflektimi, mund të themi që sovraniteti fiton një kuptim të ri; pushteti sovran është ai që zotëron kompetencën e kompetencës në fushën e tij të përcaktuar nga Kushtetuta.

Pranimi i teorisë së ndarjes së sovranitetit, lidhja gjithnjë e në rritje mes shteteve gjatë shekullit XX, vullneti për të nënshtruar shtetin ndaj së drejtës dhe rregullave ndërkombëtare, kanë provokuar pyetjen lidhur me rëndësinë e konceptit absolut të sovranitetit (Mortier, 2011:67).

Shumë studiues të së drejtës kanë tentuar të sqarojnë marrëdhënien mes sovranitetit dhe shtetit, personalitetin juridik të shtetit dhe nënshkrimin e tij ndaj së drejtës. Sovraniteti juridik, në fakt, shtron çështjen e nënshkrimit të shtetit sovran ndaj së drejtës dhe mbi këtë logjikë, doktrina kushtetuese e konsideron shtetin si një subjekt të së drejtës i cili ka varësi ndaj kombit sovran. Duke u nisur nga kjo mund të shtrohet pyetja se si mundet që shteti si një person moral që i nënshtrohet të drejtës të jetë në të njëjtën kohë edhe sovran (Mortier, 2011:67)?

Sipas A.Haquet është e pamundur të gjendet pika e takimit mes shtetit si subjekt i së drejtës dhe sovranitetit. Një shtet ose është një person moral që i nënshtrohet të drejtës, por nuk është sovran, ose shteti është sovran dhe nuk i nënshtrohet detyrimit për të respektuar të drejtën (Haquet, 2004:132). Ai konkludon që vetëm nocioni i sovranitetit juridik mund të sigurojë një shpjegim bindës ndaj këtij bllokimi. Shteti si person moral i nënshtrohet të drejtës sepse ai posedon vetëm sovranitetin juridik dhe si rrjedhojë ai nuk mund të dalë përtej kufijve të kompetencave që i ka vënë vetes. Ndërsa Kombi është politikisht sovran, i “zhveshur” nga personaliteti moral dhe që nuk i nënshtrohet të drejtës. Sipas kësaj analize, mbajtësi i vërtetë i sovranitetit është Kombi i cili e ushtron sovranitetin me ndërmjetësinë e shtetit (Mortier, 2011:68).

Ky interpretim do të vërë në diskutim karakterin absolut të sovranitetit të shtetit duke mos prekur ndërkohë karakterin absolut të sovranitetit kombëtar. Nëse pushteti i shtetit analizohet në aspektin e kompetencave, kjo do të thotë që në planin e brendshëm, ai përcakton detyrimet ndërkombëtare që ka marrë përsipër dhe në planin ndërkombëtar, ai merr pjesë në hartimin dhe në zbatimin e rregullave të përbashkëta. Në këtë kuptim, shteti është juridikisht sovran, ai është i lirë të zgjedhë ushtrimin apo jo të disa kompetencave.

Sovraniteti juridik i shtetit nënkupton një tërësi të drejtash dhe detyrimesh (Cheng, 1991:583) që i imponohen njësoj të gjitha shteteve⁷.

Ky interpretim përbën padiskutim një dobësim të karakterit absolut të sovranitetit dhe një prishje të marrëdhënies mes sovranitetit të shtetit dhe sovranitetit kombëtar. Ky lloj sovraniteti përbën gjithashtu edhe një bazë reflektimi mbi lidhjen midis sovranitetit dhe së drejtës ndërkombëtare që u shfaq në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Sovraniteti juridik është një faktor që vë në diskutim konceptin absolut të sovranitetit, por në të njëjtën kohë, ai saktëson që sovraniteti ngelet një koncept qëndror i së drejtës ndërkombëtare për sa kohë që ajo përcakton shtetin dhe si rrjedhojë edhe pjesëmarrjen e tij në rendin ndërkombëtar (Aglaé: 1995:941). E drejta ndërkombëtare, në mënyrë paradoksale, justifikon vazhdimësinë e konceptit të sovranitetit të shtetit dhe kufizimin e tij të mundshëm.

Nga ana tjetër, duhet thënë që, sovraniteti juridik lë mënjanë çështjen e sovranitetit të kombit, duke u fokusuar më shumë tek entiteti që e ushtron sovranitetin, pra tek shteti, se sa tek titullari i tij, siç ndodh me teoricienët e sovranitetit politik. Sovraniteti si kompetencë modifikon konceptin e pushtetit të shtetit, pa provokuar ndërkohë një modifikim të pushtetit të kombit.



Sovraniteti paraqitet si një nocion evolutiv i cili vishet me karakteristikat e shoqërisë në të cilën zbatohet (Kranz, 1992:441). Kështu duke u nisur nga trajtimi që iu bë në këtë kapitull evolucionit të sovranitetit, qoftë në aspektin e përmbajtjes, qoftë në aspektin e titullarëve të

⁷ Shih nenin 2, paragrafi 1 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

tij, mund të themi që ky koncept ka kaluar nga të qenurit plotësisht absolut në domosdoshmërinë e kufizimit të tij.

Më konkretisht, gjatë kësaj analize historike të lindjes dhe të zhvillimit të teorive të sovranitetit, mund të themi që sovraniteti pësoi ndryshime lidhur me titullarin e tij dhe si pasojë e këtyre ndryshimeve u vu në rrezik sovraniteti mbretëror dhe monarkia absolute duke shkuar kështu drejt zëvendësimit të tij me sovranitetin popullor.

Megjithatë, duhet theksuar që, teoritë e shekullit XVIII nuk vënë në dyshim asnjëherë karakterin absolut të sovranitetit. Përkundrazi sovraniteti e ruan karakterin e tij absolut pavarësisht se ai është transferuar nga një autoritet tek tjetri, nga mbreti tek një entitet abstrakt (David, 1996:323).

Por më vonë, ballafaqimi i karakterit absolut të sovranitetit me teoritë gjermane nxjerr në pah elementë të ri analize lidhur me titullarët e sovranitetit. Pas ndryshimeve të shumta teorike, shteti fiton personalitet juridik njësoj si kombi dhe bëhet jo vetëm një entitet që shërben për organizimin e pushtetit, por edhe një mbajtës i mundshëm i sovranitetit. Për shkak të këtij ndryshimi, sovraniteti politik bëhet një nocion kompleks, i cili nuk është i qartë se kujt i përket: kombit, shtetit, përfaqësuesve apo një kombinimi të këtyre tre subjekteve? Pra këto teori veprojnë drejtpërdrejtë tek titullari i sovranitetit dhe tek lidhja shtet-komb. Megjithatë, të gjithë autorët bien dakord në një pikë që sovraniteti politik është supremacia e një pushteti që nuk njih asnjë konkurrent tjetër.

Sovraniteti politik, i cili përcakton pushtetin absolut të sovranit, i duhet të ballafaqohet me shfaqjen e konceptit të sovranitetit juridik. Një koncept i tillë udhëhiqet nga një rrymë e fortë konstitucionaliste dhe vuri në diskutim pandashmërinë dhe supremacinë e sovranitetit.

Koncepti juridik i sovranitetit, i njohur si kompetenca e kompetencës, shkakton një pikëpyetje të madhe mbi rëndësinë e kriterëve të sovranitetit të identifikuar nga Bodin.

KAPITULLI IV: QASJET BASHKËKOHORE NDAJ KONCEPTIT TË SOVRANITETIT

Hyrje

Debatet rreth konceptit të sovranitetit nuk janë shuar asnjëherë, që nga koha e shfaqjes së tij si koncept politiko-juridik deri në ditët e sotme. Në të vërtetë, duhet pranuar që nëse sovraniteti është një koncept problematik, siç e afirmonte Waltz (Waltz, 1979:95), kjo ndodh për shkak të pamundësisë që shfaqet në kohët bashkëkohore për të realizuar konceptin e sovranitetit sipas kuptimit të tij tradicional. Kjo pamundësi krijohet si rezultat i shfaqjes së disa fenomeneve të reja, të cilat nuk ekzistonin në kohën kur vetë koncepti *sovranitet* u prezantua. Bëhet fjalë për fenomene të tilla si: globalizimi dhe ndërvarësia, rritja gjithnjë e më shumë në numër e traktateve dhe e organizatave ndërkombëtare, etj. Megjithatë këto evolucione “empirike” nuk janë të vetmet që kanë provokuar diskutime mbi konceptin e sovranitetit. Ekzistojnë edhe qasje të reja kritike të cilat kanë vënë në diskutim këtë nocion. Kështu Onuf (Onuf, 1991:425) shkruan: “Me shfaqjen dhe zhvillimin e debateve akademike vitet e fundit lidhur me suksesin dhe perspektivat e modernitetit, është parë e nevojshme të bëhet një rishqyrtim apo një ripërcaktim i konceptit të sovranitetit”.

Pra sot sovraniteti diskutohet njëkohësisht në dy aspekte: në aspektin empirik dhe në aspektin epistemologjik. Ky interesim, në kohët aktuale, për konceptin e sovranitetit vjen si nevojë për t’i dhënë një kuptim të ri këtij nocioni i cili për një kohë të gjatë është konsideruar si i pakapshëm dhe i errët (Sorensen, 1999:590).

Në këtë kapitull do të synojmë të trajtojmë mënyrën se si koncepti i sovranitetit është dekompozuar, është vënë në diskutim dhe është riformuluar. Ajo çfarë konstatojmë gjatë procesit të transformimit të konceptit të sovranitetit është se ky koncept edhe pse ka evoluar dukshëm ai asnjëherë nuk e ka humbur koherencën e tij analitike.

Përballë evolucioneve të tilla, doktrina juridike bashkëkohore ofron qasje të ndryshme ndaj nocionit të sovranitetit duke kërkuar më shumë në mundësinë për ta ri-interpretuar se sa për ta zhvlerësuar atë.

Në fund të fundit do arrijmë të shohim që sovraniteti nuk kuptohet sot në mënyrë uniforme nga të gjithë, por secili prej autorëve ose secila prej qasjeve që trajton nocionin e sovranitetit i jep këtij të fundit një imazh të caktuar i cili ndryshon, pa diskutim, me imazhin që mund t'i japë një tjetër autor apo një tjetër qasje.

4.1. Adaptimi i konceptit të sovranitetit me një realitet të ri ndërkombëtar

Sot, përballë një realiteti të ri të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare shtrohet çështja e adaptimit apo e aktualizimit të konceptit të sovranitetit. Krasner (Krasner, 1997:51, Krasner 1989:89) është i mendimit që modeli Westphalian empirikisht është i pasaktë. Ndërsa Werner dhe De Wilde (Werner & De Wilde, 2001:285) afirmojnë që po shkohet gjithnjë e më shumë drejt spostimit të elementëve konkretë që afirmojnë ekzistencën e shteteve sovrane. Ose siç thoshte James (James, 1986:166) nëse sovraniteti tradicional nuk reflekton realitetin aktual ndërkombëtar atëherë është e nevojshme të ofrojmë perspektiva të reja mbi konceptin e sovranitetit, duke kërkuar, siç është cituar edhe më lart, më shumë në mundësinë për ta ri-interpretuar se sa për ta zhvlerësuar atë.

3.1.1. Sovraniteti pozitiv dhe sovraniteti negativ sipas Robert Jackson

Jackson, përfaqësues i Shkollës Angleze, ishte ndër autorët e parë i cili i hapi rrugë ri-konceptualizimit të sovranitetit. Ai përqëndrohet, në veçanti, në studimin e një fenomeni i cili duket se është në kontradiktë me sovranitetin në kuptimin e tij tradicional. Ky fenomen lidhet me ekzistencën e atyre shteteve të cilat nuk plotësojnë të gjitha kriteret për të qënë sovrane. Këto shtete, sipas Jackson, klasifikohen si “kuazi-shtete” dhe janë kryesisht të pranishme në Botën e Tretë. Këto shtete paraqesin një sfidë të madhe analitike: si shpjegohet ekzistenca e tyre kur në thelb iu mungon “substanca” shtetërore? Si mund të konsiderohen këto shtete sovrane kur ato nuk e ushtrojnë autoritetin e tyre sovran? (Mathieu, 2012:4).

Për të shpjeguar këtë fenomen, Jackson e “hap” konceptin e sovranitetit drejt mundësive për interpretime të reja nën dritën e realiteteve bashkëkohore. Ai është i mendimit që për të kuptuar mënyrën e funksionimit të sovranitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare është e nevojshme të dallojmë sovranitetin pozitiv dhe atë negativ. Sovraniteti pozitiv, sipas Jackson, presupozon që shtetet posedojnë kapacitete të mjaftueshme që i lejojnë atyre të jenë zotër të vetes. Ndërsa sovraniteti negativ nënkupton lirinë e shteteve për të rregulluar çështjet e tyre të brendshme pa ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm (Jackson, 1990:29,27). Nëqoftëse forma e parë e sovranitetit korrespondon me sovranitetin shtetëror ideal duke qënë se shteti këtu e ushtron në mënyrë efektive autoritetin e tij, forma e dytë i korrespondon shfaqjes së një rregjimi të ri të sovranitetit. Jackson sqaron se para shfaqjes së këtij rregjimi të ri, shtetet sovrane në kuptimin pozitivist të sovranitetit, pra empirikisht, kishin autoritet real dhe të identifikueshëm, gjë që nuk ndodh realisht sot, siç është rasti i

shteteve të shumta “josubstanciale”. Këto “kuazi-shtete” i mbijetojnë realitetit aktual vetëm falë mbrojtjes minimale kundër ndërhyrjeve të jashtme dhe jo nga fakti se këto shtete ushtrojnë autoritet substancial apo pozitiv brenda territoreve të tyre (Mathieu, 2012:5).

Pra sipas Jackson sistemi ndërkombëtar ka pësuar një ndryshim të thellë ku “kuazi-shtetet” jo vetëm që mbrohen nga ndërhyrjet e jashtme, por ato, edhe pse nuk e ushtrojnë efektivisht autoritetin e tyre, nuk mund as të pushojnë së ekzistuari, as të pushtohen nga një forcë e jashtme. Jackson, duke nënvizuar idenë që vetëm shtetet pozitivisht sovranë posedojnë autoritet absolut dhe ekskluziv në territorin e tyre dhe që sovraniteti negativ nuk ka të bëjë shumë me sovranitetin në kuptimin tradicional të tij, u ndërgjegjësuara në lidhje me një ndër anomalitë më të shpeshta të sovranitetit, që konkretisht ka të bëjë me mungesën e attributeve sovranë të “kuazi-shteteve”, të cilat megjithatë vazhdojnë të jenë të pavarur.

3.1.2. Sovraniteti si “hipokrizi e organizuar” sipas Stephen Krasner

Në vitin 1999, Krasner, teoricien realist, do të interesohet për të analizuar funksionimin empirik të sovranitetit. Krasner synon të sqarojë, njësoj si Jackson por në një aspekt më të gjërë, përse sovraniteti vazhdon të ekzistojë si një normë qendrore në marrëdhëniet ndërkombëtare, pavarësisht cënimeve të vazhdueshme ndaj këtij koncepti. Në të vërtetë, për Krasner (Krasner, 1999:28) pavarësia, e cila duhet të burojë nga sovraniteti, është shkelur në mënyrë të vazhdueshme, si rrjedhojë shkeljet e sovranitetit janë bërë një rutinë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Për të shpjeguar këtë fakt, sipas Krasner mund të jepen dy shpjegime. Së pari, marrëdhëniet ndërkombëtare janë një mjedis në të cilin normat kanë pak ndikim. Pse? Arsyeja e këtij ndikimi të zbehtë lidhet me faktin që aktorët shtetërorë nuk i nënshtrohen në mënyrë të

sinqertë këtyre rregullave. Për Krasner, rregullat respektohen vetëm atëherë kur aktorët shtetërorë kanë interes për ta bërë. Ky qëndrim e bën Krasner ta konsiderojë sovranitetin si një “hipokrizi të organizuar”, që do të thotë norma juridike respektohet nga aktorët shtetërorë kur kjo është në interesin e tyre për ta bërë, por dhunohet atëherë kur nuk i përshtatet interesave të tyre. Kështu, respektimi i normave ndërkombëtare, siç mund të jetë edhe sovraniteti, do jetë në varësi të interesit personal të aktorëve shtetërorë (Lake, 2003:309). Nga kjo fare lehtë mund të konkludojmë që koncepti i sovranitetit, në mënyrë alternative, edhe respektohet edhe dhunohet.

Fakti që normat kanë vetëm ndikim relativ në raport me pushtetin dhe me interesin e më të fuqishmëve, do të thotë që ky qëndrim i Krasner nuk përfaqëson të vetmin sqarim se pse sovraniteti është vazhdimisht një normë e shkelur. Sipas Krasner sovraniteti mund të ndahet në katër pjesë, të cilat zakonisht i gjejmë të grupuara tek koncepti unitar i sovranitetit: 1. Sovraniteti i brendshëm, i cili nënkupton organizimin e pushtetit politik brenda territorit të një shteti dhe niveli i kontrollit efektiv i ushtruar nga autoriteti shtetëror; 2. Sovraniteti si ndërvarësi që ka të bëjë me aftësinë e autoriteteve publike për të kontrolluar flukset ndërkufitare; 3. Sovraniteti ligjor ndërkombëtar, që i referohet njohjeve të ndërsjellta mes shteteve; 4. Sovraniteti westphalian i cili nënkupton përjashtimin e ndërhyrjes së faktorëve të jashtëm në çështjet e brendshme të një shteti, pra ky lloj sovraniteti i referohet rregullit të mos-ndërhyrjes (Krasner, 1999:9). Ajo çfarë vlen të thuhet pas kësaj ndarjeje është se këto elementë të ndryshëm që përbëjnë sovranitetin janë të pavarur nga njëri-tjetri. Thënë me fjalë të tjera, një shtet mund të ketë sovranitet ligjor ndërkombëtar, por është i paaftë të sigurojë pavarësinë në zgjidhjen e çështjeve të tij të brendshme duke lejuar kështu, në mënyrë indirekte, ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm. Pra mund të mos ketë sovranitet westphalian. Për më tepër ushtrimi i një forme të sovranitetit mund të ndikojë në humbjen e

një forme tjetër të tij (Krasner, 1999:4). Mund të përmendim si shembull rastin e shteteve që aderojnë në Bashkimin Evropian. Aderimi i tyre në këtë organizatë ndërkombëtare riafirmon sovranitetin e tyre ligjor ndërkombëtar, por ka si pasojë cënimin e pjesshëm të sovranitetit westphalian të shteteve aderuese.

Kështu sipas Krasner (Krasner, 1999:226) elementët e ndryshëm të sovranitetit nuk janë të lidhur me njëri-tjetrin si një tërësi organike, përkundrazi ato ndryshojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Pikërisht kjo ndarje radikale e elementëve të sovranitetit i jep mundësinë Krasner të shpjegojë që sovraniteti vazhdon të ekzistojë si nocion kyç në të drejtën ndërkombëtare pavarësisht se ai shpesh herë edhe çënohet.

Teoria e Krasner përfaqëson me të vërtetë një evolucion të madh në teorinë e sovranitetit. Qasja sipas së cilës sovraniteti është një koncept i pandarë dhe absolut pak nga pak i hap rrugë qasjeve të reja sipas të cilave sovraniteti jo vetëm që mund të ndahet por edhe mund të përdoret dhe negociohet me të në varësi të interesave të aktorëve shtetërorë (Mathieu, 2012:7).

3.1.3. Sovraniteti si fakt social

Një qasje tjetër ndaj nocionit të sovranitetit u shfaq në mesin e viteve '90 nga ana e hulumtuesve konstruktivistë. Sipas tyre sovraniteti është një fakt social, pra është një koncept i krijuar në mënyrë intersubjektive nga vetë aktorët shtetërorë (Zaum, 2007:2, 29). Sipas tyre sovraniteti nuk është më një e “dhënë” por është rezultat i një procesi të vazhdueshëm krijimi. Praktikrat dhe vendimet e aktorëve shtetërorë kanë ndikuar në transformimin e sovranitetit. Megjithatë ky transformim nuk do të thotë që përmbajtja e konceptit të sovraniteti mund të ndryshojë sipas dëshirës. Në momentin kur sovraniteti merr

formë, pra krijohet, ai nuk mund të transformohet lehtësisht. Këtë qëndrim mban në fakt edhe Lake (Lake, 2003:308) sipas të cilit: “ta konsiderosh sovranitetin si një fakt social nuk do të thotë se ai është një koncept fluid dhe i lakueshëm”.

Përmbajtja e sovranitetit nuk është fikse dhe siç e shpjegon Aalberts (Aalberts, 2006:3): “sovraniteti si nocion është krijuar, është ruajtur dhe është modifikuar” përmes praktikave dhe ritualeve. Këtu mund të përmendim fare mirë ndërveprimet mes shteteve, të cilat përcaktojnë kuptimin e sovranitetit duke kontribuar kështu në stabilizimin apo në ndryshimin e tij. Autorët konstruktivistë e vënë theksin tek aspekti social i konceptit të sovranitetit, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në relativizimin e interpretimit klasik të sovranitetit si pushtet apo autoritet absolut (Mathieu, 2012:8).

Sipas Philpott sovraniteti është transformuar përgjatë “revolucioneve ideologjike”, ku deri më sot dy më të rëndësishmet janë: traktatet e Westphalisë dhe procesi i dekolonizimit. Por kuptimi i sovranitetit mund të transformohet fare mirë edhe nga dy zhvillime të kohëve aktuale: integrimi i shteteve në Bashkimin Evropian dhe rritja e rëndësisë së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore. Lidhur me këtë të fundit Reus-Smit ishte i mendimit që sovraniteti nuk mund të konsiderohet si një normë “vetë-referuese”, pasi ajo varet nga parime të jashtme të cilat i janë inkorporuar gradualisht vetë konceptit. Konkretisht, të drejtat e njeriut janë inkorporuar tek koncepti i sovranitetit që nga mesi i shekullit të njëzet, inkorporim i cili solli nevojën e ripërcaktimit se çfarë është ose çfarë duhet të jetë një shtet sovran. Me pak fjalë, me kalimin e kohës sovraniteti është transformuar qoftë në aspektin e burimit të legjitimitetit, pra të titullarit të tij, qoftë në aspektin e shtrirjes së veprimtarive që i janë besuar shtetit sovran (Biersteker dhe Weber, 1996:14).

Për të përmbledhur atë çfarë pasqyruam më lart mund të themi që pas viteve '90 koncepti i sovranitetit ka një vizion të ri. Por Jackson dhe Krasner nuk mjaftohen me faktin që i kanë hapur rrugë interpretimeve mbi sovranitetin dhe kanë ndarë elementët përbërës të tij. Autorët konstruktivistë insistojnë në aspektin evolutiv të sovranitetit. Kuptimi i sovranitetit nuk duhet të përcaktohet mbi bazën e një përkufizimi të ngurtë dhe të pandryshueshëm, pasi çdo epokë ka modelin e saj të sovranitetit (Thomson, 1995:228). Kështu sovraniteti, vazhdimisht, është ndërtuar dhe rindërtuar duke lënë ndërkohë të pandryshueshme disa aspekte dhe duke modifikuar disa të tjerë (Jackson, 2007:23).

Problemi i këtyre qasjeve është se ato përballen gjithmonë me të njëjtin problem: është e vështirë të ripërcaktohet kuptimi i sovranitetit pa sakrifikuar qëndrueshmërinë e këtij koncepti. Për të evituar këtë pengesë duhet që të vihen kufizime lidhur me transformimin e konceptit të sovranitetit sepse po nuk u vendosen caqet rrezikohet të shkohet larg përkufizimit fillestar duke mos e ri-interpretuar atë por duke krijuar një koncept krejtësisht të ndryshëm (Keohane, 2002:743, Jackson 1999:433).

4.2. Evolucioni bashkëkohor i konceptit të sovranitetit

Forma aktuale e sovranitetit, në thelb, nuk është në kundërshtim me konceptin tradicional të tij. Plasticiteti i sovranitetit, i cili u afirmua dukshëm nga ata që vunë në diskutim versionin klasik të tij, nuk shpie domosdoshmërisht drejt mungesës së koherencës konceptuale të sovranitetit. Për të kuptuar pse, le të shohim pak më në detaje evolucionin aktual të përmbajtjes së sovranitetit.

4.2.1. *Sovraniteti si përgjegjësi dhe sovraniteti si aftësi*

Pjesa më e madhe e studiuesve të sovranitetit, pavarësisht se e kanë atakuar këtë koncept, ata asnjëherë nuk e kanë vënë në diskutim kuptimin tradicional të tij. Pra, pavarësisht çdo interpretimi aktual të sovranitetit, thelbi konceptual i tij është ruajtur, duke bërë kështu që koncepti i sovranitetit pavarësisht evolucionit të tij, të mos e humbasë koherencën e vet. Ky justifikim klasik i sovranitetit bëhet më qëllimin për të kuptuar dobinë e tij. Është e qartë se koncepti i sovranitetit është larg të qënurit një koncept arbitrar dhe që, tradicionalisht, roli i tij ka qënë t'iu garantojë entiteve politike pavarësinë ndaj faktorëve të jashtëm, pavarësi e cila në fund të fundit presupozohet të jetë fitimprurëse për shtetet (Jackson: 1990:183). Kështu sovraniteti lejon një ndarje mes sferës së autoritetit të brendshëm dhe mjedisit të jashtëm, por kjo ndarje është e justifikueshme vetëm atëherë kur shteti sovran arrin qëllimin e tij, pra kur ai e konkretizon se pse është i pavarur. Thënë me fjalë të tjera, kjo ndarje ndodh atëherë kur ekzistenca e shtetit të pavarur shihet si e dobishme në aspektin e krijimit të një rendi që të shpie drejt asaj që quhet “*bonne vie*” (jetesë e mirë) (Mathieu, 2012:10).

Sipas Bain (Bain, 2003:168), shteti sovran është hapësira e duhur ku koncepti “i/e mirë” apo “i/e dëshirueshëm/shme” mund të krijohet dhe potencialisht të materializohet. Keohane (Keohane, 2002:744) ndërkohë kombinon me njëri-tjetrin konceptin e sovranitetit me atë të suksesit. Jackson (Jackson, 1990:136) argumenton se pavarësia politike dhe mirëqenia socio-ekonomike janë një gjë e vetme, duke përjashtuar këtu rastin e “kuazi-shteteve” të cilat, për arsye të justifikueshme, nuk kanë një sovranitet real. Mund të përmendim në fund edhe qëndrimin e autorit Zaum (Zaum, 2007:35) sipas të cilit sovraniteti pozitiv përshkruan një shtet që gëzon të drejtën për të qënë i pavarur si rezultat i aftësisë së tij për t'i ofruar të mira politike popullit të tij. Thënë me fjalë të tjera, sovraniteti është një shpërblim i kushtëzuar, sepse shteti është i kushtëzuar në respektimin e disa përgjegjësive brenda

hapësirës së ushtrimit të sovranitetit të tij. Pra, është e qartë lidhja mes sovranitetit dhe përgjegjësisë së shtetit dhe lidhja mes sovranitetit dhe aftësisë së shtetit, por për të kuptuar më mirë se si ka evoluar koncepti i sovranitetit në këtë këndvështrim është e rëndësishme të identifikojmë përmbajtjen dhe kuptimin e fjalës “bonne vie” (jetesë e mirë) .

4.2.2. *Sovraniteti dhe “qeverisja e mirë”*

Kuptimi që i jepet sot sovranitetit reflekton para së gjithash konceptin perëndimor të “jetesës së mirë”, e cila juridikisht shprehet me termin “qeverisje e mirë”. Qeverisja e mirë i referohet atyre elementëve që konsiderohen si të domosdoshëm për mirëqënien publike dhe një qeverisje është e mirë kur ajo i siguron shoqërisë së saj atë për të cilën ajo ka nevojë. Më konkretisht ato nevoja publike që i gjejmë tek koncepti i qeverisjes së mirë janë: demokracia liberale, ekonomia e tregut dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këto tre elementë përfaqësojnë sot një normë referuese të sovranitetit, ekzistenca e të cilave kushtëzohet nga ekzistenca e një shteti mirëqeverisës. Në literaturën bashkëkohore, ndodh rëndom që të përmendet ky relativitet i nocionit të sovranitetit në raport me aftësinë e shtetit për t’i siguruar popullsisë së tij një qeverisje të mirë. Kështu pra, duke u nisur nga domosdoshmëria e pranisë së këtyre elementëve tek një shtet në mënyrë të tillë që ky i fundit të njihet si sovran, mund të themi që sovraniteti pa një qeverisje të mirë shndërrohet në një koncept jo të plotë dhe si rrjedhojë në një koncept të cënuar (Mathieu, 2012:10-11).

Të tilla tendenca të reja në lidhje me sovranitetin janë shumëfishuar këto vitet e fundit. Një ndër mbështetësit kryesorë të këtij koncepti është Krasner (Krasner 2004:93) i cili i jep të njëjtin kuptim shprehjeve “dështimet e qeverisjes” dhe “dështimet e sovranitetit”.

Mirëpo ky lloj ri-karakterizimi i sovranitetit (Etzioni, 2006:75) bën të mundur (ri-) hyrjen e konceptit të hierarkisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke qënë se sovraniteti nuk ushtrohet njësoj në të gjitha shtetet. Mund të përmendim këtu rastin e shteteve të dobëta, shtetet në ndërtim, rastet e ndërhyrjeve humanitare, në të cilat është e nevojshme ndërhyrja e faktorëve të jashtëm për të përforcuar shtetin dhe sovranitetin e tij.

Një ndër autorët më kritikë ndaj kësaj qasjeje është Zaum, sipas të cilit sovraniteti përfshin në vetvete tre elementët e cituara më lart të qeverisjes së mirë, por sipas tij ky konceptualizim i ri mbi sovranitetin e shtyn bashkësinë ndërkombëtare të shkelë një ndër parimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, atë të vetëvendosjes së shteteve (Zaum, 2007:5, 40).

Duke e konsideruar sovranitetin si një koncept që, në mënyrë të qartë, lidhet me shprehjet “jetesë e mirë” apo “qeverisje e mirë” shtrohet çështja e normativës së konceptit. Në qoftë se përmbajtja e sovranitetit është përcaktuar nga një shoqëri ndërkombëtare gjërësisht perëndimore, atëherë mund të themi që sovraniteti është një disiplinë që i imponohet shteteve dhe ju tregon atyre formën e eksistencës dhe formën e duhur të organizimit politik (Aalberts, 2006:164).

Sigurisht që aspekti normativ i sovranitetit nuk është diçka e re. Sipas Thomson teoritë e Bodin dhe të Hobbes ishin më shumë justifikuese se sa përshkruese të situatës politike të asaj kohe ku të dy këto autorë kanë tentuar të ndërtojnë një sistem të qëndrueshëm politik nëpërmjet zgjerimit të kompetencave të shtetit (Thomson, 1995:214). Por fakti që diskutimet e shumta mbi sovranitetin shpesh herë shprehin atë çfarë është politikisht e dëshirueshme (Kalmo & Skinner, 2010:9) është një tregues që sovraniteti mund të konceptohet si një dëshirë për një sistem më të mirë politik i konceptuar në mënyra të

ndryshme në periudha të ndryshme kohore. Megjithatë, vlen të theksohet që pikërisht tek aspekti normativ i sovranitetit qëndron çështja e raportit mes sovranitetit dhe pavarësisë. Për një kohë të gjatë, të dy konceptet janë përdorur si sinonime. Për shembull Waltz shkruante: “të thuash që një shtet është sovran do të thotë që ai vendos vetë se si do të zgjidhë çështjet e tij të brendshme dhe ato të jashtme” (Waltz, 1979:96). Megjithatë, nëse sovraniteti përcakton se çfarë duhet të bëjë një shtet për t’u njohur si sovran në arenën ndërkombëtare, atëherë mund të themi që sovraniteti është më shumë një pavarësi e kushtëzuar, se sa një pavarësi absolute, siç pasqyrohet tek përkufizimi klasik i sovranitetit. Pse pavarësi e kushtëzuar? Që një shtet të quhet sovran ai duhet të ketë materializuar një sistem politik dhe shoqëror të udhëhequr nga “jetesa e mirë” ose thënë në terma juridikë nga “qeverisja e mirë”.

4.3. Qasjet post-pozitiviste mbi konceptin e sovranitetit

Nëse qasjet e ndryshme, sidomos ato konstruktiviste, kanë treguar qartësisht se kuptimi i sovranitetit nuk është i pandryshueshëm dhe që ai i është nënshtruar transformimeve të vazhdueshme, na ngelet të trajtojmë çështjen e mëposhtme: kush e përcakton ose kush ndikon në kuptimin e sovranitetit? Thënë me fjalë të tjera, nga ku burojnë normat sovrane? Për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, nuk vijnë shumë në ndihmë qasjet konstruktiviste, por janë qasjet post-pozitiviste ato që duke pranuar dimensionin normativ të sovranitetit, na japin mundësinë për të kuptuar më mirë funksionimin e tij (Mathieu, 2012:13).

4.3.1. Sovraniteti: një koncept domosdoshmërisht normativ

Qasjet post-pozitiviste trajtojnë çështjen e kuptimit të sovranitetit në një këndvështrim të ri: sipas tyre është e pamundur të përcaktohet kuptimi i sovranitetit pa përfshirë normativen e

tij, thënë me fjalë të tjera, është e vështirë të përcaktohet kuptimi i sovranitetit pa i imponuar atij një koncept të veçantë i cili mund të përkufizohet. Sovraniteti nuk ka një kuptim të qëndrueshëm (Bartelson, 1995:12) dhe është një nocion i cili ndryshon historikisht dhe gjeografikisht (Weber, 1995:16). Në qoftë se sovraniteti ka një kuptim apo përmbajtje, kjo nuk mund të jetë e përjetshme apo universale. Në lidhje me këtë çështje Walker sqaron se trajtimi i problemit të sovranitetit me fokus tek përkufizimi i tij favorizon një amnezi totale lidhur me karakterin e tij historikisht dhe gjeografikisht specifik (Walker, 1993:166). Thënë me fjalë të tjera, sovraniteti transformohet në një objekt ontologjik duke i dhënë kështu këtij nocioni një kuptim evolutiv (Doty, 1996:96).

Sipas post-pozitivistëve sovraniteti është në të njëjtën kohë i lidhur me evoluimin e shoqërive dhe në kërkim të një përkufizimi të qëndrueshëm të kuptimit të tij. Sipas Walker, sovraniteti duhet të mendohet si një praktikë e gjërë politike dhe jo si një kërkesë juridike abstrakte (Walker, 1993:154). Koncepti i sovranitetit jep një përgjigje të saktë lidhur me çështjen e mundësisë së jetës në komunitet. Walker afirmon që “jetesa e mirë”, e udhëhequr nga parime universale, mund të materializohet vetëm brenda komuniteteve të ndryshme politike (Walker, 1993:64). Sovraniteti përcakton se si mund të jenë dhe se si duhet të jenë komunitetet. Pra tek nocioni i sovranitetit mund të gjejmë në të njëjtën kohë edhe aspektin artificial edhe atë vullnetar. Ky këndvështrim mbi sovranitetin i dha shtysë Bartelson të arrijë në konkluzionin që: “kur duhet të përcaktojmë kompetencat dhe përmbajtjen e sovranitetit nuk kemi rrugë tjetër vetëm të kërkojmë pozicionimin e tij në kohë dhe në hapësirën politike” (Bartelson, 1995:3, 33). Thënë me fjalë të tjera, sovraniteti reflekton një vizion apo një perceptim të veçantë të “realitetit”.

Kështu sovraniteti bëhet pjesë qendrore e kritikave post-koloniale të marrëdhënieve ndërkombëtare. Nuk ka asnjë dyshim për autorët post-pozitivistë që Perëndimi, dhe më

konkretisht Shtetet e Bashkuara, janë në thelb dhe domosdoshmërisht sovranë dhe mishërojnë “modelin e gjallë” të sovranitetit (Doty, 1996:97). Sipas Dunn universaliteti i sistemit shtetëror perëndimor ka kontribuar në deligjitimimin dhe në abolimin e strukturave tradicionale socio-politike të shteteve të jugut dhe në këtë mënyrë edhe në delegjitimin dhe në abolimin e “sovranitetit” (Dunn, 2003:40). Megjithatë, kritikët post-kolonialë janë përqëndruar kryesisht në formën e shteteve kombe dhe në aspektin iluziv të pavarësisë së fituar nga ish-kolonitë, duke shpjeguar veçanërisht që shteti dhe vetë sovraniteti nuk janë enë bosh por kanë një përmbajtje nga e cila është e vështirë të shmangesh ose të largohesh (Seth, 2000:221).

Kështu sovraniteti mund të konsiderohet si një “horizont i diskutueshëm” për sa kohë që ai përcakton se sa kufizon masën e mundësive (Walker, 1993:10). Sipas Walker, koncepti i sovranitetit është një gjykim që na tregon shumë në lidhje me jetën tonë politike dhe në lidhje me mundësitë që na ofron bota politike në të cilën ne jetojmë (Walker, 1993:25).

4.3.2. *Një sovranitet përformues?*

Sipas analizave post-pozitiviste, të projektosh sovranitetin si një fenomen të thjeshtë empirik është vërtet problematik (Bartelson, 1995:52). Është problematik sepse, parë në këtë këndvështrim, koncepti i sovranitetit nuk mund t’i nënshtrohet një analize përfundimtare të tij (Prokhovnik, 2007:30).

Meqënëse post-pozitivistët vënë në dyshim efikasitetin dhe vlefshmërinë e analizave empirike të sovranitetit, atëherë lind pyetja se çfarë alternative tjetër propozojnë ato në lidhje me kuptimin e sovranitetit? Duke u nisur nga postulatët e sipërcituar, të cilët e shohin sovranitetin si një debat konstitutiv, teoritë post-pozitiviste janë fokusuar në mënyrën se si

sovrانيتeti i jep jetë një realiteti politik të veçantë (Aalberts, 2006:4). Kështu realiteti i marrëdhënieve ndërkombëtare nuk mund të kuptohet përtej debateve që e përbëjnë atë. Kjo nuk do të thotë që realiteti empirik nuk ekziston, por që ky realitet, më saktë, është rezultat i diskutimeve në kuptimin e gjërë të fjalës (qoftë diskutime, qoftë praktika). Duke përmbysur logjikën e pranuar në përgjithësi, Weber insiston në atë që diskutimet mbi sovranitetin nuk shërbejnë vetëm për të përshkruar realitetin e jashtëm por ato në fund të fundit përbëjnë vetë realitetin. Kjo qasje e Weber-it ndaj konceptit të sovranitetit është një ndër arritjet më të spikatura të post-pozitivistëve. Më konkretisht, bëhet fjalë për të kuptuar dhe për të studiuar se si është “shkruar” sovraniteti, domethënë se si diskutimet i japin jetë një “realiteti” sovran specifik. Vetëm nëpërmjet këtyre praktikave janë identifikuar dhe krijuar themelet e sovranitetit dhe si rrjedhojë janë krijuar vetë shtetet sovrane (Weber, 1995:27).

Nisur nga sa më sipër, nuk mund të flasim për një realitet sovran “neutral” që imponohet, por për një luftë të vazhdueshme politike për kuptimin që duhet t’i jepet konceptit të sovranitetit. Kjo luftë “ripërcakton” kompetencat dhe kufijtë e kompetencave të dhëna nga sovraniteti si burim i legjitimitetit të autoritetit sovran. Një ndër lufrat më të qarta lidhur me konceptin e sovranitetit është ajo e “ndërhyrjes” në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sipas Weber, ndërhyrja dhe sovraniteti nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin dhe që këto ndërhyrje nuk janë shkelje të sovranitetit, por janë episode stabilizimi (domosdoshmërisht të përkohshme) që imponohen po nga sovraniteti⁸. Thënë me fjalë të tjera, ndërhyrjet përforcojnë konceptin e sovranitetit. Kështu, kuptimi i sovranitetit dhe i ndërhyrjeve evoluon sipas aftësisë së shtetit për të ushtruar autoritetin e tij sovran. Analiza e

⁸ Për më tepër shih: Weber, C. (1995). *Simulating Sovereignty: Intervention, The State and Symbolic Exchange*, Cambridge, Cambridge University Press.

ndërhyrjeve ndërkombëtare është, pra, një shembull relevant se si sovraniteti është shfaqur në debatet juridike, duke lejuar ose ndaluar disa praktika ndërhyrëse⁹.

Më konkretisht, mund të themi që një popullsi, një qeverisje, kufijtë dhe një ushtri nuk janë ne vetvete elementët e nevojshëm përbërës të një shteti sovran; janë debatet akademike, diplomatike, politike, etj. ato që i japin këtyre elementëve kuptimin e tyre, që i krijojnë dhe që i japin një rol kyç në formimin e një shteti sovran. Këto analiza, pavarësisht qëndrimit të tyre, nuk mohojnë dot “materialitetin” apo “empirizmin” e konceptit të sovranitetit. Megjithatë, këto elementë përbërës nuk kanë ekzistuar para shprehjes përformuese të shtetit dhe të vetë sovranitetit (Weber, 1992:92). Një analizë përformuese e sovranitetit fokusohet më shumë në efikasitetin e debateve se sa në faktin se sa kjo analizë korrespondon me një realitet të ashtuquajtur “para-ekzistues”.

Në konkluzion të asaj se çfarë u analizua më lart mund të themi që post-pozitivistët kanë kontribuar në përcaktimin e kuptimit të sovranitetit, duke u nisur pikërisht nga roli themelor që ato i kanë dhënë debateve mbi sovranitetin. Megjithatë, fakti që ato e analizojnë sovranitetin në një mënyrë performative nuk do të thotë që ato pranojnë një fleksibilitet total të konceptit. Në të vërtetë, për të qënë efikase, debatet duhet të përsëriten, të jenë interaktive dhe realiteti që krijohet nëpërmjet këtyre debateve nuk duhet të jetë objekt ndryshimi në mënyrë të vazhdueshme. Prandaj shtetet, njësoj si sovraniteti, ruhen, mbrohen, sulmohen, riprodhohen, tronditen dhe ri-legjitimohen në mënyrë të vazhdueshme (Walker, 1993:168).

⁹Shih: Malving, H., (2006). “State Sovereignty and Intervention: A discourse analysis of interventionary and non-interventionary practices in Kosovo and Algeria”, New York, Routledge.

4.4. Karakteristikat e sovranitetit

Pavarësisht qasjeve bashkëkohore ndaj konceptit të sovranitetit, duhet thënë se thelbi i kuptimit tradicional të sovranitetit nuk ka pësuar ndryshime, pra është një nocion i cili nuk e ka humbur koherencën e vet, pavarësisht formave të reja nëpërmjet të cilave ai shprehet sot.

Duke e konsideruar sovranitetin si cilësia e patjetërsueshme e shtetit për të qënë superior në territorin e tij dhe për të qënë i pavarur në arenën ndërkombëtare, natyrshëm dalin në pah dy karakteristikat e sovranitetit: 1) epërsia e shtetit në çështjet e tij të brendshme dhe 2) pavarësia e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare. Parë nën këtë prizëm sovraniteti paraqitet në dy aspekte: në atë të jashtëm dhe në atë të brendshëm. Të dy këto aspekte janë të lidhura në mënyrë organike me njëri-tjetrin dhe janë komponentët e pamohueshëm të nocionit të sovranitetit. Për të kuptuar lidhjen mes aspektit të jashtëm dhe atij të brendshëm të sovranitetit le të marrim një shembull konkret: Nëse shteti privohet nga epërsia e tij në çështjet e tij të brendshme ai nuk mund të dalë kurrësi si i pavarur në skenën ndërkombëtare dhe e kundërta nëse çënohet pavarësia e jashtme e një shteti, ky shtet ose e humbet epërsinë e tij brenda territorit të vet ose ekziston një kërcënim real për dhunimin e kësaj epërsie (Kuzmin, 1969:57).

4.4.1. *Epërsia e shtetit mbi çdo pushtet tjetër si karakteristikë kryesore e shtetit sovran*

Një ndër karakteristikat esenciale dhe përcaktuese të ekzistencës së shtetit është epërsia e shtetit brenda territorit të tij. Falë kësaj karakteristike, aparati shtetëror krijohet dhe organizon veprimtarinë e vet pavarësisht çdo pushteti tjetër shoqëror brenda vendit (Omari, 2007:52). Fillimisht epërsia apo supremacia e shtetit është zhvilluar që në periudhën e

Mesjetës, ku mbizotëronte doktrina e sundimit territorial dhe e plotfuqishmërisë së pushtetit. Më konkretisht, në Mesjetë, flitej për plotfuqishmërinë e pushtetit të Monarkut dhe të Papës dhe për dominancën territoriale, të cilat të marra së bashku përfaqësonin tërësinë e të drejtave supreme të pushtetit të cilat ishin të pakufizuara dhe të patjetërsueshme. Më vonë, epërsia territoriale është projektuar të jetë si gjithë të drejtat e tjera të pushtetit shtetëror, që buron nga e drejta reale mbi tokën ose mbi territorin dhe e përcaktuar kështu ose si pushteti i shtetit, ose si sovraniteti i shtetit. Megjithatë nuk është e justifikueshme që epërsia territoriale të identifikohet me sovranitetin. Epërsia territoriale përfaqëson vetëm një pjesë të sovranitetit, që është ajo e brendshme. Më specifikisht, sovraniteti i brendshëm është cilësia e shtetit për të qënë e vetmja organizatë politike dhe territoriale kompetente për të përcaktuar të gjithë rendin e marrëdhënieve shoqërore brenda vendit të tij nëpërmjet vendimeve të detyrueshme për t'u zbatuar brenda kufijve territorialë të vendit (Zhekeyeva, 2009:39).

Janë bërë tentativa, nga autorë të ndryshëm, për ta interpretuar supremacinë e shtetit në mënyrë më të zgjeruar, përtej konceptimit të saj vetëm si pjesë e sovranitetit të brendshëm të një shteti. Për shembull, Martens Ph. ishte i mendimit që supremacia e shtetit prezantohet në dy drejtime: në aspektin e brendshëm, që ka të bëjë me pavarësinë e shtetit në ushtrimin e kompetencave brenda territorit të tij dhe në aspektin e jashtëm, që i referohet pavarësisë që gëzon shteti në arenën ndërkombëtare (Martens, 1887:286).

Megjithatë, jemi të mendimit që interpretimi i nocionit “sundim i shtetit” si pjesë e sovranitetit të brendshëm dhe e sovranitetit të jashtëm, nuk është i argumentuar. Supremacia apo epërsia është karakteristikë vetëm e sovranitetit të brendshëm, i cili shprehet në atë që të gjithë personat fizikë apo juridikë duhet t'i nënshtrohen shtetit brenda kufijve të territorit të tij. Thënë me fjalë të tjera, supremacia e pushtetit shtetëror në

territorin ku ai shtrihet nënkupton, gjithashtu, edhe mungesën e çdo kufizimi formal për pushtetin shtetëror në nxjerrjen e atyre dispozitave që atij i duken të arsyeshme. Vendosja e rendit juridik dhe organizimi i mbrojtjes së tij është një e drejtë ekskluzive e pushtetit shtetëror. Asnjë organizatë tjetër politike brenda vendit dhe asnjë organizatë e shteteve të tjera nuk e ka këtë prerogativë brenda territorit të një shteti të caktuar (Omari, 2007:51).

Megjithatë, pa dashur të minimizojmë rëndësinë e kësaj karakteristike themelore të sovranitetit, duhet të pranojmë që vitet e fundit praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare, në disa raste, e ka kapërcyer këtë parim, që dikur absolutizohej (Omari, 2007:51-52).

Mund të përmendim këtu rastin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë bërë objekt i shqetësimit ndërkombëtar (Ross, 2001:12). Që nga miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948, janë nënshkruar mes shteteve një numër i konsiderueshëm traktatesh shumëpalëshe që synojnë në mënyrë të veçantë mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e nenit 55 të Kartës së Kombeve të Bashkuara që lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare (Forsythe, 2006:36). Dispozitat përkatëse të nenit 55 ofrojnë, *inter alia*, promovimin universal dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut pa dallim race, feje, gjinie apo gjuhe, me qëllim krijimin e kushteve të stabilitetit dhe mirëqenies të cilat janë të nevojshme për marrëdhëniet paqësore dhe miqësore ndërmjet shteteve. Kjo qasje e ka spostuar krejtësisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut në arenën ndërkombëtare (Henkin, Neuman, Orentlicher, Leebon, 1999:273). Për shkak se para vitit 1945 sovraniteti i shtetit është parë përgjithësisht si absolut, rregullimi i marrëdhënieve mes shtetit dhe qytetarëve u trajtua fillimisht si një çështje e brendshme dhe për këtë arsye ato trajtoheshin vetëm nga ligji i brendshëm. Megjithatë, që nga viti 1945 pothuajse të gjitha shtetet u përfshinë në

regjime ndërkombëtare (Archer, 2001:109), gjë e cila solli ndikim të thellë në konceptin e sovranitetit të shtetit si absolut. Marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut përbënin një regjim të tillë. Sot, me shumë mundësi, shumë pak shtete do të pohojnë se mbrojtja e të drejtave të njeriut duhet të trajtohet si një çështje e brendshme (Reisman, 1990:84). Në këtë drejtim Forsythe argumenton se ideja e sovranitetit të shtetit nuk është një mburojë automatike dhe e padepërtueshme kundër aksionit ndërkombëtar në çështjet që konsiderohen si thelbësisht të brendshme (Forsythe, 2006:25).

Në të shkuarën mbrojtja e sovranitetit shtetëror nga parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti, ka qënë një pengesë e fortë në lidhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Edhe pse Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme sanksionuan në nenin 2 (7) të Kartës së Kombeve të Bashkuara se shkeljet e të drejtave të njeriut të njohura dhe të mbrojtura ndërkombëtarisht nuk janë krejtësisht çështje brenda juridiksionit të shteteve anëtare, shtetet megjithatë vazhduan t'i referoheshin sovranitetit dhe parimit të mosndërhyrjes si një mjet politik për të penguar mbrojtjen e të drejtave ndërkombëtare të njeriut (Delbrück, 1993:715). Parimi i mosndërhyrjes sfidohet nga besimi i bashkësisë ndërkombëtare se ajo ka "përgjegjësinë për të mbrojtur" (Simonovic, 2002:372-373). Pasojë e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut është dobësimi i nocionit të sovranitetit absolut të shtetit dhe rritja e njëkohshme e solidaritetit të ndërsjellë mes shteteve (Schermers, 2002:187). Kufizimi i sovranitetit shtetëror shpjegohet kështu me argumentin se të drejtat e njeriut nuk janë më ekskluzivisht nën juridiksionin e brendshëm të shtetit, por kanë të bëjnë edhe me komunitetin ndërkombëtar (Perrez, 2000:50).

Sovraniteti i shtetit brenda territorit të tij është sfiduar edhe nga praktika e traktateve shumëpalëshe të cilat krijojnë institucione mbikombëtare. Avancimi i shoqërisë ndërkombëtare sot ndodhet në një stad të tillë sa që mund të konstatohet që shtetet po

funksionojnë gjithnjë e më shumë në kuadrin e organizatave ndërkombëtare, se sa brenda kufijve të tyre shtetërorë.

Shekulli XX shënoi një interes të madh në mesin e shteteve për të nënshkruar traktate shumëpalëshe. Kur një shtet aderon në një traktat të veçantë shumëpalësh, ai me vullnetin e tij të lirë heq dorë nga disa elementë të sovranitetit dhe të pavarësisë së tij.

Në të vërtetë, jo vetëm në Evropë, por në pjesë të ndryshme të botës po zhvillohen procese rajonale të integritimit. Duke u përfshirë në këto procese integrimi, shtetet transferojnë një pjesë të caktuar të sovranitetit të tyre kombëtar drejt organeve mbikombëtare, siç është rasti i Bashkimit Evropian. Ky mekanizëm mbishtetëror është krijuar nga shtetet, sepse këto të fundit e pranojnë që ekzistojnë disa çështje shtetërore të cilat nuk mund të marrin zgjidhjen e duhur nëse ato veprojnë në mënyrë të pavarur (Mills, 1997:274). Forcimi i organizatave ndërkombëtare dhe i bashkëpunimit të institucionalizuar konsiderohet si çelësi për arritjen e stabilitetit brenda sistemit ndërkombëtar (Delbrück, 1993:706). Sipas Delbrück kjo lëvizje në drejtim të rritjes së institucionalizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar tregon një gatishmëri në rritje të shteteve për të pranuar kufizime të gjëra mbi sovranitetin e tyre në favor të implementimit dhe zbatimit të ligjit ndërkombëtar (Delbrück, 1993:706).

Në vitin 1964 Friedmann ka identifikuar fillimin e integritit të shteteve të Evropës Perëndimore me një traditë të gjatë të sovranitetit kombëtar në komunitetet mbikombëtare. Sipas tij marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore dhe e drejta ndërkombëtare janë zhvilluar në tri nivele të ndryshme, përkatësisht: 1. Sistemi tradicional i marrëdhënieve diplomatike apo i marrëdhënieve të "bashkëjetesës". Kombet e Bashkuara me organet kryesore të tij politike, Asambleja e Përgjithshme dhe Sekretariati, janë në thelb një zgjerim i institucionalizuar i kësaj shoqërie tradicionale ndërkombëtare; 2. Një shoqëri

transnacionale e cila është e përfaqësuar nga rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet me interes të përbashkët. Agjentët kryesorë të këtyre marrëdhënieve transnacionale janë shtetet, duke përdorur konventat shumëpalëshe ose dypalëshe në fusha të tilla si transporti ndërkombëtar, komunikimi dhe shëndeti dhe gjithashtu grupe gjysmë-publike dhe private, si Kryqi i Kuq Ndërkombëtar; 3. Një shoqëri mbikombëtare, në të cilën aktivitetet dhe funksionet e shteteve janë tek institucionet e përhershme ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato rajonale. Këto institucione nxjerrin statusin e tyre nga traktatet dhe janë mbështetur nga marrëveshja dhe kontributet e shteteve anëtare (Friedmann, 1964:37-38).

Si rezultat i Luftës së Dytë Botërore ka një pranim të përgjithshëm të parimit që shtetet që veprojnë si agresorë abuzojnë me sovranitetin e tyre dhe liderët e tyre mund të jenë drejtpërsëdrejti të përgjegjshëm për komunitetin ndërkombëtar. Krijimi i këtij parimi ka shënuar një ndryshim revolucionar në kufijtë e sovranitetit shtetëror (Nagan & Hammer, 2004:160). Është gjithnjë e në rritje marrëveshja mes anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar, sipas së cilës ata njerëz, të cilët kryejnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, të njohura ndërkombëtarisht, duhet të përballen me drejtësinë penale ndërkombëtare (Mills, 1997:84). Më 17 korrik të vitit 1998 shumica e shteteve që mori pjesë në Konferencën e Romës miratoi Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Juridiksioni i Gjykatës mbulon genocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është një hap i rëndësishëm drejt legjitimitetit të parimeve të caktuara të përgjegjësisë ndërkombëtare dhe të ligjit ndërkombëtar (Caldwell, 1999:234). Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është një tregues i qartë i vullnetit të komunitetit ndërkombëtar për të vënë nën përgjegjësi individë të caktuar, të ngarkuar me detyra

shtetërore dhe kur gjatë ushtrimit të autoritetit shtetëror ato kanë tejkaluar kufijtë ligjorë (Brand, 2002:25).

4.4.2. *Pavarësia e Shtetit*

Karakteristikë tjetër themelore e sovranitetit të shtetit është, padiskutim, edhe pavarësia e shtetit në skenën ndërkombëtare. Në fakt ekzistojnë dy qasje të ndryshme lidhur me përcaktimin e pavarësisë së shtetit. Qasja e parë i referohet pavarësisë së jashtme, si pjesë e sovranitetit të jashtëm (Kuzmin, 1969:57). Qasja e dytë i referohet pavarësisë si pavarësi e pushtetit të shtetit qoftë në çështjet e brendshme, qoftë në çështjet jashtë kufijve të tij (Oppenheim, 1948:130). Qasja e fundit nuk ka gjetur përkrahjen e mjaftueshme pasi është më korrekte që kur flitet për pavarësinë vëmendja të përqëndrohet tek marrëdhëniet e shtetit me subjektet e së drejtës ndërkombëtare dhe jo tek çështjet e tij të brendshme. Nuk është me vend të trajtohet koncepti “pavarësi e shtetit” duke iu referuar veprimtarisë së tij brenda kufijve të vendit dhe marrëdhënieve të tij me subjektet e tjera brenda vendit, kjo për një arsye të thjeshtë, shteti është e vetmja organizatë politike dhe territoriale që posedon pushtetin shtetëror dhe vendimet e tij janë të detyrueshme brenda kufijve territorialë të shtetit (Zhekeyeva, 2009:40-41). Dhe të vazhdosh të flasësh për pavarësinë në këtë aspekt është vërtet e pakuptimtë.

Si përfundim, mund të themi që pavarësi do të thotë që shteti është i garantuar nga çdo ndërhyrje e jashtme në përcaktimin dhe në realizimin e politikave të tij të brendshme dhe të jashtme, po ashtu dhe në zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Pavarësi do të thotë gjithashtu që çdo shtet ka të drejtën ekskluzive për të vepruar në mënyrë të pavarur brenda limiteve të kompetencave të tij, por me kushtin e moscënimit të normave të së drejtës ndërkombëtare.

Vitet e fundit sovraniteti ka kaluar nga një koncept i paprekshëm drejt një katalizatori debatesh në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në qoftë se disa studiues mjaftohen në ndarjen e sovranitetit në komponentë të ndryshëm, disa të tjerë shkojnë edhe më larg, duke ripërcaktuar madje edhe vetë përmbajtjen e konceptit të sovranitetit. Por, pavarësisht qasjeve bashkëkohore ndaj konceptit të sovranitetit, duhet thënë se thelbi i kuptimit tradicional të sovranitetit nuk ka pësuar ndryshime, pra është një nocion i cili nuk e ka humbur koherencën e vet, pavarësisht formave të reja nëpërmjet të cilave ai shprehet sot. Megjithatë, pa dashur të minimizojmë rëndësinë e konceptit të sovranitetit dhe të karakteristikave themelore të tij, duhet të pranojmë që vitet e fundit praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare, në disa raste, e ka kapërcyer këtë koncept, që dikur absolutizohej.

KAPITULLI V – SOVRANITETI NË BASHKIMIN EVROPIAN: NJË SOVRANITET RELATIV

Hyrje

Koncepti i sovranitetit, sipas të cilit shteti nuk duhet të jetë nën autoritetin e një shteti tjetër dhe se ai ushtron ekskluzivisht pushtetin e tij brenda një territori të caktuar, është sfiduar tashmë nga procesi i integritetit evropian. Padyshim që Bashkimi Evropian mbetet një nga projektet më të diskutueshme në botën moderne. Zakonisht, BE-ja është portretizuar si simbol i unitetit evropian, ku spikat triumfi i sovranitetit të përbashkët mbi nacionalizmin e tepruar.

Në fakt, vetë evolucioni që ka pësuar Bashkimi Evropian, që nga krijimi i tij deri tek anëtarësimi i 28 shteteve, të cilët ushtrojnë kompetenca të përbashkëta në më shumë se 50 fusha të ndryshme të jetës politike, ekonomike dhe sociale të Shteteve anëtare, ka sjellë zhvillime të rëndësishme të cilat nuk na lejojnë më ta shohim konceptin e sovranitetit të Shteteve anëtare të BE-së në të njëjtën mënyrë siç do ta shihnim atë po të mos ekzistonte integrimi evropian. Dhe në të vërtetë, gjatë krijimit të traktateve dhe zhvillimit të së drejtës së BE-së, sovraniteti i shteteve e ka humbur karakterin e vet absolut dhe është shndërruar në sovranitet relativ duke bërë kështu që të gjitha kompetencat shtetërore të ushtrohen në forma krejtësisht të ndryshme nga ato tradicionale.

Në të vërtetë, kuptimi fillestar i sovranitetit e humb pashmangshmërisht rëndësinë e tij nëpërmjet procesit të transferimit të kompetencave të shteteve anëtare drejt BE-së.

Gjithashtu duhet të theksojmë se një tjetër faktor i rëndësishëm që ka “minuar” konceptin tradicional të sovranitetit absolut të shtetit është padyshim zhvillimi i politikave komunitare.

Një tregues tjetër i minimizimit të konceptit të sovranitetit absolut është zhvillimi gjithnjë e në rritje i së drejtës komunitare e cila duke iu imponuar skajshmërisht sistemeve juridike të Shteteve anëtare i ka dhënë Bashkimit Evropian autonomi juridike.

5.1. Karakteristikat institucionale dhe sistemi juridik i Bashkimit Evropian

Përpara se të analizojmë faktorët kryesorë të cilët përbëjnë një kërcënim real për konceptin e sovranitetit shtetëror, le të bëjmë një ndalesë të shkurtër lidhur me karakteristikat institucionale dhe sistemin juridik të BE-së.

Bashkimi Evropian ka një kuadër institucional që synon të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t'u shërbejë interesave të tij, shtetasve të tij dhe Shteteve anëtare si dhe të sigurojë qëndrueshmëri, efektivitet dhe vijimësi të politikave dhe veprimeve të tij (Borchardt, 2010:45). Organet thelbësore të BE janë:

-Parlamenti Evropian përfaqëson popujt e Shteteve anëtare të BE-së. Neni 14 i TBE-së i jep një status të barabartë Parlamentit me Këshillin, ku këto dy institucione sëbashku do të ushtrojnë funksione legjislative dhe buxhetore.

-Këshilli Evropian përbëhet nga përfaqësuesit e nivelit të lartë të Krerëve të Shtetit ose të Qeverisë në BE dhe ka si rol kryesor atë të përcaktimit të orientimeve të politikave të përgjithshme për veprim të BE-së¹⁰.

-Këshilli përbëhet nga përfaqësues të Qeverive të Shteteve anëtare. Traktati i Lisbonës parashikon udhëzime të pakta në lidhje me kompetencat e Këshillit. Në nenin 16 (1) të TBE-së thuhet vetëm se: Këshilli, së bashku me Parlamentin Evropian, do të ushtrojë

¹⁰ Për më tepër shih nenin 15 të TBE-së

funksiione legjislatiue dhe buxhetore. Ai do të kryejë funksione të hartimit të politikës dhe koordinimit, ashtu siç parashikohen në Traktatet. Pavarësisht parashikimeve të kufizuara në TBE rëndësia e Këshillit është e konsiderueshme në “drejtimin” e BE-së dhe mbetet strumbullari i vendimmarrjes dhe i procesit legjislativ të BE-së.

-Komisioni përbëhet nga një përfaqësues për çdo Shtet anëtar. Në nenin 17 të TBE-së parashtrihen kompetencat e Komisionit: Komisioni garanton zbatimin e traktateve; mbikqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit; aktet legjislatiue të Bashkimit mund të miratohen vetëm mbi bazën e propozimit të Komisionit.

-Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian gjykon çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e Traktateve themeluese dhe të normativës së Bashkimit Evropian, raportet midis Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare, etj.

-Banka Qëndrore Evropiane është motorri i bashkimit ekonomik dhe monetar. Detyra e saj është të ruajë stabilitetin e monedhës evropiane, Euros, dhe të kontrollojë sasinë e monedhës në qarkullim.

-Gjykata e Audituesve kontrollon ligjshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të BE-së si dhe menaxhimin e burimeve financiare.

BE-ja është jo vetëm një krijim i së drejtës, por edhe një komunitet që bazohet tek e drejta. Ajo nuk funksionon e bazuar në detyrimin apo shtrëngimin, por nëpërmjet forcës së ligjit. BE-ja nuk është thjesht krijim i së drejtës, por ajo ndjek objektivat e saj përmes së drejtës. Jetën e popujve në Shtetet anëtare nuk e disiplinon kërcënimi i forcës por e drejta e bashkimit. Kjo e drejtë përbën bazën e sistemit institucional e cila u jep institucioneve të bashkimit mjetet për të miratuar instrumenta të ndryshëm ligjorë, që janë të detyrueshme

për Shtetet anëtare dhe shtetasit e tyre. E Drejta e Bashkimit përcakton edhe marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shteteve anëtare (Puto, 2014:10).

Sistemi juridik komunitar është ndërtuar nga tërësia e normave që rregullojnë dhe sistemojnë organizimin dhe zhvillimin e Komunitetit Evropian dhe raportet ndërmjet tyre e Shteteve anëtare (Canaj & Bana, 2011:160).

Organet e Bashkimit Evropian nxjerrin disa lloj aktesh ligjore që në përgjithësi duhet të mbizotërojnë ndaj të drejtës së brendshme të vendeve anëtare. Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian¹¹ përcakton se për të ushtruar kompetencat e tij, institucionet e Bashkimit duhet të adoptojnë rregullore, direktiva, vendime, rekomandime dhe opinione.

-Rregulloret, janë aktet kryesore të Bashkimit Evropian. Nxirren nga Këshilli i Ministrave të BE-së në bashkëpunim me Parlamentin. Ato kanë efekt të detyrueshëm të drejtpërdrejtë në të gjithë territorin e vendeve anëtare. Rregullorja ka fushëveprim të përgjithshëm. Ajo është e detyrueshme në të gjithë elementët e saj, si përsa i përket mjeteve që duhet të përdorin Shtetet anëtare ashtu edhe rezultatit që duhet të arrijnë dhe ka efekt të drejtpërdrejtë në të drejtën e Shteteve anëtare. Pra rregullorja ka si qëllim unifikimin e së drejtës së Bashkimit duke u ndaluar Shteteve anëtare ta zbatojnë atë në mënyrë të paplotë ose të përzgjedhin vetëm disa dispozita për zbatim. Duke pasur efekt të drejtpërdrejtë në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare, ajo bëhet pjesë e sistemit të tyre pa pasur nevojë për transpozim duke parashikuar të drejta e detyrime njësoj si e drejta e tyre e brendshme (Borchardt, 2011:92). Pra në rastin e rregulloreve Shtetet anëtare kanë detyrimin të mos pengojnë efektet e drejtpërdrejta të tyre.

¹¹ Shih nenin 288 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian

-Direktivat, janë akte normative të cilat duhet të adaptohen në legjislacionin e brendshëm të çdo Shteti anëtar me anë të ligjeve pritëse të nxjerra nga secili shtet brenda një periudhe të caktuar. Nxirren nga Këshilli i Ministrave të BE-së në bashkëpunim me Parlamentin. Aktet e brendshme shtetërore të nxjerra nga këto vende nuk është e thënë të jenë identike me Direktivën por ato duhet të jenë në harmoni me të. Ekziston gjithashtu rasti i atyre pjesëve të direktivave të cilat karakterizohen nga qartësia dhe aplikueshmëria e drejtpërdrejtë. Këto direktiva quhen *self-executing* dhe aplikohen menjëherë nga adoptimi i tyre në çdo vend anëtar. Direktivat, janë të detyrueshme vetëm për rezultatin që duhet të arrihet, duke e lënë në diskrecionin e Shteteve anëtare të zgjedhin mënyrat dhe mjetet e arritjes së tij. Ato u drejtohen Shteteve anëtare dhe si rregull masat e transpozimit do të prodhojnë efekte në rendin juridik kombëtar. Direktivat garantojnë standartizimin e legjislacionit të Bashkimit dhe mbrojnë larmishmërinë e strukturave dhe traditave kombëtare. Megjithëse traktati nuk e përmend zbatimin me efekt të drejtpërdrejtë të direktivave, Gjykata e Drejtësisë e ka njohur këtë efekt në kushte të caktuara. Një ndër vendimet e para që vendosën zbatimin e drejtpërdrejtë të direktivës është ai i 17 dhjetorit 1970¹² në të cilin Gjykata konstatoi se: “Nëse pas përfundimit të afatit të transpozimit do të refuzohej efekti i drejtpërdrejtë i direktivës, atëherë asaj do t’i hiqej çdo efekt i dobishëm në një kohë që sipas traktatit ajo përbën një akt të detyrueshëm”. Gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim konstant në çështjet që i janë paraqitur si p.sh në vendimin e 5 Prillit 1979 në çështjen 148/78 (Pubblico Ministero v Ratti, rec. 1629), sipas së cilës fakti që sipas nenit 189 të Traktatit (aktualisht neni 288 i TFBE) rregulloret janë direkt të zbatueshme, nuk do të thotë që kategoritë e tjera të masave të parashikuara nga ky nen nuk mund të prodhojnë asnjëherë një efekt të tillë. Një Shtet anëtar i cili nuk ka transpozuar masa të kërkuara nga direktiva brenda periudhës së parashikuar, nuk mund të mbrohet kundrejt individëve me

¹² Vendimi i 17 Dhjetorit 1970, SpA SACE v Finance Minister of the Italian Republic, çështja 33/70.

argumentin e dështimit të tij për të përmbushur detyrimet e direktives. Gjyqtari kombëtar është i detyruar ta zbatojë direktivën kur afati i transpozimit të saj ka përfunduar dhe ajo parashikon për individët të drejta e detyrime të pakushtëzuara e të sakta¹³. Është e rëndësishme të theksohet se sipas jurisprudencës të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë efekti i drejtpërdrejtë u lejon individëve t’i referohen një direktive kundër shtetit , por nuk lejon rastin e anasjelltë. Një direktivë e pa transpozuar asnjëherë nuk mund të vendosë detyrime kundrejt individëve, kjo do të thotë se shteti ose një palë private nuk mund t’u referohet dispozitave të direktivës kundrejt individëve të tjerë¹⁴. Ky rregullim gjen zbatim për dy arsye: së pari, shteti nuk mund të përfitojë nga mospërmbushja e detyrimeve të tij në të drejtën komunitare dhe së dyti, individëve nuk mund t’u vihen detyrime që rrjedhin nga një dispozitë e pa transpozuar duke qënë se ata nuk janë përgjegjës për mostranspozimin e saj. Së fundi, individët kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim dëmi nga Shtetet anëtare në rast se ata nuk transpozojnë në kohë një direktivë ose e transpozojnë atë në mënyrë jo korrekte¹⁵.

- **Vendimet**, janë akte që kanë fuqi vetëm në një pjesë të kufizuar të territorit të BE-së pasi i drejtohen një Shteti apo një grupi të ngushtë Shtetesh të caktuara. Ato kanë efekt të drejtpërdrejtë. Vendimi, është i detyrueshëm në të gjithë elementët e tij përkundrejt subjekteve që u drejtohet. Megjithatë duhet dalluar rasti kur marrësit e vendimit janë personat fizikë ose juridikë nga ai kur vendimet i drejtohen një ose shumë Shteteve anëtare (Zajmi, 2009:123). Në rastin e parë vendimi ka efekt të drejtpërdrejtë, ndërsa kur i drejtohet shteteve aplikohet jurisprudenca mbi direktivat, pra ai ka efekt mbi individët kur plotësohen kushtet e përcaktuara për direktivat mbi efektin e drejtpërdrejtë.

¹³ Vendimi i 19 Janarit 1982, Ursula Becker kundër Inanzamt Munster-Innenstadt, çështja 8/81, paragrafi 24.

¹⁴ Vendimi i 26 Shkurtit, M. H. Marshall kundër Southampton dhe South-West Hampshire area Health Authority , çështja 152/84, paragrafët 43, 48-49.

¹⁵ Vendimi i 19 nëntorit 1991, Frankovitch et Bonifaci, çështjet 6/90 dhe 9/90 rec.5357.

- **Rekomandimet dhe Opinionet** janë akte që nuk janë të detyrueshme për Shtetet anëtare dhe i drejtohen gjithë shteteve në territorin e BE-së. Këto akte nuk kanë efekt detyrues. Rekomandimet e këshillojnë subjektin që i drejtohen të sillet në një mënyrë të caktuar, pa i imponuar detyrime juridike. Ndërsa Opinionet nxirren nga institucionet e Bashkimit për të vlerësuar një situatë të caktuar apo zhvillime brenda Bashkimit ose të një Shteti anëtar. Në disa raste, opinionet përbëjnë një parakusht për një padi në Gjykatën e Drejtësisë (nenet 258 dhe 259 të TFBE-së). Opinionet, ashtu si dhe Rekomandimet nuk janë të detyrueshme dhe jepen nga organet e BE-së për çështje të caktuara me interes për Bashkimin Evropian (Puto & Alimehmeti, 2014:15).

Bashkimi ka ndërkohë të drejtë që të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me një ose disa shtete ose organizata ndërkombëtare kur parashikohet nga Traktatet ose kur marrëveshja është e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në Traktate. Bashkimi mund të lidhë me këto subjekte edhe marrëveshje asocimi që përmbajnë të drejta dhe detyrime reciproke për palët, marrëveshje mbi veprimet e përbashkëta dhe ato mbi procedurat e posaçme. Këto marrëveshje ndërkombëtare kanë karakter detyrues i cili i imponohet si institucioneve të Bashkimit Evropian ashtu edhe Shteteve anëtare. Gjykata e ka përkufizuar marrëveshjen e asocimit si “një mjet që krijon lidhje speciale e të privileguara të vendeve të treta me Komunitetin, të cilat nga ana e tyre marrin pjesë në sistemin komunitar. Nga ana tjetër Komuniteti, bazuar edhe në nenin 238, duhet të garantojë marrjen e masave për të gjitha fushat që mbulon traktati”. Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit kur janë të qarta, preçize dhe krijojnë të drejta dhe detyrime për personat fizikë a juridikë janë drejtpërdrejtë të zbatueshme. Megjithatë Gjykata Evropiane e Drejtësisë e lidh efektin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve kontraktuale që lidh Bashkimi me llojin e kësaj marrëveshjeje (Puto & Alimehmeti, 2014:14).

5.2. Procesi i transferimit të kompetencave dhe ndarja e sovranitetit

Në traktatet themeluese të Bashkimit Evropian dhe gjatë integritimeve komunitare, parimi i ndarjes së kompetencave është konsideruar dhe është pranuar që ka ushtruar ndikim të konsiderueshëm tek koncepti i sovranitetit duke e shndërruar tashmë këtë të fundit në një nocion që nuk është më një dhe i pandarë. Kjo ndarje e kompetencave, që për hir të së vërtetës, është komplekse, sjell si pasojë privimin e shtetit nga tërësia e prerogativave të sovranitetit sipas kuptimit tradicional të tij. Thënë me fjalë të tjera, sot sovraniteti i shteteve po përjeton një realitet të ri në Bashkimin Evropian (Mortier, 2011:232).

5.2.1. *Traktatet themeluese të Komuniteteve Evropiane (KEQÇ, KEEA, KEE): pranimi i parimit të transferimit të kompetencave shtetërore*

Krijimi i Komunitetit Evropian pati si qëllim të tij evitimin e përsëritjeve të gabimeve të së shkuarës, evitimin e konflikteve mes shteteve evropiane, konflikte që i çuan gjithmonë këto shtete në luftra me njëri-tjetrin.

Kështu etërit e Komunitetit Evropian kishin si objektiv krijimin e një hapësire evropiane të aftë për të evituar rënien përsëri të Evropës (Mortier, 2011:232) dhe pse për ta kishte pak rëndësi se çfarë pasojash do të sillte krijimi i kësaj hapësire mbi sovranitetin e shteteve, parim i cili, të themi të vërtetën, është konsideruar edhe si përgjegjësi i konflikteve evropiane. Etërit themelues adoptuan një qasje integruese, të iniciuar nga Jean Monnet i cili synonte jo vetëm në krijimin e një organizate klasike ndërkombëtare por edhe të një organizate e cila synonte të ftonte shtetet e Evropës që ushtrimi i kompetencave të tyre shtetërore të bëhet tashmë në mënyrë të përbashkët, në nivel komunitar (Mortier,

2011:232). Pra që nga krijimi i tij, Komuniteti Evropian vishet me një koncept të bazuar në përzierjen e sovraniteteve shtetërore.

Transferimi i parë i kompetencave drejt një entiteti mbikombëtar i cili përbëhej nga disa shtete është realizuar me Traktatin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe të Çelikut, të nënshkruar me 18 prill 1951 nga Franca, Gjermania, Italia dhe tre vendet e Beneluksit. Ky traktat përfaqësoi më shumë se një marrëveshje klasike, pasi ai krijoi institucione të pavarura nga autoritetet publike kombëtare dhe i veshi ato me të drejta sovrane, administrative dhe gjyqësore, të drejta që u janë transferuar nga Shtetet anëtare (Bello, 2010:33-34). Kjo eksperiencë e parë në transferimin e kompetencave, ndonëse e limituar, ishte një tregues i vullnetit të shteteve për fragmentimin e pushtetit sovran të tyre duke qënë se tashmë, me nënshkrimin e KEQÇ-së, shtetet nënshkruese nuk kishin më pushtet për të vendosur të vetme rregulla të detyrueshme për zbatim në fushën e qymyrit dhe të çelikut. Fusha që mbulonte KEQÇ-ja sigurisht që ishte e kufizuar, por Traktati kishte të bënte me një aspekt të rëndësishëm të kompetencave sovrane të shtetit meqënëse bëhej fjalë në atë kohë për të organizuar menaxhimin e burimeve të qymyrit dhe çelikut në një nivel tjetër, të ndryshëm nga ai shtetëror.

Ky transferim i kompetencave do të vazhdojë më tej me krijimin e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (1957) i cili do të rriste në një shkallë më të ndjeshme transferimin e kompetencave të shtetit drejt këtij entiteti mbikombëtar, i cili ishte i ngarkuar për zbatimin e një politike të përbashkët në këtë fushë. Kështu, gradualisht gjashtë shtetet e para të Komuniteteve Evropiane filluan të pranojnë transferimin e kompetencave të tyre drejt komuniteteve evropiane.

Një traktat tjetër i rëndësishëm, ai i themelimit të Komunitetit Ekonomik Evropian (1957) çoi në rritjen e integritit ekonomik mes shteteve, gjë që gradualisht shkaktoi pamundësinë për Shtetet anëtare për të përcaktuar vetë zgjedhjet ekonomike pa ndërhyrjen e Bashkimit Evropian.

Ndarja e kompetencave mes Shteteve anëtare dhe komuniteteve evropiane u bë, në të vërtetë, me Traktatet e Romës por që vetëm me nënshkrimin e traktateve të tjera pasuese pati një rritje të këtyre kompetencave në favor të BE-së.

5.2.2. Nga Akti i Vetëm Evropian tek Traktati i Lisbonës: një ndarje kompetencash e miratuar por veçanërisht komplekse

Bashkimi Evropian, që në fillimet e tij, karakterizohej nga aftësia për ndarjen e kompetencave mes tij dhe Shteteve anëtare, më pas ka pasur një ngadalësim të këtij procesi të shkaktuar nga rezistenca e identiteteve kombëtare për të ruajtur sovranitetin e tyre shtetëror. Rasti tipik ishte ai i reagimit francez ndaj politikave komunitare të viteve '60, ku Franca si shenjë proteste filloi të mos marrë pjesë në aktivitetet e KEE-së. Konkretisht në vitin 1965 u krijua një tension mes Shteteve anëtare, kur sipas dispozitave kalimtare të Traktatit të KEE-së kishte ardhur momenti që Këshilli i Ministrave të kalonte nga votimi unanim në shumicë të cilësuar. Ky qëndrim i Francës është njohur si politika e “karriges bosh” (Sauron, 2000:60-61), e cila solli si rezultat arritjen e një marrëveshjeje, që u bë e njohur si Kompromisi i Luksemburgut. Ky kompromis pati një ndikim të konsiderueshëm mbi zhvillimet e Komunitetit gjatë dy dekadave të ardhshme. Sipas kësaj marrëveshjeje, edhe në rastet kur në Traktat parashikohej vendimmarrje me shumicë votash, debati duhej të vazhdonte deri sa të arrihej votimi unanim, sa herë që ishin në rrezik interesat kombëtare.

Një praktikë e tillë vendimmarrjeje shënoi një kthim të politikave ndërqeveritare në BE, e cila do të zgjaste në vitet në vijim (Craig & De Burca, 2013:151). Gjithsesi duhet thënë se kjo ishte një periudhë kalimtare.

Akti i Vetëm Evropian, më pas Traktati i Maastricht-it, Traktati i Amsterdimit dhe Traktati i Nicës sfiduan dimensionin ndërqeverisës të Komunitetit. Ato u priren drejt fuqizimit të dinamikës mbikombëtare të Komunitetit duke rritur gradualisht fushat në të cilat komunitetet evropiane do të ushtronin kompetencat e tyre.

Kufizimi i kompetencave me traktatet e njëpasnjëshme më në fund ka rezultuar në një ndarje të vërtetë të tyre mes komuniteteve evropiane dhe Shteteve anëtare. Në këtë mënyrë, Shtetet anëtare kanë zgjedhur, gjatë procesit të krijimit dhe të zhvillimit të BE-së, të transferojnë një pjesë gjithnjë e më të rëndësishme të kompetencave të tyre sovrane. Kështu sovraniteti i shtetit, parë nga një qasje politike, është dobësuar dhe është konkurruar nga një formë e re e ushtrimit të sovranitetit (Mortier, 2011:234), e cila paradoksalisht ka një dimension kolektiv, krejt të ndryshëm nga kuptimi fillestar i sovranitetit.

Megjithatë, duhet thënë që ndarja e kompetencave është një çështje e vështirë sepse është me të vërtetë delikate dhe jo shumë e qartë se deri ku sovraniteti i Shteteve anëtare sfidohet nga Bashkimi Evropian. Fushat në të cilat lejohet transferimi i kompetencave nuk janë të paraqitura të gjitha në mënyrë të qartë në Traktate, të cilat nganjëherë të referojnë në mënyrë indirekte ose lënë ndonjë mundësi ndërhyrjeje nga ana e BE-së duke provokuar kështu kufizime të sovranitetit të paautorizuara nga Shtetet anëtare¹⁶.

Transferimi i kompetencave është rritur ndjeshëm vitet e fundit, në rrjedhjen e Traktateve deri me Projektin e Traktatit të Kushtetutës Evropiane, i cili mbart vlera ilustruese

¹⁶ Për më tepër shih: J.-P. Jacque “droit institutionnel de l’Union européenne”, 2ème édition, fq. 141

pavarësisht se ky Traktat nuk u zbatua asnjëherë për shkak të mosratifikimit të tij. Ky Projekt-Traktat kishte si qëllim jo vetëm të absorbonte *acquis communautaire* të traktateve të mëparshme, por të shkonte edhe më tej: në organizimin e cedimit të Shteteve anëtare nga disa prej pushteteve të tyre sovrane (Mortier, 2011:234).

Nenet nga I-12 deri tek I-18 të Projekt-Traktatit Kushtetues parashikojnë kategoritë e kompetencave të BE-së dhe ilustrojnë ndarjen e pushteteve sovrane mes Shteteve anëtare dhe Bashkimit Evropian. Më konkretisht, neni I-12 i këtij Traktati kishte si qëllim të përmbledhte modalitetet e ndarjes së kompetencave mes entitetit mbikombëtar dhe Shteteve anëtare por ky tekst, i cili, siç u citua dhe më lart, nuk u zbatua asnjëherë për shkak të mosratifikimit të tij, nuk modifikonte ndarjen e kompetencave dhe i lejonte gjithmonë BE-së zgjerimin e kompetencave të tij. Kjo konfirmon një formë të sovranitetit ligjor të fituar nga Bashkimi Evropian përgjatë rrjedhjes së traktateve dhe mbi të gjitha fundin e absolutizmit të sovranitetit shtetëror. Kompetencat “ekskluzive” dhe ato “të përbashkëta” nuk u modifikuan nga Projekt-Traktati themelues për një Kushtetutë Evropiane (neni I-13 dhe I-14); nga ana tjetër, fusha e kompetencave ndihmëse është shpjeguar qartë në nenin I-17 me termat : “veprim mbështetës, koordinues ose plotësues” (Mortier, 2011:234).

Kështu ky tekst ofron, për më tepër, një afirmim të qartë dhe zyrtar të ndarjes së sovranitetit, i cili më përpara praktikohet por në mënyrë të heshtur. Vënia në diskutim e sovranitetit juridik të Shteteve anëtare shfaqet gjithashtu qartazi në nenin 308 të Traktatit të Romës, i përfshirë në Projekt-Traktatin mbi Kushtetutën Evropiane, në nenin I-18 të tij si klauzola e fleksibilitetit. Në fakt, kjo dispozitë i lejon Bashkimit Evropian të zgjerojë fushën e kompetencave të tij që në momentin kur ndërhyrja e institucioneve të BE-së vlerësohet si e dobishme për mbrojtjen e objektivave që i janë besuar nga traktatet komunitare (Mortier, 2011:234).

Më vonë, Traktati i Lisbonës, në lidhje me këtë çështje, nuk bën përjashtim nga rregulli pasi Preambula, neni 1 dhe neni 2 i këtij traktati reflektojnë objektiva veçanërisht të gjëra të BE-së, e cila është e lirë për t'i përdorur për zgjerimin e kompetencave të saj. Në çdo rast, ndarja aktuale e kompetencave lë në duart e BE-së një marzh të rëndësishëm manovrimi. Në të vërtetë, Traktati i Maastricht-it, në versionin e Traktatit të Lisbonës, i jep Bashkimit Evropian kompetenca të gjëra për të ndërhyrë në një numër fushash¹⁷. Në mënyrë të ngjashme mund të përmendim nenin 7 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian i cili në pamje të parë mund të duket sikur ka listuar në mënyrë të qartë fushat ku BE-ja mund të ndërhyjë por në fakt ky saktësim është bërë në vija të përgjithshme aq sa kompetencat e transferuara mund të duken të pakufizuara (Oberdorff, 2008:288). Pavarësisht se Traktati i Lisbonës ka meritën e të qënurit i qartë, duhet theksuar që as ky traktat nuk mund të ndryshojë ndonjë gjë që ka të bëjë me aftësinë e BE-së për të shtrirë akoma më tej kompetencat e saj.

Në të vërtetë dispozitat kryesore mbi kompetencat gjenden në TFBE. Në fusha specifike zbatohen kategori të ndryshme kompetencash dhe pasojat konkrete ligjore burojnë nga një kategorizim i tillë. Kategoritë kryesore janë ato ku kompetencat e BE-së janë ekskluzive, atje ku ndahen mes shteteve (kompetencat e përbashkëta), atje ku BE kufizohet në mbështetjen/koordinimin e veprimit (kompetencat plotësuese/mbështetëse) si dhe kategori speciale për veprimtarinë e BE-së në sferën e politikës ekonomike dhe të punësimit, si dhe të Politikës së Përbashkët, të Jashtme dhe të Sigurisë (Craig & De Burca, 2013:215).

Kompetencat e përbashkëta janë simbol i ndarjes së sovranitetit mes dy entiteteve, ku njëri është shtetëror dhe tjetri është mbikombëtar. Në kuadrin e këtyre kompetencave, shteti dhe BE-ja mund të veprojnë së bashku por në të njëjtën kohë duhet të evitojnë çdo lloj

¹⁷Shih: Traktati i Lisbonës: neni 3 i TBE-së

kontradiktoriteti në veprimin e tyre. Në teori, secili prej entiteteve mund të ndërhyjë aty ku tjetri nuk e ka bërë por kjo situatë, pa diskutim, që është në favor të BE-së duke qënë se ky i fundit ka një shtrirje territoriale shumë më të madhe dhe shumë më të rëndësishme se sa ajo e një shteti dhe si rrjedhojë edhe ndikim më të madh. Kështu masat që merr BE-ja do t'i imponohen të gjitha Shteteve anëtare, ndërkohë e kundërta ndodh me masat që marrin Shtetet anëtare, të cilat aplikohen vetëm ndaj këtij të fundit (Mortier, 2011:235).

Në nenin 2 (2) të TFBE-së përcaktohen kompetencat e përbashkëta: “Kur traktatet i akordojnë Bashkimit një kompetencë të përbashkët me Shtetet anëtare, në një fushë specifike, Bashkimi dhe Shtetet anëtare mund të nxjerrin ligje dhe të miratojnë akte ligjërishit detyruese në atë fushë. Shtetet anëtare do t'i ushtrojnë kompetencat e tyre deri në atë shkallë ku Bashkimi nuk i ka ushtruar kompetencat e veta. Shtetet anëtare do t'i ushtrojnë kompetencat e tyre deri në atë shkallë ku Bashkimi ka vendosur të mos i ushtrojë kompetencat e tij”. Fushat që përfshihen në kompetencat e përbashkëta përcaktohen në nenin 4 të TFBE-së¹⁸. Por duhet thënë që kompetenca e përbashkët është një kategori e përgjithshme dhe zbatohet në disa fusha kryesore e cila nuk është domosdoshmërisht përfundimtare (Craig & De Burca, 2013:222). Kështu mund të themi se caktimi i atyre fushave të cilat rregullohen me anë të kompetencave të përbashkëta është pothuajse i pamundur për t'u prerë me thikë, gjë që komplikon seriozisht mundësitë e Shteteve anëtare për të ndërhyrë dhe e bën të vështirë dallimin midis asaj që është kombëtare dhe asaj që është mbikombëtare. Në logjikën e kompetencave të përbashkëta, shteti kufizohet në ushtrimin e pushteteve të tij sovrane pasi ndërhyrja e tij është në varësi të ndërhyrjes apo jo më parë të BE-së. Përpara një situatë të tillë sovraniteti juridik i Shteteve anëtare e humbet ekskluzivitetin e tij (Mortier, 2011:236).

¹⁸ Për më tepër shih nenin 4 të TFBE-së

Procesi i Bashkimit Evropian miraton idenë që sovraniteti i shtetit tashmë është i përbashkët. Megjithatë, influenca e BE-së shkon akoma më tej me kompetencat ekskluzive duke qënë se në ato fusha ku aplikohen kompetencat ekskluzive, shteti është i privuar krejtësisht nga kompetencat e tij dhe nuk ka mjetet e veprimit, pra është i privuar të ndërhyjë (Mortier, 2011:236).

Kompetencat ekskluzive të BE-së janë ato që dukshëm ndikojnë më shumë tek sovraniteti i shteteve, kjo sepse në ato fusha tek të cilat zbatohen kompetencat ekskluzive dhe të cilat i janë transferuar ekskluzivisht entitetit evropian, shtetet nuk kanë më asnjë fuqi veprimi.

Në nenin 2 (1) të TFBE-së përcaktohet kategoria e kompetencave ekskluzive, që kanë për pasojë faktin që vetëm Bashkimi mund të nxjerrë ligje dhe të miratojë akte ligjërish detyruese. Fushat që përfshihen në kompetencat ekskluzive parashtrohen në nenin 3 (1) të TFBE-së: politika monetare e shteteve anëtare që kanë si monedhë euron, bashkimi doganor, politika tregtare e përbashkët, politika e konkurrencës, po ashtu edhe ruajtja e burimeve detare. Megjithatë fusha e kompetencave ekskluzive ka pësuar zgjerime të njëpasnjëshme për shkak të interpretimeve të traktateve të bëra nga Komisioni¹⁹ dhe nga GJED-ja, të cilët me praktikat e tyre interpretuese kanë gjithmonë tendencë të privilegjojnë integritetin²⁰ (Heymann, 2010:5). Në çdo rast, shtetet nuk mund të ndërhyjnë në ato fusha ndaj të cilave BE-ja ka kompetenca ekskluzive, edhe pse këto fusha mund të kenë qënë më përpara nën pushtetin sovran të tyre. Në lidhje me këto kompetenca bëhet fjalë më shumë se sa për një ndarje të sovranitetit. Në fakt, mund të themi që bëhet fjalë për një privim të vërtetë të shteteve nga sovraniteti i tyre, për shkak të pamundësisë që ato kanë për të zbatuar një kompetencë që nuk i përket më. Thënë me fjalë të tjera, kjo ndarje e

¹⁹Shih: Raporti i Komisionit, 27 tetor 1992

²⁰Shih: Vendimi Rottman, 20 mars 2010, Nr.135/08

kompetencave vë në pozitë vërtet të vështirë Shtetet anëtare duke favorizuar ndërkohë Bashkimin Evropian.

Gjithashtu BE-ja ka kompetenca plotësuese/mbështetëse të cilat i lejojnë të plotësojnë normativat shtetërore kur këto të fundit janë të pamjaftueshme për rregullimin e marrëdhënieve për të cilat janë krijuar. Mundësia për të zbatuar këto kompetenca plotësuese është një faktor i vërtetë i vënies në diskutim të sovranitetit të shtetit duke qënë se entiteti mbikombëtar mbetet praktikisht i lirë për të sjellë një vlerësim cilësor mbi të drejtat kombëtare .

Në nenin 2 (5) të TFBE-së parashikohet se BE-ja mund të ndërmarrë veprime për mbështetjen, koordinimin apo plotësimin e veprimeve të Shteteve anëtare, pa i marrë kompetencat e tyre në këto fusha dhe pa prishur harmonizimin me të drejtat e Shteteve anëtare. Fushat që futen brenda kompetencave të tilla parashikohen në nenin 6 të TFBE-së: mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njerëzve, industria, kultura, turizmi, arsimi, trajnimi profesional, rinia dhe sporti, mbrojtja civile dhe bashkëpunimi administrativ.

Përpara kompetencave të tilla është e rëndësishme të kuptohet shtrirja e kompetencave të Bashkimit Evropian për fusha që futen brenda kësaj kategorie. Megjithëse harmonizimi për këto fusha përjashtohet, BE mund të miratojë akte detyruese ligjore mbi bazën e dispozitave specifike për ato fusha. Kur BE miraton akte të tilla ligjore, ato i detyrojnë Shtetet anëtare dhe kompetencat e Shteteve anëtare do të kufizohen deri në atë shkallë që e përcakton akti detyrues ligjor (Craig & De Burca, 2013: 226). Pra kuadri i kompetencave të Bashkimit Evropian brenda këtyre fushave nuk duhet nënvlerësuar. Metoda standarte sipas Traktatit të Lisbonës është që Bashkimi Evropian të fuqizohet për të marrë masa për të arritur objektivat e renditura në atë fushë (Craig & De Burca, 2013:225).

Në fund të fundit, është GJED-ja që i rikthehet sqarimit të ndarjes së vërtetë të kompetencave mes Shteteve anëtare dhe BE-së; megjithatë, përsëri, interpretimi i saj është gjithmonë në favor të Bashkimit Evropian (Berramdane & Rossetto, 2005:80) kjo sepse dimë që misioni i GJED-së është që të jetë garantuesi ligjor i sistemit komunitar. Paqartësia e traktateve, në fakt, i lejon BE-së të zgjerojë vazhdimisht fushën e kompetencave të saj, duke u ndihmuar fort nga institucionet e saj integruese, siç janë Komisioni dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Transferimi i kompetencave sjell një ndryshim substancial të kuptimit të shtetit, gjë që është krejtësisht armiqësore në raport me konceptin e sovranitetit. Shumë fusha mund të ilustrojnë këtë braktisje të sovranitetit nga ana e shteteve. Ushtrimi i kompetencave që i atribuohet ekskluzivisht BE-së është krejtësisht i qartë në fushën e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare. GJED-ja në këtë mënyrë siguron që shtetet të mos veprojnë në mënyrë individuale lidhur me marrëveshjet tregtare ndërkombëtare pasi këtë të drejtë duhet ta ketë vetëm BE-ja²¹.

Fusha të tjera janë të prekura nga rritja e kompetencave të BE-së, duke përfshirë kështu policinë dhe sigurinë e brendshme. Në fushën e sigurisë, Bashkimi Evropian ka një kompetencë që është e lidhur me sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë. Shtetet nuk janë më të lira që të zbatojnë politikën që duan dhe ky është veçanërisht rasti në çështjet doganore.

BE-ja ka gjithashtu kompetenca ekskluzive në çështjet monetare dhe këtu Shtetet anëtare janë të privuara krejtësisht nga kjo kompetencë (Borçard, 2010:39). Shtetet nuk kanë më monedhat e tyre kombëtare, por kanë vendosur të implementojnë një monedhë të vetme që i imponohet shumicës së Shteteve anëtare të BE-së. Në këtë fushë dhe për shkak të

²¹ Për më tepër shih: Opinion i GJED-së, 4 tetor 1979 dhe Opinion i GJED-së 1/94, 15 nëntor 1994.

kompetencave ekskluzive, krijohet një politikë e vërtetë komunitare, e cila ka ndikuar fuqishëm në cënimin e sovranitetit. Kjo ndodh sepse në këtë fushë ndodhet edhe esenca e kompetencave sovrane të shtetit.

Shfaqja dhe zbatimi gjithnjë e në rritje i fushave ku zbatohen kompetencat ekskluzive të BE-së kanë kontribuar në zbatimin e politikave të vërteta komunitare duke iu lënë një linjë veprimi Shteteve anëtare influenca e të cilëve po reduktohet gjithnjë e në më shumë fusha. Sovraniteti juridik ekziston gjithmonë si një kapacitet për të administruar kompetencat por titullari i tij tashmë është i pasigurtë, ashtu siç është tashmë i pasigurtë edhe kuptimi i tij.

5.2.3. Parashikimet kushtetuese të Shteteve anëtare “të vjetra” mbi transferimin e kompetencave në Bashkimin Evropian

Në vitin 1951, një sërë shtetesh evropiane vendosën për t’i dhënë fuqi sovrane institucioneve mbikombëtare duke krijuar Komunitetin Evropian të Çelikut dhe të Qymyrit (KEÇQ). Për ta legjitimuar një hap të tillë, Franca, Gjermania dhe Italia u mbështetën mbi kushtet që lejojnë kufizimet e sovranitetit ose transferimin e fuqive sovrane tek organizatat ndërkombëtare, të parashikuara në dispozitat kushtetuese të cilat u futën për herë të parë tek kushtetutat e pas Luftës së Dytë Botërore. Vendet e Beneluksit hartuan dispozita të ngjashme disa vite mbas anëtarësimit në Komunitetin Evropian të Çelikut dhe të Qymyrit (KEÇQ) apo në Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE). Meqënëse marrëveshje të reja u krijuan dhe më shumë shtete u bënë anëtare, autorizimi kushtetues për integrimin Evropian u bë më i shumëllojshëm. Në veçanti, Marrëveshja e Maastricht-it bëri që shumë shtete të parashikonin dispozita kushtetuese për transferimin e fuqive tek Bashkimi Evropian (BE)

dhe çoi në amendime të ndryshme që kishin lidhje me aspekte specifike të anëtarësimit në BE .

Meqënëse eksperiencia midis Shteteve anëtare ‘të vjetër’ është disi e shumëllojshme, katër modele kryesore të kushtetutave kombëtare duhet të dallohen për pranimin e integritimit në BE²²:

- kushtetutat të cilat përmbajnë një dispozitë të veçantë për delegimin e fuqive të shteteve tek Bashkimi Evropian. Ato megjithatë janë rishikuar në lidhje me aspekte të ndryshme specifike të anëtarësimit në BE (Gjermani, Francë, Austri, Portugali);
- kushtetutat të cilat përmbanin fillimisht një dispozitë të caktuar për delegimin e fuqive shtetërore tek Bashkimi Evropian, por që e kanë konfirmuar edhe më pas me disa dispozita të tjera në lidhje me këtë anëtarësim (Irlandë, Suedi, Greqi);
- kushtetutat ku anëtarësimi në BE është pranuar nën një klauzolë kryesore për organizatat ndërkombëtare, por disa amendime janë bërë në lidhje me aspekte specifike të anëtarësimit në BE (Finlanda, Belgjika, Italia, Spanja);
- kushtetutat në të cilat nuk përmendet Bashkimi Evropian, por pranohet anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare (Danimarka, Luksemburgu, Holanda).

Grupi i parë dhe i dytë përfshin ato kushte të cilat kanë dispozita të caktuara mbi delegimin ose transferimin e fuqive tek Bashkimi Evropian, me një diferencë që vjen nga niveli i përfshirjes së direktivave të BE-së në këto kushtetuta. Franca, Gjermania, Portugalia i

²² Albi Anneli, “EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe – Zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe Kushtetutat e Evropës Qendrore dhe Lindore”, Cambridge University Press, 2005.

amenduan kushtetutat e tyre në këtë aspekt gjatë procesit të ratifikimit të Marrëveshjes së Maastricht-it (Puto & Alimehmeti, 2014:22).

Në Irlandë, Austri dhe Suedi kushtetutat u amenduan kur shtetet hynë në Komisionin Evropian/Bashkimin Evropian, ndërsa Greqia i bëri amendimet në 2001. Grupi i mëparshëm i shteteve, sikurse dhe Austria, kanë në një mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme të ligjëruara të anëtarësimit të tyre në kushtetutat e tyre, duke e bërë këtë gjë në një kapitull të veçantë (Franca, Austria) ose përgjatë gjithë kushtetutës (Gjermani, Portugali). Ndërkohë, shtete të tjera e kanë kufizuar rishikimin kushtetues të lidhur me BE-në në një ose dy pika. Për të dhënë një shëmbull të neneve të delegimit, neni 88(1) i Kushtetutës Franceze, i cili është pjesë e një titulli të ri XV mbi Bashkimin Evropian, thotë që Franca do të marrë pjesë ‘në Bashkimin Evropian të përbërë nga shtete të cilët kanë zgjedhur vetë për të ushtruar disa prej fuqive të tyre të përbashkëta. Neni 23 (1) i Kushtetutës Gjermane siguron pjesëmarrjen në BE për “të krijuar një Evropë të Bashkuar”, dhe e lejon vendin që “të delegojë fuqitë sovraane” për këtë qëllim. Duhet të theksohet se megjithëse në Kushtetutën Austriake, neni për delegimin i drejtohet “organizatave ndërqeveritare” se sa shprehimisht BE-së, rëndësia simbolike e vendosjes së një seksioni të tërë mbi “Bashkimin Evropian” në kapitullin e parë fare të Kushtetutës (Kapitulli 1B, neni 23-a-23f) e justifikon përfshirjen e kësaj në këtë grup. Kushtetuta Irlandeze përdor një formulë tjetër, duke parashikuar që Irlanda mund të bëhet anëtare e Komuniteteve Evropiane (neni 29(4)). Duke pasuar vendimin *Crotty* që ka lidhje me ratifikimin e Aktit Unik Evropian, kushtetuta irlandeze është amenduar më pas për të siguruar një autorizim të veçantë për ratifikimin e çdo marrëveshje të re. Në Greqi, neni 28 i cili thotë që fuqitë mund t’i jepen organizatave ndërkombëtare, u plotësua në 2001 me një nen të ashtuquajtur ‘neni interpretues’ sipas të cilit dispozitat e nenit 28 në mënyrë të barabartë përbëjnë

themelin për pjesëmarrje në procesin e integrimit evropian (Puto & Alimehmeti, 2014:22-23).

Grupi i tretë dhe i katërt janë formuar nga ato kushtetuta ku integrimi në BE është pranuar nën një nen të përgjithshëm të organizatat ndërkombëtare, në vend që BE të adresohet në veçanti (Puto & Alimehmeti, 2014:23).

Ndërkohë që ato të grupit të tretë përmbajnë disa amendime që kanë lidhje me disa aspekte specifike të anëtarësimit në BE, kushtetutat e grupit të katërt janë akoma efektivisht të heshtura mbi anëtarësimin në BE në 2004. Në fakt, panorama kushtetuese u dominua nga grupi i fundit deri në 2000-2001 – kushtetutat e Danimarkës, Luksemburgut, Hollandës, Italisë, Greqisë nuk i dhanë lexuesit ndonjë shenjë të anëtarësimit të vendit në BE. Megjithatë Greqia për herë të parë futi në 2001 të lartpërmendurin ‘neni interpretues’ dhe Italia futi në të njëjtin vit një dispozitë (neni 117) mbi ndikimin e ligjit të BE-së mbi rajonet, i cili plotëson nenin 11 mbi ‘kufizimet e sovranitetit’, megjithëse ky i fundit vazhdon të konsiderohet si baza kryesore për anëtarësimin në BE. Finlanda pranoi në 2000 një kushtetutë të re, e cila trajton disa aspekte specifike të anëtarësimit në BE, veçanërisht ri-ndarjen e fuqive të institucioneve shtetërore në mënyrë që të përfaqësojë vendin në çështjet e BE-së. Kushtetuta e re zëvendësoi atë të mëparshmen, e cila megjithëse adresonte pjesëmarrjen e Parlamentit në çështjet e BE-së, nuk përmbante ndonjë bazë të veçantë për delegimin e fuqive. Anëtarësimi u bë me anë të ashtuquajturës ‘sistemi i amendimit përjashtues’, sipas së cilës Parlamenti mund të ratifikojë, me anë të një shumice të veçantë, marrëveshje të cilat bien në konflikt me kushtetutën (Puto & Alimehmeti, 2014:23).

Kushtetuta e Spanjës nuk e përmend në veçanti BE-në, por bën pjesë në grupin e tretë për shkak të amendimit të nenit 13(2), ku e drejta e shtetasve të shteteve të tjera për të votuar

dhe për t'u votuar në zgjedhje, në bazë të kushteve të vendosura në marrëveshje, u fut përpara se të ratifikohej Marrëveshja e Maastricht-it. Kushtetuta belge gjithashtu bën pjesë në grupin e tretë për shkak të të njëjtit kusht, e kombinuar me disa referenca të tjera për BE-në (Puto & Alimehmeti, 2014:23).

Duke pasur parasysh prezencën shumë intensive të BE-së në fushat e mëparshme sovrane të udhëheqjes, duhet të jetë interesante për të konsideruar arsyet pse transferimi i fuqive tek BE nuk është i shprehur në mënyrë eksplicite në shumë kushtetuta. Në lidhje me shtetet e Beneluksit, është komentuar që kushtet mbi organizatat ndërkombëtare u pranuan gjatë viteve 1950-1970 me një orientim mbi anëtarësimin në Komisionin Evropian dhe amendimi nuk ka qenë në axhendë sepse këto vende kanë qenë tradicionalisht shumë pro integritetit evropian dhe nuk është krijuar asnjë konflikt kushtetues. Ky është kryesisht rasti me Italinë, ku neni për integrimin u vendos me qëllim anëtarësimin në Kombet e Bashkuara dhe u aplikua më vonë në lidhje me anëtarësimin në Komisionin Evropian. Klauzola e Luksemburgut mbi transferimin 'e përkohshëm' të sovranitetit (neni 49 bis) është shpjeguar në bazë të numrit të vogël të popullsisë dhe rrjedhimisht të diskutimit të rrallë ligjor. Italia nisi në gjysmën e dytë të viteve 1990 një rishikim të rëndësishëm të kushtetutës, e cila mund të ketë futur gjithashtu nenet e BE-së, por i tërë plani u përmbys në vitin 1998 për arsye politike; eventualisht dispozitat mbi rajonet në kontekstin e ligjit të BE-së u adoptuan në vitin 2001. Italia duke bërë pjesë në një sistem mbikombëtar më të gjerë i ka kaluar pjesë të sovranitetit të saj në lidhje me traktatet BE-së, me kufirin e vetëm të paprekshmërisë së parimeve dhe të drejtave themelore të garantuara nga Kushtetuta (kundra-limite) (Puto & Alimehmeti, 2014:24)

Gjithashtu, duket të ketë një lidhje interesante midis faktit që shumë kushtetuta që nuk kanë një dispozitë mbi transferimin e fuqive të BE, kanë një procedurë më të vështirë në lidhje

me amendimin. Ndërkohë që kushtetutat e dy grupeve të para mund të amendohen nga një procedurë relativisht e thjeshtë parlamentare, përveç Irlandës ku kërkohet një referendum, kushtetutat e dy grupeve të tjera kërkojnë për amendim ose shpërbërjen e Parlamentit, aprovimin nga dy Parlamente të njëpasnjëshme, ose një referendum. Kur amendohen dispozitat kryesore, parlamenti duhet të shpërbëhet në Belgjikë, Luksemburg ndërsa në Spanjë kërkohet gjithashtu dhe një referendum (Puto & Alimehmeti, 2014:24).

Ndërkohë në Greqi kërkohet aprovimi me anë të dy votimeve të parlamentit, në Finlandë amendime urgjente mund të adoptohen me një shumicë prej pesë të gjashtave të anëtarëve të Parlamentit. Në Danimarkë, një referendum kërkohet për amendimet. Faktor tjetër i cili është i lidhur me amendimet ka ndikim të veçantë në Finlandë dhe në Holandë, ku marrëveshjet që konfliktojnë me kushtetutën mund të aprovohen nga Parlamenti me një shumicë të veçantë votash (Puto & Alimehmeti, 2014:26).

Pas analizës mbi parashikimet kushtetuese të Shteteve anëtare mbi delegimin e sovranitetit drejt Bashkimit Evropian, tani do të bëjmë një ndalesë lidhur me çështjet që kanë çuar në amendime kushtetuese dhe që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të anëtarësimit në BE. Ka një shumëllojshmëri çështjesh të tilla, por ndër këto, tri çështje mund të dallohen nga të tjerat të cilat kanë shkaktuar ndryshime në një numër të konsiderueshëm të kushtetutave të Shteteve anëtare.

Së pari, tetë vende e kanë konsideruar të nevojshme për të siguruar në Kushtetutë kontrollin e Parlamenteve Kombëtare mbi qeveritë në procesin e vendimmarrjes në BE. Çfarë do të thotë kjo? E drejta e Parlamentit për t'u informuar në lidhje me propozimet për aktet legislative në BE, dhe për t'u lëshuar pozicione qeverive kombëtare në aktivitetin e tyre të vendim-marrjes në Këshill. Dispozita të tilla i gjejmë në kushtetutat e Gjermanisë (nenet 23

(2-3), 52 (3a)), Finlandës (nenet 93 (2), 96-7, 50 (3)), Portugalisë (nenet 161n, 163f dhe 197 (1i)), Austrisë (neni23e), Suedisë (Kapitulli 10 i aktit Parlamentar), Francës (neni 88 (4)), Belgjikës (neni 168) dhe Greqisë (neni 70 (8)). Arsytet për ndryshime të tilla janë shumë të njohura: procesi i vendimmarrjes në BE është i dominuar kryesisht nga dega ekzekutive, i shoqëruar me një erozion në rritje të pushtetit të lartë të Parlamenteve për të nxjerrë ligje për shkak të delegimeve të njëpasnjëshme të kompetencave në BE (Puto & Alimehmeti, 2014:28).

E drejta e qytetarëve të BE-së për të drejtën aktive dhe pasive në zgjedhjet e komunave lokale në një Shtet tjetër anëtar ka çuar në nevojën për të bërë një amendim në Gjermani (neni 28 (1)), Francë (neni 88 (3)), Portugali (neni15 (5)), Austri (nenet 23a dhe 117 (2)), Spanjë (neni 13 (2)) dhe Belgjikë (neni 8 (3)). Përveç kësaj, kushtetuta portugeze dhe ajo austriake gjithashtu përcaktojnë shprehimisht të drejtën e qytetarëve të BE-së për të kandiduar dhe për të votuar në zgjedhjet e Parlamentit Evropian. Arsytet për ndryshime të tilla vijnë nga pikëpamja tradicionale kushtetuese që përcakton se të drejtat e votimit u përkasin qytetarëve për shkak të lidhjes së tyre të fortë komb-shtet. Këto dispozita çuan në nevojën për rishikim pas futjes nga Marrëveshja e Maastricht-it të së drejtës së votës aktive dhe pasive të qytetarëve të BE-së në zgjedhje të tilla, nëse ata banojnë në një Shtet tjetër anëtar (Neni19 (1)KE). Në Francë, kjo është paraprirë nga gjetja e Këshillit Kushtetues ku në vendimin për miratimin e Traktatit të Maastricht-it²³ interpretohet se të drejtat zgjedhore të qytetarëve të BE-së në zgjedhjet lokale të shteteve të tjera të Komuniteteve, shkojnë në kundërshtim me nenin 3 të Kushtetutës, i cili parashikon se sovraniteti kombëtar i takon

²³Vendimi nr.92-308 DC, i datës 9 Prill 1992, i publikuar në www.conseil-constitutionnel.fr. Të shihet në veçanti Jacques J.P., “Commentaire de la décision du Conseil constitutionnel n 92-308 DC du 9 avril 1992: Traité sur l’Union européenne 1992” (1992) Revue Trimestrielle du Droit Européen 251; L. Dubois, ‘France’ in Rideau, ‘Etats Membres’, pp. 217-21; Bonnie, ‘Constitutionality of Transfers’, pp. 517-32.

popullit, i cili e ushtron atë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ose me anë të referendumit dhe se vetëm shtetasit francezë e formojnë elektoratin.

Grupi i tretë i ndryshimeve ka të bëjë me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (BEM). Nga dymbëdhjetë shtete pjesëmarrëse, dispozitat për këtë efekt gjenden në kushtetutat e Gjermanisë, Francës, Portugalisë dhe Greqisë. Lidhur me autoritetin e një shteti dhe identitetin kombëtar, kontrolli mbi monedhën vendase ka formuar tradicionalisht një bazë tjetër të rëndësishme të sovranitetit dhe është e rregulluar në një farë forme në shumë kushtetuta (Chirico, 2003:139). Në krahasim me shumë fusha të tjera të politikave, ku Shtetet anëtare kanë deleguar në BE vetëm tek disa prej prerogativave, hyrja në BEM do të thotë një dorëzim i plotë, megjithëse progresiv i kompetencave monetare (Chirico, 2003:144). Njësoj si me çështjen e të drejtave të votimit të qytetarëve të BE-së, Këshilli Kushtetues Francez përcaktoi në vendimin e Maastricht-it se BEM dëmton “kushtet kryesore të ushtrimit të sovranitetit kombëtar” dhe për këtë arsye çon në nevojën për të bërë një amendim kushtetues përpara ratifikimit të Traktatit. Neni i ri 88 (2) i Kushtetutës franceze parashikon se: “Franca jep pëlqimin për transferimin e kompetencave të nevojshme për krijimin e Bashkimit Ekonomik Monetar”.

Në Gjermani, ratifikimi i Marrëveshjes se Maastricht-it, u parapri gjithashtu nga një ndryshim në këtë drejtim. Grundsgesets (Ligji Themeltar Gjerman) parashikon se detyrat dhe kompetencat e Bankës Federale mund t’i transferohen Bankës Qëndrore Evropiane, e cila është e pavarur dhe kryesisht e lidhur me qëllimin për të siguruar stabilitet të çmimeve. Kushtetuta Portugese u amendua në lidhje me këtë në dy raste, në vitin 1992 dhe në vitin 1997. Si pasojë e amendimit të vitit 1997, neni 102 parashikon se Banka e Portugalisë do të kryejë funksionet e veta në përputhje me ligjin dhe me rregullat ndërkombëtare me të cilat shteti portugez duhet të jetë në përputhje (Botelho Moniz, 1998:4).

Përveç sa është thënë më lartë, disa çështje kanë çuar në ndryshime kushtetuese në dy apo tre shtete. Këto kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e nënndarjeve federale, rajoneve autonome dhe/ose bashkive vendore në çështjet e BE-së²⁴; ndalimin e pushteteve paralele me Parlamentin Evropian dhe me institucionet shteterore²⁵ dhe procedurat kombëtare për emërimin e zyrtarëve të BE-së²⁶. Duhet të theksohet se vetëm Kushtetuta e Irlandës shprehimisht përcakton supremacinë e ligjit të Bashkimit Evropian (neni 29 (4)). Në kushtetutat e tjera, kjo çështje e rëndësishme është e vendosur në nenet mbi aplikimin e së drejtës ndërkombëtare, të cilat në disa raste janë futur në funksion të zbatimit të ligjit të KE-së (p.sh. në Hollandë). Përveç ndryshimeve të mësipërme, ka një shumëllojshmëri çështjesh të tjera të cilat kanë sjellë një ndryshim në secilin nga Shtetet anëtare. Për shembull, Austria ka paraqitur amendamentet në lidhje me disa çështje organizative që kanë të bëjnë me punën dhe zgjedhjet e anëtarëve të Parlamentit Evropian (nenet 10 (1), 23b, 30 (3), 151 (11), 141). Kushtetuta belge ka një dispozitë në lidhje me datën e zgjedhjeve të Parlamentit Evropian (neni 117 (2)), etj.

Kushtetuta e Finlandës i klasifikon çështjet e BE-së si kompetenca të qeverisë, ndërsa përfaqësimi në punët e jashtme zakonisht ka qenë nën përgjegjësinë e Presidentit (neni 93). Kushtetutat e Austrisë (neni 23) dhe Portugalisë (neni 164) rregullojnë emërimin kombëtar të zyrtarëve të BE-së, dhe Austria ka një ndryshim mbi pjesëmarrjen në Politikën e Përbashkët dhe të Jashtme të Sigurisë (neni 23). Kushtetuta franceze përmban një dispozitë mbi lëvizjen e lirë të personave, me një referencë mbi Traktatin e Amsterdimit. Kushtetuta gjermane përmban një dispozitë mbi të drejtën e azilit në lidhje me shtetet e KE-së (neni 16), dhe në lidhje me administrimin e tatimeve të KE-së në nivelin federal (neni 108 (1)).

²⁴Kushtetutat e Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës dhe Portugalisë.

²⁵Kushtetutat e Italisë, Finlandës dhe Austrisë.

²⁶Kushtetutat e Austrisë dhe Portugalisë.

Gjermania ka ndryshuar kohët e fundit nenin 12 të Kushtetutës, për të lejuar aksesin e grave në shërbimin ushtarak, në përgjigje të rastit Tanja Kreil në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë²⁷.

5.2.4. Kushtetutat e vendeve të Evropës Qëndore dhe Lindore dhe parashikimet kushtetuese mbi transferimin e kompetencave sovrane

Në një përshkrim të përgjithshëm, mund të themi se historia kushtetuese e dhjetë vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore ka kaluar në katër faza kryesore transformimi²⁸:

- miratimi i kushtetutave të para në shumicën e vendeve si rezultat i krijimit të republikave të pavarura midis dy luftërave botërore;
- aplikimi i kushtetutave komuniste mbas ardhjes në pushtet të Bashkimit Sovjetik në vitet 1940;
- miratimi i kushtetutave të reja ose rishikim të plotë të kushtetutave komuniste pas ndryshimit të regjimit në fillim të viteve 1990; dhe
- rregullimet e mëpasme të kushtetutave, duke përfshirë edhe 'hapjen' e kushtetutave për transferimin e kompetencave tek organizatat ndërkombëtare dhe tek BE-ja.

Me ndryshimin e regjimit komunist ndodhen edhe transformime në kushtetutat e vendeve ish-komuniste. Shtetet e reja apo te riformatuara miratuan kushtetuta të reja, ndërsa vendet e Evropës Qendrore zgjodhën për një amendament të mëpasëm të kushtetutave të tyre Komuniste. Për shembull, Hungaria ruajti Kushtetutën sovjetike të vitit 1949, edhe pse e rishikoi të tërën në vitin 1989 dhe bëri nëntë amendime të mëtejshme në vitin 1990, deri në

²⁷ Çështja C-285/98, Tanja Kreil kundër Gjermanisë, 2000, ECR I-69.

²⁸Për më tepër shih: Dick dhe Howard A.E.(dhe të tjerë.), "Constitution Making in Eastern Europe, Woodrow Wilson, Washington, Amerikë, 1993; Bartole S., "Riforme costituzionali nell'Europa centro-orientale, Bolonja, Itali, 1993.

atë pikë që Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se, si pasojë e ndryshimeve, "një Kushtetutë e re hyri në fuqi dhe ajo ndryshoi rrënjësisht rendin e mëparshëm shtetëror, politik dhe juridik"²⁹. Në fakt edhe pas këtij vendimi, sipas të cilit amendamentet ishin të përkohshme dhe do të hartohesh një tekst i ri kushtetues, Kushtetuta e vitit 1949 vazhdon të jetë akoma e aplikueshme.

Në Çekosllovakia, Kushtetuta Komuniste e vitit 1960, e cila iu nënshtrua një rishikimi themelor në 1989-90, u mbajt me forcë zyrtarisht deri në shpërbërjen e Federatës. Një kushtetutë e re e Çekosllovakisë është debatuar në periudhën 1990-1992. Megjithatë, pas ndarjes së Republikës Çeke dhe Sllovake në vitin 1992, të dyja vendet miratuan kushtetuta të reja. Në Poloni, kushtetuta komuniste e vitit 1952 u amendua tërësisht në vitin 1989 dhe 1990, edhe pse mbeti në fuqi. Në dhjetor të vitit 1992, e ashtuquajtura "Kushtetuta e vogël" u miratua, e cila mbajti në fuqi një pjesë të Kushtetutës së 1952, duke përfshirë edhe kapituj për të drejtat e qytetarëve. Edhe pse drafte për një kushtetutë të re kanë ekzistuar nga viti 1991 e tutje, mungesa e konsensusit politik mbi zgjedhjen e një modeli parlamentar apo presidencial vonoi miratimin e kushtetutës së re deri në vitin 1997 (Puto & Alimehmeti, 2014:33).

Ndryshe nga vendet e Evropës Qendrore, vendet e Evropës Jug-lindore dhe dy vendet balltike zgjedhën kushtetuta krejtësisht të reja, ku tre prej tyre u pranuan me anë të "*fuqisë së saj*" në referendum. Kushtetuta rumune është miratuar me referendum në vitin 1991 dhe Kushtetuta e Bullgarisë është miratuar nga Asambleja e Pergjithshme Kombëtare po në të njëjtin vit. Në shtetet baltike, (ri)miratimi i kushtetutave u parapri nga hapa të caktuara kushtetuese që hapen rrugën për ri-vendosjen e sovranitetit të tyre e cila është *de jure* e

²⁹Vendimi Nr. 11/92 (III.5) AB Hatarozat No. 23, datë 5 Mars 1992, i cituar në Pogany I., "Constitutional Reforming Central and Eastern Europe: Hungary's Transition to Democracy", International and Comparative Law Quarterly, 1993.

vlefshme, por *de facto* e pezulluar. Këto hapa filluan me miratimin e Deklaratave të Sovranitetit në periudhën 1988-1989, ku zbatueshmëria e ligjeve federale të Bashkimit Sovjetik iu nënshtrohej një ratifikimi paraprak nga Sovjetët e Lartë lokalë (organet më të larta qeverisese lokale të Republikës Federale të Bashkimit Sovjetik). Kjo u pasua me futjen e dokumentave kushtetuese, të cilat përgatiten modalitetet për shkëputjen nga Bashkimi Sovjetik, duke çuar në referendume për pavarësi në vitin 1991. Bazuar në një miratim në masë të pavarësisë në këto referendume, vendet shpallën Deklaratat e tyre të Pavarësisë dhe filluan të punonin për kushtetuta të reja (Puto & Alimehmeti, 2014:33-34).

Kushtetutat e reja post-komuniste shënojnë në shumë mënyra një ndarje të plotë nga e kaluara totalitare. Si reagim ndaj sistemit sovjetik, të gjitha kushtetutat shpallin parimet themelore të demokracisë liberale, si pluralizmi politik; mbrojtja e të drejtave dhe lirive civile dhe politike; zgjedhje të lira, një shtet i bazuar mbi udhëheqjen sipas ligjit; ndarja dhe ekuilibri ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; liria ekonomike; pronësia private; shtypi i lirë. Ndër ndryshimet më të rëndësishme në të gjithë rajonin, gjatë dekadës së kaluar, ka qënë amendimi i shumicës së kushtetutave në lidhje me transferimin e kompetencave në BE dhe organizata ndërkombëtare, si edhe në lidhje me detyrime të tjera ndërkombëtare, si ato që vijnë nga Marrëveshjet me Evropën dhe anëtarësimit në NATO. Por këto amendime ndodhën shumë vonë sepse nuk duhet harruar se kushtetutat post-komuniste të Evropës Qëndrore dhe Lindore janë dukshëm në mbrojtje të sovranitetit, krahasuar me shumë kushtetuta të tjera në Evropën Perëndimore. Pesë dekadat e nënshtërimit të detyruar ndaj Bashkimit Sovjetik, me pasoja të dëmshme për kulturën, ekonominë dhe jetën sociale të këtyre vendeve dhe për ekzistencën kombëtare në vendet baltike, kanë lënë një shenjë të thellë tek kushtetutat. Pse ndodhën shumë vonë? Karakteristikë e kushtetutave të Evropës Lindore është se, megjithëse u aprovuan gjatë

periudhës kur kushtetutat e Evropës Perëndimore po adaptoheshin për të mirëpritur Traktatin e Maastrichtit, ato nuk kishin ndonjë parashikim që të autorizonte procesin “Kushtetues” të Integritit Evropian, apo thjeshtë një klauzolë të hapur integruese. Më konkretisht, nëntë nga dhjetë kushtetutat e EQL-ve duke qënë “fanatike” të sovranitetit të tyre shtetëror nuk kishin parashikuar dispozita për transferimin e kompetencave tek organizatat ndërkombëtare deri kohët e fundit dhe në disa vende, amendimi i sovraniteti është i ndaluar, ose në disa të tjera amendime të tilla duhet ose mund të kalojnë vetëm me referendum³⁰.

Duhet të theksohet se gjatë procesit të hartimit të kushtetutave të reja, ekspertë të huaj në disa vende kanë rekomanduar përfshirjen e dispozitave për transferimin e kompetencave tek organizatat ndërkombëtare. Për shembull, në Republikën Çeke, drafti i kushtetutës përmbante një nen për këtë qëllim, dhe u theksua se pa dispozitën përkatëse, kjo Republikë mund edhe të mos ishte në pozicionin për të hyrë në Bashkimin Evropian. Heqja e këtij neni nga kushtetuta finale u konsiderua si një rast interesant nga këshilltarët e huaj³¹. Nenet për integrimin në organizatat ndërkombëtare dhe evropiane ishin gjithashtu të rekomanduara nga ekspertë të huaj në Estoni gjatë diskutimeve në Mbledhjet Kushtetuese.

Përveç masave të mësipërme, ekzistojnë disa parashikime kushtetuese në lidhje me ndryshimin e sovranitetit. Disa kushtetuta të vendeve të EQL-së thjesht ndalojnë ndryshimin e neneve kryesore të kushtetutave (Rumania dhe Republika Çeke) ose deklarojnë disa parime të pandryshueshme dhe të padiskutueshme (Estonia - sovraniteti dhe pavarësia; Slloveni - të drejtën për vetëvendosje kombëtare).

³⁰ Albi Anneli, “EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe”, Cambridge University Press, 2005.

³¹ Stein Eric, “International Law in Internal Law: Toward Internationalization of Central-Eastern European Constitutions?”, American Journal of International Law, 1994.

Në katër kushtetuta, amendimi i dispozitave për sovranitetin kërkon një referendum, ndërsa në tre të tjera kjo është fakultative. Në Rumani, kushtetuta kërkon një referendum për ndryshimet kushtetuese; kjo pasqyron qëllimin e Asamblesë Kushtetuese për të bërë ligjin themelor të vendit “të gdhendur në gur”. Kushtetutat e Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë kërkojnë një referendum për ndryshimin e dispozitave themelore të paraqitura në kapitujt e parë, duke përfshirë këtu edhe sovranitetin. Në Letoni dhe Estoni, dispozitat e zakonshme gjithashtu mund të jenë në mënyrë opsionale subjekt i një referendumi. Polonia ofron një referendum opsional posaçërisht për ndryshimin e dispozitave themelore të Kapitullit I, si dhe për hyrjen në organizatat ndërkombëtare (Puto, 2013:32).

Kushtetuta sllovene jep të drejtën e një referendumi për çdo ndryshim në kushtetutë, ku dhe kërkohen tridhjetë deputetë. Në Bullgari, ndryshimet kushtetuese nuk mund të bëhen me referendum, por Asambleja e Përgjithshme Kombëtare duhet të zgjidhet posaçërisht në mënyrë që të amendojë çështjet themelore. Duhet të theksohet gjithashtu se mundësia e mbajtjes së një referendumi është parashikuar në ndryshimet e fundit të BE-së për futjen në organizata ndërkombëtare ose në BE të Republikës Çeke, Sllovenisë dhe Letoni-së. Referendumet, kërkojnë një pjesëmarrje minimale mjaft të lartë (zakonisht 50 përqind, dhe $\frac{3}{4}$ të të gjithë qytetarëve të cilët kanë të drejtë vote në lidhje me amendimin e nenit 1 në Lituaninë), dhe nuk mund të rinisen gjatë një periudhe të caktuar në rast dështimi. Së fundi, ndryshimi i procedurës së amendamentit kushtetues kërkon një referendum në Estoni, Letoni, Lituaninë dhe Rumania. Në Poloni, një referendum i mundshëm është përcaktuar posaçërisht për këtë rast, ndërsa në Bullgari duhet të zgjidhet Asambleja e Përgjithshme Kombëtare (Puto, 2013:32).

Në fund të kësaj analize mund të themi që, parashikimet kushtetuese të vendeve të EQL-ve mbi delegimin e kompetencave në organizatat ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë futja e

neneve për statusin e së drejtës ndërkombëtare, ndoshta reflektojnë natyrën graduale të largimit nga një mungesë e plote e dimensionit ndërkombëtar në Kushtetutat Komuniste drejt pranimi tashmë në mënyrë të shprehur të ndërkombëtarizimit të tyre në kuadër të një konteksti evropian.

5.3. Zhvillimi i politikave evropiane integruese dhe praktika e shtyllave: nga Maastricht-i tek Lisbona

Përtej kompetencave të përcaktuara nga Traktatet e BE-së, këto të fundit shtuan edhe prerogativa specifike për Bashkimin Evropian të cilat i japin këtij entiteti ekskluzivitetin në implementimin e politikave komunitare, që do të thotë se Shtetet anëtare duhet të arrijnë shumicën për marrjen e vendimeve në këto fusha dhe se nuk mund të vendosin më në mënyrë individuale për to.

5.3.1. Praktika e vjetër e shtyllave

Koncepti i shtyllave në Bashkimin Evropian paralajmëroi një tjetër sfidë për sovranitetin e Shteteve anëtare, koncept i cili është i bazuar në nevojën për të zbatuar një orientim të përbashkët në nivel evropian.

Përtej komuniteteve evropiane dhe sistemit të tyre të integruar, procesi i integrimit evropian bazohej gjithashtu, pas Traktatit të Maastricht-it dhe para Traktatit të Lisbonës, në dy shtylla të cilat funksiononin sipas një metode tradicionale të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërqeveritar. Kjo praktikë e shtyllave, e cila është suprimuar totalisht me Traktatin e Lisbonës, ruan një dimension thelbësor shpjegues në lidhje me metodën e “ingranazhit komunitar”. Shtylla e parë lejonte zbatimin e fushës së bashkëpunimit gjyqësor dhe shtylla

e dytë lejonte zbatimin e një forme të ekzistencës së BE-së në skenën ndërkombëtare (Mortier, 2011:239).

Duhet të theksojmë se pasojat e zbatimit të këtyre dy shtyllave ishin paradoksale pasi ato përfshinin në të njëjtën kohë ruajtjen e sovranitetit të shteteve por edhe vënien në diskutim të konceptit të sovranitetit absolut. Kështu, bashkëpunimi i dëshiruar nga Traktati i Maastricht-it në skenën ndërkombëtare dhe në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ka kontribuar për të forcuar integrimin e BE-së pasi pa këto dy shtylla pranë komuniteteve evropiane, asnjë kompetencë nuk do të mund t'i atribuohet institucioneve evropiane në lidhje me këto fusha.

Megjithatë ky bashkëpunim nuk dukej *a priori* se cënonte sovranitetin e shteteve pasi në këto fusha, parimi i unanimitetit, vazhdonte të imponohej dhe mbetej simboli i pushtetit të bllokimit nga ana e Shteteve anëtare.

Nga njëra anë, sovraniteti i shteteve mbetej gjithmonë një koncept i aplikueshëm. Të dy komponentët plotësues iu shtuan komuniteteve me qëllim krijimin e Bashkimit Evropian por ato i nënshtroheshin regjimit të unanimitetit, sipas së cilit çdo Shtet anëtar kishte të drejtën e kundërshtimit, pra kishte kontroll ndaj kompetencave të tij. Kështu sovraniteti i Shtetit anëtar ruhej, por ideja për të implementuar një qëndrim të përbashkët, si në arenën ndërkombëtare ashtu edhe në çështjet e sigurisë dhe të drejtësisë ka kontribuar tashmë në krijimin e konkurrencës potenciale ndaj shtetit (Mortier, 2011:239).

Nga ana tjetër, nëse teoria ka mbrojtur idenë në favor të ruajtjes së sovranitetit të shtetit, realiteti është krejt ndryshe. Në fakt, sipas metodës integruese, tashmë të instaluar, bashkëpunimi ka rezultuar fillimisht në krijimin e pozicioneve të përbashkëta dhe më pas gradualisht kjo çoi në zbatimin e politikave të vërteta evropiane. Është e qartë se në këtë

kontekst evolutiv, kufiri mes bashkëpunimit dhe integritetit do të bëhet gjithnjë e më shumë i vështirë për t'u përcaktuar dhe kjo lëvizje do të ndikojë domosdoshmërisht tek sovraniteti i shtetit (Mortier, 2011:240).

Në kuadrin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (PJSP), Këshilli ka përcaktuar veprimet e përbashkëta si dhe parimet e politikës së jashtme. Shtetet janë të lidhura me këto veprime të përbashkëta që nga momenti kur ato janë vendosur nga Këshilli. Nëse shteti dëshironte të rishikonte pozicionin e tij duke u tërhequr kjo nuk ishte e mundur³². Shteti nuk kishte mundësi manovrimi pas momentit të marrjes së vendimit. Kjo pamundësi për të devijuar nga respektimi i veprimeve të përbashkëta reduktonte ndjeshëm sovranitetin e shteteve.

Në mënyrë të ngjashme, në kuadrin e Bashkëpunimit në Drejtësi dhe në Punët e Brendshme (BDPB), bashkëpunimi sigurisht rezultoi në një vendimmarrje unanime që, siç e kemi parë, pengonte Bashkimin Evropian në posedimin e plotë të pushtetit sovran, por gjithsesi, nuk ekzistonte mundësia e tërheqjes pasi ishte marrë vendimi. Ndikimi i këtyre rregullave në fushën e policisë dhe të drejtësisë çoi, pashmangshmërisht, në dobësimin e sovranitetit të shteteve. Neni 34 i TBE-së parashikon që: Këshilli merr masa dhe favorizon bashkëpunimin për të kontribuar në ndjekjen e objektivave të BE-së duke vendosur unanimitetin, në formën e qëndrimeve të përbashkëta, në kuadrin e vendimmarrjes, etj.³³.

Praktika e dy shtyllave ka ndikuar kështu në përmbajtjen e sovranitetit të Shteteve anëtare, si në aspektin e jashtëm, ashtu dhe në aspektin e brendshëm. Kjo praktikë ka krijuar një lloj

³² Shih nenin 12 të Traktatit të Maastrichtit i cili përcakton parimet, orientimet e përgjithshme të politikës së jashtme, strategjitë e përbashkëta, veprimet dhe qëndrimet e përbashkëta. Shih gjithashtu nenet 14 dhe 15 të Traktatit të Maastrichtit të cilat i imponojnë Shteteve anëtare për të respektuar veprimet dhe qëndrimet e përbashkëta të cilat, në mënyrë të pashmangshme kanë ndikime tek sovraniteti shtetëror. Këto nene janë zëvendësuar me nenet 25, 28 dhe 29 të TBE.

³³ Shih nenin 34 të TBE-së

tranzicioni nga ushtrimi i pastër i kompetencave shtetërore drejt një ushtrimi të plotë të këtyre kompetencave në nivel komunitar. Shtetet anëtare nuk kanë pasur gjithmonë mundësinë e zgjedhjes; edhe atëherë kur ato kanë pasur mundësinë të jenë pjesë apo jo e vendimeve të marra në kuadrin e shtyllave, forca institucionale e BE-së shpesh iu ka imponuar atyre të gjejnë një kompromis. Dy shtyllat e bashkëpunimit përbënin në çdo rast një zgjerim të fushave nën kompetencën e BE-së, zgjerim i cili, duke ecur sipas logjikës së integritit progresiv, do të privonte shtetet nga një pjesë e sovranitetit të tyre qoftë politik, qoftë juridik.

Traktati i Amsterdimit përbën etapën e parë të “komunitarizimit” të një pjesë të madhe të kompetencave të shtyllës së tretë. Një numër i madh çështjesh, që tradicionalisht ishin kompetencë e shteteve sovraane morën karakter komunitar, të tilla si politikat e emigracionit, e drejta e azilit, rregullat për kalimin e kufijve, etj. Me Traktatin e Amsterdimit, shtylla e tretë, ajo e bashkëpunimit gjyqësor dhe policor, është bërë më e ngushtë. Këtu bëhet fjalë për një bashkëpunim gjithnjë e më të qartë mes autoriteteve gjyqësore dhe atyre të policisë. Në fakt qëllimi ishte i qartë: BE-ja synonte që gradualisht të braktiste metoden e bashkëpunimit të thjeshtë duke synuar triumfin e komunitarizmit. Konkretizimi i këtij objektivi u arrit plotësisht me Traktatin e Lisbonës nëpërmjet metodës së hapave të vegjël (*méthode des petits pas*), e cila “shkriu” të tre shtyllat me qëllim riintegrimin e tyre në BE (Mortier, 2011:241).

Thënë me fjalë të tjera, sovraniteti po përballë me atë që etërit themelues të BE-së e kanë quajtur “një bashkim gjithnjë e në rritje midis popujve”. Ky bashkim, pa diskutim, ka ndikuar në fragmentimin e kompetencave të shteteve dhe në çdo rast këto kompetenca nuk i përkasin më, në tërësinë e tyre, shtetit sovran.

5.3.2. Forcimi dhe zgjerimi i politikave komunitare

Fillimisht Shtetet anëtare të BE-së kanë humbur një pjesë të kompetencave të tyre në ato fusha që nuk preknin thelbin e sovranitetit. Shtetet anëtare e pranuan heqjen dorë nga një pjesë e kompetencave të tyre, veçanërisht në çështjet me karakter ekonomik sepse ishin të vetëdijshme se nga kjo heqje dorë nuk prekej thelbi i sovranitetit dhe sepse shtetet u pajtuan me idenë e integritimit për të shmangur përsëritjen e gabimeve të së shkuarës (Mortier, 2011:242).

Me zhvillimin e integritimit evropian, institucionet e BE-së kanë krijuar politika të vërteta komunitare, të integruara, politika të cilat i imponohen Shteteve anëtare në mënyrë të panegociueshme. Këto politika komunitare kanë një rol të veçantë në gjirin e BE-së pasi ato synojnë të përforcojnë pushtetet e BE-së në raport me shtetet dhe në mënyrë të pashmangshme ky përforcim ndikon në dobësimin gjithnjë e më tepër të konceptit të sovranitetit absolut të shtetit (Mortier, 2011:242).

Koncepti i politikës komunitare nuk është gjithmonë i qartë, por nga ana tjetër, qëllimet që ajo ndjek janë krejtësisht të qarta pasi bëhet fjalë për të zbatuar objektivat e traktateve. Ajo çfarë është e sigurtë është që politikat komunitare privojnë pothuajse tërësisht shtetet nga pushteti i tyre për të vepruar.

Politikat komunitare udhëhiqen nga parime të cilat vënë në diskutim sovranitetin e shteteve, të tilla si: parimi i integritimit, parimi i proporcionalitetit, parimi i subsidiaritetit, parimi i supremacisë së të drejtës komunitare, etj. (Icard, 2001:22). Parimi i integritimit është ndoshta një ndër ato që ndikon më shumë tek sovraniteti i shteteve pasi ky parim nënkupton që

shtetet i nënshtrohen plotësisht vendimeve të marra nga instancat evropiane dhe që këto vendime në mënyrë logjike kanë pasoja në sistemin e brendshëm ligjor.

Kështu pra, mund të themi që politikat komunitare kanë një ndikim të madh ndaj kompetencave juridike të shteteve që nuk mund të kompensohen me anë të parimit të subsidiaritetit, i cili u sanksionua për herë të parë me Traktatin e Maastricht-it.

Me përfundimin e tregut të përbashkët, shteti nuk është më i vetmi entitet juridik që ka fuqinë për t'i imponuar norma juridike qytetarëve të tij. Kështu Tregu Unik supozon harmonizimin e normave juridike të aplikueshme për aktorët ekonomikë, që natyrshëm të çon drejt rritjes në të njëjtën kohë të normave të përcaktuara nga BE-ja dhe të fushave ku BE-ja ushtron kompetencat e veta (Milo, 2002:149-159).

Një shembull tjetër tipik që ilustron se sa është dobësuar sovraniteti i shteteve dhe se si ky koncept nuk ka tashmë ato elementët e tij tradicionalë është padiskutim politika monetare e BE-së. Përtej faktit që BE-ja ushtron kompetenca ekskluzive në çështjet monetare, mund të themi fare mirë që në kuadrin e BE-së po zhvillohet një politikë e mirëfilltë komunitare. Për më tepër, vënia në qarkullim e monedhës së përbashkët³⁴ dhe mbi të gjitha përcaktimi i normave monetare nga Banka Qendrore Evropiane, e cila merr të gjitha kompetencat që kishin më përpara Shtetet anëtare lidhur me këtë fushë, veçanërisht në lidhje me normat e interesit, supozojnë humbje të sovranitetit monetar. Po ashtu, mund të themi që politika monetare ka një ndikim të fortë tek sovraniteti i shteteve pasi në protokollin e fazës së tretë për kalimin drejt Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, është sanksionuar se ky kalim nuk ka rrugë kthimi për Shtetet anëtare (Mortier, 2011:244).

³⁴Shih: Rregullorja nr. 1103/9 , 17 qershor 1997, JOCE, L162, 19 Qershor 1997, dhe rezoluta nr. 97/236 , JOCE, 2 gusht 1997.

Krijimi i Bankës Qëndrore Evropiane ka finalizuar modifikimin e sovranitetit monetar kjo pasi BQE-ja është një institucion i cili ushtron ndikim shumë më të madh tek sovraniteti monetar se sa vetë Euro-ja. Tashmë, politika monetare e Shteteve anëtare drejtohet nga BQE-ja³⁵ e cila përcakton, në pavarësi të plotë, strategjitë dhe orientimet që duhet të ndiqen për të siguruar stabilitetin dhe forcën e monedhës evropiane, në raport me pritjet e Shteteve anëtare (Borçard, 2010:73-74). Padiskutim që zbatimi i një politike të tillë ndikon në reduktimin e hapësirës së veprimeve për shtetet në çështjet e politikës ekonomike. Detyrimi monetar peshon gjithashtu edhe mbi Shtetet anëtare për sa i përket treguesve ekonomikë, pasi ato duhet t'i respektojnë këto tregues në mënyrë të detyrueshme për të bërë të mundur integrimin e zonës euro dhe ruajtjen e saj. Këto kritere të mirëmenaxhimit, sidomos për sa i përket borxhit publik, detyrojnë shtetet që të kufizojnë hapësirat e tyre të veprimit, kufizim i cili ndodh më shumë në periudhat e vështirësive ekonomike botërore.

Në këtë kontekst ekonomik, vërtet delikat, i cili ka dobësuar kompetencat ekonomike të Shteteve anëtare, pritej që Komisioni të ishte më fleksibël në këtë fushë, por përkundrazi kërcënimet ndaj Euros nuk kanë bërë asgjë tjetër veçse e kanë fuqizuar Bashkimin Evropian. Kështu, krerët e shteteve dhe të qeverive u mbledhën në Bruksel me 28 dhe 29 tetor 2010 dhe morën vendime të rëndësishme të cilat kishin si qëllim fuqizimin e monedhës Euro. Shfaqja e një qeverisjeje të re ekonomike³⁶ është tregues i asaj se si politikat komunitare luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e relativizimit të sovranitetit të shteteve. Shtetet anëtare të zonës euro kanë humbur një pjesë të ndjeshme të marzhit të veprimit lidhur me elaborimin e politikave të tyre ekonomike.

³⁵Shih: Nenet 128, 129, 130 të TBE-së, Versioni i Traktatit të Lisbonës

³⁶Për më tepër shih: "L'Allemagne obtient un futur changement du Traité européen », journal La croix, 29.10. 2010

Kështu integrimi evropian ka ndikuar, në mënyrë të pashmangshme, që shtetet të heqin dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre duke mos shpresuar, ndërkohë, në një kthim të situatës *quo ante*. Duhet pranuar pra, me pak fjalë, se koncepti i sovranitetit të shtetit ka ndryshuar, ndoshta dhe në mënyrë të pakthyeshme.

5.3.3. Humbja e ndikimit të rregullit të unanimitetit

E drejta komunitare ka ndryshuar në mënyrë të qartë konceptin e sovranitetit, pavarësisht nga fakti se ajo sjell më shumë pyetje se sa përgjigje në lidhje me të ardhmen e sovranitetit dhe me rolin që ai luan tek Shtetet anëtare.

Shtetet që kanë aderuar në Bashkimin Evropian kanë pranuar të integrojnë, në të drejtën e tyre të brendshme, një entitet të ri juridik, në të cilin mënyrat e adoptimit të rregullave të së drejtës bëjnë të mundur largimin nga aplikimi i një rregjimi juridik të zakonshëm për organizatat ndërkombëtare, siç është për shembull, unanimiteti. Parimi i unanimitetit është një mburojë e dobët, jo gjithmonë hermetike, e cila mund të jetë një pengesë e konsiderueshme për krijimin e normave të domosdoshme në një shoqëri globale dhe një faktor pengues në krijimin e një qëndrimi të përbashkët në skenën ndërkombëtare.

E drejta komunitare nuk e përfill konceptin absolut të sovranitetit. Shtetet nuk janë më plotësisht zotër të zgjedhjeve të tyre sepse pushteti i tyre vendimmarrës është kufizuar ndjeshëm, sidomos në ato çështje ku nuk kërkohet më unanimiteti. Sa më shumë që të zgjerohet shumica e kualifikuar, aq më shumë vihet në diskutim sovraniteti i shtetit, në kuptimin e tij absolut. Kështu aftësia e shtetit për të përcaktuar kompetencën e kompetencës

së tij është në diskutim. Absolutizmi i sovranitetit nuk mund të bazohet në idenë që shteti është i lirë të kontrollojë kompetencat e veta.

Kufizimi i rregullit të unanimitetit është paralajmërimi i parë i dobësimit të shtetit. Ky rregull tradicionalisht imponohet në të gjitha organizatat ndërkombëtare, për të evituar kufizimin e dimensionit politik të sovranitetit dhe bazohet tek formula: një shtet = një votë. Ndërsa në kuadrin e BE-së, ekzistojnë disa fusha, të cilat drejtohen falë rregullit të shumicës, të thjeshtë apo të kualifikuar. Humbja e ndikimit të rregullit të unanimitetit dhe zhvillimi paralel i shumicës së kualifikuar përbën një presion të madh ndaj konceptit absolut të sovranitetit shtetëror (Mortier, 2011:206).

Por le të shohim edhe anën tjetër të medaljes. Në të vërtetë duhet pranuar që edhe vetë parimi i shumicës së cilësuar ushtron presion ndaj sovranitetit. Sipas disa autorëve zhvillimi i rregullit të shumicës ndikon pashmangshmërisht në limitimin e sovranitetit, duke qënë se shteti duhet të pranojë edhe ato rregulla për të cilat nuk ka rënë dakord. Ndërsa disa të tjerë, në të kundërt, janë të mendimit që fushat ku kërkohet zbatimi i shumicës së kualifikuar janë të kufizuara gjë që nuk mund të ndikojë në shfaqjen e fenomenit të reduktimit të sovranitetit (Mortier, 2011:206).

Në fakt, për të vlerësuar nëse bëhet fjalë për një braktisje të vërtetë të sovranitetit të shtetit apo thjesht për një dobësim të tij ne duhet të analizojmë shtrirjen e shumicës së kualifikuar. Sipas neneve 122-5 dhe 205-3 të Traktatit të KE-së, rregulli i unanimitetit kishte rëndësi të konsiderueshme dhe aplikohet në fushat më të ndjeshme të organizimit komunitar³⁷, tregues i asaj që sovraniteti i shteteve ruhej pjesërisht.

³⁷ Këto nene, në thelb, janë riprodhuar nga në nenin 238 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, në versionin e Traktatit të Lisbonës.

Edhe Traktati i Lisbonës i rikthehet rregullit të unanimitetit por nuk i jep atij një vend të privilegjuar në politikat komunitare. Në të vërtetë, Traktati i Lisbonës, heq dorë në një masë të madhe nga aplikimi i unanimitetit, duke bërë që pesëdhjetë fusha të rëndësishme komunitare të mos i nënshtrohen rregullit të unanimitetit, por shumicës së kualifikuar. Mund të përmendim këtu fusha të tilla si: qarkullimi i lirë i personave, kontrolli i kufijve, azili dhe mbrojtja e refugjatëve, Europol, mbrojtja civile, etj. Ndërkohë kalojnë vetëm me unanimitet vendimet lidhur me politikat fiskale, sigurinë sociale, politikën e jashtme dhe sigurinë e përbashkët (Mortier, 2011:207).

Të tilla modalitete vendimmarrjeje në kuadrin e BE-së kufizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sferën e veprimit të Shteteve anëtare. Në fakt, Shtetet anëtare nuk privohen plotësisht nga e drejta e tyre për të zgjidhur çështjet e ndryshme shtetërore, por përdorimi i shumicës së kualifikuar në një numër të konsiderueshëm fushash rezulton në një humbje reale të influencës së shtetit. Në lidhje me këtë, përdorimi i pasarelave apo klauzolave urë, prezente në Traktatin e Lisbonës, mund të ndikojnë në përshpejtimin e privimit të Shteteve anëtare nga pushteti vendimmarrës. Ato bëjnë të mundur që Këshilli Evropian të vendosë njëzëri, që në fusha të caktuara të kalojë nga parimi i unanimitetit në vendimmarrjen me shumicë të cilësuar, apo nga një procedurë e veçantë në procedurën e rregullt legjislativ³⁸.

³⁸Klauzolat urë të përgjithshme dhe ato specifike i lejuan Këshillit që të bëjë të mundur kalimin e disa çështjeve me rregullin e shumicës. Për më tepër shih: Neni 48-7 TBE, 31 TFBE, 81 TFBE, 312 TBUE, versioni i Traktatit të Lisbonës.

5.4. Integrimi i së drejtës komunitare në të drejtën e brendshme: një raport hierarkik në disfavor të sovranitetit shtetëror

Çështja e integrimit të traktateve komunitare dhe në përgjithësi e së drejtës komunitare në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare është e lidhur në mënyrë të pashmangshme me vlerën specifike të kësaj të drejte.

Nga doktrina është vënë re se raporti midis të drejtës komunitare dhe të drejtës së Shteteve anëtare nuk është i ngjashëm me raportin e zakonshëm midis të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme³⁹. Në fakt, ndërsa raporti midis sistemit ndërkombëtar dhe sistemit të brendshëm zgjidhet me një marrëdhënie koordinimi midis dy sistemeve juridike dhe reciprokisht autonome, ai midis sistemit komunitar dhe sistemeve të Shteteve anëtare është një raport integrimi duke qenë se ata nuk gjenden në një marrëdhënie reciproke të barabartë, por sistemi komunitar ka tendencë të integrohet në sistemin e brendshëm.

5.4.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i së drejtës komunitare

Efekti direkt i së drejtës komunitare ka të bëjë me aftësinë e saj për të krijuar drejtpërsëdrejti të drejta ose detyrime tek subjektet e së drejtës (*persona fizikë ose juridik në Shtetet anëtare*), të drejta dhe detyrime të cilat subjektet mund t'i përdorin përpara një juridiksioni gjyqësor kombëtar ku ky i fundit ka detyrimin t'i garantojë ato. E drejta komunitare mund të arrijë efikasitetin e saj të plotë përballë burimeve të së drejtës

³⁹ Draetta Ugo & Parisi Nicoletta, "Elementi di diritto dell'Unione Europea – Parte Speciale, Il Diritto Sostanziale – Elementi të së drejtës së Bashkimit Evropian – Seksion i Vecantë, II e Drejta Themelore", Giuffrè, Milano, Itali 2004.

kombëtare të një Shteti anëtar dhe i gjithë ky pohim ka për garant gjyqtarin kombëtar (Puto & Alimehmeti, 2014:43).

Në të drejtën ndërkombëtare efekti direkt përbën një përjashtim ndërsa në drejtën komunitare efekti direkt është një parim. Njohja e këtij parimi ka për qëllim të mos u japë në dorë Shteteve anëtare çështjen e vënies në jetë të traktateve komunitare. Duke qënë se subjektet e së drejtës komunitare përfitojnë të drejta nga traktatet dhe këto mund t'i ushtrojnë përpara një juridiksioni gjyqësor kombëtar të një Shteti anëtar, këto subjekte bëhen automatikisht aktorë të së drejtës komunitare duke pasur gjithashtu mundësinë për të kundërshtuar autoritetet kombëtare mbi përputhshmërinë me të drejtën komunitare. Në këtë kontekst roli i gjyqtarit kombëtar është themelor (Puto & Alimehmeti, 2014:43).

E parë nën optikën e të drejtës evropiane, kjo kërkon detyrimisht që e drejta komunitare të gëzojë një farë autoriteti në të drejtën e Shteteve anëtare. Traktatet nuk shprehen lidhur me këtë raport, dhe i ka takuar gjykatës së drejtësisë që të sqarojë këtë çështje, sidomos mbi dy karakteristika të rëndësishme që janë prioriteti dhe efekti direkt që ka e drejta komunitare në raport me të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare (Puto & Alimehmeti, 2014:44).

Çështja VAN GEND & LOOS kundër HOLLANDEËS⁴⁰

Një ndërmarrje hollandeze për transport Van Gend & Loos ngriti padi kundër autoriteteve doganore hollandeze për vënien e tatimit të importit ndaj një prodhimi kimik nga Gjermania, i cili ishte më i lartë se tatimet në importet e mëparshme. Ndërmarrja këtë e konsideronte shkelje të Nenit 12 të Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian, i cili ndalon futjen e tatimeve të reja të importit apo rritje të tatimeve të tjera ekzistuese midis Shteteve anëtare. Gjykata në Hollandë pezulloi procesin gjyqësor dhe referoi rastin në

⁴⁰ Çështja 26/62 (1963) Van Gend en Loos kundër Administratës Holandeze

Gjykatën e Drejtësisë për qartësim të diapazonit dhe implikimeve ligjore të nenit të lartëpërmendur të Traktatit themelues të KE-së.

Gjykata e Drejtësisë shfrytëzoi këtë rast si mundësi për të përcaktuar disa vërejtje të natyrës thelbësore, që kanë të bëjnë me natyrën ligjore të BE-së. Në vendimin e vet, Gjykata deklaroi se: “Objektiva e Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian – themelimi i tregut të vetëm, funksionimi i të cilit është çështje e palëve të interesuara në Komunitet, lë të kuptohet se ky Traktat është më shumë se një marrëveshje që krijon obligime reciproke midis Shteteve kontraktuese. Këtë qëndrim e konfirmon preambula e Traktatit, e cila u referohet jo vetëm qeverive por edhe popujve. Ky qëndrim është konfirmuar në mënyrë më specifike edhe me themelimin e institucioneve të pajisura me të drejta sovraane, ushtrimi i të cilave ka ndikim në Shtetet anëtare dhe qytetarëve të tyre ... Nga kjo mund të konkludohet se Komuniteti përbën një rend të ri ligjor në të drejtën ndërkombëtare, për beneficionin e të cilit, Shtetet kanë kufizuar të drejtat e tyre sovraane, megjithëse vetëm në disa fusha, dhe subjektet nga të cilat përbëhen jo vetëm Shtetet anëtare por edhe shtetasit e tyre.”

Në lidhje me rastin konkret, pyetja që shtrohej ishte se nëse edhe individët mund të bazoheshin në nenin 12 të Traktatit të KEE-së, i cili, brenda Tregut të Përbashkët, ndalon në mënyrë të shprehur vendosjen e detyrimeve të reja apo rritjen e detyrimeve ekzistuese nga Shtetet anëtare. Ky ishte rasti i parë kur GJED diskutoi mundësinë për të konsideruar direkt të zbatueshme një normë të Traktateve. Në këtë vendim (çështja 26-62) Gjykata ka sqaruar se: “Rendi komunitar është një rregullim i një lloji të ri që njeh si subjekte jo vetëm shtetet por edhe qytetarët. Pavarësisht nga legjislacioni i Shteteve anëtare, e drejta komunitare jo vetëm që vendos detyrime ndaj individëve, por synon gjithashtu që t’iu japë atyre të drejta. Këto të drejta lindin jo vetëm kur janë dhënë shprehimisht nga Traktati, por

edhe nëpërmjet detyrimeve që vendos Traktati në mënyrë të përcaktuar qartë mbi individët, ashtu si edhe mbi Shtetet anëtare dhe mbi institucionet e Komunitetit.”

Në këtë rast zbatueshmëria e drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme e normave të Traktatit të KEE-së identifikohet me efektin e drejtpërdrejtë të saj, pra nga qëndrimi i saj krijoheshin pozicione juridike subjektive të individëve. Ndërsa në raste të tjera zbatimi i drejtpërdrejtë i një norme të së drejtës komunitare nuk sjell domosdoshmërisht efektin e drejtpërdrejtë të saj. Normat komunitare të vetëzbatueshme zbatohen drejtpërdrejtë mbi personat të cilëve duan t’u japin të drejta subjektive perfekte (të plota) si ndaj shtetit të tyre të përkatësisë ashtu dhe ndaj shteteve të tjera. Përkrah këtyre normave me efekt të drejtpërdrejtë për individët ekzistojnë të tjera që u drejtohen së pari Shteteve anëtare ose institucioneve komunitare (Puto, 2013:78-79).

Shtetet anëtare janë drejtpërdrejtë të interesuara nga e drejta komunitare. Raportet midis rendit juridik të Bashkimit Evropian dhe rendeve juridike të Shteteve anëtare, duhen konsideruar si raport integrimi, meqënëse rendi i parë është i destinuar të integrohet në të dytët. Komuniteti e ka bazën e vet në një qëndrim të përbashkët të vullnetit të Shteteve anëtare për të vepruar dhe funksionuar së bashku (Puto, 2013:80).

Arsyetimi i Gjykatës mbi zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të normave të TKE-së lidhet me formulimin e qartë të detyrimit që përmbajnë normat e traktatit, i cili nuk kërkon detajime të mëtejshme dhe është i aftë të krijojë efekte të drejtpërdrejta. Këtë qëndrim ka mbajtur GJED-ja në rastin *Demirel*⁴¹, ku theksoi se: “Një dispozitë në një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga Komuniteti me vendet jo anëtare, duhet të konsiderohet si e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë kur, duke pasur parasysh formulimin, qëllimin dhe natyrën e vetë marrëveshjes, dispozita përmban një detyrim të qartë dhe të saktësuar, i

⁴¹ Çështja 12/86, Përmbledhja e GJED 1987, 3719

cili nuk i nënshtrohet, për sa i përket zbatimit ose efekteve të tij, miratimit të ndonjë mase ndaluese”.

Për normat e Traktatit që nuk e kanë këtë shkallë qartësie në formulim, krijimi i efekteve detyruese është subjekt i normave të mëtejshme zbatuese komunitare apo shtetërore. Megjithatë asgjë nuk e ndryshon natyrën e tyre detyruese dhe absolute edhe kur ato nuk janë të vetëzbatueshme. Thjesht zbatimi i tyre është subjekt i nxjerrjes së akteve vijuese të zbatimit (Zajmi, 2011:100).

I njëjti qëndrim shprehet drejtpërdrejt në Traktat apo në opinionet e GJED-së edhe mbi normat e legjislacionit dytësor. Kështu sipas nenit 249 të TKE-së: Rregulloret janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në çdo Shtet anëtar. Por a ka mbajtur GJED-ja të njëjtin qëndrim edhe për direktivat të cilat janë të detyrueshme vetëm për qëllimin apo objektivin që duhet arritur, por jo për mënyrën e tyre të zbatimit nga Shtetet anëtare?

Një opinion i ngjashëm në favor të zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë është dhënë nga GJED edhe për direktivat. Pyetjes nëse direktiva mund të konsiderohet drejtpërdrejtë e zbatueshme edhe pse shtetet duhet të ndërhyjnë pozitivisht për zbatimin e tyre duke nxjerrë akte normative zbatimi, i është përgjigjur GJED në një opinion të dhënë prej saj në të ashtuquajturin, rasti *Francovich dhe të tjerët kundër Republikës së Italisë*⁴². Sipas direktivës 80/987 të KEE për mbrojtjen e të punësuarve nga shtetet në rast falimentimi të biznesit lidhur me pagesën e rrogës dhe të sigurimeve të plota shoqërore pavarësisht nga dividendët likuidues të kompanisë u takon shteteve të krijojnë garanci ligjore të brendshme për këtë situatë. Në këtë rast, Andrea Francovich, Daniella Bonifaci dhe disa prej kolegëve të tyre nuk u shpërblyen sa duhet kur firma për të cilën ata punonin, falimentoi. Meqënëse Italia kishte dështuar në zbatimin e kësaj direktive në afat, nuk kishte asnjë garanci ligjore

⁴² Çështja 6/90 (1991) Andrea Francovich dhe Danila Bonifaci e të tjerë kundër Italisë

kombëtare se pagat e tyre do të paguheshin ose që ato do të kompensoheshin në ndonjë formë tjetër. Të punësuarit e prekur vendosën të padisnin drejtpërsëdrejti shtetin italian në gjykatë. Gjykata kombëtare, së cilës iu drejtua çështja, ia kaloi atë GJED-së për një vendim paraprak, meqënëse ligji italian nuk kishte përgatitur ndonjë dispozitë për një kompensim të tillë.

Në gjykimin e vet të 19 nëntorit 1991, Gjykata Evropiane vendosi për të dëmtuarit se ata mund të kërkonin që pagat e tyre të paguheshin të plota nga shteti italian. Duke vepruar kështu, GJED vendosi një precedent të ri në çështjen ligjore evropiane. Për pasojë, Shtetet anëtare që dështojnë në zbatimin e një direktive brenda afatit mundet që, në rrethana të caktuara, të paditen prej qytetarëve të tyre për t'u kompensuar, edhe pse në ligjin kombëtar nuk ka dispozita për këtë. Pra, Gjykata në këtë rast mbrojti qëndrimin se direktiva është e aftë të krijojë efekte ligjore të menjëhershme me hyrjen e saj në fuqi, pavarësisht nëse shteti i ka nxjerrë normat e brendshme të zbatimit apo jo. Mund të themi se cilësia e zbatimit të drejtpërdrejtë e fitoi të drejtën e qytetarisë për të gjitha normat e ligjit komunitar parësor apo dytësor të afta për të krijuar efekte direkte (Zajmi, 2011:101).

5.4.2. Supremacia e së drejtës komunitare

Nëse u referohemi parashikimeve të Traktatit të Bashkimit Evropian nuk do të gjejmë shprehje të posaçme lidhur me çështjen e supremacisë të legjislacionit komunitar përkundrejt atij të Shteteve anëtare. Referenca e vetme e mundshme në këtë drejtim është Neni 10 i Traktatit të Bashkimit Evropian⁴³, i cili vendos një detyrim mbi Shtetet anëtare që të marrin masat e nevojshme për të garantuar se detyrimet përkatëse sipas Traktatit

⁴³ ish Neni 5 i Traktatit të KE-së

respektohen prej tyre. Ato gjithashtu kanë detyrimin të distancohen nga çdo veprimtari që mund të pengojë arritjen e objektivave të këtij Traktati. Kështu neni 10 i tij parashikon që “Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme, qofshin të përgjithshme apo të posaçme për të garantuar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Traktat, ose që vijnë si rezultat i veprimtarisë së institucioneve të Komunitetit. Shtetet duhet të ndihmojnë në arritjen e objektivave të Komunitetit. Shtetet anëtare duhet të heqin dorë nga ato masa që mund të rrezikojnë arritjen e objektivave të këtij Traktati.”

Megjithatë traktatet, siç e përmendem më sipër, nuk shprehen konkretisht për prioritetin e së drejtës komunitare, prandaj kjo duhet nënkuptuar. Në kuadër të detyrës së saj për të siguruar respektimin e së drejtës komunitare, Gjykata e Drejtësisë është shprehur edhe për supremacinë e së drejtës komunitare ndaj të drejtës së brendshme të Shteteve anëtare. Ato që kanë rëndësi për të drejtën komunitare janë pasojat që Gjykata e Drejtësisë vuri në dukje nëpërmjet këtij parimi dhe që kanë të bëjnë me detyrimet e Shteteve anëtare në kuadër të rendit të tyre të brendshëm juridik. Këto pasoja kanë efekt mbi sistemin kushtetues kombëtar, ç’ka bën të domosdoshme njohjen e prioritetit të kësaj të drejte mbi të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare (Puto, 2013:72).

Parimi i prioritetit të së drejtës komunitare mbi të drejtën kombëtare është vepër e Gjykatës së Drejtësisë në vendimin e saj **Costa kundër Enel**⁴⁴ i dhënë ky me rastin e një konflikti ndërmjet traktatit komunitar dhe ligjit Italian. Sipas vendimit të gjykatës norma juridike kombëtare e krijuar në kohë pas normës komunitare nuk mund të kundërshtojë këtë të fundit. Norma juridike kombëtare e cila ka ekzistuar në kohë përpara normës komunitare pavarësisht se duke qënë se është krijuar më përpara normës komunitare nuk ka pasur mundësinë të njihte normën komunitare (*e cila ka ardhur në kohë pas saj*) nuk ka më arsye

⁴⁴ Çështja 6/64 rec. 1141.(1964) Costa kundër ENEL

të vazhdojë të aplikohet, ç'ka do të thotë që nuk kanë më fuqi juridike pas daljes së normës komunitare, pra kjo e fundit ka fuqi prapavepruese. Ky afirmim është shprehur në vendimin e Gjykatës së Drejtësisë në çështjen *Simmenthal*⁴⁵.

Në vendimin *Costa kundër ENEL*, GJED në fillim nxjerr në pah natyrën e veçantë që paraqet Komuniteti, “me një kohëzgjatje të pakufizuar, i pajisur me atributet të tijat personale, me personalitet juridik ndërkombëtar, me zotësi juridike, me zotësi për një përfaqësim ndërkombëtar dhe më saktësisht të pushteteve reale përsa i përket kufizimit të kompetencave ose të transferimit të pushteteve të Shteteve anëtare drejt Komunitetit”, me qëllim për të nxjerrë në pah që Shtetet anëtare në fusha të caktuara, i kanë kufizuar shumë të drejtat e tyre të sovranitetit dhe kanë krijuar kështu një trupë të drejtë të aplikueshme për shtetasit e tyre si dhe për ato vetë (Puto, 2013:72).

Më pas, Gjykata nënvizon natyrën e vetë traktateve, të cilët së bashku kanë krijuar një rend juridik të veçantë i cili integrohet në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare. Në qoftë se ky rend juridik është i veçantë në krahasim me të drejtën ndërkombëtare, rregullat e aplikueshme për të drejtën ndërkombëtare klasike, në këtë rast vlejnë. Nga momenti i integritit të së drejtës komunitare në rendin juridik kombëtar të Shteteve Anëtare rrjedh edhe pamundësia për të vlerësuar si më të rëndësishme, një normë juridike kombëtare e cila bie në kundërshtim me traktatin. Nga ana tjetër, në rast se Shtetet anëtare do të aplikonin të drejtën komunitare në raport me të drejtën e tyre të brendshme, kjo do të sillte cënimin në uniformitetin e së drejtës komunitare. Gjithashtu, një aplikim i ndryshëm i së drejtës komunitare sipas çdo Shteti Anëtar do t'i jepte gjithashtu rrugë diskriminimit të bazuar në shtetësinë, diskriminime këto që ndalohen nga vetë traktati (Puto, 2013:72).

⁴⁵ Çështja 106/77, rec 629 (1978) *Administrata e Financave të Shtetit kundër Simmenthal S.p.a*

Në konkluzionin përfundimtar Gjykata e Drejtësisë nënvizon se “.... Përdorimi i një burimi të pavarur të së drejtës, pra në rastin tonë i së drejtës së traktateve, nuk mundet për shkak të natyrës së saj të veçantë origjinale të shikohet në kundërshtim me një burim të së drejtës së brendshme të Shteteve anëtare cilido qoftë ky...”

Në dallim nga marrëveshjet ndërkombëtare rëndom, Traktati i Komunitetit Evropian ka krijuar rendin e vet ligjor, i cili me hyrjen në fuqi të Traktatit, bëhet pjesë integrale e sistemit ligjor të Shteteve anëtare, dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar nga gjykatat kombëtare. Ligji që buron nga traktati, si një burim i pavarur i së drejtës, për shkak të natyrës së tij të veçantë dhe origjinale nuk mund të tejkalohet nga parashikimet e së drejtës së brendshme. Kjo do t’i mohonte atij karakterin si ligj komunitar dhe do të rrezikonte bazën ligjore të vetë Komunitetit⁴⁶. Ajo çfarë del e qartë, është se normativa komunitare integron normativën e brendshme, por në asnjë rast e kundërta. E drejta e brendshme e Shteteve anëtare nuk ushtron asnjë lloj influence në rendin juridik komunitar, ndërkohë që e kundërta ndodh normalisht. Me pak fjalë, normat komunitare shkrihen në rendet e brendshme juridike duke integruar këtë sistem. Pra ato plotësojnë një seri normash të brendshme, por këtë e bëjnë në bazë të sistemit hierarkik të burimeve të së drejtës⁴⁷. Siç duket kemi një imponim që vjen nga lart me pasojë integrimin, për shkak të bindjes ndaj supremacisë së të drejtës së BE-së (Puto, 2013:73).

Gjykatat e të gjitha niveleve të Shteteve anëtare duhet të lënë mënjanë ligjin e brendshëm dhe të zbatojnë ligjin komunitar në rast se i pari bie në kundërshtim me normën komunitare,

⁴⁶Çështja 6/64(1964) Flaminio Costa kundër Enel

⁴⁷ Greco Guido, “Argomenti di Diritto Amministrativo—Argumenta të të Drejtës Administrative”, Botimi i tretë, Giuffrè, Milano, 2008, f.10

pa patur nevojë që të presin vendimin e gjykatës kushtetuese ose të ndonjë institucioni tjetër për t’jua njohur këtë të drejtë⁴⁸.

Çështja COSTA kundër ENEL⁴⁹

Gjykata e Drejtësisë në çështjen Costa kundër ENEL vendosi përkrah parimit të zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë atë të superioritetit të normës komunitare mbi normën kombëtare, qofshin ato ligje ose norma të rangut kushtetues. Kjo çështje bazohej shkurtimisht në faktet vijuese: Një individ paraqiti kërkesë para një gjykate kombëtare se ligji që e kombëtarizonte prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike nuk ishte në përputhje me Traktatin e Komunitetit Evropian. Gjykata kombëtare e dërgoi çështjen tek Gjykata Evropiane e Drejtësisë për gjykim paraprak. Arsyetimi i Gjykatës në këtë rast është i shkurtër pavarësisht përpunimit të konceptit të efektit të drejtpërdrejtë ku theksohet nevoja për zbatim të drejtpërdrejtë nga ana e gjykatave kombëtare të normave që janë miratuar në kuadër të Komunitetit. Ndërkohë që fokusi i Gjykatës në rastin *Van Gend en Loos* ishte nëse Neni 12 (tarifat doganore mbi importet prej Shteteve anëtare në Shtete të tjera anëtare) do të sillte të ashtuquajturin **efekt direkt** - zbatueshmëri të menjëhershme në gjykatat kombëtare në lidhje me aplikantët individë, kështu që, një individ mund të kërkonte zbatimin e këtij neni nga gjykatat kombëtare. Në rastin Costa k. ENEL shkohet edhe më tej. Qëndrimi i Gjykatës është bazuar në vizionin e saj për tipin e Komunitetit që kishin themeluar Traktatet dhe llojin e sistemin ligjor që ky Komunitet kishte nevojë të krijonte. Në këtë rast kjo Gjykatë e zgjeroi teorinë e saj kushtetuese të Komunitetit duke deklaruar se shtetet kanë krijuar një Komunitet sovran duke kufizuar të drejtat e tyre sovrane (Puto, 2013:81).

⁴⁸ Vendimi datë 9 Mars 1978, “Amministrazione delle Finanze dello Stato v. Simmenthal S.p.a –Administrata e Financave të Shtetit kundër Simmenthal S.p.a”, Çështja 106/77

⁴⁹ Çështja 6/64 (1964) Flaminio Costa kundër Enel

Gjykata në vendimin e saj theksoi jetëgjatësinë e papërcaktuar të Komunitetit dhe autonominë e pushtetit të tij, sidomos kufizimin e kompetencës apo transferimin e pushteteve nga shtetet tek KE-ja. Gjykata pati vendosmërinë për të argumentuar se “fjalët dhe fryma e Traktatit” nënkuptonin se “është e pamundur për shtetet të marrin masa të mëvonshme të njëanshme për një rend ligjor që e kanë pranuar në mënyrë reciproke”. Gjykata theksoi se parimi i supremacisë del qartë në Nenin 189 të Traktatit të KE-së⁵⁰ sipas të cilës parashikimet e tij kanë fuqi detyruese dhe zbatohen direkt mbi Shtetet anëtare. Gjykata gjithashtu theksoi se ky parashikim nuk shoqërohet nga ndonjë rezervë normative “ndaj nuk do të kishte kuptim nëse ndonjë shtet në mënyrë të njëanshme do të shfuqizonte efektet e tij me anë të masave legislative kombëtare në mënyrë që legjislacioni kombëtar të mbizotëronte mbi atë të KE-së”. Ndaj, Gjykata arriti në një përfundim të tillë në rastin *Costa* që kthehet në një interpretim klasik dhe të cilit do t’i bëhet referencë në raste të tjera në të ardhmen: “Nga të gjitha sa u trajtuan, e drejta që buron nga Traktati, një burim i pavarur i së drejtës, për shkak të natyrës së vet të veçantë e origjinale, nuk mund të tejkalohet nga parashikimet ligjore kombëtare. Transferimi nga shtetet, pra nga sistemi ligjor vendas në sistemin ligjor të Komunitetit i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Traktati shoqërohet me një kufizim të përhershëm të të drejtave sovrane të shteteve ndaj veprimeve të njëanshme të papërputhshme me konceptin e Komunitetit e nuk mund të kenë përparësi” (Puto, 2013:81).

***Çështja Simmenthal kundër Komisionit të Komuniteteve Evropiane*⁵¹**

GJED e çoi më tej doktrinën e supremacisë me çështjen Simmenthal kundër Komisionit të Komuniteteve Evropiane e që kishte të bënte me faktet si vijon: Në rastin *Simmenthal*

⁵⁰ Shih nenin 249 të TBE-së.

⁵¹ Çështja 106/77 (1978) Administrata e Financave të Shtetit kundër Simmenthal S.p.a

SPA(1978) një gjyqtar Italian kishte përpara një mosmarrëveshje midis një Rregulloreje të Këshillit për organizimin e përbashkët të tregut të mishit të viçit dhe legjislacionit Italian për veterinarinë dhe shëndetin publik. Kështu, legjislacioni Italian ndryshe nga Rregullorja e KE-së, mund të shpallej antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese dhe jo nga gjykatat e zakonshme. A mundet që një gjykatës i shkallës së parë në Itali të mos e merrte parasysh legjislacionin vendas që kamospërputhshmëri pa pritur që ky legjislacion të shfuqizohet nga Gjykata Kushtetuese? Gjykata Evropiane e Drejtësisë mbajti qëndrimin se gjykata vendase ka detyrimin t'i njohë vlefshmëri të plotë të drejtës komunitare edhe sikur të binte ndesh me legjislacionin vendas dhe pa pritur që një gjykatë më e lartë të shprehej për rastin. Kjo çështje bëri të qartë se përparësia e ligjit komunitar vlen jo vetëm në rastin e konfliktit me një normë kombëtare që është miratuar para normës komunitare, por dhe kur norma kombëtare është miratuar pas normës komunitare. Gjykata u shpreh se çdo parashikim ligjor, pavarësisht kohës së miratimit, nuk do të zbatohet nëse cënon zbatimin e plotë dhe efektiv të ligjit Komunitar.¹⁸⁸ Gjykata shkoi më tej duke pohuar se një parashikim komunitar ndalon nxjerjen e masave të reja kombëtare që bien në kundërshtim me ligjin Komunitar¹⁸⁹. Pra edhe këtë herë GJED riafirmoi pamundësinë e zbatimit të ligjit kombëtar ekzistues që u gjend në kundërshtim me ligjin e Komunitetit dhe më tej mori vendim që Shtetet Anëtare janë të detyruara të mos miratojnë asnjë legjislacion të brendshëm, që bie ndesh me ligjin ekzistues të Komunitetit. Vendimi i çështjes Simmenthal nxorri qartë rëndësinë praktike të Doktrinë së supremacisë⁵², çështjen se cilat do të jenë organet kombëtare që do të zbatojnë supremacinë. Sipas GJED është pikërisht gjyqtari kombëtar i zakonshëm që në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje midis ligjit komunitar dhe atij kombëtar do të zbatojë ligjin komunitar dhe se çdo gjykatë kombëtare duhet.....të zbatojë të drejtën komunitare plotësisht dhe të mbrojë të drejtat që kjo e fundit u njeh individëve dhe duhet në

⁵²Martin Stiernstrom, "The Relationship Between Community Law and National Law", vol. 5, 2003, f.5.

të njëjtën kohë të lerë mënjane dhe të mos zbatojë asnjë parashikim të së drejtës kombëtare që mund të bjerë ndesh me të, pavarësisht se mund të jetë miratuar më parë apo më pas nga rregullimi në nivel komunitar”.

***Çështja Internationale Handelsgesellschaft k.Einfuhr*⁵³**

Në çështjen Internationale Handelsgesellschaft v. Einfuhr (1970) Gjykata arsyetoi si vijon: “Referimi tek rregulla apo koncepte të së drejtës kombëtare për të gjykuar mbi vlefshmërinë e masave që institucionet e Komunitetit kanë ndërmarrë do të kishte një efekt të kundërt mbi uniformitetin dhe efikasitetin e të drejtës komunitare. Vlefshmëria e këtyre masave mundet vetëm të gjykohe nën dritën e të drejtës komunitare..., Vlefshmëria e këtyre masave komunitare apo efektet e tyre mbi një shtet anëtar nuk mund të ndikohen nga hamendësi apo supozime për rënien ndesh me të drejtat themelore sikundër mund të jenë të parashikuara në kushtetutën e atij shteti apo parimet kushtetuese për ndërtimin e atij shteti”.

Çështja Internationale Gesellschaft bashkë me çështjen *Costa* sqaruan shumë pyetje në lidhje me marrëdhëniet mes ligjit kombëtar të Shteteve Anëtare dhe të drejtës komunitare. *Costa* hedh themelet e doktrinës së supremacisë duke deklaruar se e drejta komunitare do të marrë përparësi mbi ligjin kombëtar. Në Internationale Gesellschaft Gjykata deklaroi se e drejta komunitare ka përparësi mbi çdo ligj kombëtar, çfarëdo qoftë statusi ligjor i ligjit kombëtar. Kështu, dispozitat themelore kushtetuese në një kushtetutë kombëtare nuk mund të shkelin të drejtën komunitare. Gjykatat kombëtare të Shteteve anëtare duhet të zbatojnë të drejtën komunitare, pra, edhe në qoftë se nuk ka një përplasje të tyre me dispozitat e veta kombëtare (Puto, 2013:84).

⁵³ Çështja 11/70 (1970) Internationale Handelsgesellschaft k.Einfuhr

5.4.3. “Kundra-limitet” ndaj përparësisë së të drejtës komunitare

Sipas parimit të përparësisë së të drejtës komunitare, hierarkia e normave të të drejtës në sistemet juridike kombëtare përmbysset, në favor të së parës. Zbatimi me rigorozitet i këtij parimi nënkupton kështu një braktisje të sovranitetit të shtetit duke qënë se edhe vetë teksti kushtetues do rishikohet në rast kontradikte me normën komunitare.

Megjithatë Shtetet anëtare nuk heqin dorë krejtësisht nga sovraniteti i tyre dhe kanë “kundra-limite” ndaj përparësisë së të drejtës komunitare, sipas të cilave tekstet kushtetuese i nënshtrohen të drejtës komunitare por me disa kushte. Mund të përmendim këtu disa raste të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane dhe Gjykatë Kushtetuese Italiane të cilat ishin të parat që vunë në jetë zbatimin e “kundra-limiteve” duke vendosur si parim që përparësia e të drejtës komunitare buron nga Kushtetutat kombëtare dhe si e tillë ajo nuk mund t’i imponohet kësaj të fundit⁵⁴. Kështu në rastin *Solange I* (1974), Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane vendosi se, në rastin hipotetik të një konflikti ndërmjet ligjit të Komunitetit dhe garantimit të të drejtave themelore sipas Kushtetutës gjermane, ato që do të kishin superioritet do të ishin të drejtat kushtetuese gjermane. Konkretisht Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane citoi: “Për aq kohë sa procesi i integritetit të komunitetit nuk ka përparuar në atë shkallë që edhe e drejta komunitare të përmbajë një katalog, që është vendosur nga një parlament e që ka fuqi, dhe është i njëjtë me katalogun e të drejtave themelore të parashikuara nga Kushtetuta, pas marrjes së vendimit të Gjykatës Evropiane që kërkohet nga neni 177 i EWG V-së, lejohet dhe rekomandohet iniciimi i një kontrolli kushtetues nga një gjykatë e Republikës Federale Gjermane tek Gjykata Kushtetuese Federale, nëse gjykata çmon se një dispozitë e të drejtës komunitare, që për të është e

⁵⁴Shih: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane: *Solange I*, 29 maj 1974, *Solange II*, 22 tetor 1986. Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Italiane: Frontini, 18 dhjetor 1973. Për një analizë doktrinale të kësaj çështjeje shih: J.-V. Louis dhe Th. Ronse, *L'ordre juridique de l'Union européenne*, Bruylant, 2005.

rëndësishme për vendimmarrjen në një çështje konkrete, është e pazbatueshme për shkak se, dhe për aq sa, ajo bie ndesh me një të drejtë themelore të parashikuar nga Kushtetuta”. Nga ky pasazh i vendimit të GJKFGJ mund të konkludojmë që në rastin e përplasjes së të drejtës komunitare me një pjesë të së drejtës kombëtare, dhe më saktë të garancive kushtetuese të të drejtave themelore, ajo që fiton është garancia kushtetuese e të drejtave themelore, për aq kohë sa organet përgjegjëse të komunitetit, nuk e kanë mënjnauar konfliktin e normave sipas mekanizmit përkatës të marrëveshjes.

Ndërsa në rastin *Solange II* (1986) Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane moderoi qëndrimin e saj në dritën e zhvillimit të një doktrine të mbrojtjes të të drejtave themelore të GJED-së. duke u nisur nga fakti se e drejta komunitare ka patur ndryshime që prej kohës së dhënies së vendimit në 1974, duke përfshirë edhe ndryshimet në doktrinën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe faktit që të gjitha Shtetet anëtare tashmë janë anëtare të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata gjermane mbajti këtë qëndrim: “Për aq sa kohë sa aleancat evropiane, veçanërisht jurisprudenca e Gjykatës Evropiane garanton një mbrojtje të efektshme të të drejtave themelore kundrejt pushtetit sovran të komuniteteve, mbrojtje kjo që meriton të njëjtën vëmendje si mbrojtja e të drejtave themelore, e ofruar si diçka e domosdoshme nga Kushtetuta, që garanton të paktën thelbin e të drejtave themelore në përgjithësi, Gjykata Kushtetuese Federale nuk do të ushtrojë më kompetencat e saj kontrolluese mbi zbatimin e së drejtës komunitare, e cila vepron në territorin e Republikës Federale Gjermane si bazë ligjore për vendimmarrjen e gjykatave apo autoriteteve gjermane dhe si pasojë, ajo nuk do të kontrollojë këtë të drejtë lidhur me standartet kushtetuese të të drejtave themelore”.

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane e zgjeroi dukshëm qëndrimin e saj në lidhje me supremacinë e së drejtës komunitare me çështjen Brunner k. Traktatit të Bashkimit

European, Në vendimin e saj të gjatë dhe të ngarkuar politikisht GJKFGJ bëri të qartë se pranimi i epërsisë të së drejtës komunitare kufizohet nga parimi i delegimit. Në të vërtetë parimi i dhënies ose i transferimit të kompetencave kufizon kompetencat e Bashkimit Evropian duke qënë se dispozitat kushtetuese kanë parashikuar nevojën e miratimit parlamentar për çdo hap shtesë në procesin drejt integritetit evropian, dhe kjo përbën një garanci për të drejtat themelore dhe sundimin e ligjit. Po ashtu GJKFGJ ruan juridiksionin për të goditur çdo legjislacion antikushtetues pavarësisht nëse ai është miratuar nga organet e Bashkimit Evropian ose nga parlamenti gjerman.

Pavarësisht të gjithave mund të themi se, edhe pse gjykatat gjermane kanë arritur në përfundimin se të drejtës komunitare i duhet dhënë përparësi ndaj asaj kombëtare Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane e ka bërë të qartë qëndrimin e saj se ajo do të vazhdojë të rishikojë veprimtaritë e institucioneve evropiane dhe agjencive të saj për të garantuar që këto të fundit të mos tejkalojnë kompetencat e tyre.

Ndërsa një rast tjetër i përballjes së drejtës komunitare me atë kombëtare u zhvillua në Gjykatën Kushtetuese Italiane e cila u përball me problemin e rolit të traktateve të BE-së në rendin juridik italian ishte me çështjen nr. 183, 18 dhjetor, 1973 (rasti Frontini). Konkretisht në këtë rast bëhet fjalë për të përcaktuar pozicionimin e Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian në rendin juridik italian. Neni 189 i këtij traktati parashikonte se rregulloret evropiane kanë të njëjtën vlerë me legjislacionin parësor. Në fakt ky artikull përcakton se rregulloret evropiane kanë shtrirje të përgjithshme, janë të detyrueshme në të gjitha pjesët e tyre dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjitha Shtetet anëtare. Ky parashikim ishte i papranueshëm për gjyqtarin italian për dy arsye: e para një parashikim i tillë do të thotë heqje dorë nga sovraniteti shtetëror dhe së dyti një dispozitë e tillë modifikonte strukturën themelore kushtetuese të shtetit, gjë që nuk lejohet nga neni 11 i Kushtetutës Italiane.

Ndërkohë ky qëndrim iu referua Gjykatës Kushtetuese Italiane e cila vendosi se: “neni 189 i Traktatit nuk e ka shkelur sovranitetin e shtetit. Në të vërtetë, Italia fitoi kompetenca të reja, siç është e drejta për të emëruar përfaqësuesit e tij në institucionet evropiane dhe të drejtën për të marrë pjesë në Komisionin Evropian dhe Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Dhe në mënyrë që të deklarojë se rregullat evropiane nuk janë në konflikt me sovranitetin e shtetit, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se neni 11 i Kushtetutës Italiane nuk lejon kufizime të sovranitetit në çdo rast, por vetëm atëherë kur është e nevojshme arritja e paqes dhe e drejtësisë në mesin e Kombeve. Kështu, ato kufizime të cilat shkelin parimet themelore të rendit kushtetues apo të drejtat themelore të individëve nuk janë të lejuara”. Ky ishte, sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, interpretimi i saktë i nenit 189 të Traktatit. Dhe në rastet kur kemi keqinterpretim të këtij neni Gjykata Kushtetuese deklaroi se ka fuqinë për të ushtruar shqyrtimin kushtetues të normave të Traktatit si të papjtueshme me parimet kushtetuese.

Këto praktika gjyqësore tregojnë që thelbi i Kushtetutës nuk mund t’i nënshtrohet të drejtës komunitare. Qëllimi i tyre ishte të mbrohen vlerat më të larta të rendit juridik të brendshëm, simbol i ruajtjes së sovranitetit kombëtar.

Megjithatë, duhet thënë që, kjo rezistencë e gjykatave kushtetuese kombëtare nuk është krejtësisht efektive duke qënë se shteti e ruan sovranitetin e tij vetëm në hipotezën kur nga Shtetet anëtare ushtrohet një kontroll përputhshmërie i së drejtës komunitare me normat kushtetuese kombëtare. Në rastin kur nuk ndodh ky kontroll, e drejta komunitare do të aplikohet në territorin e Shtetit anëtar pa u kontrolluar më nga ky i fundit.

Në fakt, duhet theksuar që Bashkimi Evropian krijon norma juridike të cilat, siç e thamë edhe më lart, i “shpëtojnë” kontrollit të Kushtetutave kombëtare duke qënë se gjyqtarët kushtetues ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi traktatet dhe shumë rrallë mbi tekstet e

së drejtës së prejardhur e cila nuk është objekt i asnjë mase të veçantë për t'u vënë në zbatim në të drejtën e brendshme. Mund të përmendim këtu rregulloret komunitare të cilat zbatohen në mënyrë direkte në legjislacionin e brendshëm të Shteteve anëtare (Borçard, 2010:89) duke mos pasur nevojë për ndërhyrje parlamentare dhe si rrjedhojë ato i shpëtojnë edhe kontrollit të ushtruar nga legjislacionet kombëtare. Kështu nuk ka asnjë mundësi për Shtetet anëtare që të shprehen në lidhje me kushtetutshmërinë e një rregulloreje (Borçard, 2010: 89-93) .

Nga gjithë sa u tha më lart, mund të konkludojmë që e drejta komunitare “sulmon” në mënyrë direkte konceptin e sovranitetit absolut të shtetit. Shteti sot nuk është më i vetmi pronar i kompetencave në shumë fusha shtetërore.

Problemi i vërtetë i sovranitetit është se ai duhet të gjejë vendin e tij në një organizatë ndërkombëtare ku shtetet nuk kanë më monopolin vendimmarrës dhe ku bashkëjetesa e sistemeve juridike kombëtare po komplikon në mënyrë të konsiderueshme marrëdhëniet juridike, qoftë në aspektin e brendshëm, qoftë në aspektin e jashtëm.

Përballë këtij kolizioni sistemesh juridike, roli i gjyqtarit është vërtet i rëndësishëm. Ai, nëpërmjet interpretimeve të tij mund të bëjë të mundur bashkëekzistencën e normave juridike dhe pse jo t'i përfaqësojë ato. Roli i gjyqtarit kombëtar ka evoluar dhe ai sot nuk është më thjesht në shërbim të së drejtës të prodhuar nga shteti. Ai duhet të ballafaqojë pozicionin e tij me atë të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Pra, shteti nuk është më i vetmi entitet që bën drejtësi por e ndan atë edhe me organizma të tjera ndërkombëtare. Në fakt, kjo ndarje kompetencash sjell një ndër humbjet më kryesore të funksioneve të shtetit, të cilat janë dhe simboli kyç i sovranitetit shtetëror.

5.5. Sovraniteti përballë pushtetit të gjyqtarëve

Një ndër atributet e sovranitetit, veçanërisht të rendësishme, është pushteti për të bërë drejtësi. Tradicionalisht ky pushtet i është rezervuar shtetit dhe më konkretisht gjyqësorit që operon në çdo shtet. Në të gjitha vendet demokratike, dëgjojmë formulën që gjyqtari ka pushtetin për të bërë drejtësi në emër të popullit që ai përfaqëson. Megjithatë ky parim bazë i sovranitetit po përjeton ndryshime të vazhdueshme meqënëse gjyqtari kombëtar shndërrohet në të njëjtën kohë edhe në gjyqtar komunitar dhe zhvillimi i juridiksioneve ndërshtetërore po kontribuon në krijimin e një drejtësie mbikombëtare, e cila gradualisht të çon në krijimin e një interpretimi ligjor, të përbashkët për të gjitha shtetet (Mortier, 2011:213).

5.5.1. *Shteti i nënshtruar ndaj juridiksionit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë*

Sot Shtetet anëtare të BE-së duhet t'i bëjnë ballë juridprudencës së GJED-së. Nënshtrimi i shteteve ndaj vendimeve të kësaj gjykate është një ndër treguesit kryesorë të shpërbërjes së sovranitetit shtetëror.

GJED-ja zgjidh mosmarrëveshjet mes Shteteve anëtare, por roli i saj, në fakt, shkon përtej meqënëse juridiksioni i saj është i detyrueshëm si për institucionet e BE-së ashtu edhe për personat (fizikë apo juridikë), të cilët mund t'i nënshtrohen juridiksionit të kësaj gjykate, kuptohet duke përmbushur disa kushte të detyrueshme.

E kemi cituar dhe më lart që duke sanksionuar përparësinë e së drejtës komunitare, GJED-ja kontribuon në dobësimin e sovranitetit të shtetit, i cili është i detyruar të zbatojë një të drejtë që nuk është aspak nën kontrollin e tij. Por roli i GJED-së në dobësimin e sovranitetit të shtetit shkon më tej. Interpretimi i gjërë i së drejtës komunitare zgjeron në masë të madhe

fushëveprimin e kësaj të drejte si dhe fuqia shtrënguese e GJED-së në raport me Shtetet anëtare që nuk kanë respektuar këtë të drejtë, është po ashtu tregues që shteti nuk është më i vetmi sovran, i pakontestueshëm, në territorin e vet.

GJED-ja është krijuese e ligjit. Në të vërtetë, ky funksion buron nga karakteri i paqartë i traktateve të BE-së dhe nga pamundësia e organeve të tjera të BE-së për të vënë në diskutim interpretimet e kësaj Gjykate.

Duke përfituar nga pamundësia e organeve komunitare për të dhënë interpretime të tjera lidhur me të drejtën komunitare, GJED-ja përdor metoda të ndryshme për të zgjeruar fushën e ndërhyrjes së të drejtës komunitare duke ndikuar kështu edhe në imponimin e kësaj të drejte Shteteve anëtare. Duke u bazuar tek objektivat e traktateve, GJED-ja adopton qartësisht një interpretim në favor të së drejtës komunitare që amplifikon karakterin e saj integrues. Me praktiken e saj GJED-ja synon të përforcojë pavarësinë e së drejtës komunitare (Boulouis, 1974:155).

Kështu, GJED-ja me interpretimin e saj në favor të së drejtës komunitare promovon integrimin në kurriz të sovranitetit shtetëror. Shtetet i nënshtrohen interpretimit të së drejtës të bërë nga GJED-ja duke qënë se ato, në lidhje me këtë çështje, nuk mund të ushtrojnë asnjë lloj influence dhe duke qënë se GJED-ja është një organ i pavarur dhe shkalla e fundit e gjyqësorit. Pushteti i GJED-së është veçanërisht i rëndësishëm duke qënë se ajo ka disa procedura të cilat e lejojnë atë të imponojë këtë të drejtë dhe të vendosë sanksione ndaj shteteve në rast shkeljeje. Kështu shteti nuk mund të gëzojë sovranitet të plotë duke qënë se GJED-ja nuk heziton në asnjë moment të përdorë të gjitha mjetet që ka në dispozicion për të siguruar respektimin e parimit të përparësisë së të drejtës komunitare (Mortier, 2011:217).

Që heret, GJED-ja i ka imponuar Shteteve anëtare mos-zbatueshmërinë e normave të brendshme të cilat bien ndesh me të drejtën komunitare. Përballë rastit të konfliktit mes normës së brendshme dhe normës komunitare, gjyqtari jo vetëm që nuk duhet të zbatojë normën kombëtare⁵⁵ por Shtetet anëtare kanë detyrimin për të eliminuar nga rendi i tyre juridik ato norma që nuk përputhen me të drejtën komunitare⁵⁶. Pra GJED-ja shkon edhe më tej: nuk mjaftohet me mos-zbatueshmërinë e normës kombëtare por i detyron shtetet që të modifikojnë ose të shfuqizojnë këtë të fundit në rast se ajo ka kundërshti me normën komunitare⁵⁷. GJED-ja përdor gjithashtu edhe mekanizmin e gjykimeve paraprake të cilat influencojnë të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare dhe imponojnë zbatimin uniform të së drejtës komunitare⁵⁸.

Ndër të gjitha mjetet që posedon GJED-ja, gjykimi ndaj shkeljeve sipas nenit 260 të TFBE-së është treguesi më tipik i kufizimit të sovranitetit të shteteve pasi ai bën të mundur imponimin e së drejtës komunitare shteteve “të pabindura”. Kështu, kur Komisioni konstaton mosrespektim të së drejtës komunitare, ai është i legjitimuar, pasi i ka dhënë mundësi shtetit shkelës për sqarime, për t’iu drejtuar GJED-së në mënyrë që kjo e fundit të konstatojë shkeljen dhe të sanksionojë shtetin shkelës. Sanksionet tipike janë ato të karakterit financiar. Në vitin 2000 GJED-ja ka vendosur për herë të parë një dënim të tillë kundër shtetit shkelës⁵⁹. Këto sanksione financiare detyrojnë Shtetet anëtare për të respektuar të drejtën komunitare dhe si rrjedhojë e kësaj fushe e kompetencave të tyre kufizohet.

⁵⁵Shih: GJKE, Komisioni k/ Italisë, 13 korrik 1972. Çështja nr. 48/71.

⁵⁶Shih: GJKE, Komisioni k/ Italisë, 24 mars 1988, Çështja nr. 104/86, rec. f. 1799. Shih gjithashtu: Komisioni k/ Italisë, 17 prill 1988, Çështja nr. 225/86, rec. f. 2271.

⁵⁷ Shih: Vendimi i GJKE : Komisioni k/ Italisë, 11 prill 1978, Çështja 100/77, rec. fq. 879 dhe Vendimi Kobler, 30 shtator 2003, Çështja nr. 224/01 rec. fq. 10239.

⁵⁸ Shih Vendimin e GJED, 2 mars 2010, Çështja T 16/04, Arcelor / Parlement et Conseil, revue Europe, Mais 2010, fq. 16

⁵⁹Shih:GJKE, Komisioni k/ Greqisë, 4 korrik 2000, Çështja nr. 387/97, rec. fq. 5047.

Një rast tjetër ku GJED-ja siguron mbizotërimin e së drejtës komunitare ndaj asaj të brendshme është rasti i atyre personave (fizikë apo juridikë) të cilët mund t'i drejtohen kësaj gjykate nëse të drejtat apo interesat e tyre të ligjshme i janë cënuar për shkak të shkeljes të së drejtës komunitare nga një Shtet anëtar. Në një vendim të saj, *Humblet*, GJED-ja vlerësoi që shteti shkelës duhet jo vetëm të vërë në zbatim ligjin por duhet gjithashtu të riparojë të gjitha pasojat e dëmshme që kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të ligjit ose i zbatimit të gabuar të tij⁶⁰. Në këtë pikë GJED-ja mund të shërbejë si një gjykatë plotësuese për shtetasit e vendeve anëtare, të cilët kërkojnë të mbrojnë të drejtat e tyre tek një entitet tjetër, që nuk është shteti i tyre.

Zhvillimi i juridiksioneve ndërshtetërore kontribuon në modifikimin e konceptit të pushtetit shtetëror i cili gjithnjë e më shumë po bëhet objekt i proçeseve gjyqësore të cilat nuk mund të kontrollohen nga vetë ai. Ky fenomen përforcohet nga fakti që këto gjykata ndërkombëtare kanë tendencën për t'i imponuar vizionin e tyre gjykatave të larta kombëtare dhe në mënyrë më specifike gjyqtarëve kombëtarë, të cilët nuk janë më vetëm në shërbim të shtetit dhe të së drejtës shtetërore.

5.5.2. *Bashkëpunimi i ngushtë mes GJED-së dhe gjykatave kombëtare*

Sipas parimit të sovranitetit, vendimet e marra nga gjykatat kushtetuese kanë karakter imponues për të gjithë hierarkinë e normave. Këto vendime nuk mund të kontestohen, tregues ky i pavarësisë së pushtetit gjyqësor në shërbim të shtetit dhe të qytetarëve të tij. Megjithatë sot ky pushtet nuk përjashtohet nga kritikrat duke qënë se juridiksionet ndërkombëtare ushtrojnë nganjëherë kontroll mbi punën e gjyqtarëve kombëtarë, gjë e cila ndikon në dobësimin e sovranitetit të shteteve.

⁶⁰ Shih: GJKE, *Humblet* k/ Belgjikës, Çështja nr. 6/60 rec. fq. 1125.

Kështu GJED-ja nuk është kufizuar gjithmonë në bërjen e rolit të interpretuesit të së drejtës komunitare por ajo edhe ka tentuar të harmonizojë të drejtat kushtetuese të Shteteve anëtare, duke kufizuar kështu hapësirën e veprimit për gjyqtarët kushtetues. Në fakt GJED-ja edhe pse nuk ka si qëllim të ndërhyjë në organizimin gjyqësor të Shteteve anëtare, në emër të parimit të autonomisë institucionale dhe procedurale të Shteteve anëtare (Rideau, 2006:986), ajo detyron juridiksionet kombëtare të zbatojnë të drejtën komunitare⁶¹.

Në çdo rast, tundimi për të ushtruar kontroll ndaj juridiksioneve të brendshme bëhet nëpërmjet mekanizmit të vendimeve paraprake, të cilat i lejojnë GJED-së të imponojë interpretimin e saj dhe të uniformizojë zbatimin e së drejtës komunitare në të gjithë territorin e BE-së. Me anë të këtij mekanizmi, gjyqtarët kombëtarë kur ndodhen përpara paqartësive në interpretimin e së drejtës komunitare mund t'i drejtohen GJED-së e cila do të shprehet në mënyrë përfundimtare lidhur me kuptimin e normës dhe me zgjidhjen juridike që do ta zbatohet. Mekanizmi i vendimit paraprak parashikohet në nenin 267 të TFBE-së, në zbatim të së cilit gjykatat kombëtare mund të kërkojnë udhëzim nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë lidhur me të drejtën e BE-së. Aty ky gjykatat kombëtare duhet të zbatojnë dispozitat e së drejtës së BE-së në ndonjë rast para tij, mund të pezullojnë procesin dhe të kërkojnë nga GJED-ja sqarim të vlefshmërisë së instrumentit të BE-së dhe/ose interpretimit të instrumentave dhe Traktateve. Gjykata Evropiane e Drejtësisë përgjigjet më tepër në formë të vendimit se sa në formë të opinionit këshillues; kjo thekson natyrën detyruese të vendimit të saj. Procedura paraprake e vendimit, ndryshe nga procedurat e tjera, nuk është procedurë kundërshtuese, por vetëm një fazë në procesin gjyqësor që fillon dhe mbaron në gjykatat kombëtare. Domethënë duhet të sigurohet një interpretim i njëtrajtshëm i ligjit të BE-së dhe i unitetit të rendit ligjor të BE-së (Borçard, 2010:108-109).

⁶¹Shih: Vendim i GJKE:Lorenz, 11 dhjetor 1973, Rec. f. 1471.

Fillimisht i kufizuar (Lecourt, 1976:274), gjykimi paraprak është shndërruar në një praktikë relativisht të zakonshme. Në fakt, të tilla gjykime përbëjnë burimin kryesor të aktivitetit të Gjykatës. Siç e kanë konfirmuar dhe shumë autorë, GJED-ja e përdor këtë mekanizëm për të përforcuar integrimin juridik dhe për të shkuar gradualisht tek integrimi gjyqësor (Kovar, 1994:35). Me kalimin e kohës, është krijuar një bashkëpunim i ngushtë mes GJED-së dhe gjykatave të ndryshme kombëtare, të cilat frymëzohen nga jurisprudenca e GJED-së dhe që gradualisht adoptojnë qëndrime të përbashkëta, sidomos në çështjet komunitare (Bonichot, 2008:746).

Në fakt GJED-ja është e prirur për të zhvilluar më tej këtë bashkëpunim, i cili nënkupton një privim progresiv të pushtetit gjyqësor të shtetit⁶². GJED-ja nuk përcakton rregullat proceduriale të zbatueshme, por përcakton kërkesat e së drejtës komunitare të cilat duhet të plotësohen nga gjyqtarët kombëtarë (Grevisse & J.-C. Bonichot, 1991:287). Gjykata verifikon nëse dispozitat e së drejtës kombëtare nuk i pengojnë gjykatat të zbatojnë të drejtën komunitare; kështu gjyqtari duhet të privilegjojë rendin juridik komunitar⁶³. Ky dobësim i pushtetit gjyqësor shtetëror është reflektuar edhe tek ndryshimi i rolit të gjyqtarëve kombëtarë, të cilët nuk konsiderohen më si gjyqtarë në shërbim të normës shtetërore, por si gjyqtarë komunitarë tashmë. Në fakt, traktatet e BE-së i kujtojnë gjyqtarit kombëtar që ai duhet të garantojë zbatimin dhe efektin e drejtpërdrejtë të së drejtës komunitare⁶⁴, gjë e cila e shndërron gjyqtarin kombëtar në një gjyqtar të së drejtës së përbashkët. Kështu gjykatat kombëtare i referohen gjithnjë e më shumë dispozitave komunitare. Në çdo rast ato sigurojnë supremacinë e rendit komunitar ndaj të gjitha teksteve kombëtare ligjore ose nënligjore. Gjykatat kombëtare tashmë janë edhe gjykata

⁶²Shih: GJKE, 15 dhjetor 1995, Bosman, Çështja nr. 415/93, rec. fq. 4921 dhe GJKE, 11 nëntor 1997, Eurotunnel, rec. fq. 6315.

⁶³Shih: Vendimi i GJKE, 15 maj 1986, Johnston, Çështja nr. 222/84, rec fq. 1651 dhe vendimi i GJKE, 19 qershor 1990, Factortame, Çështja nr.213/89, rec. fq. 2433.

⁶⁴ Shih nenin 19 të TBE-së në versionin e Traktatit të Lisbonës.

komunitare, që do të thotë se ato nuk janë më të lidhura plotësisht dhe ekskluzivisht me shtetin (Grevisse & Bonichot, 1991:297).

Nga ky konstatim mund të nxirren pasoja të reja ndaj konceptit të sovranitetit. Sot një ndër prerogativat kryesore të sovranitetit, të projektuara nga J.Bodin, ajo e bërjes drejtësi, gjithnjë e më pak po ofrohet nga shteti. Megjithatë, kjo analizë ka vend për diskutime, pasi që cilado qoftë norma e aplikuar nga gjyqtari, drejtësia jepet gjithmonë në emër të popullit.

Këto dy aspekte kontradiktore të lënë dyshimin në lidhje me ruajtjen e sovranitetit të shtetit përse i përket funksionit të tij për të bërë drejtësi dhe aftësive të kombit për t'i besuar pushtetin gjyqësor një entiteti tjetër, që nuk është shteti.

Gjyqtarët kombëtarë, në fakt, po tentojnë të rezistojnë në lidhje me supremacinë e së drejtës komunitare në raport me Kushtetutën. Kjo rezistencë mund të përkthehet fare mirë në afirmimin e supremacisë të së drejtës kushtetuese, parim të cilin gjyqtarët kombëtarë vazhdojnë ta zbatojnë me prioritet duke e konsideruar si një ndër simbolet e fundit të rezistencës së sovranitetit shtetëror (Mortier, 2011:223).

Gjithsesi në çdo rast, gjykata kombëtare kur do të marrë një vendim ka parasysh të drejtën komunitare duke qënë se kjo e drejtë kondicionon dhe vlefshmërinë e së drejtës kombëtare⁶⁵.

Ky evolucion i rolit të gjyqtarit, thjesht tregon një zhvendosje të pushtetit gjyqësor, jashtë shtetit, i cili nënkupton një formë të ndarjes së aftësive për të mbrojtur të drejtat dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Kjo zhvendosje pushtetesh vë në diskutim rolin e shtetit por të ndodhur përpara mungesës së një Kushtetute të vërtetë evropiane dhe të një entiteti

⁶⁵ Për më tepër shih: Opinioni i F. Chaltiel, në: *l'application du droit communautaire par le juge national*, Mélanges Isaac, fq. 843.

evropian të paaftë për të konkuruar me shtetin, mund të themi që pushteti për të dhënë drejtësi i atribuohet, pavarësisht të gjithave, sovranitetit kombëtar (Mortier, 2011:224).

Përballë triumfit të së drejtës mbi sovranitetin, shteti dhe kombi nuk kanë të njëjtat armë për të mbrojtur vendin e tyre dhe pushtetin e tyre. Në organizimin juridik modern, nuk mund të flasim më për sovranitet absolut të shtetit, ndërkohë sovraniteti kombëtar mesa duket e ruan vendin e tij. Në këtë kuptim, mund të themi që, sovraniteti kombëtar e ruan dimensionin absolut pavarësisht transformimeve të shumta. Sovraniteti sot është në duart e kombit i cili ka zgjedhur që ushtrimin e pushteteve të tij të mos e realizojë vetëm nëpërmjet shtetit, por edhe nëpërmjet formave të tjera, të cilat, pashmangshmërisht, do të sjellin pasoja tek sovraniteti i shtetit.

5.6. Pjesëmarrja e organeve politike kombëtare në fragmentimin e sovranitetit shtetëror

Çështjet e trajtuara në Projekt-Traktatin e Kushtetutës Evropiane dhe në Traktatin e Lisbonës tregojnë një ndarje mes shteteve dhe kombeve, mes identitetit kombëtar dhe integritetit evropian, mes nevojës politike dhe pretendimeve sovrane. Evolucionin historik i BE-së dhe zgjerimet e tij janë, gjithashtu, tregues të kësaj ndarjeje dhe të modifikimit të vizionit të sovranitetit shtetëror.

5.6.1. Projekt-Traktati i Kushtetutës Evropiane: një heqje dorë e Shteteve anëtare dhe një rezistencë e kombeve

Në mënyrë paradoksale, vetë shteti kontribuon në dobësimin e sovranitetit, pasi vetë shtetet, të nxitur nga nevojat ekonomike, politike, ushtarake, i kanë dhënë Bashkimit Evropian kompetenca të tilla sa që sot BE-ja mund të konsiderohet si një konkurrent serioz i shtetit. Madje vetë projekti për krijimin e një Kushtetute të Bashkimit Evropian ka treguar vullnetin e shteteve për të krijuar një Evropë me vokacion mbikombëtar dhe të integruar (Mortier, 2011:252).

Projekt-traktati i Kushtetutës së Bashkimit Evropian ishte shprehje e një vizioni integruar të Evropës dhe kishte si mision të tij zgjidhjen e dy vështirësive thelbësore: vështirësia e parë kishte të bënte me pamundësinë e shteteve për zgjidhjen e çështjeve ekonomike dhe sociale, të cilat në fakt kishin marrë karakter tashmë ndërkombëtar dhe ishin vërtet komplekse për t'u zgjidhur në nivel shtetëror; vështirësia e dytë i referohej ngërçit institucional në të cilin ndodhej Bashkimi Evropian (Bello, 2010:322-329).

Ajo çfarë konstatohet nga ky projekt-traktat është se shtetet filluan negociatat për ratifikimin e tij pa marrë parasysh pasojat që ky traktat do të sillte në të ardhmen ndaj konceptit të sovranitetit shtetëror. Shtetet u fokusuan në ushtrimin e kompetencave të përbashkëta në ato fusha ku ato e kishin të vështirë të vepronin në mënyrë individuale dhe në të njëjtën kohë të evitonin rënien e BE-së në një qorrsohak. Në këtë projekt-Kushtetutë, pas shumë kompromiseve, u pranua hartimi i një teksti i cili dëmtonte në një shkallë të gjërë konceptin e sovranitetit të Shteteve anëtare (Bello, 2010:322-329).

Me hartimin e këtij projekt-traktati shtetet pranuan që tashmë koncepti i sovranitetit nuk është më absolut duke pranuar kështu në mënyrë të heshtur ndarjen e kompetencave. Thënë më konkretisht, ky dokument përfshiu disa aspekte, që për nga vetë natyra e tyre, e vinin në diskutim kuptimin tradicional të sovranitetit, të tilla si: përdorimi i termit Kushtetutë,

përfshirja e Kartës së të Drejtave Themelore, zgjerimi i shumicës së cilësuar, zgjerimi i kompetencave të BE-së në ato fusha ku shtetet e kishin të pamundur të vepronin individualisht, ripërsëritja e parimit të supremacisë, etj. (Mouton, 2008:754).

Me këtë projekt-traktat, shtetet i dhanë fund përfundimisht luftës kundër ndarjes së sovranitetit, i cili është edhe sot një ndër parimet udhëheqëse të Bashkimit Evropian. Mjafton të përmendim thjesht përdorimin e termit “Kushtetutë” për të kuptuar se ekzistonte vullneti i shteteve për të lejuar ndarjen e sovranitetit, edhe pse në atë periudhë përdorimi i termit “Kushtetutë” nuk ishte i përshtatshëm. Tregues të tjerë se shtetet pranuan ndarjen e sovranitetit ishin edhe rritja e kompetencave të BE-së në ato fusha të cilat më përpara ishin nën kompetencat ekskluzive të shteteve, po ashtu edhe zgjerimi i përdorimit të shumicës së kualifikuar (Mortier, 2011:253).

Projekt-traktati për Kushtetutën Evropiane kufizonte shtrirjen e sovranitetit shtetëror. Konkretisht, neni I 6 i traktatit parashikoi supremacinë e së drejtës së BE-së. Kështu, natyrshëm ky nen na çon drejt idesë që Kushtetuta e BE-së duhet të ketë supremaci ndaj të gjitha kushtetutave kombëtare të shteteve anëtare. Me parashikimin e këtij parimi në traktat, shtetet më në fund hoqën dorë nga koncepti absolut i sovranitetit të tyre duke pranuar tashmë që ekziston një pushtet tjetër juridik mbi to. Lidhur me këtë parim, disa autorë kanë konstatuar vështirësi të interpretimit të tij në praktikë. Në të vërtetë, disa autorë vlerësojnë që kombinimi i këtij neni me nenet e tjera të këtij traktati nuk do të thotë “braktisje” e sovranitetit të shtetit (Cassia, 2004:6). Ndërsa autorë të tjerë ishin të mendimit që zbatimi i këtij parimi ndikon, pjesërisht, në heqjen dorë të sovranitetit nga ana e shteteve. Pavarësisht qëndrimeve të kundërta, mund të themi që shtetet gjithsesi e pranuan mundësinë e ndarjes së sovranitetit.

Pavarësisht ndikimeve që ky projekt-traktat do të kishte mbi konceptin e sovranitetit dhe pas shumë kompromiseve, ai u nënshkrua nga të gjitha Shtetet anëtare me 29 tetor 2004, në Romë. Ndërkohë pasojat juridike të këtij traktati do të vinin vetëm pas ratifikimit të tij nga të gjitha Shtetet anëtare të BE-së. Pjesa më e madhe e shteteve preferuan ratifikimin e këtij projekti në rrugë parlamentare, duke evituar kështu ratifikimin me anë të referendumit (Oberdorff, 2008:775). Parlamentet kombëtare e ratifikuan të gjithë traktatin, duke treguar kështu vullnetin e shteteve për të lejuar zgjerimin e kompetencave të BE-së, zgjerim i cili në mënyrë direkte ndikonte edhe në kufizimin e sovranitetit të shteteve. Ndërsa në ato shtete ku ratifikimi i traktatit do të bëhej me anë të referendumit, solli rezistencën e popullsisë për të mos lejuar zgjerimin e kompetencave të BE-së dhe si rrjedhojë edhe mosratifikimin e tij. Shtetet anëtare të BE-së ishin të bindura që ky traktat kishte një të ardhme të suksesshme, por refuzimi i ratifikimit të tij nga populli francez dhe nga ai hollandez solli shuarjen e këtyre ideve.

Shkaqet e këtij refuzimi janë debatuar gjatë. Dështimet e këtij traktati ishin konsekuente. Le të marrim shembullin e Francës. Refuzimi i popullit francez për ratifikimin e këtij traktati erdhi si pasojë e shqetësimeve për rendin e brendshëm juridik dhe si pasojë e idesë që ishte përhapur në atë kohë që Evropa ishte përgjegjëse për të gjitha vështirësitë që po kalonte Franca. Megjithatë dhe përtej debatit francez lidhur me arsyet e dështimit të këtij traktati, përveç faktit që populli francez ishte kundër liberalizimit të tepruar të BE-së, një ndër shkaqet kryesore të këtij dështimi ishin pa dyshim edhe ato me karakter institucional dhe politik (Bello, 2010:324).

Lidhur me qëndrimin e tyre ndaj Bashkimit Evropian, autorët kanë mbajtur pozicione të ndryshme për sa i përket interpretimit të traktatit dhe pasojave të mosratifikimit të tij. Ato u

përqëndruan më shumë tek e ardhmja e BE-së dhe tek forma juridike që do të merrte kjo organizatë pas dështimit të Kushtetutës⁶⁶.

Sipas C.Zorgbibe, e ardhmja e BE-së mund të projektohet në tre forma të ndryshme: BE-ja në formën e një konfederate, BE-ja në formën e një përbindëshi institucional si përshebull një perandori e re⁶⁷ dhe BE-ja e rithemeluar, në kuptimin që të krijohet një Evropë politike mbi bazat e një reflektimi të ri të Shteteve anëtare (Zorgbibe, 2005:138). Disa autorë ishin të mendimit që bashkimi politik nuk vihet në diskutim, por që ai thjesht do të vonohet dhe do të fokusohet tek shtetet e tjera si për shembull tek dyshja Franko-Gjermane (Dehousse, 2005:132). Disa autorë të tjerë i frikësoheshin një kthimi të mundshëm të koncepteve nacionaliste të cilat mund të ndikonin në frenimin e ndërtimit politik të Bashkimit Evropian (Herzog, 2005:424).

Gjithsesi mund të themi që reagimet kombëtare ndaj traktatit nuk e çuan Bashkimin Evropian një hap prapa dhe as nuk riafirmuan ekzistencën e sovranitetit shtetëror absolut. Më së shumti mund të themi që sovraniteti kombëtar vazhonte të mos pranonte plotësisht zhdukjen e rolit të shtetit në favor të BE-së.

Përballë kësaj situate dhe në mungesë të një “plani B” (Jacqué, 2008:822), Traktati për Kushtetutën Evropiane nuk vazhdoi më tej por Shtetet anëtare kërkuan që të dilnin nga kjo krizë duke ndjekur idenë e procesit të integritit, gjithmonë për arsye utilitare të komunitetit ndërkombëtar. Autoritetet shtetërore, me në krye ato franceze, kontribuan në rinisjen e procesit të hartimit të një traktati të ri evropian duke mos u distancuar nga ideja e ndarjes së sovranitetit mes BE-së dhe Shteteve anëtare.

⁶⁶ Për më tepër shih: R. Dehousse, *la fin de l'Europe*, édition Flammarion, 2005 dhe P. Moreau Defarges, *Où va l'Europe ?*, Édition Eyrolles, 2006.

⁶⁷ Për më tepër shih: D. Rousseau, *le traité constitutionnel*, le Monde, 22 tetor 2002, dhe G. Verthofstad, *Les Etats-Unis d'europe*, édition Luc Piris, 2006.

Idetë e para për hartimin e një traktati të ri filluan me presidencën britanike, por më shumë ishte presidenca gjermane ajo që insistoi tek kjo ide (Mortier, 2011:257).

Me Deklaraten e Berlinit të 25 marsit 2007, shtetet e kuptuan që po përballeshin me një domosdoshmëri juridike, në kuptimin që BE-ja kishte nevojë për një rinovim të sistemit të saj institucional dhe vendimmarrës, e cila do të marrë padiskutim parasysh edhe vështirësinë e qytetarëve evropianë për të pranuar një formë të tillë të bashkimit politik (Mortier, 2011:257).

Në qershor 2007, Këshilli Evropian vendosi të thërrasë një konferencë ndërqeveritare për të mundësuar miratimin e shpejtë të një traktati reformues të funksionimit të BE-së. Kjo konferencë i parapriu Traktatit të ardhshëm të Lisbonës.

5.6.2. Traktati i Lisbonës: kontradikta Shtet/Komb mbi ndarjen e sovranitetit

Të shtyrë nga nevoja, Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian konfirmuan vullnetin e tyre që BE-ja të jetë një person i plotë juridik. Traktati i Lisbonës është hartuar pikërisht për këtë qëllim. Ai është quajtur një traktat kushtetues që nuk e thotë emrin e tij dhe që ka për objektiv transferimin e neneve të parashikuara në Traktatin e Kushtetutës Evropiane (Bello, 2010:342-344).

Parë në shumë aspekte, Traktati i Lisbonës, i nënshkruar me 17 dhjetor 2007, është provë e vullnetit të shteteve për të pranuar ushtrimin e përbashkët të sovranitetit. Ky traktat, në fakt, inkorporon në përbërjen e tij pjesën më të madhe të dispozitave institucionale dhe materiale të parashikuara në Traktatin për Kushtetutën e BE-së, ndërkohë “zhduk” të gjithë ato elementë të traktatit të cilat tregonin qartë ambicien konstitucionaliste të autorëve të këtij

traktati (Oberdorff, 2008:775). Në thelb, Traktati i Lisbonës është një katalog amendentesh përkundrejt dy traktateve, konkretisht ndaj traktatit të KE-së që në versionin e Lisbonës njihet me emrin Traktati mbi funksionimin e BE-së dhe të Traktatit të BE-së që në versionin e Lisbonës njihet me emrin Traktati mbi Bashkimin Evropian . Me traktatin e Lisbonës, shtetet kanë gjetur më në fund një zgjidhje ndaj kërkesave kombëtare për të bërë të mundur avancimin e procesit të integritimit evropian siç ishte shpresuar të arrihej edhe me Traktatin për Kushtetutën e BE-së⁶⁸.

Ajo çfarë qartazi vihet re nëpërmjet këtij traktati është zgjerimi i fushave ku BE-ja do të ushtrojë kompetencat e saj ekskluzive. Çdo transferim kompetencash i parashikuar në traktat shkon gjithmonë në favor të BE-së dhe në asnjë moment në favor të Shteteve anëtare. Çfarë vihet re tjetër nga dispozitat e këtij traktati është edhe mosnjohja e parimit të autonomisë pasi shtetet do të jenë gjithmonë subjekte të rendit superior të interpretimit të Gjykatës së Drejtësisë. Gjithashtu vëmë re se në përputhje me Traktatin për Kushtetutën Evropiane, Traktati i Lisbonës përmban dispozita që transformojnë kompetencat plotësuese në kompetenca të ndara (Michel, 2008:43), duke përforcuar kështu idenë e një sovraniteti të ndarë⁶⁹.

Ndarja e sovranitetit duket sikur është pranuar nga Shtetet anëtare në masën ose në fushat ku shteti pranon t'i besojë BE-së disa prerogativa. Ky traktat mund t'i japë Bashkimit Evropian mundësinë për të koordinuar politikat kombëtare, sidomos në fushën e sigurisë, drejtësisë, emigracionit, etj.

⁶⁸M. Giscard D'Estaing thoshte për Traktatin e Lisbonës: “të gjitha dispozitat institucionale të Traktatit kushtetues janë të përhira në Traktatin e Lisbonës.” Në, le Monde, 26 tetor 2007.

⁶⁹Shih nenin 2 të TFBE-së, i cili sanksionon që Shtetet anëtare i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm aty ku BE-ja nuk i ka ushtruar kompetencat e saj.

Këto mundësi për të ndarë sovranitetin mes BE-së dhe Shteteve anëtare mund të provokojnë një diversifikim të plotë ose të pjesshëm të kompetencave të shtetit dhe si rrjedhojë një modifikim të ushtrimit të sovranitetit qoftë juridik, qoftë politik. Ky modifikim konstatohet fare mirë me anë të klauzolave urë të cilat përforcojnë aftësinë e BE-së për të ndërhyrë në zgjedhjet politike të bëra nga Shtetet anëtare. Klauzola të tilla janë ato të së drejtës penale, të së drejtës familjare, të realizimit të tregut të brendshëm. Nëpërmjet këtyre klauzolave bëhet i mundur zhvillimi i fushës së veprimit të BE-së (Mortier, 2011: 259).

Në traktatin e Lisbonës ka edhe elementë të tjerë nëpërmjet të cilëve nënkuptohet se shtetet kanë pranuar ndarjen e sovranitetit ose ushtrimin e sovranitetit vetëm nga BE-ja, në fusha të caktuara. Konkretisht, mund të përmendim Zonën e Sigurisë dhe të Drejtësisë e cila nuk është më një shtyllë, por në të vërtetë ka marrë karakter komunitar me një fushë të gjërë bashkëpunimi në çështjet civile dhe penale, siç është Eurojus dhe Europol. Traktati parashikon po ashtu edhe vendosjen graduale të një sistemi menaxhimi të integruar të kufijve (Dutheil de la Rochère, 2008:59). Për më tepër, aplikimi tashmë i shumicës së cilësuar dhe jo i unanimitetit është tregues i reduktimit të kompetencave sovrane të shteteve (Labayle, 2008:58). Përpara Traktatit të Lisbonës, shumica e kualifikuar është përdorur për shumë çështje, përfshi bujqësinë, rregullat e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisin, ndërsa me Traktatin e Lisbonës ky rregull do të zgjerohet edhe në fusha të tjera si energjia, azili dhe migracioni nga vendet jo anëtare të BE-së⁷⁰. Përdorimi i shumicës së kualifikuar u zgjerua në fushat politike që më herët ishin objekt i unanimitetit, veçanërisht çështjet lidhur me bashkëpunimin policor dhe gjyqësor (Azizi, 2011:594). Në mënyrë të ngjashme, zgjerimi i kompetencave të jashtme të BE-së ofron mundësinë për të kuptuar

⁷⁰Shih nenin 53 të TFB-së

nëse është e nevojshme që shtetet të heqin dorë pjesërisht nga sovraniteti i tyre. Në lidhje me këtë, duhet thënë që institucionet e reja të krijuara nga traktati i Lisbonës, si Përfaqësuesi i Lartë dhe Presidenca e qëndrueshme e BE-së, i japin kësaj të fundit një fizionomi në skenën ndërkombëtare, që do të thotë më tepër ndikim ndërkombëtar.

Traktati i Lisbonës është një hap drejt konfirmimit të rolit të BE-së në skenën ndërkombëtare. Në versionin e ndryshuar të nenit 3/5 të TBE-së sanksionohet se: “Në marrëdhëniet me botën, Bashkimi mban dhe nxit vlerat dhe interesat e veta si dhe jep kontribut në mbrojtjen e qytetarëve të tij. Ai kontribuon për paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës, solidaritetin dhe respektin e ndërsjellë midis popujve, tregtinë e lirë dhe të ndershme, zhdukjen e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të të drejtave të fëmijëve, si edhe zbatimin rigoroz dhe zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara”. Një formulim i tillë i ngjason një forme të deklarimit të hyrjes së një shteti të ri në skenën ndërkombëtare. Në mënyrë të ngjashme, neni 2/5 i TFBE-së përcakton një objektiv të përgjithshëm i cili do të bëjë të mundur që BE-ja të shtrijë kompetencat e saj në disa fusha të reja, të cilat përpara këtij traktati ishin në kompetencën e Shteteve anëtare.

Afirmimi i BE-së në skenën ndërkombëtare i jep mundësinë këtij të fundit që të mund të përfundojë marrëveshje ndërkombëtare në emër dhe për llogari të tij. Përfaqësimi në skenën ndërkombëtare nëpërmjet Përfaqësuesit të Lartë për çështjet e jashtme dhe të sigurisë, e drejta ligjore që i njihet BE-së për të zbatuar një politikë të mbrojtjes së përbashkët, janë edhe këto tregues të afirmimit të personalitetit juridik ndërkombëtar të BE-së dhe si rrjedhojë janë edhe tregues të transformimit të mënyrës së ushtrimit të sovranitetit në favor të Bashkimit Evropian (Maddalon, 2008:61).

Nga sa u tha më lart, një gjë është e qartë, shtetet duken se janë të bindura të heqin dorë nga një pjesë e sovranitetit, ndërsa popullsia, që vazhdon të jetë e lidhur me identitetin kombëtar dhe në kundërshtim me pozitën që shtetet dëshirojnë t'i japin BE-së, nuk është me të vërtetë gati të heqë dorë. Ky ndryshim pozitash është tregues i një ndarjeje të vazhdueshme mes Shtetit dhe Popullit, ndarje e cila vë në vështirësi konceptet juridike të cilat përdoren zakonisht për të përshkruar pushtetin e shtetit sovran.

5.6.3. Zgjerimi i BE-së dhe ndikimi i tij tek sovraniteti i shteteve: një hendek mes vullnetit të Qeverive dhe vullnetit të Kombeve

Zgjerimet e njëpasnjëshme të BE-së kanë ardhur si pasojë e vullnetit të Shteteve anëtare duke mos lejuar qytetarët evropianë që të japin një vendim të tyre lidhur me këto çështje. Duke qënë se kriteret e pranimit në BE janë goxha të rrepta, popullsia evropiane nuk mund të shprehet në lidhje me aderimin e një shteti të ri, por do të jenë vetëm qeveritë e Shteteve anëtare që do të marrin pjesë në procesin e integritetit të një shteti të ri. Në fakt, do të jetë Këshilli Evropian i cili do të vendosë në mënyrë unanime pranimin apo jo të kandidaturës së një shteti për t'u anëtarësuar në BE (Borçard, 2010:54).

Nga zgjerimet e mëparshme dhe sidomos ai i vitit 2004, të gjitha Shtetet anëtare mbështeten aderimin e dhjetë shteteve të reja në BE. Ndërkohë popullsia evropiane nuk u konsultua lidhur me çështjen në fjalë. Çfarë do të thotë kjo? Kjo është një dëshmi e asaj që Bashkimi Evropian është vepër e shteteve dhe jo vepër e popullsisë evropiane.

Megjithatë çështja e zgjerimit të BE-së është shumë e rëndësishme pasi ajo përcakton rëndësinë dhe cilësinë e ushtrimit të sovranitetit të përbashkët. Politikat e zgjerimit janë ato që përcaktojnë gjithashtu atë se çfarë popullsia evropiane dëshiron që të bëjë me BE-në dhe

rolin që ajo dëshiron që t'i japë këtij të fundit në raport me Shtetet anëtare në kuadrin e ushtrimit të kompetencave të brendshme dhe të jashtme të sovranitetit. Lidhur me këtë çështje shtrohet edhe pyetja: A mund të vazhdojë të zgjerohet BE-ja edhe pse ajo gjithnjë e më tepër po ushtron kompetenca shtetërore? Deri më tani, progresi i shteteve të BE-së ka qenë i tillë: zgjerimi të vazhdojë por duke pasur gjithnjë parasysh rëndësinë e thellimit, që nuk është diçka e lehtë (Mortier, 2011:262).

Ky progres, përgjithësisht, është pranuar nga popullsia evropiane gjatë zgjerimeve të viteve 1973, 1981, 1986, 1995 për shkak se të gjitha shtetet aderuese i përkisnin Evropës Lindore dhe fakti që ato, gjeografikisht, ishin shtete evropiane nuk mund të kontestohet⁷¹. Zgjerimi i vitit 2004 me 10 shtete të Evropës Lindore⁷² ka shkaktuar më shumë vështirësi, pasi u ngrit çështja e zhvendosjes së qendrës së Evropës, po ashtu edhe çështja e rreziqeve që mund të vinin si rezultat i konkurrencës ekonomike mes Shteteve anëtare. Një shqetësim të tillë kishte Franca pasi ky zgjerim i ri nënkuptonte spostim të qendrës së gravitetit të Evropës, ku Franca mund të humbiste influencën e saj në këtë organizatë⁷³.

Popullsia evropiane filloi të dyshojnë në dobinë e zgjerimeve por duke qenë se Shtetet anëtare nuk u konsultuan me ta që nga ratifikimi i traktateve ato nuk patën mundësi që të prononcoheshin në lidhje me oportunitetin e zgjerimit. Kjo mungesë konsultimesh tregon një hendek mes vullnetit të qeverive dhe vullnetit të kombeve, hendek i cili nuk është shfaqur zyrtarisht që në fillim. Kjo përçarje mesa duket nuk e ka ndërmend të reduktohet, përkundrazi ka shumë gjasa që të amplifikohet nëse marrim parasysh hyrjen e ardhshme dhe të mundshme të shteteve të reja në BE (Mortier, 2011:263).

⁷¹Në 1973 aderon në BE Irlanda, Mbretëria e Bashkuar dhe Danimarka, në 1981 aderon Greqia, në 1986 aderon Spanja dhe Portugalia, në 1995 aderon Austria, Suedia dhe Finlandë.

⁷²Në 2004 aderojnë në BE Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Sllovenia, Sllovakia, Hungaria, Qipro, Malta dhe Republika Çeke; në 2007 aderojnë Bullgaria dhe Rumania dhe zgjerimi i fundit i BE-së u shënua në 2013 me aderimin e Kroacisë.

⁷³Për më tepër lexo analizen e M. K. R. Weinstein, *l'Europe fille de la France*, journal La croix, 27 maj 2005

Tashmë zgjerimi i BE-së është i kushtëzuar nga një problematikë delikate e cila ka të bëjë me atë se deri ku shtrihen kufijtë e Evropës. Dhe në fakt, kjo problematikë është diskutuar veçanërisht nga mbrojtësit e rrymës “anti-zgjerim” përse i përket rastit të Turqisë. Përveç faktit se natyra evropiane e Turqisë paraqet interesa historike, juridike dhe fetare, ajo paraqet edhe çështjen nëse kombet që i përkasin BE-së duan të marrin përsipër rrezikun e transferimit të sovranitetit të tyre, në një kohë kur disa shtete, siç mund të jetë Turqia, nëse aderohet në BE, për shkak edhe të numrit të madh të popullsisë, mund të marrë në dorë drejtimin e BE-së (Oberdorff, 2008:106).

Në qoftë se duam të arrijmë në disa konkluzione lidhur me reagimet e popullsisë evropiane ndaj zgjerimeve të BE-së, mund të themi se këto reagime janë vërtet kontradiktore. Nga njëra anë duket se ato pranojnë që shtetet të mos jenë mbajtëset e vetme të sovranitetit, por edhe BE-ja të ushtrojë ndikimin e vet tek sovraniteti shtetëror, nga ana tjetër, ato nuk duan të heqin dorë nga sovraniteti i tyre. Diçka duhet të jetë e qartë, nëse BE-ja vishet me pushtete shtetërore, kjo është vetëm për shkak se sovranitetet kombëtare, të gjitha sëbashku, kanë pranuar t’i transferojnë BE-së prerogativat e tyre. Në mënyrë të ngjashme, zgjerimi mund të ndodhë vetëm atëherë kur popullsia evropiane është e sigurtë se do të mund të kontrollojë pasojat.

Shembulli francez tregon që shtetet vazhdojnë të mos jenë plotësisht të vetëdijshme për mosbesimin e qytetarëve evropianë në lidhje me procesin e zgjerimit dhe në lidhje me frikën e humbjes së kontrollit mbi ushtrimin e sovranitetit. Kështu, pas dështimit të referendumit lidhur me Projekt-Kushtetutën Evropiane dhe duke besuar me të drejtë apo gabimisht që çështja e hyrjes së Turqisë në BE kishte kushtëzuar votën, qeveritarët preferuan që të sigurojnë qytetarët se Kushtetuta franceze do të kërkojë zhvillimin e referendumit për çdo traktat që parashikonte hyrjen e një shteti të ri në BE (Mortier,

2011:264). Por, në të vërtetë, ky angazhim i qeveritarëve përpara qytetarëve të tyre ishte simbolik dhe lidhja mes Shtetit-Qeveritarëve-Popullsisë ishte veçse një fasadë. Amendamentet e fundit të Kushtetutës franceze, të 23 korrikut 2008, i dhanë fund këtij angazhimi duke mos i dhënë kështu mundësi popullit francez për të luajtur një rol të rëndësishëm në procesin vendimmarrës të zgjerimit⁷⁴.

Në fund të kësaj çështjeje, duhet thënë se, dështimet e njëpasnjëshme të integritetit afirmojnë që ndarja e sovranitetit juridik mes shteteve dhe BE-së është pranuar si nga shtetet ashtu edhe nga qytetarët evropianë. Ndërkohë nuk mund të themi të njëjtën gjë për sovranitetin politik për të cilin thjesht ideja e ndarjes është e vështirë për t'u pranuar nga qytetarët evropianë. Në këto kushte, fragmentimi i sovranitetit politik mund të analizohet vetëm në aspektin e kompetencave sovrane dhe të evoluimit të këtyre të fundit.

Megjithatë, mund të themi se sovraniteti vazhdon të mbetet prerogativë e shtetit dhe e kombit dhe kjo ndodh për dy arsye: e para Bashkimi Evropian ka rezerva lidhur me marrjen përsipër plotësisht të rolit të sovranit në vend të shteteve dhe së dyti, prezenca e vazhdueshme e shteteve në institucionet e BE-së.

5.7. Sovraniteti i shteteve kandidate në fazën e paraanëtarësimit: parashikimet kushtetuese në lidhje me pozicionimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemet e tyre juridike

Mëgjithëse nga doktrina është përcaktuar se BE-ja është një organizëm i veçantë, *sui generis*, i cili me të gjithë autoritetin e tij i imponohet Shteteve anëtare këto të fundit i

⁷⁴Për më tepër shih: Nenin 88-5 i Kushtetutës Franceze

mbetën besnikë deri diku idesë së sovranitetit kombëtar. Themi deri diku sepse si pjesë e këtij sovraniteti është edhe e drejta për të përcaktuar hierarkinë e normave të zbatueshme në territorin përkatës, por fakti i përfshirjes në një organizatë të tillë ndër të tjera përcakton edhe një ngurtësim të këtij sovraniteti për shkak se hierarkia e normave të zbatueshme ndikohet edhe nga e drejta komunitare dhe zbatueshmëria e saj.

Në fakt, duke qenë se jemi ndaluar në çështjen e sovranitetit në periudhën e para-hyrjes në BE dhe për të konstatuar se sovraniteti i shteteve kandidate “preket” edhe në këtë stad është me shumë interes të analizojmë pozitën juridike të Marrëveshjes së Asociimit, marrëveshje e cila ka si palë nga njëra anë Komunitetin Evropian dhe Shtetet e tyre anëtare dhe nga ana tjetër shtetin e asociuar. Me anë të kësaj marrëveshje palët krijojnë një marrëdhënie juridike duke u bazuar në të drejta e detyrime të përcaktuara në të. Disa nga këto dispozita shprehin vullnetin e palëve për të arritur synime të caktuara ndërsa disa të tjera parashikojnë të drejta e detyrime reciproke të palëve në marrëveshje.

Dispozitat e MA-ve janë të ngjashme me ato të traktateve të BE-së dhe për këtë arsye referimi duhet bërë në jurisprudencën e GJED-së për çështjet që ajo ka shprehur efektin e drejtpërdrejtë të këtyre dispozitave⁷⁵. Kështu efektet ligjore të MA-ve në rendin ligjor kombëtar të vendeve që nuk janë Shtete anëtare të BE-së janë të drejtpërdrejta, megjithatë në rradhë të parë varen nga interpretimi që gjyqtarët kombëtarë u bëjnë kushtetutave përkatëse duke i dhënë prioritet zbatimit të neneve të Marrëveshjeve të Asociimit në raport me legjislacionin vendas. Së dyti, efektet ligjore janë në varësi të interpretimit që gjykatat i bëjnë objektivave të dispozitave të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në (Zajmi, 2011:109).

⁷⁵ Çështja Van Gend en Loos nr.26/62 (1963)

Në këtë rast lind pyetja: nëqoftëse MA-ja apo më vonë traktati i aderimit do të ketë ndonjë klauzolë që bie ndesh me kushtetutën e këtyre vendeve cili do të jetë raporti i tyre? Cila e drejtë do të zbatohet në këtë rast? Nga praktika dhe jurisprudenca e GJED-së është theksuar tashmë epërsia e së drejtës komunitare (të legjislacionit parësor e dytësor) ndaj së drejtës të brendshme. Kjo do të thotë se edhe me rastin e integritit të vendeve në BE, ato do të pranojnë mënyren e funksionimit të BE-së si edhe epërsinë e së drejtës komunitare, ndoshta si një nga kushtet e pashprehura për t'u anëtarësuar.

Por cilat janë konkretisht parashikimet që bëjnë Kushtetutat e vendeve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me integritin dhe pozicionin e marrëveshjeve ndërkombëtare në hierarkinë e normave juridike?

- Maqedonia: Në kushtetutën e Maqedonisë përcaktohen disa parime bazë lidhur me asociimin dhe raportin e së drejtës ndërkombëtare ndaj asaj kombëtare. Kështu neni 118 i Kushtetutës parashikon që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas kushtetutës janë pjesë integrale e sistemit të brendshëm ligjor dhe nuk mund të ndryshohen nga ligji. Ndërsa neni 120 parashikon mundësinë e asociimit në bashkime apo komunitete (një rast konkret do të ishte integriti në BE) me shtetet e tjera duke përcaktuar organet që mund të vendosin për një çështje të tillë dhe mënyren se si do të vendosin. Pra edhe kushtetuta maqedonase nuk lejon epërsinë e së drejtës komunitare mbi të drejtën kushtetuese.

- Mali i Zi: Në parimet themelore kushtetuese të Malit të Zi neni 9 parashikon: “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare do të bëhen pjesë integrale e sistemit të brendshëm juridik. Do të kenë supermaci ndaj legjislacionit kombëtar dhe do të zbatohen në mënyrë direkte në rast se kjo marrëveshje dhe ligji kombëtar rregullojnë në mënyrë të ndryshme një çështje të caktuar”. Pra mbetemi sërish në momentin që është garantuar epërsia e së drejtës

ndërkombëtare mbi legjislacionin kombëtar por jo mbi kushtetutën. Kjo çështje mbetet për t'u diskutuar pasi edhe vetë gjykata kushtetuese e Malit të Zi nuk është shprehur në lidhje me një çështje të tillë.

- Serbia: Edhe kushtetuta serbe parashikon detyrimin për të respektuar të drejtën ndërkombëtare si edhe bërjen pjesë të vetë sistemit të brendshëm juridik të marrëveshjeve të ratifikuara sipas legjislacionit. Neni 194 i kësaj kushtetute përcakton hierarkinë e normave të zbatueshme dhe në majë të kësaj piramide është kushtetuta serbe më pas e drejta ndërkombëtare dhe ligjet.

- Kosova: Në kushtetutën e saj Kosova ka përcaktuar mënyrën e funksionimit të shtetit të ri. Marrëveshjet ndërkombëtare rregullohen nga dispozitat 16-19 të saj. Kështu neni 16 sanksionon epërsinë e kushtetutës ndaj të gjitha akteve të tjera juridike si edhe parimin se Kosova respekton të drejtën ndërkombëtare. Në nenin 17 është theksuar mundësia e lidhjes së marrëveshjeve me qëllim anëtaresimin në organizata ndërkombëtare. Megjithëse marrëveshjet e tilla bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç rasteve kur nuk janë të vetzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji (neni 19/1). Më pas theksohet epërsia e marrëveshjeve ndaj ligjeve kombëtare.

5.7.1. Sovraniteti në kuadrin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Procesi i integrimit evropian të Shqipërisë, ka parashtruar një sërë aspektesh dhe tendencash të reja, të cilat lidhen ngushtësisht me një kuptim bashkëkohor të parimit të sovranitetit shtetëror. Ky proces ka gjetur pasqyrim edhe në tekstin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila ka afirmuar klauzola të rëndësishme që vendosin parimet

bazë, për përgatitjen dhe legjitimimin e integritit të Shqipërisë në aleancat ndërkombëtare. Ato parashikojnë një shtet të së drejtës që respekton të drejtën ndërkombëtare dhe u kanë dhënë akteve ndërkombëtare të ratifikuara, fuqi mbiligjore; sigurojnë një shtet sovran që aderon në organizatat ndërkombëtare, u delegon atyre kompetenca shtetërore për çështje të veçanta, si dhe mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, me qëllim ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtarë. Duhet theksuar se, Kushtetuta e vitit 1998, në Shqipëri, ishte ndër kushtetutat e para në Evropë që sanksionoi dispozita të vlefshme për procesin e integritit (Zaganjori & Anastasi & Çani, 2011:59-60).

Nëse analizojmë sistemin normativ në Kushtetutë, vërejmë një tendencë të dukshme të trupëzimit të normave ndërkombëtare në të drejtën e brendshme të vendit, duke krijuar dy sisteme të ndryshme të raportit të normave. Sistemi i parë, rregullon raportin e akteve të brendshme me normat klasike të së drejtës Ndërkombëtare Publike, kurse i dyti, rregullon marrëdhëniet që krijohen midis normave të brendshme, me normat e organizatave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria aderon me marrëveshje të posaçme (Zaganjori & Anastasi & Çani, 2011:60).

Në rastin e parë, raporti midis marrëveshjeve ndërkombëtare që ratifikohen me ligj nga Republika e Shqipërisë me normat e brendshme, bazohet në dy parime themelore: *së pari*, në parimin e zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara (me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji); *së dyti*, në parimin e epërsisë së marrëveshjeve ndërkombëtare mbi ligjet e vendit, në rast konflikti midis tyre⁷⁶.

Sistemi i dytë i normave, paraqet disa veçori të cilat e ndryshojnë nga sistemi i sipërpërmendur. Këto parime, Kushtetuta i ka vendosur posaçërisht, për ratifikimin e

⁷⁶ Neni 122/1,2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

marrëveshjeve për aderimin e Shqipërisë në organizata ndërkombëtare. Edhe këtu afirmohen parimet e sipërpërmendura siç është ai i zbatimit të drejtpërdrejtë të normave të nxjerra prej kësaj organizate, kur kjo parashikohet shprehimisht në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë. Por, përpos këtij, parimi i epërsisë së normave të organizatës ndërkombëtare, shtrihet jo thjesht mbi ligjet e brendshme në kuptimin formal të fjalës, por mbi të gjithë “*të drejtën e vendit*”. Nga ana tjetër, parashikohet parimi i delegimit të kompetencave shtetërore për çështje të caktuara, në bazë të marrëveshjes. Kështu, parimi i epërsisë së normave të organizatës ndërkombëtare mbi “*të drejtën*” e vendit, është i dallueshëm nga epërsia e marrëveshjeve të ratifikuara në kuadrin e së drejtës klasike Ndërkombëtare Publike, të cilat *expressis verbis* kanë një epërsi vetëm mbi “*ligjet*” e vendit. Në gjuhën shqipe, e drejta e vendit përfshin të gjitha normat e brendshme, përfshirë edhe Kushtetutën e Shqipërisë, prandaj është e kuptueshme një epërsi e tyre edhe mbi vetë Kushtetutën dhe jo vetëm mbi ligjet e brendshme. Natyrisht, kjo “*klauzolë e epërsisë*” zbatohet për normat e organizatave ndërkombëtare, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në to, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj. Edhe pse Kushtetuta nuk i është adresuar në mënyrë të shprehur drejtpërdrejt Bashkimit Evropian dhe të drejtës Komunitare, dallohet qartë marrëdhënia e veçantë që ajo krijon me këtë të fundit (neni 122/3 i Kushtetutës). Pra, në rastin e aderimit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, me vullnetin e popullit të shprehur përmes përfaqësuesve të tij, kryhet bartja e sovranitetit të shtetit, në mënyrë të pjesshme, për çështje të caktuara, përmes delegimit të kompetencave shtetërore. Nuk ka dyshim, se në këtë rast kemi të bëjmë jo vetëm me kufizimin e sovranitetit të shtetit (aspekti i jashtëm), por edhe me kufizimin e sovranitetit të popullit (aspekti i brendshëm) (Zaganjori & Anastasi & Çani, 2011:61). Siç shprehej dhe Lloha: “Sovraniteti nuk është tashmë një vlerë që konsiderohet pa asnjë diskutim dhe

pakushte, si vlera më e lartë, duke qenë se në fusha të caktuara, është i detyruar t'i hapë rrugë vullnetit të opinionit ndërkombëtar, të artikuluar nga organizatat ndërkombëtare”⁷⁷.

Edhe pse parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare është i pranishëm në të dyja rastet, si në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ashtu edhe në marrëveshjet ndërkombëtare të aderimit, duhet shquar se në cilin moment, do të fillojë zbatimi i drejtpërdrejtë i normave ndërkombëtare. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare klasike, theksojmë se ato ratifikohen në bazë të procedurave kushtetuese dhe bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik, pasi botohen në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë.⁷⁰ Kurse, normat e nxjerra nga organizatat ndërkombëtare në të cilat aderon Republika e Shqipërisë, pas marrëveshjes së aderimit, do të zbatohen drejtpërdrejt, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e aderimit (Zaganjori & Anastasi & Çani, 2011:62).

Konkretisht, raporti midis dispozitave të traktateve të Bashkimit Evropian dhe të drejtës sonë kombëtare, do të karakterizohet nga nënshkrimi i këtyre traktateve dhe ratifikimi i tyre nga Parlamenti kombëtar (nga ratifikimi nga referendumi popullor, nëse Kuvendi vendos të kalohet në referendum). Kështu, e drejta parësore e Bashkimit Evropian do të bëhet pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe do të zbatohet drejtpërdrejt. Kurse, zbatimi i të drejtës së prejardhur të Bashkimit Evropian, vendoset pikërisht nga e drejta parësore, sikurse është interpretuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Kjo jurisprudencë ka theksuar shprehimisht që, legjislatori i shteteve duhet të shfuqizojë dispozitat që vijnë në kundërshtim merendin juridik të Bashkimit Evropian, me qëllim që të garantojë parimin e sigurisë juridike⁷⁸. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka theksuar se, në rast konflikti midis një dispozite të së drejtës së vendit, me një dispozitë të së drejtës së Bashkimit Evropian, kjo e fundit ka epërsi, pavarësisht nga natyra e dispozitës së

⁷⁷ Lloha E., *Konceptii sovranitetit dhe pasqyrimi i tij në Kushtetutën e Kosovës*, Nr.4, mars, 2010

⁷⁸ Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Komisioni kundër Francës, nr.167/73, dt.4.4.1974

brendshme⁷⁹. Ajo saktëson gjithashtu se, gjyqtari i gjykatave kombëtare duhet të zbatojë të drejtëne Bashkimit Evropian, në të gjitha rastet⁸⁰.

Kushtetuta është angazhuar të përcaktojë edhe procedurat që duhet të ndiqen për miratimin e marrëveshjeve të aderimit të Shqipërisë në këto organizata, e cila është një procedurë e dallueshme nga ratifikimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Ratifikimi i tyre bëhet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe ky i fundit, mund të vendosë që ratifikimi të bëhet me Referendum⁸¹. Të bën përshtypje fakti që kjo procedurë e parashikuar është e veçantë, por jo shumë e përforcuar. Shumica absolute që kërkohet, mbetet e ulët, po të mbajmë parasysh që një shumicë e njëjtë mund të zbatohet edhe për ratifikimin e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare⁸², si dhe po të mbajmë parasysh se, këto marrëveshje janë nënshkruar në disa nga vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian me shumicë të cilësuar. Në mjaft prej këtyre vendeve, parashikohet shumicë e njëjtë me atë që kërkohet për amendamentet kushtetuese (Zaganjori & Anastasi, Çani, 2011:63).

Në Shqipëri, nuk është menduar asnjëherë se si do të procedohet për referendumin, nëse Kuvendi vendos që ratifikimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare në bazë të së cilës Republika e Shqipërisë u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara, të bëhet me referendum. Këtë e them pasi deri më sot, në Kodin Zgjedhor nuk ka pasur asnjë dispozitë që të parashikojë rregulla për kryerjen e referendunit në këto raste, ndërkohë që rregullohet procedura e tyre në të gjitha rastet e tjera. Ky lehtësim i procedurave të aderimit dhe kjo mosvëmendje për rregullimin teknik të tyre, mund të shpjgohet me opinionin publik pro-europianist që ka ekzistuar dhe ekziston në

⁷⁹ Vendimi i GJED: Komisioni kundër Italisë, nr.48/71. Dt.13.7.1972

⁸⁰ Vendimi i GJED: Factortame, nr.213/89, dt.19.6.1990

⁸¹ Neni 123/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁸² Neni 121/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Shqipëri, që pas vitit 1990. Sidoqoftë, nuk bëhet fjalë për një shpjegim shterues, porë që edhe Kosovës, nuk i ka munguar asnjëherë kjo mbështetje e proceseve të integritit e megjithatë, ka parashikuar një shumicë të cilësuar për miratimin e aderimit (Zaganjori & Anastasi, Çani, 2011:63).

Parlamenti i Republikës së Shqipërisë ka ratifikuar me 27/06/2006 “Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre anëtare” e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2009⁸³. Në këtë mënyrë ajo është bërë pjesë e sistemit të brendshëm të normave sipas nenit 122 të Kushtetutës. Kjo marrëveshje, në hierarkinë e akteve me fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sipas rregullimeve të bëra nga neni 116, ka epërsi ndaj ligjeve kombëtare dhe në këtë mënyrë nuk mund të ketë vend për konfuzion në zbatimin e kësaj marrëveshje në rast përplasje me ligjet kombëtare. Problemi do të shtrohej në rast se kjo marrëveshje apo më pas edhe traktati i anëtarësimit në BE do të kishin përplasje me kushtetutën . Në këtë rast do të shtrohej pyetja se a do të hiqte dorë Shqipëria nga hierarkia e normave të parashikuara nga neni 116 dhe a do të vendoste në majë të saj jo më kushtetutën por të drejtën komunitare? A mundet që sipas parashikimeve kushtetuese të zbatohet e drejta komunitare edhe mbi kushtetutën tonë pa u bërë pjesë e saj sipas procedurave të anëtarësimit? Zgjidhja do të mund të jepet nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në momentin që ajo sipas nenit 131/b të shprehet mbi pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombetare (në rastin tonë për traktatin e aderimit në BE) me kushtetutën para ratifikimit të tij.

MSA-ja duke qënë se është instrumenti kryesor i PSA-së, proces i cili synon të ndihmojë në integrimin e vendit në BE, është guri i themelit edhe për të ashtuquajturat nga doktrina si

⁸³ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare. Ratifikuar nga shteti shqiptar me Ligjin Nr.9590, datë 27.07.2006 dhe hyri në fuqi në vitin 2009.

klauzola të integritetit. Bëhet fjalë për formulat specifike të parashikuara nga Kushtetuta e Shqipërisë, të cilat lidhen me pjesëmarrjen e saj në organizata supra-kombëtare. Formula e parë kishte të bënte me epërsinë e normave të kësaj organizate mbi të drejtën e vendit (neni 122/3) ndërsa formula e dytë parashikon transferimin e pushtetit tek një organizatë ndërkombëtare (neni 123). Të dyja këto formula përbëjnë një bazë të rëndësishme kushtetuese për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një organizatë ndërkombëtare, në vijim të vullnetit të saj të shprehur në marrëveshjet e arritura me këto organizata. Deri më sot nuk është bërë e mundur të kemi ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të këtij lloji, por nga interpretimi gjuhësor i nenit 122/3 dhe nga krahasimi i saj me dispozitat e tjera, arrijmë në konkluzionin se këtu nuk është fjala vetëm për epërsinë mbiligjore të akteve të nxjerra nga kjo organizatë ndërkombëtare për të cilën flet kushtetuta jonë. Kjo dispozitë parashikon një epërsi të normave të organizatës mbi të gjithë korpusin e së drejtës së brendshme të vendit, pra edhe mbi vetë kushtetutën. Sidoqoftë, ajo dispozitë mbetet disi e paqartë për sa kohë nuk është zbatuar në praktikë dhe përsa kohë nuk ka ndonjë interpretim nga Gjykata Kushtetuese. I paqartë mbetet edhe interpretimi i saj në lidhje me nenin 123 të Kushtetutës⁸⁴. Prandaj, jemi të mendimit, njësoj me studiuesin Kellermann, që referencat për efektet dhe statusin e legjislacionit të BE-së në sistemin ligjor shqiptar duhet të shtohen në Kushtetutë së bashku me bazat ligjore për anëtarësimin në BE⁸⁵.

⁸⁴ “Internacionalizimi i të drejtës Kushtetuese. Klauzolat Kushtetuese të integritetit të Shqipërisë”. Revista, Polis, Nr. 4, 2007

⁸⁵ Shih: Alfred Kellermann, “*Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë*”, botuar në revistën: “E drejta parlamentare dhe politikë ligjore”, nr.1, viti 2007

Ndarja e sovranitetit, që mund të dukej absurde po t'i referohemi përkufizimit tradicional të sovranitetit, sot po merr formë në kuadrin e një realiteti të ri evropian. Siç e pamë edhe në këtë kapitull sovraniteti shtetëror “zhvishet” nga disa elementë të kuptimit të tij tradicional, për shkak të procesit të transferimit të kompetencave sovrane nga Shtetet anëtare drejt strukturave të BE-së, për shkak të zhvillimit të politikave komunitare apo edhe të integritetit dhe të pozicionimit në pozita dominuese të së drejtës komunitare në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare.

Në fund, duhet të theksojmë se Bashkimi Evropian përveç se përbën një kërcënim për sovranitetin shtetëror të Shteteve anëtare, ai ushtron impakt të drejtpërdrejtë edhe në sistemet juridike të shteteve në fazën e paraanëtarësimit të tyre nëpërmjet Marrëveshjeve të Asocimit.

KAPITULLI VI - BASHKIMI EVROPIAN: NJË PUSHTET SOVRAN EMBRIONAR?

Hyrje

Ndikimi i Bashkimit Evropian në sovranitetin e Shteteve anëtare është lehtësisht i dukshëm. Megjithatë, edhe pse koncepti absolut i sovranitetit nuk mund të vazhdojë të mbijetojë për shkak të evolucionit të Bashkimit Evropian, mund të themi që veçantia e pushtetit shtetëror, si rrjedhojë edhe e pushtetit sovran të shtetit, nuk suprimohet nga BE-ja por përballë një realiteti të ri evropian koncepti i sovranitetit shtetëror duhet të ripërcaktohet.

Në fakt, Bashkimi Evropian pavarësisht ndikimeve që ushtron mbi pushtetin sovran të Shteteve anëtare, ai gjithsesi nuk është në gjendje që të zëvendësojë përfundimisht shtetet. Kështu BE-ja mbetet në një rrugë të ndërmjetme mes organizatës ndërkombëtare dhe shtetit ku kompetencat që tradicionalisht i janë besuar shtetit nuk mund të ushtrohen nga organet e BE-së.

Struktura ndërshtetërore nuk funksionon më në Bashkimin Evropian por gjithsesi ajo mbetet në sfond, ndërkohë që më e paqartë mbetet natyra ligjore e BE-së, ku personaliteti i saj juridik është afirmuar vetëm kohët e fundit me Traktatin e Lisbonës.

6.1. Ruajtja e sovranitetit politik të shtetit

Arsyeja pse shtetet vazhdojnë të ruajnë sovranitetin e tyre politik është sepse Bashkimi Evropian heziton të ndikojë drejtpërsëdrejti në sovranitetin politik të Shteteve anëtare. Më konkretisht, ky sovranitetit ruhet nga Shtetet anëtare sepse BE-ja nuk ka mjetet e duhura institucionale dhe demokratike që të mund të zëvendësojë shtetet dhe duke qënë e frikësuar

nga rilindja e kombeve, ajo mban një rezervë që e pengon të kërcënojë sovranitetin e shteteve. Nëse shtetet nuk janë tërësisht të privuar nga sovraniteti i tyre kjo ndodh për shkak se BE-ja refuzon të përdorë të gjitha prerogativat në dispozicion të saj dhe për shkak se struktura e saj institucionale, me gjurmë ndërshtetërore, nuk e lejon atë të marrë përsipër plotësisht rolin e sovranit. Veçanërisht, në organizimin institucional ndërkombëtar dhe evropian, shteti mbetet aktori qendror dhe i vetëm në marrëdhëniet e krijuara në nivele të tilla.

6.1.1. Ruajtja e sovranitetit të shtetit falë vetëkufizimit të BE-së

Deri më tani fushat, simbol i sovranitetit, janë ruajtur gjithmonë. Vetëm kompetencat në fushën monetare u transferuan, për shkaqe të rendit praktik dhe ekonomik, siç e kemi trajtuar më përpara në këtë punim. Fushat e policisë, të drejtësisë, të ushtrisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare janë tregues të një bashkëpunimi të mirë midis Shteteve anëtare. Ndërkohë Bashkimi Evropian refuzon që të marrë përsipër këto fusha duke evituar në këtë mënyrë një cënim të qartë të sovranitetit të shteteve (Mortier, 2011:265).

Përsa i përket kompetencave të brendshme sovrane, duke iu referuar veçanërisht bashkëpunimit në fushën e policisë dhe të drejtësisë, shtetet nuk janë plotësisht sovrane, pasi tashmë është sinjalizuar se bashkëpunimi në këto fusha po shkon drejt komunitarizimit të pjesshëm. Megjithatë, Bashkimi Evropian nuk e përdor këtë pushtet sepse në këtë fushë ai varet krejtësisht nga strukturat shtetërore. Pamjaftueshmëria operationale e BE-së në fushën e policisë dhe të drejtësisë e detyron atë të ketë rezerva lidhur me pretendimet e tij mbi sovranitetin e shteteve dhe të pranojë që Shtetet anëtare të ushtrojnë, pjesërisht, kompetenca sovrane (Mortier, 2011:266).

Po ashtu, në çështjet fiskale, Bashkimi Evropian është i limituar për shkak të parimit të unanimitetit që e pengon atë të pretendojë për një sovranitet të vërtetë. Buxheti i BE-së varet nga pjesëmarrja e Shteteve anëtare dhe nga kapacitetet financiare që këto të fundit dëshirojnë t'ia atribuojnë BE-së. BE-ja është kështu e varur ndaj Shteteve anëtare duke qënë se ajo nuk përfiton nga taksat e veta që do e lejonin atë të subvenciononte misionet dhe nevojat e saj. Në këtë kuptim, sovraniteti politik mbetet tek Shtetet anëtare meqënëse BE-ja nuk ka pushtet për të rritur taksat, prerogativë kjo themelore sovrane e shteteve (Mortier, 2011:266).

Përsa i përket taksave kombëtare, Shtetet anëtare janë krejtësisht të lira për të zbatuar sistemin e taksave që atyre iu duket më i përshtatshëm. Çështjet fiskale, të cilat i nënshtrohen unanimitetit të Shteteve anëtare në rast modifikimi, në të vërtetë, nuk janë të harmonizuara. Vetëm TVSH-ja, për arsye të konkurrencës tregtare dhe të lëvizjes së lirë të mallrave mbetet e fiksuar në një masë të madhe nga BE-ja, e cili ka një influencë të rëndësishme tek Shtetet anëtare.

Ndërkohë, transferimi i kompetencave monetare është krejtësisht i sukseshëm duke qënë se BE-ja disponon një organizim funksional lidhur me çështjen në fjalë, që është BQE-ja, e cila menaxhon efektivisht kompetencat monetare, qoftë teorikisht, qoftë në praktikë. Ky transferim kompetencash është një ndër manifestimet e pastra të një privimi real të Shteteve anëtare nga sovraniteti i tyre politik (Mortier, 2011:267).

Me ekzistencën e BE-së sovraniteti i shteteve duhet të ndahet por ky sovranitet vazhdon të ekzistojë tek shtetet kjo pasi BE-ja nuk ka kapacitetet e veta institucionale për të zbatuar kompetencat sovrane. I njëjti konstatim qëndron edhe në planin e kompetencave të jashtme. Në këtë pikë, autonomia e Bashkimit Evropian në raport me Shtetet anëtare është gjithashtu

e limituar sepse kompetencat në këto fusha, veçanërisht ato në lidhje me politiken e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, tregojnë në mënyrë të përgjithshme kompetencat e Shteteve anëtare. Në të vërtetë, është Këshilli Evropian, pra Shtetet anëtare, ato që përcaktojnë orientimet e përgjithshme të PJSP⁸⁶, duke përfshirë këtu edhe çështjet me implikime ushtarake ose strategjike⁸⁷. Në të shumtën e kohës, Këshilli është përgjegjës për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërsa Komisioni nuk ka pushtet vendimmarrës në këtë fushë.

Përveç kësaj, në fushën e politikës së jashtme, zbatimi i vendimeve të BE-së është gjerësisht në varësi të vullnetit të shteteve dhe të mjeteve që ato vënë në dispozicion për zbatimin e këtyre vendimeve. Në fakt, Bashkimi Evropian duhet të përdorë burimet diplomatike dhe ushtarake të Shteteve anëtare për të siguruar zbatimin e këtyre vendimeve (Mortier, 2011:268).

Implikimet e Traktatit të Lisbonës dhe veçanërisht ato të politikës së re të përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes⁸⁸ janë ende të vështira për t'u përcaktuar. Në të vërtetë, politika evropiane e mbrojtjes është ende në hapat e saj të parë dhe si rrjedhojë BE-ja nuk mund të pretendojë të ketë sovranitet në këtë pikë. Kështu, Shtetet anëtare ruajnë një pjesë të rëndësishme të pushtetit të tyre meqënëse ato mbajnë gjithmonë mjetet ushtarake. Megjithatë mund të themi që, funksionimi i Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes mund të sfidojë këtë pozicion dominues të shteteve. Traktati i Lisbonës avancoi ndjeshëm lidhur me këtë fushë, sidomos me parashikimin e Agjencisë së Mbrojtjes⁸⁹, por transferimi i sovranitetit nuk është kryer akoma pavarësisht presioneve ekonomike dhe botërore

⁸⁶Shih nenin 22 të Traktatit të Lisbonës

⁸⁷Shih nenin 22 të Traktatit të Lisbonës

⁸⁸Shih neni 42 i TBE, versioni i T.Lisbonës

⁸⁹Shih neni 42-46 i TBE, versioni i T.Lisbonës

(Mortier, 2011:268). Zhvillimi i një politike të mbrojtjes, nëse do të zbatohet në të ardhmen, do të përfshijë dy orientime të mëdha: së pari përpunimin dhe aplikimin e një strategjie të përbashkët të mbrojtjes dhe së dyti bashkimin e mjeteve për të bërë të mundur zbatimin e kësaj strategjie (Irondelle, 2008:125). Megjithatë, duhet thënë që në këtë pikë, përparimi i Traktatit të Lisbonës është më shumë potencial se sa realitet.

Në lidhje me këto çështje, zona e veprimit të Bashkimit Evropian është edhe më e kufizuar sepse ajo nuk ka, në shumicën e rasteve, mbështetjen e zakonshme të GJED-së, pasi kontrolli juridik nuk shtrin efektet e tij në këto fusha. Po ashtu edhe Parlamenti Evropian nuk mund të mbështesë BE-në pasi ai thjesht është konsultuar duke mos pasur të drejtën për të diskutuar⁹⁰.

Megjithatë vlen të thuhet që, traktatet e fundit të BE-së i ofrojnë këtij të fundit më shumë burime për të konkurruar me Shtetet anëtare duke përfshirë madje edhe ato fusha tipike tradicionale sovrane. Sovraniteti politik deri më tani i mbrojtur, mundet të humbasë ekuilibrin dhe të ushtrohet jo vetëm nga shtetet por edhe nga Bashkimi Evropian. Ky i fundit atëherë mund të tentojë t'i imponojë Shteteve anëtare një organizatë funksionale e aftë për të ushtruar plotësisht sovranitetin në dëm të shteteve. Por, nga ana tjetër, duhet thënë që edhe në qoftë se Traktati i Lisbonës avancohet ndjeshëm në favor të BE-së, nuk është e sigurtë që ky i fundit zyrtarisht do të zgjerojë kompetencat e tij. Në të vërtetë, qëndrimi i shteteve gjatë procesit të përpunimit të Traktatit të Lisbonës dhe dëshira e tyre për t'i hequr këtij traktati çdo element që i jepte atij karakter kushtetues janë tregues se sovraniteti i BE-së nuk është akoma gati për t'u zbatuar. Mund të themi si përfundim se ndarja e sovranitetit nuk duket se paraqet vështirësi të mëdha për shtetet për aq kohë sa kjo ndarje vazhdon të mos jetë e dukshme (Simon, 2008:32).

⁹⁰Shih nenet 3 dhe 6 të TFBE-së

Nisur nga ky konstatim, mund të thuhet që, në të gjitha rastet ka ndarje të sovranitetit por kjo ndarje nuk ndodh sipas të njëjtave kushte. Në mënyrë paradoksale, ndarja e sovranitetit politik në kuptimin e aftësisë për të kontrolluar tërësisht kompetencat sovrane bëhet në dobi të Shteteve anëtare, në kundërshtim me sovranitetin juridik i cili gjithnjë e më shumë ka tendencën që t'i përkasë BE-së.

6.1.2. Defiçiti demokratik: një faktor kryesor në kufizimin e pushteteve të BE-së

Legjitimiteti demokratik i vendimmarrjes brenda Bashkimit Evropian është debatuar prej kohësh nga institucionet kombëtare dhe ato komunitare si dhe nga literatura akademike. Këto debate kanë nxjerr në pah një problematikë të rëndësishme në lidhje me legjitimitetin demokratik të Parlamentit Evropian, që është defiçiti demokratik.

Në Parlamentin Evropian, çdo shtet ka deputetët e tij por dimensionin politik i PE-së shpesh suprimon dallimet kombëtare në favor të një logjike të partive, jo gjithmonë e përcaktuar qartë, në atë pikë që Shtetet anëtare nuk mund të besojnë seriozisht tek eurodeputetët e tyre për të mbrojtur sovranitetin e tyre.

Koncepti i evropianëve në lidhje me Parlamentin nganjëherë është negativ për shkak të natyrës së tij të largët dhe të paafësisë së tij për të sqaruar çështjet e procesit të zgjerimit, proces i cili është, në fund të fundit, burim shqetësimi për anëtarët e BE-së. Kjo është arsyeja pse PE nuk është një mbështetje e vërtetë e Bashkimit Evropian për të bërë të mundur privimin e shteteve nga sovraniteti i tyre. Kështu, dobësimi i legjitimitetit të Parlamentit Evropian është pjesërisht për shkak të brishtësisë së përfaqësimit të saj, por mbi të gjitha kjo vjen nga mosinteresimi i thellë i qytetarëve ndaj asamblesë së tyre. PE nuk

informon mbi çështjet evropiane ose e bën atë jo ashtu siç duhet dhe kjo mënyrë e të vepruarit ka larguar gjithnjë e më tepër popullsinë e Shteteve anëtare nga PE-ja.

Një tjetër kritikë mbi vendimmarrjen në BE është se ajo nuk reagon ndaj “shtysave demokratike”. Një nga tiparet themelore të regjimeve demokratike është se votuesit mund ta ndryshojnë qeverinë. Kjo nuk është e mundur brenda Bashkimit Evropian (Craig & De Burca, 2013:283).

Një tipar tjetër i argumentit mbi defiçitin e demokracisë lidhet me dominimin e ekzekutivit në kurriz të parlamenteve kombëtare. Po ashtu vlen të përmendet aspekti i brendshëm i demokracisë. Parlamenti vuan nga shkëputja midis pushtetit dhe llogaridhënies elektorale, e cila përbën një element të rëndësishëm të kritikës ndaj defiçitit demokratik të Bashkimit Evropian (Craig & De Burca, 2013:285).

Nëse Parlamenti Evropian dëshiron vërtet të reduktojë defiçitin demokratik të institucioneve evropiane, ai duhet fillimisht të vendosë kontakte me evropianët që të mund të kërkojë më vonë edhe një evolucion të kompetencave të tij. Për të siguruar këtë, PE duhet të gjejë mënyra të reja për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve evropianë dhe t’iu rikthejë atyre dëshirën për të marrë pjesë në strukturat komunitare evropiane nëpërmjet asamblesë. Duke u mbështetur më së shumti tek anëtarët e tij, Parlamenti Evropian mund të jetë në gjendje të afrohet me qytetarët evropianë meqënëse ato do të kenë më shumë akses lidhur me aktivitetet e BE-së (Mortier, 2011:270).

Pikërisht kjo dobësi e PE-së përbën një ndër faktorët kryesorë të kufizimit të pushteteve të BE-së në raport me shtetet dhe veçanërisht për shkak të mungesës së lidhjes mes qytetarëve dhe Parlamentit Evropian bëhet i mundur “minimi” i legjitimitetit të tij. Përsa kohë që do të ekzistojë një distancë legjitime mes qytetarëve dhe PE-së, kombet evropiane nuk mund t’ia

besojnë fatin e tyre deputetëve evropianë, duke preferuar të përdorin Këshillin ose të ndërhyjnë në mënyrë direkte, me referendum, kur iu jepet mundësia.

6.2. Struktura ndërshtetërore e BE-së: Shtetet gjithmonë në sfond

Analiza e institucioneve të Bashkimit Evropian vë në dukje një kundërthënie juridike që na shpie drejt konstatimit që BE-ja është në një vijë të ndërmjetme mes organizatës ndërkombëtare dhe shtetit. Nga një krahasim që i bëhet institucioneve të BE-së del në pah ky karakter i dyfishtë duke qënë se disa institucione, me kompetencat që i janë atribuar, i japin këtij organizmi karakteristikat e një shteti, ndërkohë që ka institucione të tjera që me kompetencat që ushtrojnë i japin BE-së karakteristikat e një strukture të integruar.

Sipas karakterit ndërshtetëror, Këshilli Evropian dhe Këshilli i BE-së mund të shërbejnë si shembuj, meqënëse janë organe vendimmarrëse ku Shtetet anëtare ushtrojnë të drejtën e votës. Në fakt, këto organe përbëhen nga krerët e shteteve ose krerët e qeverive të çdo Shteti anëtar, njësoj siç ndodh në një organizatë klasike ndërkombëtare. Megjithatë, duhet theksuar fakti që Këshilli i BE-së tregon tashmë një karakter specifik të bashkësisë evropiane meqënëse çdo shtet e ushtron influencën e tij në varësi të madhësisë së tij demografike⁹¹.

Përkundrazi, institucionet si GJED-ja, ndërkohë, mbrojnë një karakter të integruar të Bashkimit Evropian. GJED-ja është e shkëputur nga çdo organizim shtetëror ku gjykatësit padyshim që kanë një shtetësi, por ajo qëndron e fshehur prapa funksionit të gjyqtarit komunitar.

⁹¹Për më tepër shih: P. Avgeri & M.-P. Magnillat (dir), enjeux et rouages de l'Europe actuelle, culture et citoyenneté européennes, édition Foucher, 7ème édition, f.. 106 et 107

Institucionet e tjera mbrojnë gjithashtu idenë se BE-ja ka formatin e një organizate të veçantë ndërkombëtare, të tilla si Komisioni apo Parlamenti Evropian. Komisioni ka si qëllim kryesor të tij zbatimin e projekteve të BE-së të përcaktuar nga Traktatet pa pasur në fokus preferencat dhe prioritetet e strukturave kombëtare. Megjithatë, dhe pavarësisht karakterit të tij evropian, Komisioni nuk mund të shkëputet krejtësisht nga struktura shtetërore meqenëse ai vazhdon të përbëhet nga një numër komisionerësh të fiksuar për çdo shtet e përcaktuar kjo nga traktatet suksesive. Kështu neni 17 i TBE-së në versionin e Traktatit të Lisbonës përcaktoi që duke filluar nga 1 nëntori i vitit 2014, numri i komisionerëve do të përbëhet nga dy e treta e Shteteve Anëtare, përveç rasteve kur Këshilli Evropian vendos ta modifikojë këtë numër me anë të unanimitetit. Por aktualisht Komisioni përbëhet nga një komisioner për çdo Shtet anëtar për shkak të një angazhimi që BE ka marrë ndaj Irlandës pas referendumit të saj të dytë në lidhje me Traktatin e Lisbonës. Kështu ne shohim një vazhdimësi të *status quo-së*, me një komisioner për çdo Shtet anëtar (Craig & De Burca, 2012:175).

Në mënyrë të ngjashme, Parlamenti Evropian duket të jetë shembulli unik i bashkëpunimit dhe integritetit brenda një organizate ndërkombëtare, një koncept ky i panjohur më parë. Kjo Asamble, që përfaqëson popujt e Evropës, luan një rol qëndror në komunitetet evropiane, duke qënë se ajo është një vend i privilegjuar për reflektime dhe debate. Megjithatë, numri i deputetëve gjithmonë është përcaktuar duke iu referuar Shteteve anëtare, gjë që të bën të reflektosh se Bashkimi nuk mund të shkëputet nga struktura shtetërore⁹².

⁹²Për më tepër shih: P. Avgeri & M.-P. Magnillat (dir), *enjeux et rouages de l'Europe actuelle, culture et citoyenneté européennes*, édition Foucher, 7ème édition, f. 115

Karakteri shtetëror i institucioneve përforcohet më tej edhe nga procedurat vendimmarrëse brenda Bashkimit pasi Parlamenti Evropian nuk ka të njëjtën peshë si Këshilli në procesin e vendim-marrjes. Në këtë gjendje, kompetencat e dhëna në Parlament janë më shumë në favor të një organizate ndërkombëtare tradicionale, sidomos pasi ky i fundit po vuan nga një deficit demokratik.

Modeli aktual i BE-së është ende shumë larg një modeli federal. Sot askush nuk e di nëse vendet anëtare një ditë do të jenë në gjendje t'i japin Parlamentit Evropian pushtete të konsoliduara, të afta për të organizuar një sfidë për veprimtarinë e Këshillit dhe në këtë mënyrë edhe për vetë shtetet sovraane. Ky evoluim mund të ketë ndikime në natyrën ligjore të Bashkimit dhe në aftësinë e tij për t'u bërë një shtet sovran. Institucionet e tjera ende tregojnë vullnetin e tyre për t'i dhënë BE-së një karakter të integruar. Këtu mund të përmendim Përfaqësuesin e Punëve të Jashtme, në të njëjtën kohë edhe përfaqësues i Komisionit meqënëse ai është Komisioneri për Punë të Jashtme dhe përfaqësues i Këshillit meqënëse ai është Përfaqësuesi i Lartë për PJSB (C. Bluman & L. Dubouis, 2004: 16). Zbatimi i funksioneve të Përfaqësuesit të Lartë është një origjinalitet në Bashkimin Evropian, i cili i jep BE-së një strukturë të hershme shtetërore. Ky organ, i kërkuar nga hartuesit e Kushtetutës për Evropën, u konfirmua me Traktatin e Lisbonës ⁹³, tregues se vullneti i qeverive për t'i dhënë Bashkimit struktura të integruara është gjithmonë i pranishëm, pavarësisht episodeve të referendumeve negative.

Midis karakterit ndërshtetëror dhe karakterit të integruar, institucionet e Bashkimit Evropian mund t'i japin këtij organizmi herë karakteristikat e një superstrukture shtetërore me natyrë federale, herë karakteristikat e një strukture ndërkombëtare klasike.

⁹³Neni 18 i TFBE-së

Kjo dikotomi është konfirmuar nga elementë të tjerë që na lejojnë të themi që BE-ja nuk mund të pretendojë që është krejtësisht e pavarur nga zgjedhjet e shteteve. Kështu, procedura legislative që aplikohet në BE është një tregues i qartë i rolit kolektiv të shteteve. Po ashtu, duhet të theksohet se në arenën ndërkombëtare, Bashkimi Evropian nuk njihet si një Shtet Evropian por si një bashkim shtetesh dhe si rrjedhojë i gjithë pushteti sovran, në sensin politik, i është mohuar këtij të fundit, duke e ruajtur, kështu, Shtetet anëtare ekskluzivitetin e këtij pushteti.

Kjo paaftësi e BE-së për të zëvendësuar Shtetet Anëtare dhe si pasojë për t'i privuar ata nga sovraniteti i tyre është rezultat i natyrës juridike të paqartë të BE-së që nuk e lejon atë të jetë një shtet i vërtetë sipas përcaktimeve të doktrinės juridike.

6.3. Pamundësia e BE-së në zëvendësimin e shteteve

Paaftësia e BE-së për të zëvendësuar shtetet vjen, fillimisht, si rezultat i pasigurisë që ajo kishte në lidhje me personalitetin e saj juridik, por që sot kjo çështje mund të themi që është zgjidhur përfundimisht. Në të vërtetë, beteja e parë e iniciuar nga Bashkimi Evropian në luftën e tij për ndarjen dhe menaxhimin e sovranitetit është ajo e personalitetit juridik (Mortier, 2011:293).

Në traktatet themeluese të BE-së, vetëm komunitetet kishin personalitet juridik, falë të cilit ato mund të nxirrnin norma juridike, mund të lidhnin marrëveshje, mund të rrisnin taksat dhe falë personalitetit juridik atyre iu njëhej ekzistenca e pavarur në arenën ndërkombëtare. Personaliteti juridik i komuniteteve evropiane paraqet tre aspekte: aspekti i parë është pushteti juridik i komuniteteve evropiane në të drejtën e brendshme të Shteteve anëtare,

juridiksioni mbi mosmarrëveshjet të cilat lindin nga operacionet e kryera prej tyre dhe një personalitet juridik në të drejtën ndërkombëtare (Mortier, 2011:276). Këto aspekte të personalitetit juridik të komuniteteve evropiane i jepnin atyre mundësinë që të vepronin si persona juridikë të së drejtës publike, megjithatë kjo nuk do të thotë që komunitetet mund të pretendonin statusin e një shteti duke qënë se ato nuk kishin as një komb dhe as një Kushtetutë.

Bashkimi Evropian, duke qënë se përfshin komunitetet, *a priori* u vesh me personalitet juridik por çuditërisht, Traktati i Maastrichtit, themelues i Bashkimit Evropian, asnjëherë nuk e ka ngritur çështjen e personalitetit juridik të BE-së, në asnjë prej aspekteve të tij (Mortier, 2011:276).

Mosngritja e çështjes së personalitetit në traktatet e BE-së u kuptua si pohim i mungesës së personalitetit juridik të BE-së, qëndrim që u mbajt nga pjesa më e madhe e doktrinarëve të së drejtës ⁹⁴. Mungesa e personalitetit juridik i imponoi BE-së të vepronte vetëm nëpërmjet komuniteteve dhe në kuadrin e shtyllës së dytë dhe të tretë, gjë që mund të dobësonte veprimtarinë e tij pasi kompetencat sovraane të shteteve do t'i nënshtroheshin vetëm bashkëpunimit në kuadrin komunitar.

Megjithatë janë gjetur disa materiale të cilat tregojnë disa mënyra indirekte me anën e të cilave BE-së i është dhënë mundësia për të lidhur marrëveshje. Kështu, kapaciteti juridik i BE-së është krijuar gradualisht me përdorimin e disa prej neneve të Traktatit të KE-së i cili i jepte BE-së mundësinë për të nënshkruar marrëveshje me organizatat ndërkombëtare në fusha të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët ose të Bashkëpunimit policor

⁹⁴Shih: A.-D. Pliakos, la nature juridique de l'Union européenne, RTD eur. 1993, fq. 187. Shih gjithashtu, J. Raux, la capacité internationale de la communauté et de l'Union européenne, juris class Europe, fasc. 2200, n° 29.

dhe gjyqësor në çështjet penale. Mund të përmendim këtu nenet 24 dhe 38 të Traktatit të Amsterdimit dhe të Traktatit të Nicës të cilat i atribuonin BE-së personalitet juridik në disa fusha të caktuara dhe në mënyrë të pavarur nga Komunitetet (Charpentier, 1995:93).

Traktati i Kushtetutës Evropiane i dha fund luftës së BE-së lidhur me personalitetin e tij juridik meqënëse neni I 7 i tij “shkrinte” komunitetet dhe Bashkimin, duke i atribuar këtij të fundit personalitet juridik (Bertrand, 2005:91). Kjo fazë i dha Bashkimit Evropian karakteristikat e një personi juridik të së drejtës ndërkombëtare me kompetenca për të negociuar marrëveshje. Pavarësisht se ky traktat nuk u ratifikua, Traktati i thjeshtësuar, që u ratifikua më vonë, mban të njëjtin qëndrim, pra, që Bashkimi ka tashmë një personalitet juridik të plotë (Constantinesco & Petculescu, 2005:65)⁹⁵. Padiskutim që me zbatimin e Traktatit të Lisbonës, i cili hoqi çdo dyshim në lidhje me personalitetin juridik të BE-së, u shënua një hap i rëndësishëm për BE-në në drejtim të pretendimeve të tij për federalizëm.

Çështja e natyrës juridike të Bashkimit Evropian është një pikë kyçe që ka lidhje të pashmangshme me pranimin e idesë së dhënies së BE-së të një statusi të vërtetë sovran. Në doktrinë, çështja e natyrës juridike të BE-së ka shkaktuar debate pasi ky entitet juridik, i veshur tashmë me personalitetin e vet juridik, qëndron si një objekt i paidentifikuar juridik (Mortier, 2011:277-278).

Fillimisht, debati çoi në një interpretim klasik të kategorive juridike ekzistuese, ku autorët janë përpjekur që BE-në ta paraqesin ose si një organizatë ndërkombëtare, ose si një strukturë të tipit federal. Si fillim, u bënë përpjekje që BE-ja të paraqitej si një organizatë ndërkombëtare, por siç edhe doli në pah, BE-ja ka disa karakteristika që e pengojnë të kategorizohet si një organizatë ndërkombëtare. Mund të përmendim këtu disa nga këto

⁹⁵Shih nenin 47 të TFBE-së

veçori si: përparësia e së drejtës komunitare, ekzistenca e institucioneve të tilla si GJED-ja dhe Komisioni, shpërndarja jo e barabartë e vendeve në institucionet komunitare, zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e së drejtës komunitare, zgjerimi i votimit me shumicë të kualifikuar, zgjerimi i përhershëm i BE-së... (Mortier, 2011:278).

Përballë një realiteti të tillë, autorë të ndryshëm projektuan forma të tjera juridike të tilla si federalizimi ose konfederata, që kishin si qëllim marrjen parasysh të funksionimit specifik të Bashkimit por që në lidhje me sovranitetin, nuk korrespondonin me realitetin pasi Bashkimi nuk mund të jetë i ngjashëm me një shtet sovran. Përkrahësit e federalizmit konstatuan vetëm që BE-ja ishte më shumë një formë para-federalizmi ose një federalizëm i pjesshëm, i cili nuk ka karakteristikat e një shteti federal (Reuter, 1965:208, Piri, 2005:243). Ndërsa krahasimi i BE-së me konfederatën ishte i vështirë sepse së pari duhet të pranojmë që konfederata është një formë autonome dhe specifike e shtetit dhe së dyti, siç edhe e kemi treguar tashmë, ekziston një lidhje e ngushtë mes konfederatës dhe federatës. Po ashtu, u pa e nevojshme që të bëhet krahasimi edhe me nocionin e ri të Shteteve të Bashkimit që u evokua fillimisht me Planin Fouchet. Megjithatë, kjo e fundit ka një karakter të fortë ndërqeveritar që nuk përputhet shumë me realitetin institucional të BE-së.

Pavarësisht krahasimeve hipotetike, duhet thënë që Bashkimi Evropian është një entitet *sui generis* i cili, në qoftë se ka disa prej karakteristikave të një shteti, nuk ka ndërkohë karakteristikat thelbësore të tij, dhe si rrjedhojë BE-ja më shumë i ngjason një organizate ndërkombëtare, ngjashmëri e cila ka shtyrë disa autorë të sugjerojnë që Bashkimi i përket një kategorie juridike mes Konfederatës së shteteve dhe Shtetit Federal (Constantinesco, 2002:115).

Edhe rendet juridike kombëtare kanë tentuar të përcaktojnë natyrën juridike të BE-së nëpërmjet praktikave gjyqësore⁹⁶.

Ndërkohë tekstet përbërëse të së drejtës evropiane qëndrojnë krejtësisht të heshtur dhe nuk shprehen në lidhje me natyrën juridike të BE-së. As Traktati mbi Kushtetutën Evropiane nuk e sqaroi këtë problematikë duke përfshirë në të njëjtën kohë në përmbajtjen e tij nene në favor të integritetit dhe nene të tjera, më të nuancuara, që ishin në favor të shteteve sovrane. Traktati i Lisbonës nuk shkon më tej me trajtimin e kësaj çështjeje edhe pse redaktimi i neneve që i referohet ndarjes së kompetencave i afrohet një modeli federal (Mortier, 2011:279).

Çështja e natyrës juridike të BE-së mund të analizohet edhe nën optikën e vendimeve të dhëna nga GJED-ja. GJED-ja përdor si fillim konceptin e veçantisë së të drejtës komunitare që është i bazuar në Vendimin Van Gend en Loos dhe në Vendimin Costa kundër ENEL, vendime që njohin supremacinë e së drejtës komunitare në rendet e brendshme juridike të shteteve anëtare dhe që i japin komuniteteve dhe Bashkimit karakteristikat e një strukture autonome. Autonomia e rendit ligjor të BE-së është me rëndësi themelore për natyrën e BE-së, sepse është e vetmja garanci që BE-ja të mos humbasë nga forca ose efikasiteti gjatë bashkëveprimit me të drejtën kombëtare dhe se do të zbatohet njëtrajtshëm në mbarë BE-në (Borçardt, 2010:115).

Karakter i paqartë dhe enigmatik i natyrës juridike të Bashkimit, megjithatë të çon drejt një sigurie në lidhje me sovranitetin. BE-ja është, pa dyshim, më shumë se një organizatë ndërkombëtare, që nënkupton se shtetet nuk kanë kontroll të plotë mbi të dhe për rrjedhojë, një pjesë e sovranitetit të shteteve është transferuar tashmë në BE. Në këtë pikë, ne mund të

⁹⁶Për më tepër shih Vendimin “Vabre” të Gjykatës Franceze të Kasacionit, Vendimet Solange I, Solange II dhe Solange III të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.

konstatojmë se Bashkimi Evropian është një organizatë e veçantë, e veshur me kompetenca të natyrës shtetërore, e cila gëzon një përqindje të sovranitetit shtetëror, sidomos juridik, e megjithatë BE-ja nuk është një Shtet dhe nuk ka sovranitet të plotë. Bashkimi Evropian është tashmë një pushtet-fuqi në mes të Shteteve, i cili, nganjëherë, u imponohet atyre por që është ngushtësisht i lidhur me ta. Ky konstatim të çon natyrshëm të pyesësh veten: A është BE i veshur me sovranitet të natyrës juridike shtetërore qoftë edhe në fazën e tij embrionale?

Nëse BE-ja vishet me sovranitet shtetëror, atëherë ajo duhet të justifikojë se përmbush të gjitha kriteret e ekzistencës së një Shteti si, Kombësia, Simbolet Shtetërore dhe Kushtetuta. Në të gjitha këto elementë, Bashkimi Evropian paraqet mangësi, tregues ky i faktit që edhe nëse BE-ja ka sovranitet, qoftë edhe në stadin embrionar të tij, ai nuk mund të absorbojë Shtetet anëtare dhe të bëhet ai vetë – Shtet. Pra ai nuk është krejtësisht sovran, meqënëse i mungojnë karakteristikat e një Shteti. Bashkimi Evropian nuk është i bazuar mbi një kombësi evropiane, në një Kushtetutë dhe në një territor të mirëpërcaktuar. Të gjitha këto të meta të BE-së e pengojnë atë të zëvendësojë shtetet dhe si rrjedhojë e pengojnë atë të ketë sovranitet politik. Në këtë kuptim J. Combacau dhe S. Sur shkruanin: “Bashkimi Evropian është më shumë një organizatë klasike ndërkombëtare se sa një super-Shtet që tenton të shkojë drejt një lloji të veçantë të shoqërisë politike e cila shkon përtej kornizës tradicionale të shtetit, duke mos synuar absorbimin e këtij të fundit”(Combacau & Sur, 2001:705).

6.4. Dobësia e sovranitetit embrionar të Bashkimit Evropian: attribute shtetërore jo të plota

Bashkimi Evropian nuk mund të shkëputet plotësisht nga Shtetet anëtare dhe aq më pak t'i zëvendësojë ato. Vendosja e BE-së në këtë pozicion vjen si rezultat i mungesës së disa

atributeve shtetërore, të cilat i cituam edhe pak më lart. Në të vërtetë, BE-ja nuk bazohet në një Kushtetutë, në një Komb dhe në një territor të mirëpërcaktuar, karakteristika këto ekzistenciale të një Shteti.

6.4.1. Bashkimi Evropian: larg nga Shteti sovran i bazuar tek Kombësia

Bashkimi Evropian nuk mund të pretendojë të jetë një strukturë e pavarur dhe e barabartë me shtetet duke qënë se ai nuk bazohet në një Kombësi evropiane. Për këtë arsye BE-ja nuk gëzon sovranitetin e nevojshëm dhe si rrjedhojë nuk mund ta ushtrojë atë plotësisht. Dhe në të vërtetë, që të ekzistojë një komb, i cili pa diskutim që krijohet me kalimin e kohës dhe me vullnetin e popujve, duhet që qytetarët të jenë të vetëdijshëm që kanë një komunitet me vlera dhe tradita të përbashkëta (Mortier, 2011:281).

Pavarësisht ekzistencës së qytetarisë evropiane, shumë elementë vazhdojnë të lejojnë ndarjen e kombeve brenda BE-së duke penguar kështu krijimin e një kombi evropian. Barriera gjuhësore është ndoshta treguesi më i rendësishëm i diferencës mes popujve dhe mungesës së Kombësisë evropiane. Dallimet kulturore janë një tregues tjetër që ka tendencën për të fituar rendësi në diskrecionin e zgjerimeve. Më konkretisht, shtetet e reja anëtare kanë gjithnjë e më pak pika të përbashkëta historike apo kulturore me shtetet para aderuese. Për të konkluduar këtë logjikë, duhet thënë që kombet janë krijesa të hershme të cilat nuk mund të pushojnë së ekzistuari kaq shpejt, thjesht nga një imponim i procesit juridik. Kombësia evropiane nuk ka një ekzistencë praktike dhe juridike dhe për më tepër, për të krijuar një komb duhet ekzistenca e një jetese të përbashkët e bazuar në vetëdijën për të pasur një fat të përbashkët. Ndërkohë që kjo ide vazhdon të jetë e paqartë mes popujve evropianë. Është fakt që Bashkimi Evropian është i vonë, pak më shumë se gjashtëdhjetë vjet dhe është fakt që ndërtimi i një kombi kërkon ndarjen e vlerave të përbashkëta në një

shtrirje kohore relativisht të gjatë. Kombësia evropiane nuk mund të ndërtohet në një kohë kaq të shkurtër, dhe aq më tepër kur BE-ja vuan nga një e metë e cila lidhet me ekzistencën paraprake të Kombeve Evropiane, mbi të cilat bazohen Shtetet anëtare. Bashkimi Evropian me vështirësi ka zhvilluar qytetarinë evropiane e cila do të jetë një faktor që mund të ndikojë, ndoshta në të ardhmen, në krijimin e një Kombësie evropiane. Por vlen të thuhet që, pavarësisht qytetarisë evropiane, popujt evropianë në të vërtetë nuk janë të vetëdijshëm as për ekzistencën dhe as për dobinë e saj, duke zgjedhur të jenë së pari qytetarë të shtetit të cilit ato i përkasin (Mortier, 2011:281-282).

Për më tepër, Bashkimi Evropian ka vështirësi për të lënë mënjanë krizat dhe konfliktet e dhunshme të së kaluarës edhe pse me kalimin e viteve kjo mangësi është reduktuar. Historia e popujve evropianë është e përbashkët por jo gjithmonë e përjetuar njësoj, gjë që paraqet dukshëm vështirësi për krijimin e një kombi. Ndonjëherë ringjallja e së kaluarës, natyrshëm, nxit disa popuj evropianë që të ruajnë një pjesë të altruizmit që i pengon në krijimin e një Kombësie evropiane (Mink, 2004:45).

Në përfundim, vlen të themi që, karakteri teknokratik për të cilin BE-ja është kritikuar shpesh, nuk favorizon krijimin e një Kombi evropian. Në të vërtetë, institucionet mund të jenë një katalizator i krijimit të kombit, siç kanë qënë për disa shtete në rrjedhën e historisë. Megjithatë në kuadrin e BE-së, institucionet nuk janë mjaftueshëm legjitime sa të arrijnë deri aty sa t'iu imponojnë popujve evropianë të harrojnë krejtësisht institucionet kombëtare dhe ndërgjegjen kombëtare kolektive (Mortier, 2011:282-283).

Kjo mungesë e Kombit evropian peshon dukshëm në pamundësinë e BE-së për të zëvendësuar shtetet pavarësisht të gjitha kompetencave që ka tashmë dhe pavarësisht pozitës veçanërisht të fortë ligjore. Kjo paaftësi për të zëvendësuar shtetet vjen gjithashtu

edhe si rezultat i shenjave dalluese të BE-së, të cilat dallojnë nga ato të shteteve dhe si rezultat i problematikës konstitucionale (Mortier, 2011:283).

6.4.2. Delegimi i pjesshëm i attributeve shtetërore Bashkimit Evropian

Pavarësisht faktit që Bashkimi Evropian posedon disa prej shenjave dalluese të një shteti: flamurin, himnin dhe territorin duhet thënë që, në kontekstin evropian, këto shenja nuk kanë fuqinë për të ndërtuar pushtetin e Bashkimit Evropian dhe për ta shndërruar këtë të fundit në një Shtet sovran.

Përsa i përket territorit duhet të theksojmë se hapësira evropiane nuk është plotësisht e stabilizuar dhe se në çdo rast, ajo ka përjetuar zgjerime të shumta që e kanë bërë të luhatshme. Bashkimi Evropian është ende në ndërtim e sipër dhe vazhdon të marrë në konsideratë territore të reja, gjë që dobëson pak më shumë shanset për të krijuar një Komb evropian të themeluar mbi vlera të përbashkëta. Vlen të përmendim këtu integrimet e njëpasnjëshme, të cilat vazhdojnë të shtrojnë çështjen e legjitimitetit të integritetit të këtij ose të atij shteti. Brenda BE-së, diskutimet në lidhje me aderimet e fundit kanë kontribuar në zhvillimin e dy ideve kryesore, relativisht kontradiktore ku njëri synon të përhapë tezën e forcimit të demokracisë dhe të sigurisë në Evropë dhe tjetri, në të kundërt, synon të justifikojë shkrirjen e vlerave evropiane në një hapësirë gjeografike gjithnjë e më shumë të gjërë dhe ku mënyrat e jetesës, qoftë ekonomike apo kulturore, janë të ndryshme. Megjithatë, siç do e shohim dhe më poshtë, kufizimet dhe kufijtë e BE-së nuk janë solide por janë, gjithnjë e më shumë, pretekste për debate të nxehta mes Shteteve anëtare (Mortier, 2011:283).

Një element tjetër që e pengon Bashkimin Evropian të zëvendësojë shtetet dhe të vishet me attribute të plota shtetërore është ajo që ka të bëjë me çështjen kushtetuese. Refuzimi i Kushtetutës Evropiane e privoi BE-në nga një prej kritereve ekzistenciale të një shteti. Nëse BE-ja do të ratifikonte kushtetutën e vet atëherë mund të flisnim për një transferim real të sovranitetit shtetëror drejt BE-së duke i dhënë ndoshta këtij të fundit edhe statusin e një shteti më vete.

6.5. Kthimi i sovranitetit absolut nëpërmjet “klausolës së tërheqjes”

Sipas Traktateve Komunitare, integrimi i Shteteve anëtare ka ardhur progresivisht. Traktatet nuk e kishin parashikuar mundësinë e tërheqjes së një Shteti anëtar (Valhas, 2005: 1565), gjë e cila paraqiste vërtet vështirësi kur bëhej fjalë për traktatet me kohëzgjatje të papërcaktuar, siç ishte për shembull Traktati themelues i Komuniteteve Evropiane⁹⁷.

Prandaj është shtruar pyetja nëse Shtetet anëtare kanë apo jo mundësi reale për t'u tërhequr nga Bashkimi Evropian dhe nëse po, në çfarë kushtesh? Ky reflektim domosdoshmërisht sjell pasojë tek aftësia e shteteve për të menaxhuar lirisht zgjedhjet e tyre politike. Humbja e kësaj aftësie sjell në të vërtetë pasojë në natyrën e konceptit të sovranitetit, i cili tashmë, në këto kushte, nuk mund të pretendojë të ketë karakter absolut. Nëse shteti nuk ka mundësinë që të lërë organet komunitare, atëherë mund të themi që ai nuk është i lirë për të bërë zgjedhjet e tij politike (Mortier, 2011:246). Lidhur me këtë çështje, doktrina ka ngritur dy hipoteza: atë të tërheqjes së shtetit nga BE-ja me anë të negociatave dhe atë të tërheqjes së shtetit në mënyrë të njëanshme⁹⁸. Në rastin e parë, është pranuar se tërheqja është e

⁹⁷ Vetëm Traktati i KEQÇ kishte një kohëzgjatje 50 vjeçare (neni 97 i traktatit), ndërsa Traktati i KEE dhe EUROATOM-it ishin me afat të pacaktuar.

⁹⁸ Për më tepër shih: J.P.Jacqué “droit institutionnel de l'Union européenne, Dalloz, 2ème édition, f. 14 e në vazhdim

mundur kur të gjitha shtetet kanë dhënë pëlqimin e tyre për këtë veprim. Në rastin e dytë, vlerësohet se kjo tërheqje e njëanshme do të cënonte objektivat e traktatit. Duke u nisur nga fakti që Bashkimi Evropian nuk është konsideruar asnjëherë si një entitet federal, por më shumë si një organizatë e veçantë ndërkombëtare, me patjetër është dashur që të përcaktohej edhe mundësia juridike e shtetit për t'u tërhequr nga BE-ja (Valhas, 2005:156). Megjithatë duket sikur doktrina e vlerëson si të pamundur tërheqjen nga BE-ja duke pasur parasysh strukturën e veçantë juridike të BE-së. Për një kohë të gjatë, ky pozicion ka qënë dominues dhe duke qënë se kjo çështje nuk është shtruar asnjëherë në praktikë, deri në qershor të 2016 me zhvillimin e referendumit në Britaninë e Madhe për daljen e saj nga BE-ja, diskutimi ka mbetur thjesht teorik dhe juridik.

Në vendimin Costa k.ENEL⁹⁹, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, afirmoi që kufizimet e sovranitetit, të lejuara nga shtetet, në favor të Bashkimit Evropian janë përfundimtare (Costantinesco, 1974:236). Ky interpretim i Gjykatës Evropiane, në favor të Komunitetit Evropian, lë hapësirë për të kuptuar që shtetet nuk kishin mundësi për të dalë nga kjo organizatë.

Në çdo rast dhe në mungesë të rregullave të përcaktuara në traktate, përpara Lisbonës, shteti që dëshironte të dilte nga BE-ja do të ndeshej në mënyrë të pashmangshme me vështirësi të konsiderueshme teknike. Kështu, në raste tërheqjeje nga BE-ja do të ishte e nevojshme modifikimi në të njëjtën kohë i traktatit dhe i funksioneve të BE-së, gjë e cila do ishte vërtet delikate pasi këto modifikime kërkonin detyrimisht arritjen e unanimitetit (Mortier, 2011:247).

⁹⁹GJED, Vendimi Costa k/ENEL, 15 korrik 1964

Projekt-Kushtetuta Evropiane ka tentuar të sqarojë situatën e Shteteve anëtare në raport me BE-në. Neni I 60 i saj parashikon një procedurë të tërheqjes vullnetare të shteteve nga BE-ja. Kjo procedurë fillimisht parashikonte që tërheqja nga BE-ja duhet të jetë në përputhje me të drejtën kushtetuese të secilit Shtet anëtar dhe gjithashtu të ndiqet një procedurë që detyron shtetin që dëshiron të largohet nga BE-ja të nënshkruajë një marrëveshje me këtë të fundit (Mortier, 2011:247).

Mundësia e tërheqjes nga Bashkimi Evropian favorizon sovranitetin e shteteve, pasi këto të fundit do të jenë gjithmonë të lirë për të përcaktuar kompetencën e kompetencës së tyre (Mortier, 2011:247). Thënë me fjalë të tjera, parashikimi i mundësisë së tërheqjes mbron sovranitetin e shteteve ose të paktën mbron aftësinë e shteteve për të zgjedhur kompetencat e tyre si në planin politik ashtu edhe në planin juridik.

Megjithatë, ky nen paraqet dy vështirësi të mëdha që pengojnë praktikisht shtetet për t'u tërhequr nga BE-ja. Fillimisht, shteti do të përballlet me Kushtetutën e tij që zakonisht sanksionon idenë e pjesëmarrjes në BE. Kemi rastin e shtetit francez , Kushtetuta e të cilit i jep një status të veçantë BE-së¹⁰⁰. Dëshira për të dalë nga Bashkimi Evropian duhet të jetë në përputhje me nenet e Kushtetutës dhe kërkon formalitete shtesë. Kështu, shteti francez, që të mund të tërhiqet nga BE-ja, përballlet me nevojën e arritjes së një marrëveshjeje në Këshill, me shumicë të cilësuar, që në fakt është e vështirë për t'u arritur, veçanërisht për shtetet e mëdha.

Edhe pse Projekt-Kushtetuta nuk u ratifikua, e drejta e Shteteve anëtare për t'u tërhequr u përfshi edhe në Traktatin e Lisbonës, me të njëjtat kushte siç u përcaktua edhe në Projekt-Kushtetutën Evropiane.

¹⁰⁰Shih: Kushtetuta e Republikës Franceze, neni 88-1

Pavarësisht se kjo e drejtë është e parashikuar në nenin 50 të Traktatit të Lisbonës, duket se në praktikë e ka shumë të vështirë për t'u realizuar. Çdo Shtet anëtar nuk mund të pretendojë lehtësisht të tërhiqet nga institucionet komunitare për sa kohë që kompetencat dhe çështjet financiare të tyre janë të lidhura me ato të BE-së. Tërheqja nga BE-ja do i shkaktonte shtetit një seri problemesh. Kështu shtetit do i duhej të heqë dorë nga financimet evropiane, të rivendosë në qarkullim monedhën e vet me të gjitha çështjet ekonomike që ajo ngre, të heqë dorë nga dispozitat e së drejtës komunitare të zbatueshme nga gjykatat kombëtare, të vendosë sigurinë në kufijtë e tij territorialë, të zbatojë edhe njëherë praktiken e pasaportave, etj.

Edhe nga pikëpamja gjeopolitike, tërheqja nga institucionet e BE-së duket utopike sepse në skenën evropiane, shteti që do të tërhiqet nga institucionet komunitare do të tregohet me gisht si një shtet më shumë se sa duhet si sovran, duke rrezikuar të ngelet i izoluar në mes të Evropës.

Vështirësia më e madhe që mund të ketë një shtet në momentin kur vendos për t'u larguar nga BE-ja është ajo me karakter ekonomik. Shteti i veçuar do e ketë të vështirë që të pozicionohet në tregun botëror. Braktisja e BE-së supozon gjithashtu heqjen dorë nga një treg i cili vazhdon të jetë i fuqishëm. Në këtë kontekst, nuk është në dobinë e shteteve marrja përsipër e një rreziku të madh ekonomik si pasojë e tërheqjes nga BE-ja.

Në përfundim dhe si në çdo rast të partneritet të mirë, duhet thënë se çdo shtet që merr iniciativën për t'u larguar nga grupi edhe pse juridikisht e mundur, ai do ketë padiskutim vështirësi praktike; kostoja dhe pasojat e largimit do jenë pothuajse të pakapërcyeshme për shtetin “braktisës”.

Për këto arsye “empirike” dhe “jo juridike” shtetet janë të detyruar të vazhdojnë aventurën e tyre brenda Bashkimit Evropian pasi realiteti praktik ka tejkaluar realitetin institucional dhe atë juridik. Sovraniteti i shtetit nuk ka zgjidhje tjetër veçse të përshtatet duke u kujdesur që të mos humbasë krejtësisht përmbajtjen dhe thelbin e tij.

Megjithatë parashikimet e doktrinës lidhur me pamundësinë praktike për t’u tërhequr nga BE-ja u hodhën poshtë me anë të fenomenit “Brexit”, i cili meriton një ndalesë të shkurtër. Në qershor të 2016, 51,9% e popullsisë britanike, me anë të referendumit votuan “pro” daljes nga BE-ja. Në fakt në nenin 50 të Traktatit të Lisbonës, siç edhe u citua më lart, parashikohet mundësia juridike që një shtet të tërhiqet nga BE-ja, ndonëse në praktikë kjo rezultonte e pamundur. Pse populli britanik votoi “pro” shkëputjes nga BE-ja? Në popullsinë britanike mbizotëronte ideja se procesi i vendimmarrjes në BE kishte minuar demokracinë parlamentare britanike, dhe se e vetmja mënyrë për të rimarrë kontrollin e sovranitetit të tyre ishte largimi nga BE-ja.

Ky qëndrim, në të vërtetë, bie ndesh me faktin se qeveritë britanike kanë zgjedhur që të ushtrojnë pushtetin e tyre sovran së bashku me BE-në, në mënyrë që të arrijnë ato objektivat kombëtare të cilat nuk mund t’i arrinin të vetme, të tilla si krijimin e një tregu të vetëm, zgjerimin e BE-së, hartimin e një strategjie ambicioze për ndryshimet klimatike të BE-së, etj.

Në të vërtetë, qeveria britanike, përveç emigracionit në BE dhe pavarësisht anëtarësimit të saj në këtë organizatë, vazhdonte të përcaktonte shumicën e politikës mbi çdo çështje me interes të madh për votuesit britanikë - duke përfshirë shëndetësinë, arsimin, pensionet, mirëqenien, politikën monetare, të mbrojtjes dhe sigurisë së kufijve. Po ashtu Britania e Madhe kontrollon më shumë se 98 për qind të shpenzimeve të saj publike.

Ekonomia britanike ka avancuar shumë falë qënies së saj anëtare në BE. Britania e Madhe krenohet me rritjen më të madhe ekonomike dhe papunësinë më të ulët se shumica e ekonomive të mëdha të zhvilluara dhe renditet ndër vendet më të hapura për të bërë biznes në botën e zhvilluar. Dobësitë e saj ekonomike, të tilla si rritja e ulët e produktivitetit, duhet pranuar se, janë të vetë-shkaktuara.

A ishte koha, pra, për të kthyer pushtetin sovran tërësisht në Westminster? Rreziqet nga kjo tërheqje janë të gjera. Për shembull, Mbretëria e Bashkuar do të përjashtohet nga procesi i vendimmarrjes në BE, duke e bërë atë një vend më pak tërheqës për investime të huaja. Britania e Madhe nuk do të ketë rol në hartimin e tregjeve të hapura të BE-së për shërbimet dixhitale, financiare dhe të tjera. Gjithashtu, dalja nga BE-ja do të ketë një efekt destabilizues në pjesën tjetër të BE-së, e cila do të mbetet tregu më i madh i Britanisë.

Rreziqet kryesore në Britaninë e Madhe si pasojë e tërheqjes nga BE-ja janë ato të karakterit politik. Nivelet e larta të emigracionit nga BE-ja do të vazhdojnë. Në një botë që është shumë më e ndërvarur sot se sa atëherë kur Britania e Madhe iu bashkua Komunitetit Ekonomik Evropian në vitin 1973, nocioni i sovranitetit 'absolut' britanik tingëllon vërtet utopik. Një nocion i tillë është gjithashtu i pavlefshëm në qoftë se ai kufizon aftësinë e qeverive të ardhshme britanike për të siguruar sigurinë dhe prosperitetin e qytetarëve të tyre.

Rasti i Britanisë së Madhe përbën padiskutim një rast përjashtimor dhe *sui generis*, kjo ndoshta edhe për shkak të pozitës së veçantë që ajo kishte në BE, në krahasim me Shtetet e tjera anëtare. Gjithsesi duhet thënë që, Britania e Madhe nuk ka qenë asnjëherë e interesuar për solidaritet të plotë me anëtarët e tjerë të BE-së. Disa vite më parë, vendi zgjodhi të mos përfshihej në dy aspekte kyçe të Bashkimit: monedhën e përbashkët dhe marrëveshjen e kufijve të hapur. Këto qëndrime të Britanisë ndaj politikave komunitare janë një tregues se

ajo mund ta përballojë më me pak kosto daljen nga BE-ja se çdo Shtet tjetër anëtar. Megjithatë Britania e Madhe me ose pa Euron, me ose pa kufij të hapur ka përfituar nga Bashkimi Evropian duke mos ngelur e izoluar në lidhje me vendime të rëndësishme të karakterit ekonomik dhe gjeopolitik dhe dalja nga kjo organizatë do të sjellë pashmangshmërisht pasoja negative në ekuilibrat socio-politiko-ekonomik jo vetëm për BE-në por edhe për Britaninë dhe popullsinë e saj.

Gjithsesi vlen të sqarohet se parashikimi në Traktatin e Lisbonës i “klauzolës së tërheqjes” është një mundësi për Shtetet anëtare për të administruar lirisht zgjedhjet e tyre politike dhe pavarësisht bindjeve të doktrinës, të pamundësisë praktike të tërheqjes së Shteteve anëtare nga BE-ja, jemi të mendimit që një klauzolë e tillë është një pushtet në duart e shteteve për të zgjedhur kompetencat e tyre si në planin politik ashtu edhe në planin juridik. Dhe rasti i Britanisë u bë precedenti i vënies në jetë të largimit nga BE-ja.

Bashkimi Evropian është sot ndoshta në një udhëkryq të ekzistencës së tij, me elementë që shkojnë në favor të sovranitetit por vazhdon të jetë i paaftë në ushtrimin e sovranitetit me natyrë shtetërore. Pushteti i BE-së mund të krahasohet me një sovraniteti embrionar, i cili mbart disa prej karakteristikave të sovranitetit pa qënë ndërkohë në gjëndje të marrë përsipër të gjitha karakteristikat e një Shteti. Kështu pushteti i Bashkimit Evropian mbetet për t’u kualifikuar. BE-ja ka një lloj origjinaliteti të veshur me karakteristika dhe ndikime të shumta të cilat na çojnë në përfundime kontradiktore. Megjithatë ne duhet të përpiqemi për të sqaruar natyrën e këtij pushteti.

Ne analizuam në mënyrë të detajuar procesin progresiv të Bashkimit Evropian i cili të shpie në mënyrë të pashmangshme drejt një konfuzioni kompetencash dhe drejt një ndarjeje komplekse të sovranitetit juridik në praktikë, edhe pse fillimisht koncepti ishte thelbësisht absolut.

Ne trajtuam gjithashtu idenë që Bashkimi Evropian po përjeton një zgjerim të kompetencave të tij, dëshmi që ai ka më shumë kontroll në juridiksionin e tij në dëm të Shteteve anëtare. Dhe është pikërisht këtu ku BE-ja gëzon disa prerogativa të cilat zakonisht i besohen shteteve. Po të bëjmë një analizë të tipit federal do shohim se BE-ja mund të krahasohet fare mirë me një entitet të ri shtetëror. Megjithatë po ta shohim nga pikëpamja politike dhe nga ajo formale, do dalim në konkluzionin që BE-ja nuk plotëson kushtet e ekzistencës së një Shteti federal.

Një gjë është e qartë: Bashkimi Evropian ushtron një formë të fortë të sovranitetit material dhe juridik duke i privuar kështu Shtetet anëtare nga një pjesë e sovranitetit, por BE-ja nga pikëpamja formale dhe politike nuk mund të zëvendësojë sovranitetin e shteteve.

Ky konstatim na ndërlikon përsa i përket kualifikimit të Shtetit Sovran në lidhje me Bashkimin Evropian, i cili duket më tepër si një entitet sovran, që do të thotë se BE-ja mund të krahasohet me një entitet që posedon pushtete shtetërore paralelisht me Shtetet anëtare, por jo në mënyrë të njëjtë.

Ajo çfarë është e sigurtë, është se në ballafaqim me Bashkimin Evropian, koncepti i sovranitetit absolut është zhdukur. Vetë nocioni i sovranitetit duket se është në vështirësi pasi ai nuk kontribuon më plotësisht në kualifikimin e pushtetit shtetëror dhe nuk lejon më të përcaktojë dhe të përfshijë pushtetet e reja që i janë besuar BE-së.

Kështu nocioni i sovranitetit ka pësuar modifikim i cili ka “infektuar” jo vetëm përkufizimin e tij por edhe përdorimin e tij. Në këtë kontekst, sovraniteti lejon një manifestim, interpretim të ndarjes së pushteteve, gjë që është e vështirë të realizohet në një rend juridik i cili tradicionalisht është konceptuar si një piramidë. Ky koncept lejon të manifestohet lëvizja e dyfishtë e cila rregullon marrëdhëniet mes Shteteve anëtare dhe BE-së. Shtetet drejtojnë BE-në dhe BE-ja nga ana e vet ka fuqi prapavepruese tek Shtetet. Kështu sovraniteti i BE-së mund të interpretohet si një pushtet që qëndron mbi shtetet sovrane, të cilat, në mënyrë vullnetare, kanë pranuar t’i nënshtrohen këtij pushteti por vetëm në disa fusha dhe në disa rrethana të caktuara.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke u nisur nga pyetjet kërkimore të këtij punimi: A vazhdon të ruhet ideja e doktrinës fillestare që sovraniteti nuk mund të jetë asgjë tjetër veçse absolut? A është bashkëkohor koncepti i sovranitetit shtetëror? Çfarë kuptimi ka sot sovraniteti dhe a çënohet ai kur ballafaqohet me realitetin ndërkombëtar? A duhet të ripërkufizohet sovraniteti për të vazhduar t'i japim një kuptim kyç në përcaktimin e kuptimit të shtetit duke përjashtuar absolutizmin që tashmë është i papërshtatshëm? Sa sovrane janë Shtetet anëtare të BE-së dhe çfarë pjesë të sovranitetit të tyre kanë humbur me aderimin e tyre në BE? A po shkon Bashkimi Evropian drejt zëvendësimit të Shteteve anëtare? – mbi bazën edhe të hipotezave dhe nënhipotezave kemi arritur në këto **konkluzione**:

- Koncepti i sovranitetit është një ndër nocionet më me kundërthënie dhe më ekuivoke në fjalorin juridik ndërkombëtar. Kjo vjen për shkak të konceptimeve të ndryshme ndaj këtij nocioni në periudha të ndryshme historike. Sovraniteti ka provuar të jetë një koncept evolutiv i cili vishet me karakteristikat e shoqërisë në të cilën zbatohet (Kranz, 1992: 441). Kështu duke u nisur nga trajtimi që iu bë në këtë punim evolucionit të sovranitetit qoftë në aspektin e përmbajtjes, qoftë në aspektin e titullarëve të tij, mund të themi që ky koncept ka kaluar nga të qenurit plotësisht absolut në domosdoshmërinë e kufizimit të tij. Ballafaqimi i karakterit absolut të sovranitetit me teoritë gjermane nxjerr në pah elementë të ri analize lidhur me titullarët e sovranitetit. Kështu, sovraniteti politik bëhet një nocion kompleks, i cili nuk është i qartë se kujt i përket: kombit, shtetit, përfaqësuesve apo një kombinimi të këtyre tre subjekteve? Sovraniteti politik, i cili përcakton pushtetin absolut të sovranit, i është dashur të ballafaqohet me shfaqjen e konceptit të sovranitetit juridik. Një koncept i tillë udhëhiqet nga një rrymë e fortë konstitucionaliste dhe

vuri në diskutim pandashmërinë dhe supremacinë e sovranitetit. Koncepti juridik i sovranitetit, i njohur si kompetenca e kompetencës, ka shkaktuar një pikëpyetje të madhe mbi rëndësinë e kriterëve të sovranitetit të identifikuar nga Bodin. Megjithatë, të gjithë autorët bien dakord në një pikë që sovraniteti politik është supremacia e një pushteti që nuk njihet asnjë konkurrent tjetër.

- Vitet e fundit sovraniteti ka kaluar nga një koncept i paprekshëm drejt një katalizatori debatesh në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në qoftë se disa studiues mjaftohen në ndarjen e sovranitetit në komponentë të ndryshëm, disa të tjerë shkojnë edhe më larg, duke ripërcaktuar madje edhe vetë përmbajtjen e konceptit të sovranitetit. Mund të themi që riformulimet e vizionit klasik të sovranitetit nuk ndikojnë gjithsesi në humbjen e koherencës konceptuale të tij.
- Avancimi i shoqërisë ndërkombëtare sot ndodhet në një stad të tillë sa që mund të konstatohet që shtetet po funksionojnë gjithnjë e më shumë në kuadrin e organizatave ndërkombëtare, se sa brenda kufijve të tyre shtetërorë. Mirëpo çështja e aderimit të shteteve në këto organizata provokoi, në fillim, në doktrinën juridike idenë e kufizimit të sovranitetit të tyre. Edhe sot, në fakt, lidhur me aderimin e shteteve në organizata ndërkombëtare flasim për një reduktim të pashmangshëm të kompetencave të tyre sovrane në disa fusha të caktuara.
- Braktisja e sovranitetit absolut në planin teorik është konfirmuar në masë të madhe nëpërmjet Bashkimit Evropian. BE-ja është një eksperiment i vërtetë i sovranitetit të ndarë. Nëpërmjet këtij bashkimi vihet në jetë një ndarje e kompetencave mes shteteve dhe BE-së, që me kalimin e kohës, po merr rëndësi gjithnjë e më të madhe, duke shkuar deri aty madje sa të preken edhe kompetencat sovrane të shteteve. Ndikimet e BE-së tek shteti dhe tek sovraniteti i tij të çojnë domosdoshmërisht drejt pyetjes nëse sovraniteti, si i tillë ka ende kuptim, nëse përkufizimi i tij duhet të

ndryshojë apo nëse ai duhet t'i lërë vend një koncepti tjetër. Në të vërtetë, mes BE-së dhe Shtetit bëhet një ndarje kompetencash, ndarje e cila ka ndikuar, pa diskutim, në krijimin e modaliteteve të reja të ushtrimit të sovranitetit. Një ndarje e tillë kompetencash është thellësisht evolutive, aq më tepër kur konstatohet që ky fenomen vitet e fundit ka tendencë të përparojë akoma më shumë. Kështu, në lidhje me kompetencat, mund të themi që shteti në raport me BE-në pëson një dobësim real.

- Bashkimi Evropian është integruar plotësisht në politikën dhe në të drejtën kombëtare. Madje integrimi i drejtpërdrejtë i së drejtës komunitare po zbatohet tashmë gjithnjë e më shumë në Kushtetutat e Shteteve anëtare. Me sa duket, kohët e fundit shtetet po tentojnë të integrojnë drejtpërdrejtë në Kushtetutat e tyre të drejtën e BE-së. Duke e bërë BE-në dhe të drejtën komunitare pjesë të Kushtetutave kombëtare, shteti adopton kështu një normë supreme që, parë në disa aspekte, shndërrohet në një normë me standart të dyfishtë, nganjëherë edhe paradoksale, meqënëse Kushtetuta është në të njëjtën kohë garanti i sovranitetit dhe i pandashmërisë, por në të njëjtën kohë është edhe garanti i procesit komunitar, i cili, siç edhe e kemi trajtuar, për nga vetë natyra e tij shfaq disa prej karakteristikave të shteteve federale. Një konstatim i tillë na çon drejt përfundimit se Kushtetuta nuk është më vetëm një tekst me karakter kombëtar, por ai, si dokumenti themelor i një shteti, në dispozitat e tij, ndër të tjera, merr në konsideratë edhe transformimin e shtetit, anëtarësimin e tij në BE dhe natyrën gjithnjë e më të ndarë të sovranitetit.
- Në mënyrë paradoksale, shteti vetë kontribuon në dobësimin e sovranitetit, pasi vetë shtetet, të nxitur nga nevojat ekonomike, politike, ushtarake, i kanë dhënë Bashkimit Evropian kompetenca të tilla sa që sot BE-ja mund të konsiderohet si një konkurrent serioz i shtetit. Madje vetë projekti për krijimin e një Kushtetute të

Bashkimit Evropian ka treguar vullnetin e shteteve për të krijuar një Evropë me vokacion mbikombëtar dhe të integruar.

- E drejta ndërkombëtare dhe sidomos ajo komunitare, vë në diskutim sovranitetin e shtetit duke kërcënuar kështu karakterin absolut, suprem dhe të pandashëm të tij. Këto norma, në fakt, imponojnë një relativitet të pushtetit. Megjithatë ky evolucion i konceptit të sovranitetit nuk ka prekur pozitat e shtetit si një interlekutor i privilegjuar dhe i respektuar gjë që krijon hapësira për të justifikuar ruajtjen në praktikë të strukturës shtetërore. Shteti nuk është realisht i kërcënuar nga BE-ja. Nocioni i shtetit dhe i pushtetit shtetëror, vazhdon të jetë i maskuar nga koncepti i sovranitetit të shtetit. Kështu sovraniteti nuk “zhduket” pavarësisht evolucionit të këtij koncepti, i cili tashmë nuk e ka kuptimin tradicional të tij, por është zëvendësuar me një sovranitet më të zbutur të cilin juristët dhe studiuesit e së drejtës kanë hezituuar ta kategorizojnë si sovranitet.
- Edhe pse Gjykata e Luksemburgut vendos në pozita të privileguara integrimin, në jurisprudencën e saj shohim të dalin në pah edhe disa rregulla të cilat mbrojnë vetë esencën e shtetit, i cili vazhdon të ruajë të gjithë pushtetin e tij. Pra, GJED-ja është e prirur për të respektuar edhe identitetin kushtetues dhe kulturor të shtetit.
- Ndikimi i Bashkimit Evropian në sovranitetin e shteteve anëtare është lehtësisht i dukshëm. Megjithatë, edhe pse koncepti absolut dhe i pandashëm i sovranitetit nuk mund të vazhdojnë të mbijetojnë për shkak të evolucionit të Bashkimit Evropian, mund të themi që veçantia e pushtetit shtetëror, si rrjedhojë edhe e pushtetit sovran të shtetit, nuk suprimohet nga BE-ja por përballë një realiteti të ri evropian koncepti i sovranitetit shtetëror duhet të ripërcaktohet. Në fakt, Bashkimi Evropian pavarësisht ndikimeve që ushtron mbi pushtetin sovran të shteteve anëtare, ai gjithsesi nuk është në gjendje që të zëvendësojë përfundimisht shtetet. Kjo paaftësi

e BE-së për të zëvendësuar Shtetet anëtare dhe si pasojë për t'i privuar ata nga sovraniteti i tyre është rezultat i natyrës juridike të paqartë të BE-së që nuk e lejon atë të jetë një shtet i vërtetë sipas përcaktimeve të doktrinės juridike. Kështu BE-ja mbetet në një rrugë të ndërmjetme mes organizatës ndërkombëtare dhe shtetit ku kompetencat që tradicionalisht i janë besuar shtetit nuk mund të ushtrohen nga organet e BE-së.

- Karakteri i paqartë dhe enigmatik i natyrës juridike të Bashkimit, megjithatë të çon drejt një sigurie në lidhje me sovranitetin. BE-ja është, pa dyshim, më shumë se një organizatë ndërkombëtare, që nënkupton se shtetet nuk kanë kontroll të plotë mbi të dhe për rrjedhojë, një pjesë e sovranitetit të shteteve është transferuar tashmë në BE. Në këtë pikë, ne mund të konstatojmë se Bashkimi Evropian është një organizatë e veçantë, *sui generis*, e veshur me kompetenca të natyrës shtetërore, e cila gëzon një përqindje të sovranitetit shtetëror, sidomos juridik, e megjithatë BE-ja nuk është një Shtet dhe nuk ka sovranitet të plotë. Bashkimi Evropian është tashmë një pushtet-fuqi në mes të Shteteve, i cili, nganjëherë, u imponohet atyre por që është ngushtësisht i lidhur me ta. Ky konstatim të çon natyrshëm të pyesësh veten nëse BE është i veshur me sovranitet të natyrës juridike shtetërore që mund të kualifikohet si i tillë edhe nëse ai është në fazën embrionare.
- Nëse Bashkimi Evropian vishet me sovranitet shtetëror, atëherë ai duhet të justifikojë se përmbush të gjitha kriteret e ekzistencës së një Shteti si, Kombësia, Simbolet Shtetërore dhe Kushtetuta. Në të gjitha këto elementë, BE-ja paraqet mangësi, tregues ky i faktit që edhe nëse BE-ja ka sovranitet, qoftë edhe në stadin embrionar të saj, ai nuk mund të absorbojë Shtetet anëtare dhe të bëhet ai vetë – Shtet. Pra ai nuk është krejtësisht sovran, meqënëse i mungojnë karakteristikat e një Shteti. Bashkimi Evropian nuk është i bazuar mbi një kombësi evropiane, në një

Kushtetutë dhe në një territor të mirëpërcaktuar. Të gjitha këto të meta të BE-së e pengojnë atë të zëvendësojë shtetet dhe si rrjedhojë e pengojnë atë të ketë sovranitet politik. Është e vërtetuar tashmë që me ekzistencën e BE-së sovraniteti i shteteve duhet të ndahet por ky sovranitet vazhdon të ekzistojë tek shtetet kjo pasi BE-ja nuk ka kapacitetet e veta institucionale për të zbatuar kompetencat sovrane.

- Bashkimi Evropian refuzon t'i japë shtetit një goditje përfundimtare. Në të vërtetë BE-ja nuk do mund të ekzistonte nëse shtetet evropiane nuk do kishin vullnetin për të ushtruar në mënyrë të përbashkët kompetencat dhe për t'i dhënë përgjigje sfidave gjithnjë e më shumë transnacionale. Thënë me fjalë të tjera, shteti është pa diskutim arkitekti i Bashkimit Evropian, duke qënë kështu në të njëjtën kohë konceptuesi, organizatori dhe nganjëherë edhe ai që e pëson nga ky bashkim. Gjithashtu shteti respektohet sot edhe në dimensionin e tij kombëtar, meqënëse BE-ja vazhdon të mos mund të ketë një kombësi të vërtetë evropiane.
- Pavarësisht përkufizimit jo të formuluar saktë, sovraniteti vazhdon të jetë një nocion që përdoret për të treguar pushtetin e një shteti. Sovraniteti vazhdon të jetë, në fakt, atributi me të cilin një shtet vishet për të treguar pushtetin e tij, pavarësisht imperfeksioneve të nocionit, të përmbajtjes dhe të vënies shpesh herë në dyshim të vetë ekzistencës së tij. Kështu pra, sovraniteti është një koncept që vazhdon të tregojë dobinë e tij. Në të vërtetë, e drejta dhe praktika refuzojnë të braktisin sovranitetin si një tregues apo përcaktues të pushteteve të shtetit edhe pse dimensionin e tij absolut e ka humbur tashmë rëndësinë e tij.

Në përfundim **rekomandojmë që:**

Së pari, përdorimi i sovranitetit të ruhet në gjuhën juridike si rezultat i pranimin të një versionin më të zbutur të tij sipas të cilit karakteri absolut nuk është më një element i përkufizimit të tij.

Së dyti, nëqoftë se në aspektin e pushteteve të shtetit, sovraniteti nuk është më aq i domosdoshëm sa ishte në epokën e J.Bodin, ai vazhdon të jetë i domosdoshëm në përcaktimin e kombit. Një konstatim i tillë përforcon idenë që sovraniteti kombëtar është më pak i kërcënuar se sa sovraniteti i shtetit dhe se Kombi dhe shteti nuk duhet të vendosen në të njëjtin plan.

Së treti, sovraniteti të vazhdojë të përdoret, kjo edhe për shkak të mungesës së elementëve të tjerë përcaktues për shtetin. Kështu përdorimi i sovranitetit vjen më shumë si nevojë dhe jo sepse ai korrespondon me një përcaktues të drejtë të pushtetit shtetëror.

Së katërti, Shteti nuk ka pushuar së ekzistuari. Por ne nuk duhet ta idealizojmë më as në planin juridik dhe as në planin politik.

Së pesti, konceptet e mëdha post-revolucionare si Shteti unitar, i pandashëm nuk mund të vazhdojnë të zbatohen më. Shteti është pjesë e një bote të copëtuar dhe i detyruar të integrohet në epokën e globalizimit, të vështirësive ekonomike dhe mjedisore.

Së gjashti, Shteti të adaptohet në planin e jashtëm duke marrë pjesë në Bashkimin Evropian. Sfida e tij është se sa i aftë do jetë ai të ruajë vendin e tij në rendin botëror, kryesisht në drejtim të pushtetit demokratik, i cili mbështetet tek sovraniteti kombëtar. Ai është në të njëjtën kohë edhe aktor edhe spektator i evolucionit të pushtetit të tij sovran.

Megjithatë, duhet thënë që kompleksiteti i sovranitetit dhe pamundësia për të përcaktuar saktësisht konturet e tij, në një botë gjithnjë e në ndryshim, mund të krijojnë në të ardhmen hapësira për një ripërcaktim të mundshëm të shtetit pa të.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Drejtave të Njeriut
2. Karta e OKB
3. Kushtetuta e Austrisë
4. Kushtetuta e Belgjikës
5. Kushtetuta e Finlandës
6. Kushtetuta e Francës
7. Kushtetuta e Gjermanisë
8. Kushtetuta e Italisë
9. Kushtetuta e Kosovës
10. Kushtetuta e Kroacisë
11. Kushtetuta e Malit të Zi
12. Kushtetuta e Maqedonisë
13. Kushtetuta e Portugalisë
14. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
15. Kushtetuta e Serbisë
16. Kushtetuta e Zvicrës
17. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
18. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.
19. Projekt-Kushtetuta Evropiane
20. Rezoluta e Parlamentit Evropian, nr.97/236
21. Rregullorja e Komisionit Evropian, nr.1103/9
22. Statuti i GJNP.

23. Traktati i Amsterdemit, firmosur me 2 tetor 1997, hyn në fuqi me 1 maj 1999.
24. Traktati i Komunitetit Ekonomik Evropian (KEE), firmosur ne 25 mars 1957 ne Rome, hyn ne fuqi ne 1 janar 1958.
25. Traktati i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (EURATOM), firmosur bashke me traktatin e KEE.
26. Traktati i Komunitetit Evropian te Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ), firmosur ne 18 prill 1951 ne Paris, hyn ne fuqi ne 23 korrik 1952.
27. Traktati i Lisbonës, firmosur me 13 dhjetor 2007, hyn në fuqi 1 dhjetor 2009.
28. Traktati i Maastrichtit, firmosur me 7 shkurt 1992, hyn në fuqi me 1 nëntor 1993 (TBE).
29. Traktati i Nisës, firmosur me 26 shkurt 2001, hyn në fuqi me 1 shkurt 2003

Burime dytësore

Literaturë e huaj

1. Aalberts T. E., (2006). “Politics of Sovereignty”, Amsterdam, Vrije Universiteit.
2. Aglaé M.-J., (1995). “La souveraineté transfigurée”, RRJ.
3. Antonov I. (2003). “Germanskii federalizm (istoriya i sovremennost)”, article en russe (Le fédéralisme germanique (histoire et modernité) in Pravo i jizn, 2003, n.5.
4. Anzilotti D., (1999). “Cours de droit international”, Editions Pantheon-Assas, L.G.D.J.
5. Archer C., (2001). “International organizations” 3rd edition.
6. Avgeri P. & Magnillat M.-P., (dir), “Enjeux et rouages de l’Europe actuelle, culture et citoyenneté européennes”, édition Foucher, 7ème édition.
7. Bain W., (2003). “Between Anarchy and Society: Trusteeship and the Obligations of Power”, Oxford, Oxford University Press.

8. Bartelson J., (1995). "A Genealogy of Sovereignty", Cambridge, Cambridge University Press.
9. Basdevant J. (1936). "Règles générales du droit de la paix", RCADI, IV, vol. 58.
10. Beaud O., (2004). "La souveraineté dans la contribution à la théorie générale de l'Etat de Carré de Malberg", RDP.
11. Bertrand F.-G., (2005). "La personnalité juridique de l'Union", in la nouvelle union européenne , O. Gohin et A. Pécheul (dir), édition de Guibert.
12. Berramdane A. & Rossetto J., (2005). "Droit institutionnel de l'Union européenne", Montchrestien.
13. Biersteker T. J. & Weber, C.. (1996). "The Social Construction of State Sovereignty". In: Biersteker, T. J. & Weber, C. (eds.) *State Sovereignty as Social Construct*. Cambridge: Cambridge University Press.
14. Bluman C. & Dubouis L., (2004). "Droit institutionnel de l'Union européenne", édition Litec.
15. Bluntschli J-G., Le droit international codifié, Paris, 2ème Edition, 1886,
16. Bodley A., (1999). "Weakening the principle of sovereignty in international law: The international tribunal for the former Yugoslavia", New York University Journal of International Law and Politics.
17. Bonichot J.-C., (2008). "Loin des théories : le refus de la cour de justice d'imposer un modèle juridictionnel européen", RDP, n° 3.
18. Boulouis J., (1974). "A propos de la fonction normative de la jurisprudence, remarques sur l'œuvre jurisprudentielle de la CJCE", Mélanges Walline, le juge et le droit public, LGDJ.
19. Brand RA., (2002). "Sovereignty: The state, the individual and the international legal system in the twenty first century", Hastings International and Comparative Law Review.
20. Caldwell LK., (1999). "Is world law an emerging reality? Environmental law in a transnational world". Colorado Journal of International Law and Policy.
21. Cassese A., (1986). "International law in a divided world"
22. Cassia P., (2004), "L'article I 6 du traité établissant une constitution pour l'Europe, et la hiérarchie des normes", Revue Europe décembre.

23. Chaltiel F., (2004).“ l’application du droit communautaire par le juge national”, Mélanges Isaac, 50 ans de droit communautaire , presses de l’université des sciences sociales de Toulouse.
24. Charpentier J., (1995).“De la personnalité juridique de l’Union européenne”, in Mélanges Peiser, PUF.
25. Chaumont C., (1970). “Cours générales de droit international public”, RCADI, I, vol. 129.
26. Cheng B., (1991). “La jurimétrie : sens et mesure de la souveraineté juridique et de la compétence nationale”, JDI.
27. Chevallier J.-J., (1964). “Les grandes oeuvres politiques”. Armand Colin. 4^{em} édition.
28. Chevallier J.J., (1993). “ Histoire de la pensée politique”. Grande Bibliothèque Payot, Paris.
29. Collot C., (1965). “L’école doctrinale de droit public de Pont-à-mousson : Pierre Grégoire de Toulouse et Guillaume Barclay, fin du XVIème siècle”. Edition librairie générale de droit et de jurisprudence impr. R. Vançon.
30. Combacau J. & Sur S. (2001). “Droit international public”, Montchrestien.
31. Constantinesco V. & Petculescu I., (2005) “La personnalité juridique de l’Union , in le traité établissant une constitution pour l’Europe, analyses et commentaires”, presses universitaires de Strasbourg.
32. Constantinesco V., (2002). “ Europe fédérale ou fédération d’Etats Nations “, In une constitution pour l’Europe (dir. R. Dehousse), édition presses sciences po.
33. David M., (1996). “La souveraineté du peuple”, PUF.
34. Dehousse R., (2005).“La fin de l’Europe”, édition Flammarion.
35. Delbrück J., (1993). “ Globalization of law, politics and markets-implications for domestic law: A European perspective”, Indiana Journal of Global Legal Studies.
36. Derathé R.,(1992). “ Jean-Jacques Rousseau et la pensée politique de son temps”, Vrin.
37. Dollot R., (1947). “L’Organisation politique mondiale et le déclin de la souveraineté”, Paris, A. Pedone.
38. Doty R. L.,(1996). “Imperial Encounters: the Politics of Representation in North-South Relations”, Minneapolis; London, University of Minnesota Press.

39. Dufour, A., (1997). "Pufendorf", Burns J.H. (Dir.), *Histoire de la pensée politique moderne*, PUF.
40. Dugard J., (2005). "International law: A South African perspective", 3rd ed.
41. Dunn K. C.,(2003). "Imagining the Congo: The International Relations of Identity", New York, Palgrave MacMillan.
42. Dupuis C., (1919). "L'organisation internationale et la notion de souveraineté", Séances et travaux de l'Académie des sciences morales et politiques.
43. Dupuis C., (1937). "Les antécédents de la Société des Nations", RCADI, II, vol. 60.
44. Dupuis C., (1930). "Règles générales du droit de la paix", RCADI, II, Vol. 32.
45. Dupuis C., (1921). "Le droit des gens et les rapports des grandes puissances avec les autres Etats avant le pacte de la Société des Nations".
46. Dutheil de la Rochère J., (2008). "le Traité de Lisbonne, la documentation Française", regards sur l'actualité, juillet, n° 342.
47. Etzioni A., (2006). "Sovereignty as Responsibility". Orbis.
48. Fassbender B., (2003). "Sovereignty and constitutionalism in international law", Walker N (ed) *Sovereignty in transition*.
49. Fauchille P., (1926). "Traité de droit international public", Première partie, Tome 1, 8ème édition , Rousseau et Cie Ed.
50. Ferreira M.-P., (2009). "The erosion of state sovereignty in public international law: towards a world law?", University of Johannesburg, thèse de doctorat.
51. Forsythe DP., (2006). "Human rights in international relations" 2nded.
52. Frank C, (2000). "Traité et constitution : les limites de l'analogie", in P. Magnette (dir.) *la constitution de l'Europe*, Bruxelles.
53. Franklin,J., (1993), " Jean Bodin et la naissance de la théorie absolutiste", PUF.
54. Friedmann W., (1964). "The changing structure of international law".
55. Gelas H., (2004). "Procédure contentieuse internationale et souveraineté étatique", thèse de doctorat, Université Paris II.
56. Geouffre de la Pradelle A., (1933). "Influence de la Société des Nations sur le développement du droit des gens. La justice internationale", Les Editions internationales.
57. Ghagnolla D., (2005). "Droit constitutionnel contemporain", tome 1, Librarie Armand Colin.

58. Giraud E.,(1950). “ Le rejet de l’idée de souveraineté”, in *Mélanges offerts en l’honneur de Georges Scelle*.
59. Gohin O., (2005). “La nature juridique de la nouvelle union européenne”, in *la nouvelle union européenne*, O. Gohin et A. Pécheul (dir), édition de Guibert.
60. Goyard Fabre, S. (1989).“Jean Bodin et le droit de la République” PUF.
61. Goyard Fabre, S., (1997). “Les principes philosophiques du droit politique moderne”, Paris.
62. Grevisse F., & Bonichot J.-C., (1991). “Les incidences du droit communautaire sur l’organisation et l’exercice de la fonction juridictionnelle dans les Etats membres”, *Mélanges Boulouis, l’Europe et le droit*, Dalloz.
63. Grotius H., (1625).“Le droit de la guerre et de la paix”, Trad. P. Pradier-Fodert, (1867), Reid., Leviathan, PUF, 1999.
64. Guillermin G., (2004).“Quelques réflexions sur la notion de constitution européenne”, *mélanges Isaac*.
65. Haquet A., (2004). “Le concept de souveraineté en droit constitutionnel français”, PUF.
66. Hauriou A., (1970).“Droit constitutionnel et institutions politiques”, Montchrestien.
67. Henkin, L., (1995). “International Law: Politics, Values and Functions: General Course on Public International Law”, RCADI, V.216.
68. Henkin L., Neuman GL., Orentlicher DF., Leebron DW., (1999). “Human Rights”.
69. Herzog P., (2005).“Après le référendum, relancer une dynamique d’Union politique”, in *revue du marché commun et de l’UE*, n° 490.
70. Heymann J., (2010). “De la citoyenneté de l’Union comme révélateur de la nature de l’Union européenne”, *revue Europe*.
71. Hinsley, F.H., (1986). “Sovereignty”, 2ème Edition. Cambridge University Press.
72. Icard P., (2001).“Droit matériel et politiques communautaires”, éditions Eska.
73. Irondele B., (2008).“ l’horizon européen de l’armée française”, *revue pouvoirs*.
74. Jackson, R. H., (1999). “Sovereignty in World Politics: a Glance at the Conceptual and Historical Landscape”, *Political Studies*.
75. Jackson, R. H.,(1990). “Quasi-states: Sovereignty, International Relations and the Third World”, Cambridge, Cambridge University Press.
76. Jackson, R. H.,(2007).,“Sovereignty: The Evolution of an Idea”, Cambridge, Polity.
77. Jacqué J.-P., (2008).“Du traité constitutionnel au traité de Lisbonne”, *RDP*, n° 3.

78. Jacque J.-P., "Droit institutionnel de l'Union européenne", Dalloz, 2ème édition.
79. James A.,(1986). "Sovereign Statehood: the Basis of International Society", London, Allen & Unwin.
80. Kalmo, H. & Skinner, Q., (2010). *Introduction: A Concept in Fragments*. In: KALMO, H. & SKINNER, Q. (eds.) "Sovereignty in Fragments: The Past, Present and Future of a Contested Concept". Cambridge: Cambridge University Press.
81. Kelsen H., (1999). "Théorie pure du droit", Bruylant, Paris.
82. Kelsen H., (1944). "Peace through Law", The University of North Carolina Press.
83. Keohane, R. O.,(2003). "Political Authority after Intervention: Gradations in Sovereignty". In: Holgreffe, J. L. & Keohane, R. O. (eds.) *Humanitarian intervention. Ethical, Legal, and Political Dilemmas*. Cambridge: Cambridge University Press.
84. Korowicz M. S., (1945) "La souveraineté des Etats et l'avenir du droit international", Paris.
85. Korowicz M.-S., (1961). "Organisations internationales et souveraineté des Etats membres", Paris.
86. KovarR., (1994). "L'évolution de l'article 177 CE, la réforme du système juridictionnel communautaire", G. Vandersanden (dir.), université de Bruxelles.
87. Kranz J., (1992). "Notion de souveraineté et le droit international", Archiv des Völkerrechts, n°4.
88. Krasner S. D.,(1989). "Sovereignty: An Institutional Perspective". In: CAPORASO, J. A. (ed.) *The Elusive State: International and Comparative Perspectives*. Newbury Park - London: Sage Publications.
89. Krasner S. D.,(1999). "Sovereignty: Organized Hypocrisy, Princeton, Princeton", University Press.
90. Krasner S. D., (2001). "Rethinking the Sovereign State Model. Review of International Studies", 27, 17-42.
91. Krasner S. D., (2004). "Sharing Sovereignty: New Institutions for Collapsed and Failing States". *Review International Security*, 29, 85-120.
92. Kuzmin E.L. (1969). "Mirovoe gosudarstvo : illuzii ili realnost? Kritika burjuaznikh koncepcii suvereniteta", en russe (L'Etat mondial : illusions ou réalité ? Critique des conceptions bourgeoises de la souveraineté) M.

93. Labayle H., (2008).“ l’espace de liberté, sécurité et justice, la nouvelle frontière ?” revue Europe juillet.
94. Laferrière, J., (1947).“Manuel de droit constitutionnel”, Domat.
95. Lake D. A., (2003). “The New Sovereignty in International Relations”. International Studies Review, 5, 303-323.
96. Larrière, C., (1996). “ Pufendorf “, Raynaud P. et Rials S., *Dictionnaire de philosophie politique*.
97. Le Fur L., (1932). “Le développement historique du droit international. De l'anarchie internationale à une communauté internationale organisée”, RCADI, III, vol. 41.
98. Le Fur, L., (2000). “Etat fédéral et confédération d'états”, Panthéon Assas.
99. Lecourt R., (1976).“l'Europe des juges”, Bruylant.
100. Leikoff S., (1995). “ Oppozitsiya «suverenitet-avtonomiya v usloviyakh federalizma» : vibor mejdu «ili-ili» i «bolche-menche» article en russe, in Politicheskie issledovaniya (Polis).
101. Les six livres de la République, Botimi i Fayard, 1986.
102. Louis J.-V., & Ronse Th., (2005),“L'ordre juridique de l'Union européenne”, Bruylant.
103. Lloyd H.A., (1997). “Le constitutionnalisme”, Burns J.H., Dir., Histoire de la pensée politique moderne, PUF.
104. Maddalon P., (2008).“l'action extérieure de l'UE”, revue Europe, juillet.
105. Mairet, G., (1996).“Le principe de souveraineté, histoire et fondements du pouvoir moderne”, Gallimard.
106. Malving, H.,(2006). “State Sovereignty and Intervention: A discourse analysis of interventionary and non-interventionary practices in Kosovo and Algeria”, New York, Routledge.
107. Martens Ph.Ph., (1887).“Sovremennoe mejdunarodnoe pravo tcivilizovannikh narodov”, en russe (Le droit international contemporain des peuples civilisés) T.1, Saint Petersburg.
108. Meinecke F., (1924). “L'idée de la raison d'Etat dans l' histoire des temps modernes”, trad. Droz. 1973.
109. Meinecke, F., (1973).“ L'idée de la raison d'Etat dans l' histoire des temps modernes “, 1924, trad. Droz.

110. Merignac A., (1905). "Traité de droit public international", Tome 1, cité par Gelas H., Procédure contentieuse internationale et souveraineté étatique, Université Paris II, 1994.
111. Michel V., (2008). "Les compétences : les mots, les choses", revue Europe juillet.
112. Mills k., (1997). "Reconstructing sovereignty: A human rights perspective", Netherland Quarterly of Human Rights.
113. Mink G., (2004). "Les passés douloureux ou les difficultés à écrire à plusieurs l'histoire européenne", in le nouvel état de l'Europe, les idées forces pour comprendre les nouveaux enjeux de l'Union, édition la découverte.
114. Monaco R., (1974). "Le caractère constitutionnel des actes institutifs des organisations internationales" Mélanges Rousseau, pédone.
115. Moreau Defarges P. (2006). "Où va l'Europe ?" Édition Eyrolles.
116. Morel H., (1996). "Absolutisme", Raynaud P. et Rials S., Dictionnaire de philosophie politique, PUF.
117. Morellet J., (1926). "Le principe de la souveraineté de l'Etat et le droit international public", RGDIP.
118. Mortier, P., (2012). "Les métamorphoses de la souveraineté". Law. Université d'Angers, thèse de doctorat.
119. Mosler H., (1974). "The International Society as a Legal Community", RCADI, IV, Vol. 140.
120. Mouton J.-D. (2008). "L'évolution de l'Union européenne, quelles perspectives pour ses relations avec l'autre Europe ?" RDP, n° 3.
121. Nagan WP & Hammer C., (2004). "The changing character of sovereignty in international law and international relations", Columbia Journal of Transnational Law.
122. Oberdorff H., (2008). "Le traité de Lisbonne, une sortie de crise pour l'UE ou plus ?" RDP, n° 3.
123. Onuf N. G., (1991). "Sovereignty: Outline of a Conceptual History". Review Alternatives.
124. Oppenheim L., (1948). "International law", Tome 1, Vol. 1, traduit en russe, Moscou, M.
125. Palienko N.I., (1903). "Le développement historique de l'idée de la souveraineté et sa signification juridique", Yaroslavl.

126. Passerin d'Entreves A., (1969). "La notion de l'Etat".
127. Perrez F.X., (2000). "Cooperative sovereignty from independence to interdependence in the structure of international law". Kluwer Law International.
128. Picq, J., (2005). "Histoire et droits des Etats : la souveraineté dans le temps et l'espace européens", presses de science politiques.
129. Piris J.-C., (1994). "Après Maastricht, les institutions communautaires sont-elles plus efficaces, plus démocratiques et plus transparentes ?" RTD Eur. Janv. Mars.
130. Piris J.-C., (2005). "l'Union européenne : vers une nouvelle forme de fédéralisme", RTD eur.
131. Pliakos A.-D., (1993). "La nature juridique de l'Union européenne", RTD eur.
132. Politis N., (1925). "Le problème des limitations à la souveraineté et la théorie de l'abus des droits", RCADI, Vol. 6.
133. Scelle G., (1932). "Précis de droit des gens", Tome 1.
134. Prokhovnik R., (2007). "Sovereignties. Contemporary Theory and Practice", New York, Palgrave Macmillan.
135. Raux J., "La capacité internationale de la communauté et de l'Union européenne", juris class Europe , fasc.2200, n° 29.
136. Raynaud F., (2000). "Europe, citoyens et démocratie", cahiers français, sept, oct, n° 298.
137. Reisman WM., (1990). "Sovereignty and human rights in contemporary international law", American Journal of International Law
138. Reuter P., (1965). "Organisations européennes", PUF.
139. Reuter P., La communauté européenne du charbon et de l'acier, L.G.D.J., 1953.
140. Rideau J., (2006). "Droit institutionnel de l'UE et des communautés", LGDJ, 5ème édition.
141. Rigaudière, A., (1993). " L'invention de la souveraineté ", revue Pouvoirs, n° 67.
142. Ross A., (2001). "Geographies of justice: International law, national sovereignty and human rights", Finnish Yearbook of International Law.
143. Rousseau C., (1944). "Principes généraux du droit international public", Pedone, Tome 1.
144. Rousseau D., (2002). "Le traité constitutionnel" in le Monde, 22 octobre.
145. Rousseau J.-J., "Du contrat social ou principes du droit politique" (texte présenté et commenté par J.-M. Fataud et M.-C. Bartholy), Bordas, 1972.

146. Sauron J.L., (2000). "Cours d'institutions européennes. Le puzzle européen", Gualino éditeur, Paris.
147. Scelle G., Le Pacte des Nations et sa liaison avec le Traité de Paix, Sirey, 1919
148. Scheremers H., (2002). "Differents aspects of sovereignty", in Kreijen G (ed), State, sovereignty and international governance.
149. Seth S.,(2000). "A 'Postcolonial World'?" In: Fry, G. & O'Hagan, J. (eds.) *Contending Images of World Politics*. London: Macmillan.
150. Simon D., (2008). " les fondations, l'Europe modeste : symbole, valeur objectifs", revue Europe, juillet.
151. Simonovic I., (2002). " Relative sovereignty in the twenty first century", Hastings International and Comparative Law Review.
152. Sorensen, G., (1999). "Sovereignty: Change and Continuity in a fundamental institution". Political Studies, 47.
153. Spagnol E., (2007), "Enciclopedia delle citazioni", Garzanti.
154. Tchernyak L.Yu., (2007). "Obsheteoreticheskie problemi gosudarstvennogo suvereniteta", en russe (Les problèmes théoriques de la souveraineté d'Etat) dissertation afin d'obtenir le grade de candidat en sciences juridiques, Tchelyabinsk.
155. Tchirkin V.E. (2000). "Gosudarstvennaya vlast subiekta federacii", article en russe (Le pouvoir étatique du sujet de la fédération) in Gosudarstvo i pravo, № 10.
156. Triepel H., (1923). "Les rapports entre le droit interne et le droit international", RCADI, I.
157. Triepel H., (1920). "Droit international et droit interne", Pedone.
158. Truyol Serra, A. (1990). "Souveraineté", Sirey.
159. Thomson J. E., (1995). "State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap between Theory and Empirical Research". International Studies Quarterly.
160. Valhas A., (2005). "Souveraineté et droit de retrait au sein de l'Union européenne", RDP, n°6.
161. Van Praag L., (1915) "Juridiction et droit international public. La juridiction nationale d'après le droit international public coutumier en temps de paix", Librairie Belinfante Frères, La Haye-
162. Vecchio G.Del, (1931). "La Société des Nations au point de vue de la philosophie du droit international", RCADI, IV, Vol. 38.
163. Verthofstad G., (2006). "Les Etats-Unis d'europe", édition Luc Piris.

164. Virally M. (1983). "Panorama du droit internatinonal contemporain", RCADI, V, Vol. 183, p. 76
165. Virally M., (1990). "Le droit international en question", in Le droit international en devenir, PUF.
166. Visscher C., (1970). "Théories et réalités en droit international public", Pedone, 4ème Edition.
167. Vongolis B., (1997). "L'Etat c'était bien lui", essai sur la monarchie absolue , éditions Cujas.
168. Walker R. B. J.,(1993). "Inside/Outside: International Relations as Political Theory", Cambridge, Cambridge University Press.
169. Waltz K. N.,(1979). "Theory of International Politics", New York, McGraw-Hill.
170. Weber C.,(1995). "Simulating Sovereignty: Intervention, The State and Symbolic Exchange", Cambridge, Cambridge University Press.
171. Werner W. G. & Wilde, J. H. D.,(2001). "The Endurance of Sovereignty". European Journal of International Relations, 7.
172. Yepes J.-M., (1934). "Les problèmes fondamentaux du droit des gens en Amérique", RCADI, I, Vol. 47.
173. Zaum, D.,(2007). "The Sovereignty Paradox. Norms and Politics of International Statebuilding", Oxford, Oxford University Press.
174. Zorgbibe C., (2005). "Quel avenir pour l'Union européenne", revue politique et parlementaire, n° 1036.
175. Zhekeyeva A. (2009). "La souveraineté et la réalisation de la responsabilité internationale des Etats en droit international public". Law. Université Paris-Est; Université Nationale d'Eurasie, thèse de doctorat.
176. Draetta U. dhe Parisi N. (2004). "Elementi di diritto dell'Unione Europea – Parte Speciale, Il Diritto Sostanziale, Giuffrè, Milano, Itali 2004.
177. Anneli A. (2005). "EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe", Cambridge University Press, 2005.
178. Dick A. dhe Howard E. (1993) "Constitution Making in Eastern Europe, Woodrow Wilson, Washington.
179. Bartole S. (1993). "Riforme costituzionali nell'Evropa centro-orientale, Bologna, Itali..

180. Stein E. (1994). "International Law in Internal Law: Toward Internationalization of Central-Eastern European Constitutions?", *American Journal of International Law*.
181. Greco, G.(2008). "Argomenti di Diritto Amministrativo" Botimi i tretë, Giuffrè, Milano.
182. Stiernstrom M. (2003). "The Relationship Between Community Law and National Law", vol. 5.
183. Jacque, J.P. (1992), "Commentaire de la décision du Conseil constitutionnel n 92-308 DC du 9 avril 1992: Traité sur l'Union européenne 1992' (1992) *Revue Trimestrielle du Droit Européen*
184. Zingarelli, N. (1971). "Vocabolario della lingua italiana"

Literaturë në gjuhën shqipe

1. Anastasi, A. (2007). "Internacionalizimi i të drejtës Kushtetuese. Klauzolat Kushtetuese të integritit të Shqipërisë", *Revista, Polis*, Nr. 4.
2. Azizi A., (2011). "Traktati i Lisbonës dhe ndryshimet institucionale të Bashkimit Evropian", *Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca*, Tetovë.
3. Bello M., (2010). "E drejta institucionale komunitare evropiane", *MORAVA*, Tiranë.
4. Bodin J., (2007). "Sovraniteti". Tiranë: Dita 2000.
5. Borçard K.-D., (2010). "ABC-ja e të drejtës të Bashkimit Evropian", *Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian*
6. Cana, E. dhe Bana, S. (2014). "E drejta e Bashkimit Evropian". Onufri.
7. Kellermann, A. (2007). "Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë", botuar në revistën: "E drejta parlamentare dhe politikat ligjore", nr.1.
8. Milo P., (2002). "Bashkimi Evropian. Ideja, Integrimi, Identiteti dhe e ardhmja", *albPAPER*, Tiranë
9. Omari, L., (2007). "Parime dhe institucione të së drejtës publike". Elena Gjika, Tiranë.
10. Omari, L., (2011). "Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese". Elena Gjika, Tiranë.
11. Puto, A. (2004). "E drejta ndërkombëtare dhe publike", *albin*, Tiranë.

12. Puto, E. (2013). “Përshtatshmëria e normativës së huaj e në veçanti e Bashkimit Evropian në sistemin e brendshëm ligjor e administrativ shqiptar”, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Tiranë.
13. Puto, E. dhe Alimehmeti, E. (2014). “Sistemi ligjor dhe mbrojtja gjyqësore në BE”, Cikël leksionesh, Tiranë.
14. Zajmi, I. (2009). “E drejta Evropiane”, OMBRA GVG, Tiranë, Shqipëri
15. Zajmi, I. (2011). “Autonomia e zbatimit të ligjit komunitar”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, vol.1

Vendime te Gjykatave kombëtare dhe të huaja

1. Çështja 106/77, rec 629 (1978) Administrata e Financave te Shtetit kunder Simmenthal S.p.a.
2. Çështja 11/70 (1970) Internationale Handelsgesellschaft k.Einfuhr.
3. Çështja 12/86, Përmbledhja e GJED 1987, 3719.
4. Çështja 6/90 (1991) Andrea Francovich dhe Danila Bonifaci e të tjerë kundër Italisë.
5. Çështja C-285/98, Tanja Kreil kundër Gjermanisë, 2000, ECR I-69.
6. Vendim i GJED “Internationale Hnadelsgesellschaft”, 17 dhjetor 1970, nr.11/70.
7. Vendim i GJED “Rottman”, 20 mars 2010, nr.135/08
8. Vendim i GJED, 2 mars 2010, Çështja T 16/04.
9. Vendim i GJED, Bosman, 15 dhjetor 1995, nr.415/93.
10. Vendim i GJED, Costa k/ ENEL, 15 korrik 1964, nr. 6/64.
11. Vendim i GJED, Eurotunnel, 11 nëntor 1997.
12. Vendim i GJED, Factortame, 19 qershor 1990, nr.213/89.
13. Vendim i GJED, Humblet k/Belgjikës, nr.6/60.
14. Vendim i GJED, Johnston, 15 maj 1986, nr.222/84.
15. Vendim i GJED, Kobler, 30 shtator 2003, nr.24/01.
16. Vendim i GJED, Komisioni k/Greqisë, 4 korrik 2000, nr.387/97.
17. Vendim i GJED, Komisioni k/Italisë, 11 prill 1978, nr.100/77.
18. Vendim i GJED, Komisioni k/Italisë, 13 korrik 1972, nr.48/71.

19. Vendim i GJED, Komisioni k/Italisë, 24 mars 1988, nr.104/86.
20. Vendim i GJED, Komisioni k/Italisë, 17 prill 1988, nr.225/86.
21. Vendim i GJED, Lorenz, 11 dhjetor 1973.
22. Vendim i GJED, Van gend en loos, 7 shkurt 1963, nr. 26/62.
23. Vendim i GJND mbi Kanalin e Korfuzit, 1949.
24. Vendim i GJND, Çështja Lotus, 7 shtator 1927, nr.10.
25. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, Solange I, 29 maj 1974.
26. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, Solange II, 22 dhjetor 1986.
27. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane, Frontini, 18 dhjetor 1973.
28. Vendimi “Vabre” i Gjykatës Franceze të Kasacionit, 20 tetor 1989.
29. Vendimi i 17 Dhjetorit 1970, SpA SACE v Finance Minister of the Italian Republic, çështja 33/70.
30. Vendimi i 19 Janarit 1982, Ursula Becker kundër Inanzamt Munster-Innenstadt, çështja 8/81, paragrafi 24.
31. Vendimi i 26 Shkurtit, M. H. Marshall kundër Southampton dhe South-West Hampshire area Health Authority , çështja 152/84.
32. Vendimi Nr. 11/92 (III.5) AB Hatarozat No. 23, datë 5 Mars 1992, i cituar në Pogany I., “Constitutional Reforming Central and Eastern Europe: Hungary’s Transition to Democracy”, International and Comparative Law Quarterly, 1993.
33. Vendimi nr.92–308 DC, i datës 9 Prill 1992, i publikuar në www.conseil-constitutionnel.fr.

Akte të veçanta

1. Opinion i GJED, 15 nëntor 1994
2. Opinion i GJED, 4 tetor 1979
3. Raporti i Komisionit Evropian, 27 tetor 1992.
4. Sarkozy N. - discours de Bruxelles, 8 septembre 2006.